



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË**



DEPARTAMENTI I SË DREJTËS PENALE

**STUDIM I PAVLEFSHMËRISË SË AKTEVE NË
SISTEMIN TONË TË PROCEDURËS PENALE
DISERTACION PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR I SHKENCAVE”**

UDHËHEQËSI SHKENCOR

KANDIDATI

PROF.DR. VASILIKA HYSI

HENRIK LIGORI

TIRANË 2015

PASQYRA E LËNDËS

HYRJE	4
KREU 1. SISTEMET E PAVLEFSHMËRISË SË AKTEVE PROCEDURALE PENALE	
1.1 Formalizmi dhe sistemet e procedurës penale	6
1.2 Aktet procedurale penale dhe veset e tyre në të drejtën pozitive dhe në doktrinën shqiptare. Vështrim historik	6
1.3 Kuptimi i institutit të pavlefshmërisë së akteve në të drejtën pozitive dhe në doktrinën e huaj	9
1.3.1 <i>Procedura penale e Francës</i>	10
1.3.2 <i>Procedura penale e Italisë</i>	15
1.3.3 <i>Procedura penale e Gjermanisë</i>	20
1.3.4 <i>Procedura penale e Spanjës</i>	20
1.3.5 <i>Procedura penale e Rumanisë</i>	21
KREU 2. SISTEMI I PAVLEFSHMËRISË SË AKTEVE SIPAS KODIT TË PROCEDURËS PENALE TË VITIT 1995. PAVLEFSHMËRIA ABSOLUTE E AKTEVE	
2.1 Parimet e ndërtimit të sistemit	23
2.2 Pavlefshmëria absolute	29
2.2.1 <i>Rastet që lidhen me gjyqtarin</i>	30
2.2.2 <i>Rastet që lidhen me prokurorin</i>	50
2.2.3 <i>Rastet që lidhen me të pandehurin dhe mbrojtësin e tij</i>	60
2.3 Kuptimi i mosqënies juridike të aktit	75
KREU 3. PAVLEFSHMËRIA RELATIVE E AKTEVE	
3.1 Kuptimi i pavlefshmërisë relative të akteve	78
3.2 Mënyra e ngritjes	79
3.3 Afatet	80
3.4 Mekanizmi i korrigjimit	83
3.5 Zgjerimi i pavlefshmërisë së akteve dhe kuptimi i pavlefshmërisë së prejardhur. Ribërja e akteve dhe kthimi prapa i procedimit.	85
3.5.1 <i>Shtirja e pasojave dhe pavlefshmëria e prejardhur</i>	85
3.5.2 <i>Ribërja e akteve të pavlefshme. Regresi i procedimit</i>	88
3.6 Disa probleme të praktikës gjyqësore për pavlefshmërinë relative	89
3.6.1 <i>Pavlefshmëria e procesverbalit</i>	89
3.6.2 <i>Pavlefshmëria në temën e masave të sigurimit personal</i>	91
3.6.3 <i>Pavlefshmëria e vendimit</i>	92
3.6.4 <i>Pavlefshmëria relative dhe gjykimi i shkurtuar</i>	95

KREU 4. PAPËRDORSHMËRIA E PROVAVE TË MARRA NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN

4.1 Provat jotipike dhe provat e paligjshme	98
4.2 Kuptimi dhe format e papërdorshmërisë	100
4.3 Ngritja e papërdorshmërisë në fazën e hetimeve paraprake	102
4.4 Papërdorshmëria dhe praktika gjyqësore	102
4.4.1 Problemi i papërdorshmërisë së dëshmisë së pavlefshme (nenet 158, 154 të KPP)	103
4.4.2 Problemi i vlerës provuese të akteve të marra me anëne letërporosisë drejtuar autoriteteve të huaja gjyqësore (nenet 509-511 të KPP)	107
4.4.3 Problemi i papërdorshmërisë së provës në rastin egjykimit të shkurtuar (nenet 403-406 të KPP)	111
4.4.4 Problemi i përgjimit të telekomunikimeve dhe papërdorshmëria për shkak të çënimit të sovranitetit	112
4.4.5 Problemi i papërdorshmërisë së akteve të kryera pas përfundimit të afatit të hetimeve paraprake (neni 324.4 i KPP)	114
4.4.6 Problemi i regjistrimit të komunikimeve nga njëri prej të pranishmëve (inter praesentes)	116
4.4.7 Mbi disa probleme të tjera të praktikës gjyqësore lidhur me papërdorshmërinë e provave	118
4.5 Mbi “papërdorshmërinë e prejardhur” dhe praktikën gjyqësore.	
Profile krahasuese	122
4.5.1 Për praktikën tonë gjyqësore lidhur me provat e Sekuestruara si pasojë e një akti të kryer në kundërshtim me ligjin	122
4.5.2 Për praktikën e huaj gjyqësore lidhur me provat e sekuestruara si pasojë e një akti të kryer në kundërshtim me ligjin	124
4.5.2.a Sistemi i SHBA-ve	124
4.5.2.b Sistemi anglez	127
4.5.2.c Sistemi gjerman	129
4.5.2.ç Sistemi spanjoll	129
4.5.2.d Sistemi francez	131
4.5.2.e Sistemi italian	132
4.5.3 Disa përfundime	134
PËRFUNDIME DHE SUGJERIME	136
BIBLIOGRAFIA	140

HYRJE

E drejta procedurale penale është, në thelb, e drejta e formës së procesit. Ajo përcakton rendin dhe rregullat e kryerjes së akteve të caktuara, nga çasti i kryerjes së një veprë penale deri sa vendimi i dënimit të autorit të marrë formë përfundimtare dhe të vihet në ekzekutim. Por, forma e procesit lidhet pazgjidhshmërisht me thelbin e tij, sidomos me nevojën për të siguruar drejtëpeshimin e duhur, midis interesave në lojë: mbrojtjes së shoqërisë nga krimi përmes zbatimit të ligjit penal dhe garantimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Forma e akteve të procedurës penale dhe pavlefshmëria e tyre është nga temat më të rëndësishme dhe më delikate që vihen në diskutim në çdo proces penal. Deri në hyrjen në fuqi të Kodit të vitit 1995, e drejta jonë e procedurës penale ishte pjesë e traditës së krijuar në një sistem thellësisht inkuizitor, ku interesi i shtetit për të ndëshkuar krimin mbizotëronte hapur mbi nevojën për respektimin e lirive dhe dinjitetit të qytetarëve. Praktika gjyqësore gati 20-vjeçare e zbatimit të Kodit të ri, me gjithë përparimet dhe ndihmën e pamohueshme në drejtim të orientimit për zbatimin e drejtë të instituteve të reja, për fat të keq, vazhdon të shfaqë edhe paqartësi apo dykuptimësi të interpretimit të normave procedurale, sidomos lidhur me institutin e pavlefshmërisë së akteve dhe papërdorshmërisë së provave të marra *contra legem*.

Është kjo arsyeja themelore që zgjodhëm për të trajtuar këtë temë, padyshim ndër më të delikatet në lëndë të procedurës dhe, natyrisht, tepër e gjerë për t'u studjuar në mënyrë shteruese brenda kuadrit të një disertacioni.

Me ndihmën e Prof.Dr.Vasilika Hysit, në cilësinë e udhëheqësit shkencor, besojmë se kemi bërë një përpjekje të kujdesshme për studimin e pavlefshmërisë së formës së procesit penal dhe ndikimin e saj në ligjshmërinë e provave. Pikërisht, dikotomisë akt i pavlefshëm – provë e paligjshme i është kushtuar një vëmendje e veçantë gjatë këtij studimi, në përqasje me doktrinën e huaj dhe me jurisprudencën e gjykatave, në radhë të parë, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Tiranë, dhjetor 2015

KREU 1

SISTEMET E PAVLEFSHMËRISË SË AKTEVE PROCEDURALE PENALE

§ 1.1 Formalizmi dhe sistemet e procedurës penale

Historia e sistemeve të procedurës penale njihet dy modele abstrakte: sistemin akuzator dhe sistemin inkuizitor të procedurës. Sistemi akuzator dihet që karakterizohet nga dialektika procesuale midis palëve me interesa të kundërta (*akuzës dhe të akuzuarit*), konflikti zgjidhet nga gjyqtari që qëndron mbi palët, procesi është publik dhe me gojë dhe, gjatë procesit protagonistëve u sigurohet e ashtuquajtura “*barazia e armëve*”. Përkundër tij, sistemi inkuizitor nuk dallon rolin e akuzuesit nga ai i gjyqtarit, e vërteta synohet të arrihet në mënyrë autoritare, mbizotëron procesi sekret me shkrim dhe akuza fiton epërsi të dukshme në raport me mbrojtjen. Përmendëm që skemat e mësipërme janë teorike, në rënde të ndryshme juridikë janë zbatuar dhe vazhdojnë të zbatohen sistemet e përziera. Vartësisht nga traditat dhe sistemi i vlerave të pranuar nga shoqëria, në këto sisteme mbizotërojnë elementët akuzatorë ose inkuizitorë.

Në çdo sistem diskutohet i ashtuquajtura formalizëm i akteve procedurale, i cili nuk është një term i zhveshur nga kuptimi, por synon të sigurojë zbatimin e parimit të barazisë së shtetasve para ligjit penal. Pranohet se respekti i formës dhe sanksionet procedurale të parashikuara për shkeljet e saj janë garanci për zhvillimin e një procesi demokratik. Por, nga ana tjetër, zgjerimi i mundësive për goditjen e akteve për pavlefshmëri dhe pranimi i formave të pakorrigjueshme të saj, shkaktojnë zgjatje të procesit, i cili është i dëmshëm jo vetëm për të akuzuarin e pafajshëm (*madje, edhe për atë fajtor*), por edhe për shtetasit që shpresojnë dhe besojnë në efektivitetin e drejtësisë penale.

Pra, formalizmi i tepërt e vonon shumë zgjidhjen e procesit dhe vjen ndesh me parimin e Konventës Evropiane e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹, ndërkohë që thjeshtëzimi i formave, tipike për procedurat inkuizitore, hap rrugën për procese të parregullta dhe rrit mundësinë e gabimit gjyqësor.

Gjetja e drejtpeshimit ideal mes interesit për efektivitet të drejtësisë penale dhe sigurimit të vërtetë të garancive për mbrojtjen e shtetasve nga abuzimi me procesin, është shumë e vështirë. Në vijim, modelet e huaja dhe sistemi ynë i pavlefshmërive të formës do të studjohen edhe nga pikëvështrimi i mundësive për ruajtjen e këtij drejtpeshimi.

§ 1.2 Aktet procedurale penale dhe veset e tyre në të drejtën pozitive dhe në doktrinën shqiptare. Vështrim historik

Para Çlirimit në Shqipëri ishte në veprim procedura penale otomane, e cila i jepte formën një sistemi të përzier sipas modelit francez, por me elementë të qëndrueshëm të natyrës inkuizitore. Në Librat dhe Kaptinat e këtij Kodi nuk gjen një sistem të përgjithshëm të pavlefshmërive të akteve, por, sidoqoftë, në dispozita të ndryshme të tij sanksionohen

¹ KEDNJ-ja ka hyrë në fuqi më 3.9.1953 dhe është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996: Neni 6. E drejta për një proces të rregullt - 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm... [theksimi ynë]

pavlefshmëritë e akteve procedurale të njohura me termin nulitete². Kështu, neni 136 sanksiononte pavlefshmërinë e aktit të thirrjes në gjyq, kurse neni 143 seancën gjyqësore publike³. Dispozita të veçanta sanksiononin me pavlefshmëri shkeljen e rregullave për betimin dhe verbalizimin e gjeneraliteteve dhe thëniet të dëshmitarit (neni 145), paralajmërimin e afërmeve të pandehurit për mungesën e detyrimit për të dëshmuar (neni 146), papajtueshmërinë me funksionin e gjyqtarit për shkak të pjesëmarrjes në procedim (neni 200), rregullat e caktimit të përkthyesit (neni 286⁴), etj. Shumë interesante është dispozita që sanksionon me pavlefshmëri mungesën e arsytimit të vendimit përfundimtar⁵. Ligji otoman i procedurës në fuqi në Shqipëri rregullonte “kërkimin për nulitet” vetëm në rastet e vendimit të dërgimit të çështjes në gjyq (*pra, jo në fazën e mëparshme hetimore*) dhe vetëm në katër raste taksative⁶.

Pa dashur të zgjatemi më tepër në analizën e dispozitave të ligjit otoman, veprues në Shqipëri për një periudhë të kufizuar kohe, mund të përfundojmë se është zbatuar një procedurë garantuese, e ngjashme me simotrat europiane edhe për faktin se kjo procedurë mbështetej në institutet e ligjit francez (*shih në vijim § 1.3.1*).

Pas Çlirimit, legjislacioni i vjetër procedural penal ndryshoi katërcipërisht, për fat të keq, në drejtim të asgjësimit të të gjitha garancive të formës në favor të personit të akuzuar. Disa autorë e përligjin këtë me arsytimin se “... në ato kushte ishte e pamundur të përpunoheshin në tërësi dhe plotësisht rregullat e procedimit, nuk kishte mundësi të përpunoheshin të gjitha hollësitë mbi mënyrën e administrimit të drejtësisë.”⁷ Kjo sigurisht ka qenë një arsye, por, sikurse shtjellohet në vijim të shkrimit të cituar, kushtet e kohës kërkonin që “... procedura të ishte “e shpejtë, pa hollësira, por e plotë”⁸. Kështu, ligja nr. 61, datë 17.5.1945 e Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar e la pa fuqi legjislacionin e vjetër, kurse në dekretin nr. 392, datë 25.1.1947 theksohej qartë: “... Me një rregullim të tillë ka mundësi që gjykatat të japin drejtësi pa u bazuar në formalizma antipopullore, pa marrë parasysh ato dispozita që nuk kanë rëndësi për konstatimin e së vërtetës ...”.

Kjo mënyrë procedimi “e shpejtë dhe pa hollësira” sigurisht që ishte në dëm të të akuzuarve dhe në interes të grupimit fitues të luftës për të asgjësuar kundërshtarët politikë. E veshur me frazeologji revolucionare dhe e përligjur nga “*interesat e popullit*”, procedura e re antiformaliste i hapi rrugën arbitraritetit të ndëshkimeve penale, pa u siguruar të akuzuarve

² Procedura penale otomane në fuqi në Shqipëri (*përkthim*), kopje e shaptilografuar, Biblioteka Kombëtare Tiranë, fondi S123/10C.

³ Neni 143. – Gjykimi i çdo çështje do të jetë publik, përndryshe asht nul.

⁴ Neni 286. – Kur i pandehuni ose dëshmitarët ose njëri prej tyre nuk flasin po një gjuhë, Kryetari do të emnojë kryesisht, **përndryshe veprimi asht nul**, një interpret që të ketë së paku njëzet e një vjeç dhe, **po me sanksion nuliteti** do ta betojë se do përkthejë me besnikëri fjalimet që do të bëhen në mes t’atyne që nuk flasin po atë gjuhë [theksimi ynë].

⁵ Neni 153. - Çdo vendim definitiv dënimi do të jetë arsytuar dhe, përmbajtja e ligjës s’aplikuar do të reshtohet, **përndryshe asht nul**. Do të përmendet në se asht dhanë në formë të preme ose me të drejtë kundërshtimi ose diktimi [theksimi ynë].

⁶ Neni 254. – Kërkimi për nulitet nuk mund të paraqitet veçse kundër vendimeve të dërgimit në gjyq dhe në katër rastet që vijojnë:

1. për inkompetencë të gjykatës;
2. kur vepra nuk asht cilësuarë si krim prej ligjës;
3. kur e drejta botnore nuk asht dëgjuarë;
4. kur vendimi nuk asht dhanë prej aq gjyqtarëve sa janë caktue prej ligjës.

⁷ Gjika Grigor, “*Ligjeshmëria dhe forma procedurale – penale*”, Drejtësia Popullore, Nr. 6, nëndor-dhjetor 1960, faqe 6.

⁸ *Ibidem*.

mundësinë elementare të mbrojtjes së interesave të tyre. Nuk mund të ishte një rast i veçuar shqiptar; historia e qytetërimit tregon se thjeshtimi i procedurave ka qenë metoda e parapëlqyer e forcave të ardhura në pushtet pas situatash revolucionare, me qëllimin për të konsoliduar pozitat e tyre.

Pas kthimit të normalitetit në jetën e vendit, me ligjën nr. 1650, datë 30 Mars 1953 u miratua Kodi i ri i Procedurës Penale (*hyri në fuqi më 1 Qershor 1953*), i cili ndër vite pësoi disa ndryshime. Ndonëse procedura e re i kishte braktisur prej vitesh termat “*pavlefshmëri*” apo “*nulitet*” i akteve, në tekstin e Kodit të ri shfaqet nocioni “*shkelje e rregullave të procedurës*” që, për kushtet e kohës, mund të quhet se ishte një zhvillim pozitiv. Madje, edhe doktrina, ndoshta e inkurajuar nga fryma liberale e viteve '50, i mëshonte rëndësisë së respektimit të rregullave të formës së procesit penal: “*Respektimi i formës siguron zbatimin e garancive procedurale dhe zhvillimin normal të procedimit*”, kurse largimi nga forma e caktuar nga ligja “*... do të çonte në kufizimin e paligjshëm dhe të rrezikshëm të të drejtave të pandehurit, në kufizimin arbitrar të garancive procedurale*”⁹.

Kodi i ri siguronte disa garanci, ndonëse të kufizuara, qysh në fazën e hetimeve paraprake, edhe pse ankimi para gjyqtarit nuk ishte në konceptin e këtij ligji. Por, sidoqoftë, brenda një afati prej pesë ditësh, lejohej ankimi para prokurorit kundër veprimeve të hetuesit që “*shkelin ose kufizojnë*” të drejtat e palëve. Ky afat binte dhe ankimi mund të paraqitej në çdo kohë, nëqoftëse bëhej fjalë për kundërshtim të masës së sigurimit, për zvarritje të veprimeve hetimore dhe për veprime të paligjshme të hetuesit¹⁰.

Nga ana tjetër, Kodi sanksiononte me prishje të vendimit nga gjykata e shkallës së dytë edhe rastet e shkeljes së rëndë të rregullave të procedurës¹¹. Neni 316 synonte, pa shumë sukses, të sqaronte kuptimin e termit “*shkelje me rëndësi e rregullave të procedurës*”¹², por përcaktonte në mënyrë taksative edhe rastet më të rënda, kur shkeljet e kryera shkaktonin detyrimisht *ipso jure* prishjen e vendimit. Të tilla ishin: mospërbërja e rregullt e gjykatës, gjykimi i të pandehurit në mungesë kur nuk lejohej nga ligja, gjykimi pa praninë e mbrojtësit kur ligji e parashikonte si të detyrueshme, moskomunikimi i aktakuzës të pandehurit, kur dhunohej fshehtësia e dhomës së këshillimit dhe kur vendimi nuk ishte nënshkruar nga gjyqtarët. Ndër rastet taksative të sipërtreguara përfshihej, pa shumë kuptim, edhe rasti kur gjykata nuk vendoste pushimin e çështjes, edhe pse ndodhej para rasteve të parashikuara nga ligji (*paragrafi 2*); në këtë rast kemi të bëjmë me gabim në gjykim që mund dhe duhej të kundërshtohej para gjykatës më të lartë.

Doktrina e kohës, duke komentuar sanksionet për shkeljen e rregullave të formës, me të drejtë theksonte se “*... shkelja e mospërfillja e formës procedurale penale, është shkelje e mospërfillje e garancive themelore për shoqërinë dhe qytetarët.*”¹³

Duke përmbledhur sa parashtruam mund të përfundojmë se miratimi i Kodit të Procedurës Penale në vitin 1953 ishte një hap pozitiv drejt normalizimit të legjislacionit procedural penal. Ndonëse vepronin brenda kuadrit të një sistemi tipik inkuizitor, rregullat e

⁹ *Ibidem*, faqe 7 dhe 9.

¹⁰ Kodi i Procedurës Penale i R.P. të Shqipërisë, Botim i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë 1959, neni 205.

¹¹ Neni 314. – Shkaqet për prishjen e vendimit janë: ... 2) shkelja e rëndë e rregullave të procedurës;

¹² Neni 316. – Shkelje me rëndësi të rregullave të procedurës janë shkeljet e neneve të këtij Kodi, të cilat u hequr ose u kufizuar palëve të drejtat e tyre të garantuara me ligje, në gjykimin e çështjes ose në ndonjë mënyrë tjetër e kanë penguar gjykatën që të gjykojë çështjen nga të gjitha anët dhe kanë influencuar ose mund të influencojnë në dhënie të një vendimi të drejtë.

¹³ Gjika Grigor, «*Respektimi i normave procedurale penale, kërkesë themelore e drejtësisë sonë socialiste*», Drejtësia Popullore, Nr. 2, prill – qershor 1976, faqe 21.

formës dhe sanksionimi i shkeljes së rëndë të tyre me prishjen e vendimit, ndihmuan për sigurimin e disa garancive elementare për të pandehurin në procesin penal.

Kodi i procedurës penale i miratuar me ligjin Nr. 6069, datë 25.12.1979, nuk solli ndonjë ndryshim thelbësor përsa i përket garancive të procesit penal. U thjeshtëzuan më tej rregullat e formës, gati duke përgjysmuar numrin e neneve (*numri i neneve u tkurr nga 364 në 200*). Ky Kod u ndërtua sipas të njëjtave parime, duke u kujdesur për të ruajtur disa garanci minimale dhe elementare të formës, të cilat zeroheshin nga mungesa e hapësirave të lirisë brenda një sistemi rregullash inkuizitore, ku institucioni i mbrojtjes ishte abroguar prej vitesh, ku procesi hetimor ishte tërësisht sekret dhe ku nuk dallohej qartë roli i akuzuesit nga ai i gjyqtarit. Ky i fundit nuk mund të ishte garant i barazisë së shtetasve para ligjit penal, por, në thelb, një gjyqtar tipik inkuizitor, që frymëzohej dhe vepronte në bazë të parimit të kërimit autoritar të së vërtetës. Shënojmë se u ruajt e drejta e ankimit ndaj veprimeve të hetuesit (*nenet 107 – 108*)¹⁴, parashikohej kthimi nga gjykata i çështjes në Hetuesi kur gjatë hetimit ishin shkelur “... rregullat procedurale që garantojnë të drejtat e të pandehurit” (*neni 153.2*). Përsëri ishte e mundur që gjykata e shkallës së dytë ta prishte vendimin për “shkelje të rëndë të rregullave procedurale”, veprim i cili ishte i detyrueshëm në rastet taksative të parashikuara nga ligji (*neni 173*).

Mungesa e garancive të individit në procesin penal, që funksiononte në bazë të ligjit procedural të vitit 1979, u synua të plotësohej me disa ndërhyrje ligjvënëse të kryera pas rënies së regjimit, në vitet 1991-1992. Këto reforma sollën disa përmirësime në sistemin e procedurës, një pjesë e të cilave mbetën vetëm në letër (*për shembull, e drejta e gjyqtarit për të kontrolluar arrestimet*). Por, ato nuk mundën të preknin thelbin inkuizitor të modelit dhe, natyrisht nuk mund të ndryshonin dot rregullat e sistemit lidhur me patologjinë e akteve procedurale. Kjo nevojë u përmbush me Kodin e ri, i miratuar me ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 (*në fuqi nga data 1 gusht 1995*). Në vijim të këtij punimi do të studjohet, në veçanti, instituti i pavlefshmërisë së akteve procedurale penale sipas këtij Kodi.

§ 1.3 Kuptimi i institutit të pavlefshmërisë së akteve në të drejtën pozitive dhe në doktrinën e huaj

Sistemet e procedurës penale të së drejtës kontinentale mbështeten në një parim themelor: nëqoftëse për kryerjen e një akti ligji parashikon një formalitet, ai duhet të respektohet. Mosrespektimi i kërkesave formale të ligjit përbën shkak për sanksione. Këto të fundit, jo gjithmonë dhe detyrimisht duhet të jenë të natyrës procedurale; ligjvënësi mund të caktojë edhe sanksione të natyrës financiare apo disiplinore. Por, gjatë kryerjes së akteve procedurale penale mund të vërehen edhe parregullsi të tilla, të cilat për shkak të rëndësisë së tyre dhe dëmit që mund t'i kenë shkaktuar interesave të individit dhe të drejtësisë, mund të përbëjnë elementët e një figure të caktuar vepre penale.

Sistemi teorik i njohur si sistemi i përzier i procedurës penale, për herë të parë, mori formë në Francë me Kodin e miratuar në vitin 1808¹⁵. Sipas këtij modeli u konceptuan dhe u ndërtuan të gjitha Kodet moderne të procedurës në Evropën kontinentale, pas pohimit të vlerave të lirisë me fitoren dhe konsolidimin e sistemit kapitalist të tregut të lirë. Ligjet, doktrina dhe jurisprudenca franceze, natyrisht, ndikuan ndjeshëm në përpunimin e teorisë së përgjithshme të pavlefshmërisë së akteve procedurale penale, edhe në nivel evropian. Por, duhet theksuar se kjo

¹⁴ Kodi i Procedurës Penale i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 6069, datë 25.12.1979, që hyri në fuqi më 1 prill 1980.

¹⁵ Code d'Instruction Criminelle, hyri në fuqi në vitin 1811.

teori u përpunua, u zhvillua dhe fitoi tipare të qenësishme dhe të veçanta në doktrinën italiane. Mendimi juridik tepër i rafinuar dhe i formuar ndër vite u mishërua nga ligjvënësi në Kodin e Procedurës Penale të vitit 1989¹⁶. Në këtë këndvështrim, mendojmë se është e domosdoshme që sistemi i pavlefshmërisë së akteve procedurale penale të studjohet duke u mbështetur në institutet e përpunuara nga këto dy sisteme themelore, varësisht me ndryshimet që kanë pësuar në kohë. Gjithsesi, në interes të këtij punimi, në vijim do të këqyren edhe normat e vendosura në disa Kode të tjera evropiane.

§ 1.3.1 Procedura penale e Francës

Sistemi i procedurës penale në Francë mbështetet në Kodin e Procedurës Penale (*Code de Procédure Pénale*), miratuar më 23 dhjetor 1958, në fuqi nga data 2 mars 1959. Ndër vite, ai u është nënshtruar një sërë ndërhyrjesh ligjvënëse që kanë synuar përsosjen e sistemit, sidomos në planin e forcimit të garancive të individit në procesin penal. Disa ndryshime interesante kanë pësuar edhe dispozitat lidhur me pavlefshmërinë e akteve, sidomos me reformat e kryera në vitet 1975 dhe 1993¹⁷.

Pavlefshmëritë e akteve procedurale penale në të drejtën pozitive franceze përcaktohen me termin e përgjithshëm **nylitete** (*nullités*). Nga ky përcaktim besojmë se e ka origjinën etimologjike edhe shprehja që përdoret shpesh në doktrinën dhe jurisprudencën tonë, referuar akteve procedurale të pavlefshme si *akte nul*. E drejta dhe doktrina i grupon pavlefshmëritë sipas dy lloj klasifikimesh thelbësore¹⁸:

- a) Në pikëpamje të pranisë në tekstin e Kodit, pavlefshmëritë ndahen në *pavlefshmëri tekstuale* dhe në *pavlefshmëri virtuale* (ndryshe quhen edhe *substanciale, thelbësore*);
- b) Në pikëpamje përmbajtjes së interesave që çënohen, pavlefshmëritë ndahen në *pavlefshmëri që çënojnë interesa publike* (*nullités d'ordre public*) dhe *pavlefshmëri që çënojnë interesa private* (*nullités d'intérêt privé*).

Ndarja e parë është krejt e qartë dhe tregon se ligjvënësi francez nuk ka dashur të pranojë një regjim taksativiteti të pavlefshmërisë së akteve. Pavlefshmëritë tekstuale janë vetëm ato të parashikuara shprehimisht nga ligji, nga teksti i Kodit, ndërkohë që pavlefshmëritë virtuale nuk parashikohen në mënyrë të shprehur, por ligjvënësi e lë në çmimin e gjyqtarit që të vlerësojë, nëse shkelja e rregullave mbi formën është apo jo e një rëndësie të tillë që të diktojë një procedurë anulimi të aktit. Pra, sistemi francez nuk përcakton hipotezat e pavlefshmërive të natyrës virtuale, duke thirrur në lojë gjyqtarin rast pas rasti, në varësi të rëndësisë së shkeljes së kryer dhe provës se ajo ka ndikuar në një paragjykim efektiv të vlerës së aktit. Gjykojmë se një sistem i tillë mund të jetë i prekshëm nga subjektivizmi i gjyqtarit, i cili duhet të peshojë me shumë objektivitet rëndësinë e shkeljes së formës dhe ndikimin e saj në pasojat që prodhon akti.

¹⁶ Codice di Procedura Penale; Kodi i ri italian i procedurës penale u miratua nga Parlamenti më 22 shtator 1988 dhe hyri në fuqi më 24 tetor 1989. Miratimit të tij i parapriu një debat i gjërë juridik, i cili zgjati për gati 20 vjet.

¹⁷ Gjatë këtij viti u kryhen dy ndërhyrje të njëpasnjëshme në temën e pavlefshmërisë së akteve, përkatësisht me ligjet e 4 janarit dhe të 24 gushtit.

¹⁸ Rassat Michèle-Laure, *Procédure pénale*, 2^e édition refondue, mars 1995, PUF, Presses Universitaires de France, faqe 664.

Sigurisht, vlerësime të kësaj natyre shpeshherë janë mjaft të vështira dhe në drejtim të tyre mund të orientojë vetëm një doktrinë cilësore dhe një jurisprudencë shumë e drejtpeshuar.

Sipas ndarjes së dytë, pavlefshmëritë konsiderohen të interesit publik kur ato çënojnë parime të rëndësishme të së drejtës (*për shembull, çënimi i rregullave të juridiksionit*). Këto pavlefshmëri mund të ngrihen kryesisht, pa kërkesën e palës (quhen ndryshe *nullités sans grief*). Pavlefshmëritë quhen të interesit privat kur ato çënojnë të drejtat e një pale në proces (*ku përfshihet, para së gjithash, çënimi i të drejtës së mbrojtjes*), ato duhet të ngrihen me kërkesë të palës (quhen ndryshe *nullités à grief*). Ky klasifikim krijon paqartësi thelbësore dhe, si i tillë, është objekt kritikash shumë interesante¹⁹. Kështu, çënimi i të drejtës së mbrojtjes për mosrespektim të formës vërtet prek një interes privat, por ai është njëherësh edhe interes publik. Sikurse theksohet në dokumente të rëndësishme, edhe me vlerë ndërkombëtare, e drejta e mbrojtjes është një parim themelor i së drejtës në sistemet demokratike të procedurës penale. Kodi i vitit 1959 parashikonte të drejtën e palëve për të hequr dorë nga ngritja e një pavlefshmërie për mosrespektim të formaliteteve të marrjes në pyetje (*neni 170*) apo të kontrollimeve dhe sekuestrimeve (*neni 59, par. 3*), duke i konsideruar si pavlefshmëri që preknin interesa private, ndërkohë që duket qartë se ato çënojnë norma që lidhen me parimet e një procesi penal demokratik, pra, në thelb, prekin interesa publike. Mundësia e ngritjes së pavlefshmërive të interesit privat ishte shumë elastike, palët gjithmonë mund të gjenin një arsye për të kërkuar anulimin e akteve procedurale, fakt që në këndvështrimin e studjuesve përbënte një nga të metat thelbësore të sistemit francez të pavlefshmërisë së akteve. Kështu, drejtpeshimi i nevojshëm midis garancive të formës dhe kohëzgjatjes së procesit, anonte nga ky i fundit, ndaj lipsej një ndërhyrje reformuese e natyrës ligjvënëse.

Ligjvënësi ndërhyri me ligjin e 6 gushtit 1975, duke ndryshuar formulimin e nenit 802 të Kodit. U pranua parimi që për të ngritur një pavlefshmëri pala duhet të provonte çënimin e një interesi thelbësor. Kështu, sipas formulimit të ri, çdo juridiksion mund të shprehej për pavlefshmërinë vetëm kur ajo kishte sjellë si pasojë çënimin e interesave të palës përkatëse në proces. Me këtë formulim, drejtpeshimi i interesave u zhvendos dukshëm në favor të shmangjes së mundësive për të vonuar përfundimin e procesit brenda një afati të arsyeshëm, por ai nuk kënaqi dot edhe interesat e mbrojtjes për respektimin e garancive të formës. Përkundër këtij ndryshimi, jurisprudenca e Gjykatës së Kasacionit i qëndroi interpretimit tradicional që pavlefshmëritë thelbësore të interesit publik mund të ngriheshin edhe kryesisht, pa qenë nevoja e argumentimit të interesit të çënuar të palës.

Me ligjin e 4 janarit 1993, ligjvënësi synoi të ndërhynte për të qartësuar sistemin e pavlefshmërive, duke ndërtuar norma procedurale që studjuesit i konsiderojnë të arsyeshme. Kjo ndërhyrje ligjvënëse mëtoi të ndërtonte një sistem më racional, thelbi i të cilit mbështetej në parashikimet e mëposhtme ligjore:

- Pavlefshmëritë e parashikuara shprehimisht nga ligji (*pavlefshmëri tekstuale*) konsideroheshin *ipso facto* pavlefshmëri të interesit publik dhe mund të ngriheshin edhe kryesisht, pa qenë nevoja e paraqitjes së një kërkesë nga palët. Kështu, neni 171, i rifomular, parashikonte njëzet dispozita, shkelja e të cilave sanksionohet me pavlefshmëri automatike;
- Për të konstatuar pavlefshmëritë tekstuale nuk kërkohej detyrimisht paraqitja e një kërkesë, duke rifomular nenin 802 të Kodit;

¹⁹ Guinchard Serge, Buisson Jacques, Procédure pénale, 4^e édition, 2008, Litec, faqe 1009 – 1010.

- U shtua neni 172 i Kodit i cili parashikonte se pavlefshmëri do të kishte edhe në rastet kur shkelja e një formaliteti thelbësor (*substantial*) sillte si pasojë cënimin e interesave të një pale e cila, nga ana e saj, duhet ta provonte këtë.

Pra, ligji i 4 janarit 1993, në thelb, synonte ndërtimin e një sistemi dypolar pavlefshmëri: pavlefshmëritë tekstuale të natyrës absolute dhe pavlefshmëritë substanciale ose virtuale të natyrës relative, sa herë pala ishte në gjendje të provonte një interes të cënuar nga shkelja e rregullave për formën e aktit procedural. Ky sistem që qartësonte regjimin e pavlefshmërisë së akteve, nxirrte në pah dy mangësi kryesore²⁰:

së pari, shkelja e njëres prej dispozitave të cituara në nenin 171 passillte automatikisht pavlefshmëri, edhe pse pasojat mund të ishin të parëndësishme;

së dyti, disa nga pavlefshmëritë tekstuale të nenit 171 nuk ishin të natyrës së interesit publik.

Të metat e sipërpërmendura dëmtonin operativitetin e sistemit, duke lejuar ngritjen e pavlefshmërisë së akteve pa marrë parasysh rëndësinë e shkeljes së kryer dhe pasojën e papërfillshme të shkaktuar prej saj. Pra, drejtpeshimi i sistemit kalonte përsëri në favor të garancive të formës. Për këto shkaqe, ky sistem e pati jetën shumë të shkurtër duke u ndryshuar, pas vetëm tetë muajsh, me ligjin e datës 24 gusht 1993. Këto ndryshime i dhanë formë sistemit të pavlefshmërive ende në fuqi në procedurën penale franceze.

Ndryshimet e propozuara nga ligji i 24 gushtit 1993 ishin një rikthim në parimet e mëparshme që ligjvënësi pati synuar t'i reformonte, duke vendosur këto rregulla:

- Shfuqizimin e listës shteruese të njëzet pavlefshmërive tekstuale të parashikuara në nenin 171 të Kodit. Pavlefshmëritë tekstuale tashmë gjenden të shpërndara në dispozita të ndryshme të Kodit, por pa përcaktuar shprehimisht natyrën e tyre. Më të rëndësishmet janë pavlefshmëritë që lidhen me kontrollimet (*neni 59, par. 2*), verifikimin e identitetit (*neni 78-3, par. i fundit*), përgjimet telefonike të deputetëve dhe avokatëve (*neni 100-7, par. 3*)²¹, etj.;

- Riformulimin e nenit 171 (*sipas përmbajtjes të nenit 172 të mëparshëm*), si vijon: “*Ka pavlefshmëri kur shkelja e një formaliteti thelbësor të parashikuar nga një dispozitë e këtij Kodi ose e çdo dispozite tjetër të procedurës penale ka cënuar interesat e palës përkatëse.*”²²;

- Riformulimi i nenit 172 u lejon palëve që të heqin dorë nga ngritja e një shkakut pavlefshmërie, përfshi edhe pavlefshmëritë thelbësore, me kushtin që kjo të bëhet në mënyrë të shprehur dhe vetëm në prani të avokatit të thirrur sipas rregullave që normon ligji²³;

²⁰ Guinchard Serge, Buisson Jacques, *ibidem*, faqe 1010.

²¹ Në vijim, citimi i dispozitave dhe shqipërimi i përmbajtjes së tyre i referohen tekstit Code de Procédure Pénale, 47^e édition, Dalloz, 2006.

²² Article 171. - Il y a nullité lorsque la méconnaissance d'une formalité substantielle prévue par une disposition du présent code ou toute autre disposition de procédure pénale a porté atteinte aux intérêts de la partie qu'elle concerne.

²³ Article 172. - La partie envers laquelle une formalité substantielle a été méconnue peut renoncer à s'en prévaloir et régulariser ainsi la procédure. Cette renonciation doit être expresse. Elle ne peut être donnée qu'en présence de l'avocat ou ce dernier dûment appelé.

▪ Së fundi, riformulimin e nenit 802 të Kodit duke e rilidhur çdo juridiksion, edhe Gjykatën e Kasacionit, me të drejtën për t'u shprehur për pavlefshmëritë tekstuale dhe substanciale (*mbi kërkesë të palës ose kryesisht*), vetëm kur ato kanë sjellë si pasojë cënimin e një interesi të ligjshëm që rregullat e formës janë normuar për ta mbrojtur²⁴.

Duke përmbledhur sa më sipër, mund të përfundojmë që e drejta procedurale franceze njih dy lloj pavlefshmëri: *pavlefshmëritë tekstuale*, të parashikuara shprehimisht në tekstin e Kodit dhe *pavlefshmëritë substanciale*, të cilat nuk parashikohen në mënyrë të shprehur. Në thelb ky dallim doktrinar nuk paraqit interes praktik²⁵, sepse jurisprudenca e gjykatave ka ruajtur të pacënuar traditën e saj të dallimit midis pavlefshmërive të interesit publik, që ngrihen pa qenë nevoja e paraqitjes së një shkakut dhe të pavlefshmërive ngritja dhe shqyrtimi i të cilave kërkon detyrimisht argumentimin e një shkakut, që lidhet me cënimin e interesave të palës kërkuese.

* * *

Pas parashtrimit të sistemit të pavlefshmërisë së akteve procedurale penale në të drejtën pozitive dhe në doktrinën franceze, duhet të sqarojmë edhe disa aspekte shumë të rëndësishme që lidhen me çështjet që do të trajtojmë në vijim:

1) *A ka vendosur ligjvënësi francez afate të kufizuara për ngritjen e pavlefshmërisë së akteve procedurale?* Ky problem është shumë i rëndësishëm sepse lidhet ngushtë me nevojën e çdo rendi juridik për të gjetur drejtpeshimin e duhur midis domosdoshmërisë së respektimit të garancive procedurale dhe zgjidhjes së çështjes brenda një afati të arsyeshëm, pa lejuar zvarritje të papërligjura të procesit penal.

Në këtë aspekt, procedura franceze nisët nga parimi që pavlefshmëria e akteve të hetimeve paraprake (*instruction préparatoire*) duhet të ngrihet sa më shpejt të jetë e mundur, gjatë ose në përfundim të fazës së hetimeve. Ligji i datës 24 gusht 1993 ka vendosur dy rregulla të rëndësishme²⁶:

së pari, kërkesa e palëve për pavlefshmëri shtrihet edhe për ato që mund të jenë kryer gjatë procedurës së mëparshme (*neni 174-1, par. 1*);

së dyti, kërkesa për pavlefshmëri duhet të paraqitet, me pasojë papranueshmërie, përpara se gjyqtari hetues (*juge d'instruction*), të ketë formuluar urdhërin e dërgimit për në gjykatën e korrektimit (*tribunal correctionnel*). Për këtë arsye, ligji parashikon një afat 20 ditor për palët, pas skadimit të të cilit gjyqtari hetues i dërgon aktet prokurorit. Gjithashtu, ligji parashikon që parregullsitë e kryera para marrjes në pyetje, duke përfshirë edhe ato që mund të kryhen gjatë realizimit të këtij akti, duhet të ngrihen brenda 6 muajve nga dita e marrjes në pyetje, me pasojë humbjen e kësaj të drejte.

Këto rregulla synojnë jo vetëm sanksionimin e pavlefshmërive sa më shpejt të jetë e mundur, por kanë si qëllim që të mos lejojnë që ato të shtrihen edhe në aktet e mëpasme që kanë varësi funksionale nga akti i pavlefshëm.

²⁴ Article 802. - En cas de violation des formes prescrites par la loi à peine de nullité ou d'inobservation des formalités substantielles, toute juridiction, y compris la Cour de cassation, qui est saisie d'une demande d'annulation ou qui relève d'office une telle irrégularité ne peut prononcer la nullité que lorsque celle-ci a eu pour effet de porter atteinte aux intérêts de la partie qu'elle concerne.

²⁵ Guinchard Serge, Buisson Jacques, *vep. e cit.*, faqe 1011.

²⁶ Bouloc Bernard, Matsopoulou Haritini, *Droit pénal général et procédure pénale*, 16^e édition, Edition Dalloz, 2006, faqe 337.

2) *Cilët janë subjektet që ligji procedural u jep të drejtën e ngritjes së pavlefshmërive dhe cili organ i merr në shqyrtim ato?* Kodi ua jep këtë të drejtë si palëve private, ashtu edhe gjyqtarit hetues dhe prokurorit (*neni 170*). Por, pavlefshmëritë mund të ngrihen edhe kryesisht nga Dhoma e Hetimeve (*chambre de l'instruction*), kur dosja shqyrtohet prej saj (*nenet 174, par. 1 dhe 206 të Kodit*). Pa u zgjatur mund të pohojmë se kompetente për të deklaruar pavlefshmërinë e akteve dhe për të përcaktuar pasojat e saj është Dhoma e Hetimeve, një organ juridiksional i ngarkuar nga ligji me kontrollin e hetimeve paraprake. Pra, ligjvënësi ka synuar të shmangë shtrirjen e problematikës së pavlefshmërive gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, përveç disa rasteve të posaçme të parashikuara shprehimisht nga ligji, duke normuar zgjidhjen e pasojave të tyre qysh në fazën e hetimeve paraprake (*shih pikën 1*).

3) *A ekziston mundësia e korrigjimit të pavlefshmërive?* Kodi francez i procedurës penale parashikon dy raste të korrigjimit të pavlefshmërisë së akteve. Rasti i parë lidhet me heqjen dorë të palës nga kërkesa për pavlefshmëri, sipas rregullave që parashikon neni 172 (*shih më sipër*). Në këtë rast parregullsia e aktit quhet e rregulluar automatikisht. Rasti i dytë, lidhet me pavlefshmëritë që kanë të bëjnë me një interes publik. Në këto raste aktet e pavlefshme duhet të anulohen sa më shpejt të jetë e mundur, me qëllim ribërjen e tyre (*sigurisht, kur kjo mundësi ekziston*).

4) *Cilat janë pasojat e deklarimit të pavlefshmërisë?* Aktet e deklaruar të pavlefshëm hiqen nga dosja dhe depozitohen në sekretarinë e gjykatës së apelit (*neni 174, par. 3*). Në rastet kur pavlefshmëria prek vetëm pjesë të caktuara të aktit, ato fshihen në mënyrë të palexueshme, por gjithmonë ruhet një kopje e njësuar e aktit origjinal, që duhet të depozitohet në sekretarinë e gjykatës së apelit.

E drejta procedurale franceze e njeh edhe institutin e pavlefshmërisë së prejardhur. Pavlefshmëria e një akti mund t'i shtrijë efektet edhe në aktet e mëpasme. Shtrirja e pasojave përcaktohet nga Dhoma e Hetimeve (*neni 174, par. 3*), përfundimi i së cilës i nënshtrohet kontrollit nga gjykata (*chambre criminelle*), sipas një procedure shumë strikte. Pavlefshmëria nuk mund të shtrihet mbi çdo akt të mëpasëm nga akti i anuluar, por vetëm kur akti nul përbën “*mbështetjen e domosdoshme*” të aktit të mëpasëm, çka nënkupton një raport të qartë të lidhjes shkakësore midis dy akteve²⁷. Kriteret janë përcaktuar nga jurisprudenca e Gjykatës së Kasacionit.

Në përfundim të këtij vështrimi në sistemin francez të pavlefshmërisë së akteve, mund të arrijmë në përfundimin se ai synon konstatimin e pavlefshmërisë sa më shpejt të jetë e mundur, i nxjerr jashtë sferës së shqyrtimit aktet e anuluar për mangësi të formës dhe synon të ngushtojë shtrirjen e pasojave në aktet e mëpasme që kanë varësi funksionale nga akti nul. Por, këtij sistemi i mungon qartësia, ai priret të realizojë objektivin e shpejtësisë së zgjidhjes së çështjes, duke lënë për të dëshiruar në aspektin e sigurisë së palëve lidhur me rastet dhe tipin e pavlefshmërisë që duhet të ngrihet në një rast konkret. Sikurse vërejnë studjuesit, defekti më i madh i sistemit të përshkruar më sipër qëndron “*...në pamundësinë për të përcaktuar një listë shteruese të formaliteteve që sanksionohen me pavlefshmëri, si dhe për të saktësuar tipin e pavlefshmërisë që duhet të ngrihet*”²⁸.

§ 1.3.2 Procedura penale e Italisë

²⁷ Guinchard Serge, Buisson Jacques: *vep. e cit.*, faqe 1014 – 1015.

²⁸ Rassat Michèle-Laure, *vep. e cit.*, faqe 671

Më sipër (§ 1.3), përmendëm se sistemi italian i procedurës u reformua në themel me Kodin e ri të Procedurës Penale (*Codice di Procedura Penale*), i cili hyri në fuqi në datën 24 tetor 1989. Ligjvënësi mëshiroi në të parimet e modelit akuzator, duke krijuar një sistem të përzier, shumë më garantist se modelet e tjera të Kontinentit, ndonëse në përmbajtje të tij janë ruajtur edhe elementë të modelit inkuizitor. Në Kodin italian, sistemi i pavlefshmërisë së akteve procedurale penale, ka gjetur një zgjidhje origjinale, të përpunuar prej vitesh nga një doktrinë shumë elokuyente. Ky sistem bëhet edhe më interesant për studimin tonë në qoftë se do të mbajmë parasysh që Kodi ynë i vitit 1995 është ndërtuar thelbësisht mbi bazën e modelit italian. Ndaj, shpjegimi paraprak i parimeve dhe i kuptimit të instituteve të tij do të na ndihmojë për të kuptuar më mirë regjimin juridik të pavlefshmërive në Kodin tonë të procedurës penale.

Doktrina italiane prej vitesh ka përpunuar nocionin e aktit procedural të përkryer (*atto perfetto*), forma e të cilit përputhet me modelin abstrakt të përshkruar nga norma procedurale²⁹. Akti që nuk përputhet me modelin ligjor të normuar nga ligjvënësi konsiderohet *i vesuar*, dhe, varësisht nga rëndësia e vesit dhe ndikimi i tij në pasojat që ai prodhon, akti mund të jetë *i pavlefshëm* ose thjesht *i parregullt*. Në rastin e dytë, akti nuk konsiderohet i pavlefshëm dhe pasojat e prodhuara nuk mund të cënohen duke iu referuar parregullsisë së tij.

Ligjvënësi italian ka dashur të krijojë një sistem të qartë, ku pavlefshmëria dhe llojet e saj të paracaktohen nga ligji. Për këtë arsye, në kriterin direktiv n.7 të ligjit n. 81 të vitit 1987, me anën e të cilit Parlamenti delegoi qeverinë për të përgatitur Kodin e ri, shprehej vullneti sovran që ky Kod duhej të parashikonte në mënyrë të shprehur “... *si shkaqet e pavlefshmërisë së akteve, ashtu edhe pasojat përkatëse procedurale, deri në pavlefshmerinë e pakorrigjueshme* ...”³⁰. Pra, u mishërua në sistem *parimi i ngushtë i taksativitetit* të pavlefshmërisë së akteve procedurale penale, i parashikuar shprehimisht në nenin 177.1 me këtë formulim: “*Mosrespektimi i dispozitave të caktuara për aktet e procedimit përbën shkak pavlefshmërie vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.*”³¹ Sipas këtij parimi, pavlefshmëria e një akti mund të ngrihet vetëm kur ajo parashikohet shprehimisht nga një dispozitë konkrete “*me pasojë pavlefshmerinë*”. Kjo do të thotë se sistemi italian nuk i njeh pavlefshmëritë substanciale (*apo virtuale*), tipike për procedurën franceze, as ndarjen në pavlefshmeri të interesit publik dhe në pavlefshmeri që cënojnë interesa private (*shih § 1.3.1*). Pavarësisht nga fakti se çfarë interesash cënohen, në varësi nga rëndësia e shkëljes së kryer, ligji italian i procedurës të referon në mënyrë të shprehur nëse do të ketë pasojë pavlefshmërie dhe e çfarë tipi do të konsiderohet ajo.

Parimi i taksativitetit të pavlefshmërisë së akteve procedurale penale passjell dy rrjedhoja të rëndësishme³²:

së pari, nuk lejon zbatimin e analogjisë, çka do të thotë se nuk mund të ngrihet pavlefshmeri për raste “*të ngjashme*” në qoftë se teksti i dispozitës nuk ka sanksion të shprehur;

²⁹ Tonini Paolo, *Manuale di procedura penale*, 8° edizione, Giuffrè editore, 2007, faqe 166.

³⁰ Delega legislativa al Governo della Repubblica per l’emanazione del nuovo codice di procedura penale, approvata con la legge del 16 febbraio 1987, n. 81. Tek: “*Codice di Procedura Penale e leggi complementari*”, a cura di Giustino Gatti, Edizioni Simone, 1994, faqe 43.

³¹ Art. 177. Tassatività. — 1. L’inosservanza delle disposizioni stabilite per gli atti del procedimento è causa di nullità soltanto nei casi previsti dalla legge. Tek: *Il codice di procedura penale, annotato con la giurisprudenza*, a cura di Piermaria Corso, 3ª edizione, CELT, CasaEditriceLaTribuna, 2004 [shqipërimi ynë].

Në vijim, citimet e dispozitave të ligjit italian do t’i referohen këtij teksti. Në rast se do të përdoret tekst tjetër, ai do të citohet tek shënimet në fund të faqes përkatëse.

³² Tonini Paolo, *vep. e cit.*, faqe 173.

së dyti, kur konstatohet një pavlefshmëri nuk është rasti të gjykohet nëse ajo ka cënuar apo jo interesin e mbrojtur nga norma. Akti quhet gjithsesi i pavlefshëm.

Në kategorinë e pavlefshmërive të akteve, procedura parashikon dhe doktrina grupon këto tipe pavlefshmërish:

- 1) Pavlefshmërinë, në kuptimin e vërtetë të fjalës (*la nullità*);
- 2) Papranueshmërinë (*l'inammissibilità*);
- 3) Dekadencën (*la decadenza*).

Disa studjues përfshijnë në kategorinë e pavlefshmërive edhe sanksionin e papërdorshmërisë (*l'inutilizzabilità*), i cili godet drejtpërsëdrejti vlerën provuese të akteve të kryera në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji.

Pas këtij sqarimi të nevojshëm, le të trajtojmë shkurtimisht kuptimin e pavlefshmërive të numërtuara më sipër.

1) Pavlefshmëria - Në varësi nga rëndësia e interesit që mbron norma e shkelur, ligji italian dallon tre tipe pavlefshmërish: *absolute*, *relative* dhe *të ndërmjetme*. Në varësi nga tipi i pavlefshmërisë, ndryshon edhe shkalla e pasojave të tyre në ecurinë e procesit, si dhe regjimi juridik qoftë në aspektin e afatit brenda të cilit duhet të ngrihen, qoftë në mundësinë e korrigjimit të tyre.

a) Pavlefshmëritë absolute parashikohen në nenin 179³³ të Kodit, i cili referon pjesërisht edhe në nenin 178³⁴. Ato u referohen subjekteve kryesore të procedimit, ngrihen edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit dhe nuk mund të korrigjohen. I vetmi korrigjim i tyre ka natyrë automatike: *kur vendimi penal merr formë të prerë*³⁵. Parashikohen tri raste të pavlefshmërisë absolute, të cilat lidhen me mosrespektimin e dispozitave që kanë të bëjnë me:

³³ Art. 179. Nullità assolute. — 1. Sono insanabili e sono rilevate di ufficio in ogni stato e grado del procedimento le nullità previste dall'articolo 178 comma 1 lettera a), quelle concernenti l'iniziativa del pubblico ministero nell'esercizio dell'azione penale e quelle derivanti dalla omessa citazione dell'imputato o dall'assenza del suo difensore nei casi in cui ne è obbligatoria la presenza.

2. Sono altresì insanabili e sono rilevate di ufficio in ogni stato e grado del procedimento le nullità definite assolute da specifiche disposizioni di legge.

³⁴ Art. 178. Nullità di ordine generale. — 1. È sempre prescritta a pena di nullità l'osservanza delle disposizioni concernenti:

a) le condizioni di capacità del giudice e il numero dei giudici necessario per costituire i collegi stabilito dalle leggi di ordinamento giudiziario;

b) l'iniziativa del pubblico ministero nell'esercizio dell'azione penale e la sua partecipazione al procedimento;

c) l'intervento, l'assistenza e la rappresentanza dell'imputato e delle altre parti private nonché la citazione in giudizio della persona offesa dal reato e del querelante.

³⁵ Sqarojmë se sipas ligjit italian vendimi penal merr formë të prerë pas shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Kasacionit.

- i. Kushtet e zotësisë së përgjithshme të gjyqtarit për të ushtruar funksione juridiksionale, si dhe numrin e gjyqtarëve të domosdoshëm për formimin e kolegjeve (*neni 179.1 në lidhje me nenin 178.1, shkronja "a"*);
- ii. Nismën e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale (por jo pjesëmarrjen e tij në procedim – shih nenin 128.1, b) të Kodit tonë) – *neni 179.1*;
- iii. Thirrjen e të pandehurit ose praninë e mbrojtësit në rastet kur ajo është e detyrueshme (*neni 179.1*); *si dhe*
- iv. Në çdo rast tjetër kur pavlefshmëri absolute parashikohet nga një dispozitë e posaçme e ligjit.

b) Pavlefshmëritë e ndërmjetme parashikohen në nenin 180³⁶, me përcaktimin "*pavlefshmëri të tjera*". Në fakt, ato nuk janë tjetër veçse pavlefshmëritë e përgjithshme të nenit 178, që nuk përfshihen në nenin 179. Termat "*e ndërmjetme*" apo "*me regjim ndërmjetës*", ndonjëherë edhe "*tertium genus*", me të cilat përcaktohen këto pavlefshmëri, janë terma doktrinarë. Përfshijnë një sferë më të gjerë subjektsh, ngrihen edhe kryesisht (*sikundër pavlefshmëritë absolute*), por brenda afatesh kohore të kufizuara. Kështu, në qoftë se konstatohen përpara se të fillojë gjykimi, duhet të ngrihen nga palët para mbylljes së shqyrtimit gjyqësor dhe të deklarohen nga gjyqtari me dhënien e vendimit në shkallë të parë. Në qoftë se konstatohen në gjykim, nuk mund të ngrihen dhe as të deklarohen pas vendimit në shkallën e mëpasme. Në dallim nga pavlefshmëritë e tipit absolut, pavlefshmëritë e ndërmjetme janë të korrigjueshme.

Pavlefshmëritë e ndërmjetme lidhen me mosrespektimin e dispozitave që kanë të bëjnë me:

- Pjesëmarrjen e prokurorit në procedim (*pra, edhe para fillimit të shqyrtimit gjyqësor*), për shembull, mosmarrjen e mendimit të tij kur ligji e parashikon, mosnjoftimin e datës së seancës paraprake, etj.;

- Ndërhyrjen, ndihmën ligjore dhe përfaqësimin e të pandehurit dhe të palëve private, si dhe thirrjen në gjykim të të dëmtuarit nga vepra penale dhe të ankuesit, bie fjala, mosnjoftimin paraprakisht të mbrojtësit për të marrë pjesë në veprime kur prania e tij është e detyrueshme, mosthirrjen në gjykim e palëve private, të ndryshme nga i pandehuri, etj.

c) Pavlefshmëritë relative, që parashikohen nga neni 181, janë ato që nuk përfshihen mes pavlefshmërive absolute dhe të ndërmjetme. Janë raste më të lehta të mosrespektimit të kërkesave formale të ligjit, deklarohen me kërkesë të palës së interesuar, por brenda afatesh kohore të shkurtëra dhe janë të korrigjueshme. Si rregull, gjyqtari nuk mund të deklarojë kryesisht pavlefshmëritë e natyrës relative, me ndonjë përjashtim të përcaktuar nga dispozita të veçanta. Duke qenë se në sistemin italian të procedurës pavlefshmëritë relative deklarohen nga gjyqtari, palët duhet t'i ngrenë ato në fazën e kërkesave paraprake. Në rast se nuk deklarohen nga

³⁶ Art. 180. Regime delle altre nullità di ordine generale. — 1. Salvo quanto disposto dall'articolo 179, le nullità previste dall'articolo 178 sono rilevate anche di ufficio, ma non possono più essere rilevate né dedotte dopo la deliberazione della sentenza di primo grado ovvero, se si sono verificate nel giudizio, dopo la deliberazione della sentenza del grado successivo.

gjyqtari, ato ngrihen nga palët me ankimin e vendimit. Në të njëjtën mënyrë mund të goditen edhe pavlefshmëritë relative të konstatuara në fazën e gjykimit³⁷.

Theksojmë se pavlefshmëritë relative janë pavlefshmeri të natyrës së posaçme, të shpërndara në dispozita të ndryshme të Kodit.

2) Papranueshmëria – Është një shkak pavlefshmërie dhe sanksion procedural që godet kërkesat e palëve. Ajo synon të pengojë shqyrtimin e themelit të tyre, në qoftë se ajo nuk plotësojnë elementët e domosdoshëm të aktit që Kodi i sanksionon ”me pasojë papranueshmërie”.

Këta elementë mund të kenë të bëjnë me kohën e paraqitjes së kërkesës, përmbajtjen, aspektin formal apo legjitimitimin e palës për kryerjen e aktit. Në sistemin italian papranueshmëria mund të verifikohet nga gjyqtari, me kërkesën e palëve ose kryesisht. Nuk ka afat ligjor për deklarimin e papranueshmërisë së kërkesave, pos rasteve kur ai përcaktohet shprehimisht nga dispozita konkrete.

3) Dekadenca – Kjo lloj pavlefshmërie ka të bëjë me humbjen e së drejtës për kryerjen e një akti, në qoftë se ai nuk kryhet *brenda* dhe *jo tej* një afati të parashikuar nga ligji (afate të kësaj natyre njihen si *termini perentori*). Akti i kryer përtej këtij afati quhet juridikisht i pavlefshëm³⁸.

Edhe lidhur me afatet në të drejtën procedurale italiane vepron *parimi i taksativitetit*, i mishëruar në nenin 173³⁹ të Kodit: mosrespektimi i afateve sjell si pasojë dekadencën, *vetëm në*

³⁷ Art. 181. Nullità relative. — 1. Le nullità diverse da quelle previste dagli articoli 178 e 179 comma 2 sono dichiarate su eccezione di parte.

2. Le nullità concernenti gli atti delle indagini preliminari e quelli compiuti nell'incidente probatorio e le nullità concernenti gli atti dell'udienza preliminare devono essere eccepite prima che sia pronunciato il provvedimento previsto dall'articolo 424. Quando manchi l'udienza preliminare, le nullità devono essere eccepite entro il termine previsto dall'articolo 491 comma 1.

3. Le nullità concernenti il decreto che dispone il giudizio ovvero gli atti preliminari al dibattimento devono essere eccepite entro il termine previsto dall'articolo 491 comma 1. Entro lo stesso termine, ovvero con l'impugnazione della sentenza di non luogo a procedere, devono essere riproposte le nullità eccepite a norma del primo periodo del comma 2, che non siano state dichiarate dal giudice.

4. Le nullità verificatesi nel giudizio devono essere eccepite con l'impugnazione della relativa sentenza.

³⁸ Tonini Paolo, *vep. e cit.*, faqe 168.

³⁹ Art. 173. Termini a pena di decadenza. Abbreviazione. — 1. I termini si considerano stabiliti a pena di decadenza soltanto nei casi previsti dalla legge.

2. I termini stabiliti dalla legge a pena di decadenza non possono essere prorogati, salvo che la legge disponga altrimenti.

3. La parte a favore della quale è stabilito un termine può chiederne o consentirne l'abbreviazione con dichiarazione ricevuta nella cancelleria o nella segreteria dell'autorità procedente. (vëreni identitetin me nenin 145 të Kodit tonë).

rastet e parashikuara nga ligji. Ligji parashikon edhe mundësinë e rivendosjes në afatin e humbur, si rregull, për shkak të pamundësisë objektive për ta respektuar atë (tipike janë *rasti fator dhe forca madhore*).

Pas këtij vështrimi përmbledhës të sistemit italian të pavlefshmërive, e shohim me vend të ndalemi edhe në disa probleme të tjera, jo më pak të rëndësishme.

Së pari, duhet theksuar se Kodi italian parashikon në mënyrë të shprehur mundësinë e korigjimit të pavlefshmërisë së akteve, pos rastit të pavlefshmërive absolute të cilat janë të pakorigjueshme dhe, siç përmendëm, mund të ngrihen edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit. Kodi dallon rastet e përgjithshme të korigjimit të pavlefshmërive (*neni 183*⁴⁰), që veprojnë:

a) kur pala e interesuar ka hequr dorë shprehimisht nga kundërshtimi i tyre ose ka pranuar pasojat e aktit;

b) kur pala ka përfituar nga e drejta për ushtrimin e së cilës akti i ometuar ose i pavlefshëm është paracaktuar nga ligji.

Nuk është vendi të ndalemi në kuptimin e këtyre rasteve, pasi ato do të trajtohen gjerësisht kur të marrim në shqyrtim dispozitat përkatëse të Kodit tonë të procedurës penale.

Por, Kodi parashikon edhe rastet e posaçme të korigjimit të pavlefshmërive (*neni 184*⁴¹), të cilat kanë të bëjnë vetëm me lajmërimet, komunikimet dhe njoftimet për palët e interesuara.

Së dyti, sistemi italian i procedurës zgjidh edhe pasojat e deklarimit të pavlefshmërisë së akteve, duke i shtrirë ato edhe mbi aktet e mëpasme që varen nga akti i pavlefshëm, në kuptimin logjik dhe juridik (*neni 185.1*⁴²). Parashikohet edhe mundësia e ribërjes së aktit të deklaruar të

⁴⁰ Art. 183. Sanatorie generali delle nullità. — 1. Salvo che sia diversamente stabilito, le nullità sono sanate:

a) se la parte interessata ha rinunciato espressamente ad eccepirle ovvero ha accettato gli effetti dell'atto;

b) se la parte si è avvalsa della facoltà al cui esercizio l'atto omesso o nullo è preordinato. (vëreni identitetin me nenin 130.1 të Kodit tonë).

⁴¹ Art. 184. Sanatoria delle nullità delle citazioni, degli avvisi e delle notificazioni. — 1. La nullità di una citazione o di un avviso ovvero delle relative comunicazioni e notificazioni è sanata se la parte interessata è comparsa o ha rinunciato a comparire.

2. La parte la quale dichiara che la comparizione è determinata dal solo intento di far rilevare l'irregolarità ha diritto a un termine per la difesa non inferiore a cinque giorni.

3. Quando la nullità riguarda la citazione a comparire al dibattimento, il termine non può essere inferiore a quello previsto dall'articolo 429 (vëreni identitetin me nenin 130.2.3 të Kodit tonë).

⁴² Art. 185. Effetti della dichiarazione di nullità. — 1. La nullità di un atto rende invalidi gli atti consecutivi che dipendono da quello dichiarato nullo.

2. Il giudice che dichiara la nullità di un atto ne dispone la rinnovazione, qualora sia necessaria e possibile, ponendo le spese a carico di chi ha dato causa alla nullità per dolo o colpa grave.

3. La dichiarazione di nullità comporta la regressione del procedimento allo stato o al grado in cui è stato compiuto l'atto nullo, salvo che sia diversamente stabilito.

pavlefshëm, si dhe, rikthimi i procedimit në gjendjen dhe në shkallën ku është kryer akti i vesuar (par. 3). Rregulli i fundit ka edhe përjashtime dhe nuk vepron kur pavlefshmëria ka të bëjë me provat (par. 4).

Përfundimisht, mund të theksojmë se ligjvënësi italian ka ndërtuar një sistem të qartë dhe racional të pavlefshmërisë së akteve procedurale penale. Përcaktimi taksativ i rasteve që mund të goditen për pavlefshmëri, nuk lë shteg për interpretime të zgjeruara dhe u krijon palëve një perspektivë të qartë për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Nga ana tjetër, sanksionimi i pavlefshmërive absolute me pamundësi korrigjimi dhe instituti i shtrirjes së tyre edhe në aktet e mëpasme që plotësojnë kushtet e kërkuara, i vesh këtij sistemi natyrë garantuese në drejtim të respektimit të të drejtave të individit. Por, përcaktimi i afateve që nuk mund të zgjaten brenda të cilave mund të ngrihen pavlefshmëritë e natyrës joabsolute dhe format e posaçme të korrigjimit, krijojnë hapësirën e nevojshme për të mos lejuar zgjatje të papërligjura të procesit. Duket se është gjetur drejtpeshimi i nevojshëm midis garancive të individit dhe nevojës për ta përmbyllur procesin brenda një afati të arsyeshëm.

Në një këndvështrim më të ndryshëm, të krijohet përshtypja se sistemi italian vuan nga një formalizëm i dukshëm, por nuk duhet të harrojmë se në një proces ku aktet me shkrim, të kryera në fazën e hetimeve paraprake, vazhdojnë të jenë të rëndësishme dhe me mundësi përfshirje në fashikullin e gjykimit, vetëm respektimi i formës "... *garanton një proces demokratik që mund të sigurojë barazinë*"⁴³.

§ 1.3.3 Procedura penale e Gjermanisë

Kodi i procedurës penale të Gjermanisë⁴⁴ daton në vitin 1877. U miratua nga kancelari Bismarck, sipas modelit francez të Kodit të Napoleonit. Ky Kod, ndër vite, u është nënshtruar ndryshimeve të thella, të cilat e kanë prekur në shumë institute modelin procedural të origjinës⁴⁵. E ashtuquajtura "*reformë e vogël*", e kryer në vitin 1964, i përmirësoi ndjeshëm të drejtat e mbrojtjes. Ajo u pasua nga "*reforma e parë e madhe*" e vitit 1975, e cila realizoi ndërhyrje në shumë dispozita të Kodit, nga të cilat më e rëndësishmja ishte nxjerrja nga sistemi e figurës tradicionale të gjyqtarit hetues. Ndryshimet në procedurën penale vijuan edhe gjatë viteve '80 dhe në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar.

Megjithë ndryshimet e ndjeshme ndër vite, Kodi gjerman i ka qëndruar besnik parimit të origjinës, i njohur si *Inquisitionprinzip*⁴⁶, pra, është një kod tipik i modelit inkuizitor. Në tekstin e Kodit nuk mund të gjesh dispozita të përgjithshme që të rregullojnë pavlefshmërinë e akteve

4. La disposizione del comma 3 non si applica alle nullità concernenti le prove (vëreni ngjashmërinë me nenin 131 të Kodit tonë).

⁴³ Përfundim i nxjerrë nga Piero Calamandrei (1889 – 1956), konstitucionalist, avokat dhe profesor i shquar italian; cituar nga Lozzi Gilberto, *Lezioni di procedura penale*, G. Giappichelli Editore, 3^o edizione, Torino 2000, faqe 169.

⁴⁴ Të dhënat i referohen tekstit në frëngjishte të Kodit gjerman të procedurës: *Code allémand de procédure pénale* (texte applicable au 1^{er} janvier 1999), Traduit de l'allemand par Raymond Legeais - Président honoraire de l'Université de Poitiers, Professeur émérite de la Faculté de droit de Poitiers. Konsultuar në internet në adresën : www.juriscope.org/publications/documents/index.htm

⁴⁵ Ruggieri Francesca, "*Lineamenti del sistema processuale penale tedesco*", Relazione all'incontro di studio "Acquisizione e valutazione della prova nei Paesi dell'Unione Europea", Roma, 22.03.2000. Konsultuar në internet në adresën: www.apinter.csm.it

⁴⁶ Parimi inkuizitor (gjerm.)

apo sanksionet e tjera procedurale. Por, ato mund të gjenden të shpërndara në dispozitat që rregullojnë procedurën e rishikimit⁴⁷ (§ 377 e vijues). Në këto dispozita përdoret termi "dhunim i ligjit", me anën e të cilit nënkuptohet *ex lege* moszbatimi ose zbatimi jokorrekt i një norme juridike. Kodi parashikon edhe shkaqet e rishikimit që kanë karakter absolut (§ 378), si formimi i trupit gjykues, shkelja e rregullave për njoftimet, cënimi i të drejtave të mbrojtjes, mungesa e prokurorit apo e çdo subjekti të parashikuar nga ligji në debatin gjyqësor, shkelja e rregullave për kompetencën, etj.

Përfundimisht, mund të pranohet se modeli gjerman i procedurës penale nuk ka synuar të ndërtojë ndonjë sistem të veçantë për sanksionimin e pavlefshmërive të formës së akteve, ndaj është vështirë që të mund të shërbejë si pikë referimi për të shpjeguar institutet e ligjit tonë të procedurës.

§ 1.3.4 Procedura penale e Spanjës

Kodi i procedurës penale të Spanjës⁴⁸, në fuqi nga viti 1882, me ndryshime përmirësuese të shumta ndër vite, është konceptuar mbi bazën e modelit napoleonik të procedurës penale. Pra, Kodi spanjoll mishëron një sistem të tipit të përzier, me elementë të fortë inkuizitorë, në të cilin prokurori (*Ministerio Fiscal*), në cilësinë e përfaqësuesit të qeverisë pranë pushtetit gjyqësor, ka të drejtën për të filluar procedimin dhe për ta orientuar atë drejt hetimeve që ndiqen nga gjyqtari hetues (*Juez de Instrucción*)⁴⁹. Edhe në Kodin spanjoll, sikurse në procedurën gjermane, nuk parashikohen dispozita të përgjithshme që të rregullojnë pavlefshmërinë apo sanksione të tjera procedurale për vese të formës së aktit. Por, dispozita të posaçme normojnë pavlefshmëritë që burojnë nga shkelja e dispozitave për njoftimet (*neni 180*), cënimi i rregullave për publicitetin e seancës gjyqësore (*neni 660*), apo ato të akteve të procedimit të kryera deri në çastin kur vendoset të mos jepet autorizimi për të proceduar (*neni 677*). Kodi parashikon edhe pavlefshmërinë e debatit gjyqësor në rastin e shkeljes së rregullave apo garancive procedurale (*neni 795*), si dhe anulimin e gjykimit për shkelje të një "forme thelbësore" të procedurës (*neni 796*). Kuptimi i termit të mësipërm, me siguri, trajtohet nga doktrina dhe nga jurisprudenca e gjykatave.

Pa u zgatur më tej, përfundojmë duke vërejtur se edhe sistemi spanjoll, i mbështetur në parimet inkuizitore të ndërtimit të Kodit, nuk ofron garanci të sistemuara për shkeljen e formës së akteve procedurale. Sanksionet janë të kufizuara dhe të përhapura në disa dispozita të Kodit, pa mundur të krijojnë një sistem të njëjtësuar parimesh të përgjithshme dhe as ndonjë klasifikim sipas llojit dhe natyrës së pavlefshmërive.

§ 1.3.5 Procedura penale e Rumanisë

⁴⁷ Ky institut ka kuptimin e rishqyrtimit të çështjes nga një gjykata më e lartë, ndaj nuk duhet ngatërruar me rishikimin, në kuptimin që i jep këtij instituti Kodi ynë i procedurës.

⁴⁸ Të dhënat i referohen tekstit në frëngjishte të Kodit spanjoll të procedurës: Code de procédure pénale espagnol (texte applicable au juin 1999), traduit par Raymond Legeais - Doyen honoraire de la Faculté de Droit et des Sciences sociales de l'Université de Poitiers. Konsultuar në internet në adresën : www.juriscope.org/publications/documents/index.htm

⁴⁹ Cavini Sofia, "La pubblica accusa nei diversi stati dell'Unione Europea: breve rapporto sui principi vigenti in Italia, Francia, Germania, Gran Bretagna e Spagna", Rivista Italiana di Diritto Pubblico Comunitario, 1999, faqe 312.

Interes të veçantë studimi, në planin e pavlefshmërisë së akteve, paraqit Kodi rumun i procedurës penale⁵⁰. Instituti i pavlefshmërisë së akteve të procedurës parashikohet në kreun VI të Kodit, në një dispozitë të vetme të përgjithshme, të titulluar “*Shkeljet me pasojë pavlefshmërinë*” (neni 197)⁵¹.

Ligjvënësi rumun ka ndërtuar një sistem pavlefshmëri, që duket se frymëzohet si nga modeli francez, ashtu edhe nga ai italian. Kështu, në paragrafin (2), normohet instituti i pavlefshmërisë absolute (*ndonëse nuk përdoret ky term*), i përcaktuar si i pakorrigjueshëm dhe me mundësi ngritjeje në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit⁵². Raste të pavlefshmërive që nuk mund të shmangen dhe që mund të ngrihen, edhe kryesisht, janë ato që u referohen shkeljeve të rregullave për kompetencën, përbërjes së gjykatës, publicitetit të seancës, si dhe shkeljes së normave lidhur me praninë e prokurorit, të akuzuarit dhe ndihmën e këtij të fundit nga mbrojtësi. Shkeljet e tjera të procedurës mund të prodhojnë pavlefshmëri, por vetëm në rastet kur kanë sjellë një dëm që nuk mund të mënjanohet veçse me anulimin e aktit. Pra, sipas këtij përcaktimi, palët duhet të provojnë jo vetëm dëmin që u shkaktohet interesave të tyre, por edhe pamundësinë e mënjanimi të tij pa anuluar aktin që e ka prodhuar atë. Për këto lloj pavlefshmëri, që duket se janë të natyrës relative, Kodi rumun parashikon (*paragrafi 4*), me pasojë mospranimi, ngritjen e tyre menjëherë pas kryerjes së aktit (*kur pala ka qenë e pranishme*), ose në procedurën gjyqësore pasardhëse (*kur pala nuk ka qenë e pranishme*). Gjithashtu, ligji parashikon edhe ribërjen e akteve të prekura nga vese të formës (*paragrafi 5*).

Duke përmbledhur sa më sipër, përfundojmë se Kodi rumun paraqit risi interesante, pasi krijon një rregullim të përgjithshëm të pavlefshmërive, duke i ndarë ato në pavlefshmëri që ngrihen edhe kryesisht (*të natyrës absolute*) dhe në pavlefshmëri që ngrihen me kërkesë së palës, brenda afatesh të kufizuara dhe me mundësi ribërjen e aktit të vesuar (*tipare karakteristike të pavlefshmërive relative*). Gjithsesi, këto të fundit mbeten të papërcaktuara dhe ngrihen rast pas rasti në varësi të dëmit që i shkaktojnë interesave të palës së interesuar. Ky përcaktim tregon se Kodi rumun nuk e pranon parimin e taksativitetit të pavlefshmërive. Pavarësisht nga dallimet e tij nga ligji ynë procedural, studimi i sistemit rumun i pavlefshmërive është i dobishëm edhe për të kuptuar dhe interpretuar institutet përkatëse të Kodit tonë të procedurës.

⁵⁰ Teksti i Kodit rumun është konsultuar në internet, në adresën www.dreptonline.ro/legislatie/codul_de_procedura_penala.php. Dispozitat që do t'u referohemi në vijim janë shqipëruar nga Ilda Stefa.

⁵¹ Paragrafët (2) dhe (5) të këtij neni janë ndryshuar me ligjin nr. 356 të vitit 2006.

⁵² Neni 197. - ... (3) Pavlefshmëria e parashikuar në paragrafin 2 nuk mund të mënjanohet në asnjë mënyrë. Ajo mund të ngrihet në çdo fazë të procesit dhe merret në konsideratë qoftë dhe kryesisht.

KREU 2

SISTEMI I PAVLEFSHMËRISË SË AKTEVE SIPAS KODIT TË PROCEDURËS PENALE TË VITIT 1995. PAVLEFSHMËRIA ABSOLUTE

§ 2.1 Parimet e ndërtimit të sistemit

Kodi i procedurës penale i miratuar me ligjin Nr. 7905, datë 21.3.1995, në fuqi nga data 1 gusht 1995, normat e përgjithshme për pavlefshmërinë e akteve i ka grupuar në Seksionin V (*Pavlefshmëria e akteve*) të Kreut I (*Aktet*) të Titullit III (*Aktet, njoftimet dhe afatet*). Para së gjithash, është e domosdoshme të ndalemi tek parimet e përgjithshme të ndërtimit të grupnormave për pavlefshmërinë e akteve, të cilat së bashku me rastet e posaçme të pavlefshmërive të shpërndara në dispozita të veçanta të Kodit, i japin formë sistemit të pavlefshmërisë së akteve procedurale penale.

Përmendëm më lart se ligjvënësi ynë për të kryer reformën e procedurës penale përzgjedhi modelin italian. Padyshim një zgjedhje e drejtë, ku besojmë se duhet të kenë ndikuar jo vetëm ekspertët e huaj, por edhe tradita e përbashkët kontinentale e Civil Law-t dhe fakti se Kodi italian ishte Kodi më i ri në fuqi ndër vendet e Evropës, rrethanë kjo që krijonte sigurinë e arritjes së standarteve demokratike. Natyrisht, kjo zgjedhje mbarti me vete mangësitë e një modeli ende të pakolauduar në vendin e tij të origjinës, si dhe vështirësitë e kuptueshme të zbatimit të tij në një shoqëri pasdiktatoriale, që ende vazhdon të vuajë luhatje të ndjeshme rreth pikës së drejtpeshimit optimal liri – autoritet.

Por, në dallim nga Kodi italian, ligjvënësi ka normuar një sistem binar të pavlefshmërive, të ndarë në mënyrë të prerë në pavlefshmëri absolute dhe relative, duke shmangur kategorinë ndërmjetëse të pavlefshmërive të llojit të tretë. Kjo zgjedhje padyshim i jep qartësi sistemit duke e bërë atë më të kuptueshëm, por i bën më të shtangëta rastet e pavlefshmërive absolute, me pasoja në kohëzgjatjen e procesit penal.

Nga ana tjetër, në Kodin tonë janë të pranishme rastet e tjera që studjohen brenda sistemit të pavlefshmërive si papranueshmëria (*që godet kërkesat e palëve*) apo rënia (*dekadenca*) e të drejtave për shkak të mosrespektimit të afateve procedurale. Kuptohet që kryerja e një akti jashtë afatit të parashikuar nga ligji e bën këtë akt të papranueshëm, pra, të pavlefshëm për të prodhuar pasoja juridike.

Më sipër, cekëm paksa edhe faktin se disa studjues të huaj trajtojnë brenda temës së pavlefshmërisë së akteve edhe nocionin e *papërdorshmërisë* së provave të marra në kundërshtim me ligjin. Ligjvënësi ynë e ka materializuar në Kod institutin e papërdorshmërisë së akteve me vlerë provuese në nenin 151.4⁵³, si ves dhe si sanksion procedural. Madje, një sanksion i tillë nuk parashikohet vetëm në Kod, por edhe në nenin 32.2 të ligjit themelor të shtetit⁵⁴. Në pikëpamje metodologjike, papërdorshmëria e provave të marra *contra legem* rëndom trajtohet në doktrinën e provave dhe të procedimit provues, por ajo ndërlidhet me problematikën e pavlefshmërisë së

⁵³ Neni 151. Marrja e provave - ... 4. Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit. Tek: "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", botim i QPZ, tetor 2004.

⁵⁴ Neni 32. - ... 2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Tek "Kushtetuta dhe materiale shpjeguese", botim i QAKAPP, dhjetor 1998.

akteve, pasi vihet në diskutim vlera provuese që ato mbartim. Për këtë arsye, e gjejmë me vend që institutin e papërdorshmërisë së akteve ta trajtojmë brenda këtij punimi, në një kre të veçantë, për shkak të gjerësisë e thellësisë së problematikës që ai rrok.

Theksuam se sistemi italian i pavlefshmërive është ngritur mbi parimin e taksativitetit. Vërejmë se formulimi i këtij parimi nuk është parashikuar në mënyrë të shprehur në Kodin tonë. Ky është problemi thelbësor që duhet diskutuar. *Kemi të bëjmë me vullnetin e shprehur të ligjvënësit për të hequr dorë nga ky parim duke lejuar gjykatat që të zbatojnë analogjinë, përmes interpretimeve rast pas rasti, në varësi nga rëndësia e interesit të cënuar? Është gjykuar se mishërimi i këtij parimi nxirret nga interpretimi sistematik i dispozitave, ndaj nuk ka qenë nevoja që të sanksionohet në mënyrë të shprehur? Edhe një mundësi e tretë mund të diskutohet: mos vallë ligjvënësi i vitit 1995, pa përvojën e duhur dhe i paorientuar nga ekspertët, për shkak të moskuptimit të thelbit të parimit, vendosjen e një norme të tillë e ka quajtur të panevojshme apo të tepërt?*

Natyrisht, nuk është detyrë e thjeshtë mëtimi për t'u dhënë një përgjigje shteruese këtyre pyetjeve, argumentimi i të cilave do të jetë pjesë e rëndësishme e këtij punimi. Por, që në krye të herës, një përfundim parimor mund të nxirret: ligjvënësi ka gabuar në shmangjen e një norme kaq të rëndësishme dhe praktika gjyqësore dëshmon se është lënë mundësi për interpretime të zgjeruara, disa herë kundërthënëse që, në kushtet e një jurisprudence ende të paqëndrueshme, i çorientojnë zbatuesit e ligjit penal. Seksioni i pavlefshmërisë së akteve duhet të hapej me një dispozitë të qartë, sipas formulimit të nenit 177.1 të Kodit italian: *“Mosrespektimi i dispozitave të caktuara për aktet e procedimit përbën shkak pavlefshmërie vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.”*

Le të shohim në vijim si është orientuar praktika gjyqësore në këndvështrimin e parimit të taksativitetit.

Një vendim i kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, i vitit 2003, përbën rast që vlen të diskutohet⁵⁵, pasi janë trajtuar disa dispozita të Kodit në planin e pavlefshmërisë dhe duket se interpretuesit orientohen, ndonëse në mënyrë të paqartë, drejt pranimin të parimit të taksativitetit. Gjykata pranon se neni 428.1/ç i Kodit *“... nuk lë shteg për një interpretim më të zgjeruar nga ana e gjykatës”*, përfundim që të çon drejt interpretimit strikt të normës, vetëm lidhur me rastet kur dispozita të veçanta parashikojnë pavlefshmërinë e vendimit. Ky qëndrim i saktë përsëritet më qartë në vijim kur Gjykata shprehet: *“... jo çdo shkelle e dispozitave procedurale sjell pavlefshmëri të akteve, përveçse kur ajo është e parashikuar në mënyrë të shprehur në ato dispozita apo del nga përmbajtja e ligjit.”*

Në vijim, duket se kolegji shpreh pasiguri teksa merr në shqyrtim konstatimin e gjykatës së apelit për pavlefshmëri, për shkak se kërkesa për gjykim nuk iu komunikua njërit prej të akuzuarve (neni 331.3⁵⁶ i Kodit). Arsyetimi i apelit rrëzohet me argumentin, aspak bindës, se nuk vërtetohet që ai nuk ka marrë dijeni në rrugë të tjera, por edhe sepse një mëtim të tillë nuk e ka ngritur më parë. Në qoftë se Gjykata e Lartë do t'i qëndronte parimit të taksativitetit, arsyetimi rrëzues mund të ishte më i thjeshtë: *nuk ka pavlefshmëri sepse dispozita me numër 331.3, në rast mosrespektimi, nuk e parashikon shprehimisht një pasojë të tillë.*

Vendimi në fjalë meriton një analizë më të thelluar edhe për interpretime të tjera të ligjit procedural, por ato nuk hyjnë në objektin e këtij punimi. Gjithsesi, meqenëse po marrim në analizë parimet, vlejné të theksohen dy momente interpretuese të cilat, në gjykimin tonë, shformojnë në themel parimet e Kodit për pavlefshmërinë e akteve. *“Pavlefshmëria absolute apo*

⁵⁵ Nr. 540 i Vendimit, datë 22.10.2003, Regolli, etj.

⁵⁶ Neni 331. Dërgimi i çështjes në gjykatë. – ... 3. Kërkesa u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit.

relative e akteve të hetimit paraprak – shkruan Gjykata - nuk sjell në asnjë rast pavlefshmëri të gjykimit në shkallë të parë apo të vendimit të gjykatës, pasi vendimi merret me analizën tërësore të provave të shqyrtuara e të verifikuara në seancë gjyqësore.” Ky është një pohim krejt i gabuar, Kodi njuh institutin e pavlefshmërisë së prejardhur⁵⁷, ndaj një pavlefshmëri e mëparshme që ka lidhje logjike dhe juridike me vendimin gjyqësor mund ta bëjë atë të pavlefshëm; kuptohet që kjo nuk ka asnjë lidhje me konceptin e analizës së provave, të cilit i referohet kolegji.

Së dyti, në vendimin e paraqitur, theksohet gjithashtu: *”Gjykata e apelit, megjithëse konstaton sipas saj disa shkelje gjatë hetimit paraprak, nuk parashtron se çfarë pasoje sjellin ato dhe pse ato kanë ndikuar në ligjshmërinë e gjykimit në shkallë të parë.”* Ligji procedural nuk e detyron gjykatën e apelit që të arsyetojë lidhjen midis pavlefshmërive formale, të parashikuara në paragrafin “ç” të nenit 428, me pasojat e ardhura apo me ndikimin e tyre në ligjshmërinë e vendimit. Ligjvënësi kur ka parashikuar rastet e pavlefshmërive, që sanksionohen nga apeli me prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë, i ka prezumuar pasojat e dëmshme të tyre për palët në proces apo për mirëfunksionimin e drejtësisë penale dhe ka normuar zgjidhjen e pasojave juridike të tyre.

Zbatimi i parimit të taksativitetit në temën e pavlefshmërive shfaqet qartë në rastin e rregullit të vistimit të procesverbalit të seancës nga kryesuesi i saj, sipas kërkesave të nenit 345.2⁵⁸ të Kodit. Në rastin që po analizojmë⁵⁹, kolegji pranon taksativitetin e pavlefshmërisë së akteve, duke prishur vendimin e gjykatës së apelit Vlorë, i cili e konsideronte të pavlefshëm vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor, me arsyetimin se procesverbali i seancës nuk ishte vistuar nga kryesuesi i saj. Në përmbajtje të këtij vendimi, përcaktohet prerë parimi i taksativitetit: *”Prishja e një vendimi gjyqësor për shkak të pavlefshmërisë së tij, në kuptim të paragrafit të fundit të nenit 428 të K.pr.p., kërkon domosdoshmërisht që kjo pavlefshmëri të jetë e parashikuar në dispozita të veçanta të K.pr.penale.”*

Në një vendim të mëpasëm, kolegji e pohoi përsëri këtë qëndrim, duke konfirmuar se nuk përbën pavlefshmëri rasti kur procesverbali nuk siglohet nga kryetari në çdo faqe të tij⁶⁰. Në raste

⁵⁷ Neni 131. Pasojat e deklaramit të pavlefshmërisë – 1. Pavlefshmëria e një akti i bën të pavlefshme aktet e mëpasme që varen nga ai që është deklaruar i pavlefshëm.

⁵⁸ Neni 345. Procesverbali i seancës. - ... 2. Menjëherë pas mbylljes së seancës, procesverbali, i nënshkruar në fund të çdo flete nga ai që e ka mbajtur, i paraqitet kryetarit për ta vistuar.

⁵⁹ Nr. 350 i Vendimit, datë 31.05.2006 (ankim kundër vendimit të pushimit të çështjes, neni 329.1 i KPP). Në këtë vendim, Gjykata e Lartë me të drejtë arsyeton: *”Në çështjen objekt gjykimi një pavlefshmëri e tillë nuk parashikohet në ndonjë dispozitë procedurale. Është e vërtetë që, në kuptim të kërkesave të nenit 131 të K.pr.p., nëse rezulton se procesverbali i seancës është i pavlefshëm, atëhere bëhet i pavlefshëm edhe vendimi i gjykatës por, nga përmbajtja e nenit 122 të K.pr.p. del se procesverbali i datës 16.11.2004 është i vlefshëm. Vetë dispozita ka parashikuar që ”procesverbali është i pavlefshëm kur ka dyshime rreth personave që kanë marrë pjesë ose kur mungon nënshkrimi i nëpunësit që e ka përpiluar”. Në këtë procesverbal nuk janë rastet e parashikuara në nenin 122 të K.pr.p. për ta konsideruar atë të pavlefshëm. Ai është i nënshkruar nga nëpunësja që e ka përpiluar si dhe nuk ka dyshime rreth personave që kanë marrë pjesë. Ndryshe nga sa arsyeton gjykata e apelit Vlorë, mungesa e nënshkrimit të procesverbalit nga gjyqtari, pra mosvistimi i tij konform kërkesave të nenit 345/1-2 të K.pr.p., nuk është shkak për pavlefshmëri të procesverbalit të seancës dhe nuk bën pjesë në ato shkelje procedurale që, në kuptim të dispozitave të këtij Kodi, e bëjnë vendimin e gjykatës së rrethit të cënueshëm.”*

⁶⁰ Nr.00-2013-665 i Vendimit (70), datë 27.2.13, Kelmendi: *”Gjykata e apelit, duke mos pasur parasysh e interpretuar në mënyrë të gabuar kërkesat procedurale, gjen të pavlefshëm proces-verbalin me arsyetimin se ai*

të tilla kemi të bëjmë thjesht me një parregullsi të aktit, të pasanksionuar me pasojë pavlefshmërie.

Interes studimi paraqit një rast tjetër i praktikës gjyqësore⁶¹, kur kolegji penal u ka dhënë përgjigje pozitive mëtimeve të ngritura në rekurs nga prokurori i apelit, i cili kundërshtonte vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me argumentin se mosnjoftimi i vendimit për zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake të pandehurit, sipas nenit 324.3⁶² të KPP, nuk përbën pavlefshmëri absolute sikurse pati pranuar gjykata e rrethit, por pavlefshmëri relative. Duke pranuar tezën e prokurorit, ai Kolegj u shpreh: *"...ato akte që gjykata e apelit i trajton si absolutisht të pavlefshme nuk janë të tilla sipas nenit 128 të K.pr.p., por relativisht të pavlefshme dhe kjo pavlefshmëri duhej trajtuar sipas nenit 129 të K.pr.p. ..."*. Padyshim kemi të bëjmë me një interpretim të zgjeruar dhe mohim të rregullit të taksativitetit, sepse dispozita përkatëse nuk e sanksionon mungesën e njoftimit të zgjatjes së afatit me pasojë pavlefshmërie. Norma është e qartë dhe logjika e saj mbështetet në sigurimin e së drejtës së organit procedues për të kryer hetime. Nuk ka kuptim që personi nën hetim (*neni 34.4 i KPP të drejtat e të pandehurit i shtrin edhe ndaj personit nën hetim*) të njihet me këtë fakt, edhe në rastet kur ai është në padijeni të hetimeve që kryhen në ngarkim të tij, sepse do të kufizohej përdorimi i teknikave të posaçme të hetimeve, në fazën kur hetimet duhet të mbulohen nga sekreti. Hetimet në ngarkim të një personi, sidomos në rastet e krimit të organizuar apo të trafikëve të paligjshme, mund të zgjatën edhe me muaj dhe, sigurisht, nuk ka asnjë kuptim që personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime të njoftohen për këtë fakt. Drejtpeshimi vendoset në çastin kur personi ftohet për t'u paraqitur dhe i njoftohet fakti se në ngarkim të tij kryhen hetime. Nga ky çast ai njoftohet edhe për zgjatjet e mundshme të afatit dhe i lind e drejta për t'u ankuar në gjykatë (*neni 325.1⁶³ i Kodit*).

Pra, në raste të tilla, mosnjoftimi i aktit që disponon zgjatjen e afatit të hetimeve nuk shkakton, jo vetëm pavlefshmëri, por asnjë lloj parregullsie.

nuk është nënshkruar në çdo fletë nga kryetari i seancës, neni 117 përcakton qartë se proces-verbali nënshkruhet në çdo fletë në përfundim të seancës nga personi që e ka mbajtur dhe nga ai që procedon (kryetari i seancës), por pavlefshmërinë e tij e përcakton neni 122 i K.Pr.Penale, sipas të cilit procesverbali është i pavlefshëm kur mungon nënshkrimi i personit që e ka mbajtur dhe kur ai nuk është nënshkruar në çdo fletë nga kryetari i seancës siç pranon gjykata e apelit. Përveç kësaj në mospranimin e arsytimit të vendimit të gjykatës së apelit duhet mbajtur parasysh edhe kërkesa e nenit 345/2 të K.Pr.Penale, sipas të cilit, menjëherë mbas mbylljes së seancës proces-verbali i nënshkruar në fund të çdo flete nga ai që ka mbajtur i paraqitet kryetarit për ta vistuar, gjë që është realizuar nga gjykata e rrethit. Nga këqyrja e proces-verbaleve të seancave gjyqësore të gjykatës së rrethit të datave 6/8/14/16/22-06.2011 del se ato janë nënshkruar në fund të çdo faqeje nga personi që i ka mbajtur dhe janë vistuar nga kryesuesi i seancës veprime këto në përputhje me kërkesat e K.Pr.Penale, dhe që nuk janë pasur parasysh nga gjykata e apelit në marrjen e vendimit."

⁶¹ Nr.77 i Vendimit, datë 11.02.2004, Kazazi.

⁶² Neni 324. Zgjatja e afatit. - ... 3. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit.

⁶³ Neni 325. Ankimi për zgjatjen e afatit të hetimeve - 1. I pandehuri dhe i dëmtuari kanë të drejtë, brenda dhjetë ditëve nga njoftimi, të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve.

Rasti vijues⁶⁴ shtron për diskutim pretendimet e zakonshme të mbrojtjes për pavlefshmëri, për shkak të mosnjohimit të pandehurit ose mbrojtësit të tij, sipas nenit 179.2⁶⁵ të Kodit. Në fakt, në rastin që po studjojmë, kolegji e ka rrëzuar këtë pretendim me arsyetimin se kemi të bëjmë me pavlefshmëri relative, e cila duhej të ngrihej brenda afatit të përcaktuar nga ligji, duke arsyetuar⁶⁶: *“Në rekursin e paraqitur është pretenduar se akti i ekspertimit mbi të cilin janë mbështetur gjykatat në dhënien e vendimit (pretendim që është ngritur edhe në gjykatën e rrethit e të apelit) është absolutisht i pavlefshëm pasi vendimi për kryerjen e ekspertimit nuk i është njoftuar të pandehurit ose mbrojtësit të tij. Referuar akteve të administruara, rezulton i pabazuar ky pretendim. Në bazë të nenit 129/2 të K.pr.penale, pretendimet për pavlefshmërinë e akteve të realizuara gjatë hetimit paraprak duhet të ngrihen para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, gjë që nuk është bërë e nuk i jep të drejtën mbrojtësit apo të pandehurit të ketë pretendime në Gjykatën e Lartë, **pasi moskërkimi i pavlefshmërisë e bën aktin të ligjshëm (theksimi sipas vendimit).**”* Sikurse shihet nga përmbajtja e tekstit të nenit 179 të Kodit, mosrespektimin e normës ligjvënësi nuk e lidh me ndonjë pasojë pavlefshmërie të posaçme. Pra, në këtë vendim, kolegji penal ka bërë një interpretim të zgjeruar, në mohim të parimit të taksativitetit.

Në fakt, sikundër përmendëm pak më sipër, raste të kësaj natyre mund të trajtohen në kuadrin e përgjithshëm të një pavlefshmërie absolute, për shkak të cënimit të së drejtës së mbrojtjes. Por, interpretimi është i diskutueshëm, po të mbajmë parasysh se kontradiktoriteti mund të rindërtohet gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, kur mbrojtjes i jepet mundësia të kundërshtojë aktin dhe të propozojë kryerjen e një akti të ri. Gjithsesi, për pavlefshmëri të natyrës relative nuk mund të bëhet fjalë, ndaj rrëzimi i pretendimeve për vese të kësaj natyre na duket i drejtë.

Në disa vendime të kohëve të fundit duket se kolegji penal orientohet më shumë drejt një këndvështrimi taksativ të formave të pavlefshmërisë të parashikuara nga ligji procedural penal, kur pranon se nuk sanksionohet me pavlefshmëri moszbatimi i detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë⁶⁷ ose moscitimi i shprehur i bazës ligjore të vendimmarrjes⁶⁸. Por, shënohen edhe raste kur

⁶⁴ Nr.663 i Vendimit, datë 05.10.2005, Kulla.

⁶⁵ Neni 179. Caktimi i ekspertit - ... 2. Vendimi i organit procedues për caktimin e ekspertit i njoftohet të pandehurit ose mbrojtësit të tij, duke i bërë të ditur se ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e ekspertit, të propozojë ekspertë të tjerë, të marrë pjesë vetë në ekspertim, kur është e mundur, dhe të parashtrojë pyetje për ekspertin.

⁶⁶ Për hir të së vërtetës, ky arsyetim nuk qëndron sepse mbrojtja e ka ngritur këtë pretendim në të dy shkallët e gjyqësorit.

⁶⁷ Nr.00-2012-1569 i Vendimit (313), datë 21.11.2012, Hasani, etj.: “15. Gjykata e apelit ka argumentuar si rast me pasojë pavlefshmërinë e vendimit të shkallës së parë moszbatimin në rigjykim të detyrave të lënë në vendimin nr.682, datë 23.06.2010 të Gjykatës së Lartë e cila ka prishur vendimin dhe e ka kthyer çështjen për rishqyrtim. ...

19. ... K.Pr.Penale në nenin 440 të tij nuk ka përcaktuar si pasojë pavlefshmërinë e vendimit në rastin e moszbatimit të detyrave të lënë në rigjykim nga Gjykata e Lartë. Në vetvete nëse konstatohet kjo shkelje mund të përbëjë shkak për përgjegjësi disiplinore për trupin gjyqësor i cili nuk zbaton një detyrim ligjor duke i hapur rrugë një procesi të parregullt ligjor.”

⁶⁸ Nr. 00-2013-702 i Vendimit (117), datë 03.04.13, Doda: “Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i tërheq vërejtje kolegjit penal të gjykatës së apelit, i cili shprehet në vendim se “vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i paplotë sepse mungojë elementët e vendimit të parashikuar nga neni 383 i K.Pr.Penale dhe konkretisht nenet e zbatuara nga gjykata në shpalljen e vendimit...”. Ky argument i gjykatës së apelit nuk qëndron pasi vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka argumentuar ligjin procedural të zbatuar dhe ky argumentim i gjykatës së apelit nuk e bën vendimin e pavlefshëm në vështrim të N.383/3 të K.Pr.Penale.”

shënohet rikthim drejt një interpretimi të zgjeruar, duke iu referuar një qëndrimi ta paqartë të Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë temë⁶⁹.

Rastet e mësipërme të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë na çojnë në përfundimin se praktika gjyqësore luhet midis pranimit dhe mospranimit të natyrës taksative të pavlefshmërive, qëndrim që krijon jo vetëm paqartësi të subjekteve të procedimit penal, por edhe pasiguri në zbatimin e normave të së drejtës.

Është momenti t'u rikthemi pyetjeve që shtruan paraprakisht në hyrje të këtij kreu. Nuk mund të gjejmë dot cila ka qenë arsyeja që ligjvënësi i është shmangur modelit italian në këtë drejtim, por arsye të shëndoshë nuk besojmë që të ketë patur. Interpretimi sistematik i dispozitave të Kodit dhe studimi i tyre në lidhje me sistemet e mëdha të procedurës kontinentale, na sjell në përfundimin se metabolizmi i procesit tonë penal funksionon mbi bazën e parimit të taksativitetit të pavlefshmërive. Ka disa arsye që na çojnë drejt një përfundimi të tillë:

1) Ndonëse në nenin 2 të Kodit⁷⁰ theksohet karakteri i detyrueshëm i respektimit të normave procedurale, kjo dispozitë nuk parashikon, në mënyrë të shprehur dhe për çdo rast, sanksionimin e mosrespektimit të tyre me pavlefshmëri, por e lë të hapur për rregullim në dispozitat vijuese.

2) Kodi i Procedurës Penale, përveç normave të përgjithshme (*nenet 128-131*) parashikon posaçërisht, në mënyrë të shprehur, vetëm 16 raste taksative të sanksionuara me pavlefshmëri (*nenet 60.1, 98.3, 99.2, 100.2, 112.3, 122.1, 143.1, 158.2, 171.3, 172.3, 173.3, 339.1, 351.2, 360.3, 383.3, 426.2*). Ndërkohë, rregulla për respektimin e elementeve formale të akteve, gjenden në të gjithë tekstin e Kodit, por ato nuk sanksionohen me pavlefshmëri. Tipike janë rastet e njoftimit të afatit për zgjatjen e hetimeve paraprake (*neni 324.3*), njoftimit të vendimit të ekspertimit (*neni 179.2*), etj. Pra, nga vështrimi sistematik i normave kuptohet logjika e ligjvënësit për një përzgjedhje taksative të rasteve të pavlefshmërisë, përndryshe ai duhet ta kishte shtrirë atë për të gjitha rastet, apo të mos e parashikonte shprehimisht në asnjë rast, duke i lënë liri gjykatës për interpretimin me analogji.

3) Drejt këtij parimi mendojmë se të çon edhe interpretimi i disa dispozitave të posaçme të Kodit:

a) neni 130.1 që rregullon korrigjimin e pavlefshmërisë relative (*shih në vijim § 3.4*) normon që ekziston një mundësi e tillë, por me përjashtim të rasteve “... të parashikuara ndryshe me ligj”. Pra, paralajmërohen zbatuesit e Kodit për pamundësinë e korrigjimit në rastet kur ligji parashikon ndryshe, fakt që në thelb përbën një zgjedhje të natyrës taksative;

b) neni 143 parashikon në mënyrë të shprehur rastet kur njoftimet janë të pavlefshme, duke kufizuar shtrirjen e sanksionit edhe për rastet e tjera kur nuk respektohen rregullat e njoftimeve,

⁶⁹ Nr.00-2013-389 i Vendimit (44), datë 6.2.2013, me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes nga prokurori, që i referohet Vendimit Nr.7, datë 27.4.2005 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit kuptohet se pavlefshmëria mund të shtrihet për çdo rast mosrespektimi të dispozitave ligjore për aktet e procedimit: “... mosrespektimi i dispozitave ligjore të vendosura për aktet e procedimit shërben njëkohësisht dhe si shkak pavlefshmërie që ndikon drejtpërdrejt mbi ecurinë e procesit gjyqësor ...”

⁷⁰ Neni 2. Respektimi i normave procedurale - 1. Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.

sipas neneve 132 e vijues. Në mënyrë të posaçme rregullohet edhe rasti i pavlefshmërisë së urdhërit të thirrjes së të pandehurit për gjykimin në apel (*neni 426.2*);

c) neni 428.1, shkronja ç), i cili pasi normon rastet e posaçme kur gjykata e apelit lejohet të prishë vendimin dhe t'i kthejë aktet gjykatës së shkallës së parë, e shtrin këtë të drejtë edhe "...në çdo rast tjetër kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit". Me të njëjtën logjikë është ndërtuar edhe neni 442.1, shkronja b) i Kodit⁷¹. Kuptohet që këto janë zgjedhje taksative që nuk lejojnë interpretimin me analogji;

4) Kushtetuta parashikon të drejtën e çdo personi të paraburgosur si i dyshuar për kryerjen e një veprë penale që "...të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm..." (neni 28.3). Kjo e drejtë i garantohet çdo personi të akuzuar në vështrim të nenit 42.2 të Ligjit Themelor. Detyrimi për sigurimin e kësaj të drejte buron edhe nga Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore⁷², pjesë e së drejtës të brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe normë e epërme në raport me ligjet e vendit që nuk pajtohen me të (*neni 122 i Kushtetutës*). E drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm është vështirë të sigurohet kur rastet e pavlefshmërive interpretohen në mënyrë të zgjeruar, duke shkaktuar pashmangshmërisht rikthime të procedimit në gjendjen e mëparshme. Ky është një argument shtesë, por jo më pak i rëndësishëm, për domosdoshmërinë e interpretimit të ngushtë të dispozitave për pavlefshmërinë e akteve procedurale penale.

Pra, gjykojmë se normat e Kodit për pavlefshmërinë e akteve mund dhe duhet të interpretohen *strictu sensu*. Por, jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, burimi autoritar që orienton praktikën gjyqësore, nuk ka mundur të krijojë një qëndrim të kthjellët dhe vijëdrejtë. Sikundër theksuam më sipër, jurisprudenca e saj, ndër vite, ka paraqitur pasiguri dhe luhatje që shkojnë deri në qëndrime kundërtë. Mbledhja e Kolegjeve të Bashkuara për të dalë me një vendim unifikues mund të ishte një zgjidhje e pranueshme, që mund të vendoste rregull në këtë gjendje kaotike të zbatimit praktik të këtyre dispozitave. Por, më i mira mund të arrihej vetëm me një ndërhyrje të ligjvënësit, me qëllimin e qartë për të normuar shprehimisht parimin e taksativitetit të pavlefshmërive, duke korrigjuar njëherësh edhe një defekt të Kodit, të krijuar që në origjinën e tij 20 vjet më parë.

§ 2.2 Pavlefshmëria absolute

Regjimi i pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale penale normohet shprehimisht në nenin 128.1 të Kodit⁷³. Në paragrafin 2 të këtij neni vendoset një sanksion i prerë: "2. *Një akt i cilësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm.*" Duke u mbështetur në modelin italian të procedurës penale, ligjvënësi ynë rastet e pavlefshmërive absolute, të formuluar në paragrafin 1 të nenit 128, i lidh vetëm me subjektet kryesore të procedimit: me gjyqtarin (*shkronja a*), me prokurorin (*shkronja b*) dhe me të pandehurin e mbrojtësin e tij

⁷¹ Neni 442 Prishja e vendimit dhe zgjidhja e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim. – 1. *Gjykata e Lartë vendos prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim kur: ...*

b) vendimi është i pavlefshëm për rastet e parashikuara në këtë Kod;

⁷² E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm parashikohet shprehimisht në nenin 6.1 të Konventës.

⁷³ Neni 128 Pavlefshmëria absolute - 1. Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohet dispozitat që lidhen me:

a) kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete dhe numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod;

b) të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim;

c) thirrjen e të pandehurit ose praninë mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme.

(shkronja c). Teknika e ndërtimit të këtyre hipotezave, pa cituar dispozita të posaçme të Kodit, orienton që rastet e pavlefshmërive absolute janë raste me natyrë të përgjithshme, përderisa dispozitën konkrete të shkelur, që prodhon pavlefshmëri absolute, mbetet ta gjejnë, ta interpretojnë dhe ta ngrejnë, rast pas rasti, zbatuesit e Kodit.

Formulimi i paragrafit 2 shtron për diskutim temën e pasojave që mund të krijojnë një akt absolutisht i pavlefshëm, i cilësuar si i tillë nga ligji procedural. Në doktrinë, kjo dispozitë është interpretuar në këndvështrimin civilist⁷⁴, duke mbështetur tezën se një akt i pavlefshëm nuk prodhon pasoja juridike: “Akti absolutisht i pavlefshëm dhe ai që deklarohet i pavlefshëm me kërkesën e palës **nuk krijojnë asnjë pasojë juridike** (theksimi sipas origjinalit).”⁷⁵ Ky pohim nuk është i vërtetë në procedurën penale, ku arsye të forta të ekonomisë gjyqësore diktojnë nevojën e ruajtjes së pasojave që prodhojnë aktet e pavlefshme. Një akt i pavlefshëm, madje edhe absolutisht i tillë, i prodhon pasojat, ndonëse veprimi i tyre, normalisht, duhet të jetë i përkohshëm. Ato vazhdojnë të prodhojnë pasoja deri në çastin e korrigjimit apo të deklarimit të pavlefshmërisë së aktit. Por, nuk përjashtohet mundësia që akti absolutisht i pavlefshëm t’i ruajë pasojat e tij në rastet kur vendimi i formës së prerë nuk çënohet pas paraqitjes së rekursit dhe nuk krijohet hapësirë për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, edhe pas goditjes së tij për pakushtetutshmëri para Gjykatës Kushtetuese.

Si përfundim, mund të pohohet se kriteri dallues i pavlefshmërive absolute nga llojet e tjera të pavlefshmërive është jo vetëm mundësia e konstatimit dhe ngritjes së tyre *ex officio* (sigurisht, pa paragjykuar edhe të drejtën e palëve), në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, por edhe pamundësia e korrigjimit të tyre deri në çastin kur vendimi gjyqësor bëhet praktikisht i përvokueshëm.

Le të analizojmë, në vijim, rastet e pavlefshmërisë absolute që parashikon Kodi ynë i procedurës penale, në lidhje me jurisprudencën më përfaqësuese të Gjykatës së Lartë në këtë fushë.

§ 2.2.1 Rastet e pavlefshmërisë absolute që lidhen me gjyqtarin

Neni 128.1, shkronja “a”, i KPP sanksionon posaçërisht me pavlefshmëri absolute rastet kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me *I- kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete* dhe *II- numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod*.

I. Pjesa e parë e paragrafit “a” i referohet rastit shumë të rëndësishëm të përmbushjes së kushteve për të qenë gjyqtar i një çështjeje të caktuar, në kuptimin e aftësisë për ta fituar këtë të drejtë, por edhe në kuptimin e detyrimit për ta ushtruar atë, në respekt të plotë të normave që vendos rendi juridik. Kushtet për të fituar të drejtën për të ushtruar funksione juridiksionale parashikohen në ligjin “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”⁷⁶.

Këtu mund të shtrohen për diskutim rastet hipotetike të ushtrimit të funksioneve të gjyqtarit nga një person që nuk është emëruar ligjërisht në këtë detyrë, apo vazhdimi i ushtrimit të funksioneve edhe pas daljes në pension. Raste të tilla, ndonëse në dukje shumë teorike, janë bërë

⁷⁴ Në të drejtën civile vepron parimi i së drejtës klasike “*quod nullum est, nullum producit effectum*” (Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike, neni 92 i Kodit Civil).

⁷⁵ Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir, Procedura penale, *Komentar*, Botimet Morava, Tiranë 2003, faqe 192.

⁷⁶ Ligj nr.9877, datë 18.2.2008, ndryshuar me ligjin nr.114/2013, datë 11.4.2013.

objekt debati në doktrinën dhe jurisprudencën italiane. Në hipotezën e parë, pranohet se akti vesohet nga një sanksion më i rëndë se pavlefshmëria absolute, i quajtur “*mosqënia juridike e aktit*”⁷⁷ (shih në vijim § 2.3), për shkak se ai është kryer nga një *non iudex*⁷⁸. Në hipotezën e dytë, Gjykata e Kasacionit dallon vendimin *si akt vullneti* me shpalljen e tij përmes leximit në seancë publike dhe vendimin *si akt i shkruar*, i cili realizohet me arsyetimin, nënshkrimin dhe depozitimin e tij. Për atë Gjykatë, rëndësi ka momenti i shpalljes në seancë publike; nënshkrimi i tij në një datë të mëvonshme nga dita e daljes në pension, nuk ka ndikim në vlefshmërinë e aktit⁷⁹, edhe pse praktikisht ai është nënshkruar nga një person që nuk gëzon më cilësinë e gjyqtarit. Qëndrimi i jurisprudencës është i njëjtë edhe në rastin kur gjyqtari, pas shpalljes së vendimit, është emëruar në një detyrë tjetër, por ka nënshkruar vendimin e arsyetuar⁸⁰.

I.1 Në praktikën tonë gjyqësore, lidhur me kriterin e përmbushjes së kushteve për të qenë gjyqtar në një çështje konkrete, ka patur një debat shumë interesant lidhur me rastet kur një gjyqtar, në përbërje të një trupi gjykues të zgjedhur me short, për shkaqe të ndryshme, zëvendësohet nga një gjyqtar tjetër, por që nuk është përzgjedhur sipas procedurës së shortit, që parashikon neni 15 i ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”⁸¹ (neni 9 i ligjit në fuqi⁸²). Le të analizojmë në vijim, rastet gjyqësore objekt debati:

Rasti i parë që çeli praktikën gjyqësore u shënuar në vitin 2006⁸³. Pa qenë nevoja të hyjmë në themel të çështjes, ai paraqitet si vijon: në shkallën e parë, trupi gjykues prej pesë gjyqtarësh, i zgjedhur me short, ka vazhduar gjykimin për disa seanca, nga data 17 maj deri në datën 23 nëntor 2004. Përkishtë në këtë datë, në mungesë të njërit prej gjyqtarëve (*me sa duket për shkaqe shëndetësore ose shërbimi*), ai u zëvendësua nga një gjyqtar tjetër, *me urdhër të kryetarit të gjykatës*. Në seancën pasardhëse të datës 3 dhjetor 2004, sipas së njëjtës procedurë, është kryer rizëvendësimi nga gjyqtari i mëparshëm.

Gjykimi ka vazhduar për katër seanca të tjera, por në seancën e datës 21 shkurt 2005, një anëtar tjetër i trupit gjykues nuk është paraqitur për arsye shëndetësore. Për të mos shtyrë seancën, u procedua me zëvendësimin e tij, *përsëri me urdhër të kryetarit të gjykatës*. Në seancën pasardhëse të datës 7 mars 2005 u rivendos përbërja e mëparshme e trupit gjykues, sipas të njëjtës procedurë.

Gjykata e apelit për krime të rënda e prishi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e kthyeu çështjen për rigjykim, me trup tjetër gjykues. Apeli iu referua nenit 128.1/a të KPP duke e konsideruar vendimin e gjykatës së shkallës së parë si akt absolutisht të pavlefshëm, për mosrespektim të dispozitave që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete.

⁷⁷ “... aktet gjyqësore eventualisht të kryera do të konsiderohen juridikisht të paqena, përderisa janë kryer nga një *non iudex*”. Tek Cavallari V., Commento al nuovo codice di procedura penale, a cura di M. Chiavario, UTET, Torino 1990, faqe 293. Cituar nga Di Geronimo Paolo, La nullità degli atti nel processo penale, *Fatto & Diritto*, Collana diretta da Paolo Cendon, Giuffrè Editore, faqe 42 (Për kuptimin e akteve të paqena, shih në vijim §2.3).

⁷⁸ Me termin latin *non iudex*, në këtë rast, kuptohet një subjekt që nuk i gëzon cilësitë e gjyqtarit.

⁷⁹ Cass. Sez. VI, vendim i datës 3.6.1993, i pand. De Tommasi. Tek Di Geronimo Paolo, *vep. e cit.*, faqe 43-44.

⁸⁰ Cass. pen., sez. V, vendim n. 9047, 15 korrik 1999 (seanca 15 qershor 1999), të pand. Larini S., etj.; tek Il codice di procedura penale, annotato con la giurisprudenza, a cura di Piermaria Corso, 3^a edizione, CELT CasaEditriceLaTribuna, 2004, faqe 130-131.

⁸¹ Neni 15 – Ndarja e çështjeve gjyqësore në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor bëhet me short sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

⁸² Neni 9. Ndarja e çështjeve gjyqësore - Ndarja e çështjeve gjyqësore bëhet me short, sipas procedurave të caktuara me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

⁸³ Nr. 769 i Vendimit, datë 20.12.2006, Kabashi, etj.

Kundër këtij vendimi ushtroi rekurs prokurori, por kolegji penal i Gjykatës së Lartë nuk e pranoi rekursin e tij, duke lënë në fuqi vendimin e apelit me arsyetimin: “... *përderisa ndryshimi i trupit gjykues është bërë me urdhër* (pra, jo me short sikurse normonte neni 15 i ligjit – shënimi ynë), *jashtë rregullimeve procedurale, ky trup gjykues nuk ka patur numrin e gjyqtarëve të domosdoshëm për formimin e tij, pra ka qenë me 4 gjyqtarë, duke qenë kështu një nga rastet që, në kuptim të pikës 1 të nenit 128 të K.Pr.P., e bëjnë vendimin një akt absolutisht të pavlefshëm.*”

Të njëjtën situatë juridike paraqit edhe një rast i mëvonshëm⁸⁴. Edhe në këtë rast, gjatë gjykimit në shkallë të parë, njëri nga anëtarët e trupit gjykues u zëvendësua me urdhër të kryetarit të gjykatës, për një seancë të vetme. Seancën e radhës, sipas së njëjtës procedurë, u krye përsëri rizëvendësimi. Gjykata e apelit për krime të rënda e prishi vendimin, duke i qëndruar jurisprudencës së mëparshme. Por, edhe kolegji penal i Gjykatës së Lartë e la në fuqi vendimin e apelit, me të njëjtin arsyetim si në vendimin e tij Nr. 769, datë 20.12.2006.

Për të dy vendimet e sipërcituara të kolegjit, të marra me shumicë votash, paraqit interes studimi i mendimit të gjyqtarëve në pakicë⁸⁵. Në rastin e vendimit Nr. 769, datë 20.12.2006, ata nuk pajtohen me mendimin e shumicës duke parashtruar këto argumente:

1. Me aktin e ankimit, palët nuk kanë pretenduar shkelje të ligjit apo qoftë edhe parregullsi në formimin e trupit gjykues. Madje, në seancë gjyqësore, palët janë pyetur dhe nuk kanë patur pretendime për përbërjen e re të gjykatës;

2. Zëvendësimi i njërit prej anëtarëve të trupit gjykues me urdhër të kryetarit nuk vjen ndesh me nenin 15 të ligjit organik “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor ...*”⁸⁶ Kjo dispozitë bën fjalë “... *për ndarjen e çështjeve gjyqësore midis gjyqtarëve të një gjykate ... për të caktuar gjyqtarin relator dhe jo edhe për gjyqtarët e tjerë që do të marrin pjesë ...*”. Kjo është edhe praktika që kanë ndjekur gjykatat, përfshi këtu edhe Gjykatën e Lartë;

3. Nuk ka asnjëlloj lidhje midis nocionit të pavlefshmërisë absolute të akteve me kërkesat e nenit 15 të ligjit organik, i cili për procedurat e shortit referon në një ligj tjetër që ende nuk është miratuar;

4. Nuk çenohet paanësia e gjykatës dhe standartet që vendos neni 6.1 i KEDNJ-së, madje urdhëri me shkrim përbën një “... *formë më efektive të garantimit të transparencës në raport me palët ...*” se sa “*zëvendësimet e imponuara*” dhe siguron zhvillimin e gjykimit të pandërprerë, sipas parimit që vendos neni 342 i KPP;

5. Në dy seancat ku patën marrë pjesë gjyqtarët zëvendësues nuk u administruan dhe as u shqyrtuan prova.

Duke arsyetuar mendimin e kundërt lidhur me vendimin Nr.64, datë 14.02.2007, pakica u shton argumenteve të mësipërme, edhe dy të tjera:

6. Zëvendësimi i gjyqtarëve me urdhër, megjithëse është një veprim “*ekstraprocedural*”, nuk e bën procesin proceduralisht të cënueshëm, sepse shorti nuk është veprim procedural i parashikuar dhe i detyrueshëm nga Kodi. Një ligj, qoftë edhe organik, nuk mund të barazohet me ligjin procedural penal;

7. Kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete u referohen neneve 15 dhe 16 të Kodit, ndaj zgjerimi i rasteve të pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale është jo vetëm ligjërisht i

⁸⁴ Nr. 64 i Vendimit, datë 14.02.2007, Rustemi.

⁸⁵ Në të dy rastet, shqyrtimi në Gjykatën e Lartë është bërë nga i njëjti Kolegj.

⁸⁶ Ligj nr. 8436, datë 28.12.1998, në fuqi nga data 7.1.1999 (*Fletorja Zyrtare Nr. 33, Viti 1998*). Ky ligj iu nënshtrua disa ndryshimeve dhe shtesave, në vitet 1999, 2000, 2001, 2003 dhe, me ligjin nr.9877, datë 18.2.2008, u shfuqizua.

palejueshëm, por edhe i dëmshëm në aspektin e kërkesave kohore brenda të cilave duhet të përfundojë procesi penal.

Nuk mund të pajtohem me disa prej argumenteve të parashtruara nga pakica. Diskutohet pavlefshmëria absolute e vendimit për shkak të përbërjes së trupit gjykues, ndaj nuk ka fare rëndësi që ky aspekt i problemit nuk është ngritur nga palët (*argumenti 1*). Cilësimi i urdhërit të kryetarit si formë transparente komunikimi (*argumenti 4*), na duket një largim i papërligjur nga standartet që vendosin Kodi, Kushtetuta dhe Kartat ndërkombëtare lidhur me paanësinë e gjykatës. Ndryshimi apo rindryshimi i përbërjes së trupit gjykues me urdhër të kryetarit, nuk mund t'u krijojë siguri palëve se po gjykohen nga një gjykatë e paanshme e krijuar me ligj, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Edhe interpretimi i nenit 15 të ligjit organik (*argumenti 2*) na duket shumë i zgjeruar. Caktimi me short vetëm i relatorit nuk krijon siguri, për palët ndërgjyqëse dhe për qytetarët, se çështjet do të gjykohen nga një gjykatë e paanshme. Nëse ligji do të synonte zgjedhjen me short vetëm të relatorit, atëherë zgjedhja e shumicës së anëtarëve të kolegjeve që paracakton Kodi do të bëhej në mënyrë subjektive dhe nuk do të mund të bëhej fjalë për një gjykatë të paanshme, të krijuar me ligj.

Pa dashur të zgjatemi më tej në analizën e argumenteve të pakicës, mendojmë se për rastet e shqyrtuara nga kolegji penal, më i pranueshëm na duket qëndrimi i mbajtur nga shumica, ndonëse argumentimi i vendimit duket se vuan nga mangësi në planin analitik, që hera-herës ta lëkundin bindjen për drejtësinë e tij. Nuk mund të ndajmë të njëjtin mendim me pakicën se, për rastet e pavlefshmërisë absolute që lidhet me kushtet për të qenë gjyqtar në një çështje konkrete, ligjvënësi ka dashur t'i referohet vetëm Kodit dhe jo ligjeve që rregullojnë organizimin e pushtetit gjyqësor, apo kushteve dhe procedurave të emërimit në detyrë të gjyqtarëve. Një ndër kushtet që duhet përmbushur për të qenë gjyqtar i paanshëm në një çështje konkrete është përzgjedhja paraprake vetëm me anën e shortit. Nga kjo procedurë nuk ka pse të bëjnë përjashtim rastet e zëvendësimit të njërit prej antarëve të trupit gjykues, edhe kur shkak që mund të diktojë këtë zëvendësim do të ishte krejt i rastit dhe pa lidhje me themelin e çështjes në shqyrtim apo me palët në proces. Duke qenë se, në rastet e shkeljes së rregullave të shortit, çenohet njëri prej kushteve për të qenë gjyqtar i asaj çështjeje, prodhohet pavlefshmëri absolute (*neni 128.1/a i Kodit*), e cila mund të ngrihet edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit. Në këtë këndvështrim, vendimi i shumicës, ndonëse tepër formalist, na duket i mbështetur në ligj dhe i drejtë.

Argumenti më logjik i pakicës na duket *argumenti 5*: në seancat e zhvilluara me gjyqtarët zëvendësues nuk u administruan dhe as nuk u vlerësuan prova, pra në thelb, qënia e tyre në përbërje të trupit gjykues nuk ndikoi në dhënien e drejtësisë. Në këtë rast, pranimi i zgjidhjes së sugjeruar nga pakica, duke i tërhequr vëmendjen gjykatës së shkallës së parë për mënyrën e gabuar të ndryshimit të trupit gjykues, mund të ishte një zgjidhje më pragmatiste në funksion të zgjidhjes së çështjes brenda një afati të arsyeshëm, por mund t'i hapte rrugën një praktike gjyqësore që, rastet e pakorrigjueshme të pavlefshmërive absolute, do t'i interpretonte rast pas rasti, vartësisht nga norma e shkelur dhe pasojat që ajo do të shkaktonte, interpretim që duket se i largohet vullnetit të ligjvënësit.

Praktika e zëvendësimit të gjyqtarit me urdhër konstatohet edhe në praktika të mëvonshme gjyqësore⁸⁷. Kolegji penal i ka qëndruar jurisprudencës së mëparshme, duke konstatuar

⁸⁷ Shih përmbajtjen e vendimit të kolegjit Nr.00-2010-392 i Vendimit (185), datë 3.3.2010, Nikolla.

pavlefshmëri absolute për shkak të cënimit të kushteve që parasheh ligji për të qenë gjyqtar në një çështje konkrete⁸⁸.

Gjykata e Lartë iu rikthye së njëjtës tematikë në vitin 2011, duke dashur ta zgjidhë përfundimisht këtë problem, me anën e një vendimi unifikues⁸⁹. Rasti ishte gati identik: në përbërje të trupit gjykues, gjatë gjykimit në shkallë të parë, të cilët nuk u caktuan me short, por njëri me urdhër të kryetarit, kurse tjetri pa ndonjë akt të veçantë ku të tregoheshin shkaqet e zëvendësimit të gjyqtarit tjetër. Edhe njëherë tjetër, Gjykata e Lartë e konsideroi rregullin e shortit të barazvlefshëm me rregullat procedurale që normojnë përbërjen e trupit gjykues, me pasojë cënimin e procesit të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës së palëve për t'u gjykuar nga një gjykatë “*e krijuar me ligj*”, me pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit⁹⁰.

Edhe zgjidhja që caktoi ky vendim kaloi përmes debatesh, ngaqë një pjesë e antarëve të Kolegjeve të Bashkuara mbeti në pakicë, ndonëse argumenti i tyre, që kërkon si parakusht kontestimin e gjyqtarëve zëvendësues nga palët, nuk është bindës⁹¹ dhe nuk i qëndron logjikës së ligjvënësisë që pavlefshmëritë e natyrës absolute ngrihen edhe kryesisht, pavarësisht nga vullneti i palës që i cënohet e drejta. Në këtë këndvështrim, çmojmë se Kolegjet e Bashkuara kanë orientuar një zgjidhje të drejtë dhe të mbështetur në ligj. Por, edhe pas këtij vendimi, ka raste kur jurisprudenca e Gjykatës së Lartë i qëndron mendimit të pakicës⁹².

⁸⁸ “Duke formuar trupin gjykues në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurave Penale, sipas të cilave largimi i një gjyqtari nga trupi gjykues behet vetëm duke dhënë ai dorëheqjen, ose pas shqyrtimit dhe pranimit të kërkesës së palëve për përjashtimin e tij (nenet 17 dhe 18 të këtij Kodi), në fakt është kryer një shkelje procedurale që, sipas dispozitës së nenit 128/1-a të K.Pr.Penale, e bëjnë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, absolutisht të pavlefshëm.

Po kështu, Kolegji çmon se edhe akti i nënshkruar nga kryetari i gjykatës së rrethit, me të cilin ai cakton një gjyqtar në përberje të trupit gjykues, vjen ndesh me rregullimet procedurale penale, mbasi në asnjë prej dispozitave të K.Pr.Penale, kryetari i gjykatës nuk rezulton të ketë të drejtën procedurale për zëvendësimin e trupit gjykues, i cili në fakt, sipas parashikimeve të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “*Per organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*” realizohet me short.”

⁸⁹ Vendimi unifikues nr.2, datë 24.1.2011, Salis, etj.

⁹⁰ “11. ... Duke qënë se cënojnë drejtpërdrejt dhe në thelb parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës) dhe të drejtën e njeriut për t'u gjykuar nga një gjykatë “*e caktuar me ligj*” (nenet 15 dhe 42/2), përbën cënim të procesit të rregullt ligjor thjesht dhe vetëm shkelja e rregullave normative që parashikohen nga ligji për mënyrën e formimit të rregullt të përbërjes nominative të gjykatës në çështjen konkrete. Në kuptim e zbatim të drejtë të nenit 128, pika 1, shkronja “a” të K.Pr.Penale, aktet e nxjerra nga ajo gjykatë dhe vendimet e dhëna prej saj janë absolutisht të pavlefshme (theksimi sipas Vendimit Unifikues).

⁹¹ “21. Për rastin në shqyrtim, vlerësojmë se zëvendësimi i gjyqtarëve i pa kontestuar nga palët nuk përbën cënim të procesit të rregullt ligjor dhe nuk mund të sjellë pavlefshmëri absolute. Për rrjedhojë nuk ndodhemi përpara mosrespektimit të parimeve kushtetuese të zhvillimit të një procesi gjyqësor nga një gjykatë e paanëshme dhe e caktuar me ligj, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut” (citim nga mendimi i gjyqtarëve në pakicë).

⁹² Nr.00-2013-1124 i Vendimit (223), datë 10.7.13, Ymeri: “28. Kolegji Penal, pavarësisht se konstaton se në mënyrën e formimit të trupit gjykues konstaton dhunim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, në mënyrën se si është përfshirë gjyqtari B.H në përbërjen e trupit gjykues në kundërshtim me procedurat për zëvendësimin e anëtarit nëpërmjet shortit, si dhe caktimin prej tij të masës së sigurimit gjatë fazës së hetimit, këto shkelje nuk e kanë cenuar në thelb procesin e rregullt ligjor. Rezulton se përbërja jo e rregullt e trupit gjykues në lidhje me

Si përfundim, mund të themi se shkelja e rregullit për zgjedhjen e gjyqtarit me short, sipas nenit 9 të ligjit Nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ose nenit 15 i ligjit të shfuqizuar), shkakton pavlefshmëri absolute që çënon “kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete”, me pasojë pavlefshmërinë absolute të aktit, në bazë të nenit 128.1, shkronja a) të KPP.

I.2 Si problem të lidhur ngushtë me kushtet për të ushtruar funksionet e gjyqtarit në një çështje konkrete, praktika gjyqësore ka propozuar edhe rastet e gjykimit nga një gjykatë jokompetente në lëndë. Gjykata Kushtetuese, me një vendim të vitit 2007⁹³, duke iu referuar Kushtetutës, pohoi se “shprehja “gjykatë ... e caktuar me ligj” në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete”. Sipas Gjykatës Kushtetuese, kompetenca lëndore e gjykatës është e lidhur ngushtë me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete, ndaj fjala “ligj” përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave.

Kjo ide u zhvillua më tej, në vitin 2009, kur ajo Gjykatë theksoi se “... nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është “e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane”⁹⁴. Rasti në fjalë ka të bëjë me një çështje, e cila u gjykua nga gjykata për krime të rënda, ndonëse sipas ligjit në fuqi, në kohën e gjykimit të çështjes⁹⁵, kompetenca lëndore nuk i përkiste më gjykatave të krimeve të rënda, por gjykatave të zakonshme të rretheve gjyqësore.

Gjykata e ligjeve pranoi se detyrimi i respektimit të kufijve brenda të cilave ushtrohet juridiksioni gjyqësor është një çështje që lidhet me nenet 4/1 (*parimi i ligjshmërisë*) dhe 34 (*parimi ne bis in idem*) të Kushtetutës, ndaj ushtrimi i juridiksionit tej kompetencave të përcaktuara nga ligji mund të merret në shqyrtim kur shkelja e procedurës çënon të drejtat

pjesëmarrjen e gjyqtarit B.H ka qenë vetëm në seancën e verifikimit të masës së sigurimit të zhvilluar në datë 24.03.2009. Më tej procesi ka vazhduar me përbërjen e trupit gjykues të caktuar me short. Në këtë seancë nuk rezultoi të jenë marrë prova të cilat të jenë përdorur nga gjykata në vendimmarrjen përfundimtare, prandaj nuk ka sjellë ndonjë pasojë në procesin e të provuarit që do të çonte në pavlefshmërinë absolute të akteve të gjykimit, përfshi dhe vendimin përfundimtar.

29. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se pavarësisht se zëvendësimi i një anëtari të trupit gjykues është bërë jo me procedurën e rregullt ligjore, pasi duhej të ishte bërë nëpërmjet shortit, por me urdhër të brendshëm të kryetarit të gjykatës, kjo është nga ato parregullsi e cila nuk cenon thelbin e procesit të rregullt ligjor. Ashtu siç shprehet edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.21/2008 “... jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues, ...ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit...”.

⁹³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 17.04.2007, kërkues Koçiu, etj.

⁹⁴ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 23.4.2009, kërkues Bazelli.

⁹⁵ Ligji nr.9276, datë 16.09.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, neni 4.

kushtetuese për proces të rregullt ligjor⁹⁶, pasi lidhet me respektimin e të drejtës kushtetuese për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.

Gjykata Kushtetuese pranoi se cënimi i rregullave për kompetencën lëndore shkakton pavlefshmëri absolute, në ndryshim nga cënimi i kompetencës tokësore, e cila shkakton pavlefshmëri të natyrës relative⁹⁷. Ky pohim i Gjykatës, sidomos në rastin e pavlefshmërisë relative, duket sikur e tejkalon vullnetin e ligjvënësit, sepse shkelja e dispozitave për kompetencën nuk sanksionohet me pavlefshmëri në tekstin e Kodit. Por, ky qëndrim gjen një pikëmbështetje në nenin 83 të KPP⁹⁸, i cili normon një regjim juridik të ndryshëm të ngritjes së moskompetencës lëndore dhe tokësore: në rastin e parë, edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procesit (tipike për pavlefshmëritë absolute), kurse në rastin e dytë, nga pala e interesuar dhe vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor (tipike për pavlefshmëritë relative).

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, lidhur me raportin mes cënimit të rregullave për kompetencën lëndore dhe procesit të rregullt ligjor, ka gjetur zbatim në disa vendime të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë. Dy raste janë gati identike me rastin Bazelli⁹⁹, kurse në një rast tjetër¹⁰⁰, ndonëse nuk është shkaku thelbësor i prishjes së vendimit, kolegji ka konstatuar pavlefshmëri absolute për shkak se i pandehuri nuk është gjykuar, në shkallë të parë, nga gjykata ushtarake, por nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm.

I.3. Kushtet për të qenë gjyqtar në një çështje konkrete, plotësohen ose jo edhe varësisht nga fakti i pjesëmarrjes së mëparshme në procedim; respektimi i tyre i siguron gjyqtarit përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji, në planin e pozitës së tij *super partes* në proces. Qëllimi i normës është që të sigurojë parimin e paanësisë dhe objektivitetin e gjyqtarit në procesin e gjykimit. Këto kushte parashikohen në ligjin procedural penal, para së gjithash në dispozitën referuese, nenin 15 të KPP¹⁰¹.

⁹⁶ "... tejkallimet e kompetencave mund të merren në shqyrtim prej kësaj Gjykate kur ka patur një shkelje të tillë të ligjit procedural që ka cënuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Detyrimi i respektimit nga gjyqtari të kufirit të kompetencës është ndër të tjera parakusht për të mos lejuar që shumë gjyqtarë të ushtrojnë të njëjtin pushtet me vendime për një fakt të caktuar, duke cënuar parimin kushtetues të ligjshmërisë apo të gjykimit të një personi dy herë për të njëjtën vepër (*ne bis in idem*), të parashikuar përkatësisht në nenet 4/1 dhe 34 të Kushtetutës. Prandaj, për çdo rast dhe çështje të mundshme, ligji ka parashikuar një gjykatë kompetente për të gjykuar." (citimi sipas vendimit)

⁹⁷ "Mosrespektimi i kompetencës lëndore e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm dhe pretendimi për respektimin e kësaj kompetence mund të ngrihet si nga i pandehuri/i gjykuari, ashtu edhe kryesisht në çdo fazë të procesit. Në ndryshim nga kompetenca lëndore, akti i dhënë në mungesë të kompetencës tokësore është një akt relativisht i pavlefshëm dhe deklarohet si i tillë nga gjykata mbi kërkesën e palëve, bërë para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor." (citimi sipas vendimit)

⁹⁸ Neni 83. Moskompetenca – 1. Moskompetenca lëndore ngrihet, edhe kryesisht, në çdo gjendje e shkallë të procesit. 2. Moskompetenca tokësore dhe ajo që rrjedh nga bashkimi i procedimeve për shkak lidhje, mund të ngrihet ose të kundërshtohet, vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor.

⁹⁹ Nr.00-2010-266 i Vendimit (135), datë 17.2.2010, Lleshi; Nr.00-2010-399 i Vendimit (220), datë 10.3.2010, Bajramaj.

¹⁰⁰ Nr.00-2011-216 i Vendimit (42), 23.2.2011, Lepuri.

¹⁰¹ Neni 15. Papajtueshmëria për shkak të pjesëmarrjes në procedim - 1. Gjyqtari që ka dhënë ose që ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë të procedimit nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit në shkallët e tjera, as të marrë pjesë në rigjykim pas prishjes së vendimit.

Neni 15 i Kodit normon papajtueshmërinë e gjyqtarit me ushtrimin e funksioneve, pra kushtet për të qenë gjyqtar në një çështje konkrete, *për shkak të pjesëmarrjes në procedim*, duke parashikuar tri raste të posaçme që, në lidhje me nenin 128.1/a, në rast mosrespektimi, passjellin pavlefshmëri absolute. Këtyre rasteve u bashkohet edhe situata që rregullon neni 16 i këtij Kodi. Le t'i analizojmë në vijim rastet e përmendura më sipër:

I.3-i Në paragrafin 1, kjo dispozitë ndalon shprehimisht që i njëjti gjyqtar që ka dhënë ose që ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në njërën shkallë të gjykimit, të lejohet të ushtrojë funksionet:

- në shkallët e tjera të gjykimit;
- në rigjykim, pas prishjes së vendimit.

Norma në fjalë synon të mbrojë paanësinë e gjykimit, objektivitetin e drejtësisë penale dhe prestigjin e gjyqësorit. Gjyqtari që është shprehur me vendim në njërën shkallë të gjykimit, gjatë gjykimit në shkallën tjetër ose në rigjykim pas prishjes, vështirë se mund të qëndrojë i pandikuar nga zgjidhja që u ka dhënë çështjeve të faktit dhe të së drejtës në gjykimin e mëparshëm. Por, edhe sikur të ndryshonte mendim për shkak të parimit të objektivitetit, një gjyqtar që zgjidh të njëjtën çështje në mënyra të ndryshme bëhet i pabesueshëm për palët dhe për opinionin publik.

Vërejmë se dispozita pengon gjyqtarin që *“që ka dhënë ose që ka marrë pjesë në dhënien e vendimit ...”* në njërën shkallë të gjykimit. Interpretimi gramatikor i normës të çon në përfundimin se *nuk pengohet gjyqtari, i cili mund të ketë marrë pjesë në gjykim, por nuk ka qenë pjesë e trupës gjyqësore në dhënien e vendimit, në vendimmarrje*. Ky interpretim gjykojmë se është i drejtë, pasi vetëm në procesin e marrjes dhe të kumtimit të vendimit gjyqtari shfaq për palët dhe publikun qëndrimin e tij për çështjet e faktit dhe të ligjit që ka marrë në shqyrtim. Ky interpretim përputhet edhe me kuptimin e modelit ku është mbështetur ligjvënësi për ndërtimin e kësaj norme¹⁰².

Pra, mund të përfundojmë që nuk është i penguar për të marrë pjesë në shkallët e tjera të gjykimit ose në rigjykim pas prishjes gjyqtari që, ndonëse ka marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor, nuk ka qenë pjesë e vendimmarrjes në përfundim të procesit.

Por, sikurse shihet, ligjvënësi ka harruar të normojë ndalimin që gjyqtari, i cili ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në njërën shkallë, të pengohet të marrë pjesë në rishikimin e vendimit (*nenet 449 e vijues të Kodit*); vërejmë se një rast tipik është marrë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese, e cila me të drejtë e ka konsideruar cënim të parimit të paanshmërisë në gjykimin faktin që katër gjyqtarë, që gjykuan rekursin e të pandehurit, morën pjesë edhe në

2. Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit ose çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim.

3. Nuk mund të ushtrojë në të njëjtin procedim detyrën e gjyqtarit ai që ka qenë prokuror ose që ka kryer veprime të policisë gjyqësore ose që ka qenë mbrojtës, përfaqësues i një pale ose dëshmitar, ekspert ose që ka paraqitur një kallëzim, ankim, kërkesë për procedim ose që ka dhënë apo ka marrë pjesë në dhënien e vendimit për autorizimin e procedimit.

¹⁰² Art. 34. Incompatibilità determinata da atti compiuti nel procedimento — 1. Il giudice che ha pronunciato o ha concorso a pronunciare sentenza in un grado del procedimento non può esercitare funzioni di giudice negli altri gradi, né partecipare al giudizio di rinvio dopo l'annullamento o al giudizio per revisione (theksimet janë tonat).

përbërje të kolegjit që rrëzoi kërkesën e të gjykuarit për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë¹⁰³.

Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, ndër vite, vërejmë se ka orientuar edhe zgjidhje të debatueshme. Duke qenë se paanësia dhe objektiviteti lidhen drejtpërsëdrejti me parimet e procesit të rregullt ligjor, në këtë temë, ka ndërhyrë edhe Gjykata Kushtetuese. Le të shohim, në vijim, disa raste tipike që lidhen pikërisht me problemin që po diskutojmë:

Rasti vijues lidhet me një vendim të kolegjit, të vitit 2010¹⁰⁴, ku papajtueshmëria lidhur me pjesëmarrjen në gjykime të mëparshme interpretohet vartësisht nga fakti nëse gjyqtari i kontestuar ka shqyrtuar themelin e akuzave apo vetëm procedurën. Rasti i përket një çështjeje të gjykuar në gjykatën e apelit Shkodër, e transferuar më vonë, për shkak të kompetencës lëndore, në gjykatën për krime të rënda. Në rekursin e saj mbrojtja ngriti problemin e papajtueshmërisë të dy gjyqtarëve, të cilët patën gjykuar çështjen edhe në gjykatën e apelit Shkodër¹⁰⁵. Kolegji penal vlerësoi se vendimi është i cënueshëm, por vetëm për shkak të pjesëmarrjes në gjykim të gjyqtarit DH.H., e cila pati vendosur për kthimin e çështjes në shkallë të parë, për mangësi në procedurat e njoftimit¹⁰⁶. Për gjyqtarin tjetër, kolegji çmoi se nuk ka papajtueshmëri ngaqë, ndonëse pati gjykuar të njëjtën çështje, pati vendosur vetëm lidhur me procedurën e rivendosjes në afat (duke e pushuar gjykimin), pa gjykuar themelin e akuzave¹⁰⁷.

¹⁰³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.70, datë 17.11.2015, kërkuar Doda: “25. Edhe pse vlerësimet që gjyqtarët E.I., SH.S., T.N. dhe A.Z. kanë bërë gjatë shqyrtimit të rekursit në dhomë këshillimi formalisht janë të ndryshme nga ato të bëra prej tyre gjatë shqyrtimit, po në dhomë këshillimi, të kërkesës për rishikim, Gjykata vlerëson se pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuarit në të dyja gjykimet, ato lidhen, në fakt, me shqyrtimin e së njëjtës çështje gjyqësore. Në këto, kushte pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në këto dy gjykime nuk ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm të kërkuarit në lidhje me paanshmërinë e gjykatës, aq më tepër kur këta gjyqtarë përbëjnë shumicën në numër të trupit gjyqësor. Kur ekzistojnë kushtet që justifikojnë një dyshim të përligjur për anshmëri gjatë gjykimit, detyra e çdo gjyqtari është t’i shmangët gjykimin, në mënyrë që të mos cenohet rregullsinë e procesit gjyqësor (*shih vendimin nr.49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, pjesëmarrja e gjyqtarëve E.I., SH.S., T.N. dhe A.Z. në trupin gjyqësor që ka shqyrtuar kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë, ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tyre nga gjykimi, ka krijuar një dyshim të justifikuar të kërkuarit se vendimi i dhënë nuk ka qenë produkt i një procesi të paanshëm.” (shih, në të njëjtin vendim, edhe § C-1, 18, 22, 23)

¹⁰⁴ Nr.00-2010-1201 i Vendimit (851), datë 29.9.2010, Stragu.

¹⁰⁵ Dy gjyqtarët e gjykatës së apelit për krime të rënda, Dhurata Haveri dhe Gjovalin Përnoça, që kanë gjykuar të pandehurin Ded Stragu, kanë marrë pjesë në gjykimin e këtij të pandehuri kur kanë qenë gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Shkodër, konkretisht, me vendimet me nr.101, datë 27.05.2003 e nr.31, datë 04.03.2003, gjë që bie ndesh haptazi në kërkesat e nenit 15/1 të KPP.

¹⁰⁶ “...Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se u lejuan shkelje të dispozitave procedurale në formimin e trupit gjyqësor në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, në lidhje me praninë në përbërjen e tij të gjyqtarës Dh. Haveri. Rezulton se kjo gjyqtare ka qenë pjesë e trupës gjyqësore në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila pasi mori në shqyrtim çështjen penale konkrete, me vendimin nr.101, datë 27.05.2003 vendosi prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim (për mangësi në njoftimin e të gjykuarit). ... në marrjen e vendimit nr.101, datë 27.05.2003, Gjykata e Apelit Shkodër rezulton të ketë zhvilluar gjykimin e themelit të çështjes, pavarësisht se prishja e vendimit u vendos për shkak të mangësive procedurale që u lejuan nga Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër. Për këtë shkak, në vështrim të nenit 15, 128/1 të K.Pr.P., vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është i cënueshëm.” (citimi sipas vendimit)

¹⁰⁷ “Në lidhje me praninë në trupin gjyqësor të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda të gjyqtarit Gjovalin Përnoça, ky element procedural nuk përbën shkak për cënimin e vendimit.

Nuk mund të pajtohem tërësisht me vendimin e kolegjit, sepse gjykojmë se vendimi ishte i cënueshëm edhe për shkak të vendimmarrjes së gjyqtarit tjetër, pavarësisht se nuk pati gjykuar themelin e akuzave. Ai gjyqtar mori vendim, për të njëjtën çështje: pushoi gjykimin e rivendosjes në afat, duke mospranuar një kërkesë të të pandehurit. Kështu që ai e pati humbur garancinë e objektivitetit kundrejt palës që iu rrëzua kërkesa si pasojë e vendimmarrjes së tij.

Në një rast tjetër¹⁰⁸, gjykata e apelit Gjyrokastër prishi dhe ktheu për rigjykim në shkallën e parë një vendim të gjykatës së rrethit, për shkelje procedurale me pasojë pavlefshmërinë absolute të akteve. Pas rigjykimit, gjykata e apelit e la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë (me një ndryshim vetëm për sa i takonte masës së dënimit të zbatuar ndaj njërit prej të pandehurve). Si në gjykimin e parë, ashtu edhe pas rigjykimit, në trupin gjykues të gjykatës së apelit kanë marrë pjesë gjyqtarët M.Q. dhe I.B. Kolegji penal i Gjykatës së Lartë e prishi vendimin e gjykatës së apelit dhe e riktheu çështjen për rigjykim në të njëjtën gjykatë, me trup tjetër gjykues, duke iu referuar nenit 128.1/a në lidhje me nenin 15.1 të KPP.

Në këtë rast, të dy gjyqtarët kanë marrë pjesë dhe kanë dhënë vendim në gjykatën e apelit, pra, në të njëjtën shkallë të procedimit (pra, nuk kemi shkelje për shkak të ushtrimit të funksioneve në shkallë të tjera të gjykimin). Por, në këtë rast, mbetet vepruese pengesa që shkakton ushtrimi i funksioneve “në rigjykim, pas prishjes ...”. Gjyqtari pengohet nga ligji të marrë pjesë në rigjykim, pas prishjes së vendimit, çka nënkupton që kjo prishje mund të bëhet si nga ai vetë (*rasti i apelit*), ashtu edhe nga një gjykatë më e lartë. Në rastin konkret, gjykojmë se vendimi nr.2, datë 12.01.2005 i kolegjit penal të Gjykatës së Lartë është marrë në interpretim të drejtë të shkronjës dhe të frymës së nenit 15.1 të Kodit.

Një rast interesant, në këndvështrimin e respektimit të parimit të paanshmërisë në gjykim, për shkak të përbërjes së trupit gjykues, paraqet një vendim i kolegjit i vitit 2013¹⁰⁹. Rasti, me dy fjalë, mund të përmbledhet në pyetjen: a mund të shqyrtojë kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, gjyqtari i cili ka pasë qenë përjashtuar më parë¹¹⁰? Kolegji, me të drejtë, iu përgjigj negativisht kësaj pyetjeje, për shkak të njëanshmërisë, me pasojë cënimin e procesit të rregullt ligjor.

Kolegji penal nuk ka pranuar ekzistencën e kushteve të papajtueshmërisë në rastin kur pjesë e kolegjit që shqyrton themelin e akuzave, është edhe një gjyqtar, i cili ka rrëzuar ankimin e të pandehurit kundër vendimit të mosfillimit të procedimit ndaj prokurorit që procedonte¹¹¹.

Kjo si rrjedhojë e faktit se trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër ku bënte pjesë ky gjyqtar, është e vërtetë se ka shqyrtuar ankimin e të gjykuarit ndaj vendimit të themelit të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, porse ky trup gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër me vendimin nr.31, datë 04.03.2003 ka vendosur pushimin e gjykimin, pasi ka konstatuar se rivendosja në afat ishte bërë në kundërshtim me ligjin (me një gjyqtar), e për këtë arsye nuk iu fut shqyrtimit të themelit të çështjes, apo vlerësimit të shkaqeve që përmbante ankimi i të gjykuarit. Në këto kushte, nuk jemi përpara rasteve të parashikuara nga neni 15/1 i K.Pr.Penale.” (*citimi sipas vendimit*)

¹⁰⁸ Nr. 2 i Vendimit, datë 12.01.2005, Muçi, etj.

¹⁰⁹ Nr.00-2013-977 i Vendimit (178), datë 29.5.2013, Kelmendi.

¹¹⁰ “12. Në gjykimin në apel, i gjykuari A.K. ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit Fuat Vjerdha, kërkesë e cila është rrëzuar. Më pas kjo kërkesë është përsëritur, ...dhe është pranuar.

13. Në seancën e datës 07.06.2013, përfaqësuesi i të gjykuarit ka paraqitur një kërkesë për përjashtimin e relatorit të çështjes, gjyqtarin Luan Dervishi. Kjo kërkesë është gjykuar nga gjyqtar Fuat Vjerdha, i përjashtuar nga gjykimi sipas kërkesës më sipër dhe me vendimin datë 21.06.2012 është vendosur rrëzimi i kërkesës së përfaqësuesit të të gjykuarit A.K.....

22. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vëren se shkak i njëanshmërisë i anëtarit të përjashtuar të trupit gjykues, i cili ka vendosur mbi kërkesën për përjashtimin e një anëtari tjetër, është i bazuar.” (*citimi sipas vendimit*)

¹¹¹ Nr. 00-2012-1457 i Vendimit (268), datë 17.10.2012, Gjojeja.

Vendimi na duket i cënueshëm për shkak se, në këtë rast, gjyqtari ka humbur besimin e të pandehurit se do të gjykonte me paanshmëri dhe objektivitet, për shkak të rrëzimit të ankimit të paraqitur nga i pandehuri, lidhur me faktet e së njëjtës çështje.

Në rastin e bashkimit të dënimeve, me të drejtë, kolegji nuk ka konstatuar pavlefshmëri absolute kur gjyqtari që ka dhënë dënimet bën edhe bashkimin e tyre¹¹².

Përmendëm se, në temën që po diskutojmë, është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese¹¹³, e cila pati shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin Nr.600, datë 22.07.2005 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, në rrethanat vijuese: *kërkuesit parashtruan para saj faktin se njëri prej gjyqtarëve që pati gjykuar çështjen e tyre në përbërje të trupit gjykues të gjykatës së apelit Durrës, bënte pjesë në kolegjin penal të Gjykatës së Lartë (kolegji seleksionues), i cili pati vendosur, në dhomën e këshillimit, mospranimin e rekursit të paraqitur prej tyre. Kjo pjesëmarrje, sipas kërkuesve, çënoi të drejtën e tyre për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, që siguron neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.*

Gjykata Kushtetuese u dha të drejtë kërkuesve duke e shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin e ankimuar. Ajo Gjykatë, në arsyetimin e vendimit të saj, i referohet shprehimisht neni 15.1 të KPP, duke argumentuar se vlerësimi shumë i rëndësishëm nëse duhet të kalohen apo jo për shqyrtim në seancë gjyqësore rekursit kundër vendimeve penale të formës së prerë, duhet të bëhen *“...nga një gjykatë e paanshme.”* Në vijim të arsyetimit të saj, Gjykata Kushtetuese u shpreh: *“Është e papranueshme që një gjyqtar që ka marrë pjesë në dhënien e një vendimi në një shkallë të mëparshme të gjykimit (në rastin konkret në gjykatën e apelit), të jetë sërish në përbërje të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që do të shqyrtojë e vlerësojë shkaqet e rekursit që janë pikërisht kundër këtij vendimi.”*

Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën edhe vendimin Nr.810, datë 16.11.2005 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, në një rast identik¹¹⁴. Në të dy vendimet e saj, Gjykata e ligjeve i mëshon me forcë rëndësisë së parimit të paanshmërisë në kuptimin objektiv, i cili kërkon që drejtësia jo vetëm të bëhet, por edhe të shikohet se po bëhet, si nga palët ashtu edhe nga publiku¹¹⁵.

Parimit të paanshmërisë së gjyqtarit, në kuptimin objektiv dhe subjektiv, Gjykata Kushtetuese i është rikthyer në disa vendime të saj. Për ilustrim, po citojmë një vendim të vitit 2010¹¹⁶, veçanërisht i qartë në drejtim të zbatimit të parimit në fjalë.

¹¹² Nr.00-2011-429 i Vendimit (65), datë 28.4.11, Lleshi: *“Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dëshiron të theksojë se ndjekja e procedurës së mësipërme prej gjykatës është tërësisht në përputhje me nenin 470 të K.Pr.Penale, i cili parashikon se: “1. Gjykata që ka dhënë vendimin është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij. 2. Kur ekzekutimi ka të bëjë me disa vendime të dhëna nga gjykata të ndryshme, kompetente është gjykata që ka dhënë vendimin, i cili ka marrë formë të prerë i fundit”.*”

¹¹³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 13.04.2007, kërkues Elezi, Curri.

¹¹⁴ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 15.10.2007, kërkues Kaçi.

¹¹⁵ Për më shumë informacion lidhur me këtë temë mund të lexoni vendimin e GJEDNJ-së, në çështjen *Delcourt kundër Belgjikës*, 17.1.1970, cituar nga Gjykata Kushtetuese.

¹¹⁶ Vendimi Nr.21, datë 29.04.2010, kërkues Meçe, ku arsyetohet: *“12. Një nga elementët e rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është gjykimi i çështjes nga një gjykatë e paanshme. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në*

Por, në disa vendime të mëvonshme, na duket se Gjykata Kushtetuese e ka humbur koherencën, duke marrë vendime, në gjykimin tonë, të paargumentuara dhe në kundërshtim me jurisprudencën e qartë, të krijuar prej saj ndër vite, për raste të ngjashme. Bie fjala, në rastin kur të njëjtët gjyqtarë që zgjidhën themelin e çështjes në shkallë të parë, morën në shqyrtim edhe kërkesën e të njëjtit subjekt për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit¹¹⁷, ajo Gjykatë nuk konstatoi paanshmëri, duke krijuar konceptin e “vlerësimit për fakte të ndryshme”¹¹⁸. Me fjalë të tjera, nëse e njëjta gjykatë merr në shqyrtim dhe vendos për fakte të ndryshme, ndonëse të lidhura me të njëjtën çështje, garancitë e paanshmërisë nuk bjerren. Arsyetimi çalon për shkak se preket ai parim që vetë Gjykata Kushtetuese e ka theksuar vazhdimisht - testi objektiv i paanshmërisë: të njëjtët gjyqtarë që vendosën fajësinë e kërkuesit nuk mund të ofrojnë dot garancitë e mjaftueshme, për të përjashtuar çdo dyshim, se do të shqyrtonin me objektivitet kërkesën e tij për t’i rivendosur në afat të drejtën për t’u ankuar, pikërisht, kundër vendimit të dhënë prej tyre.

Në një rast tjetër, ku cënimi i parimit të paanshmërisë na rezulton tejet i dukshëm, Gjykata Kushtetuese nuk arriti dot të krijonte shumicën e duhur për të marrë vendim, fakt që e cënon autoritetin gati të paqortueshëm të jurisprudencës së saj, për zgjidhjen e rasteve të ngjashme¹¹⁹.

mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Gjykata çmon se paragjykimi eventual për paanshmëri dhe gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike, duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (shih vendimin nr. 12, datë 13.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

13. ... Gjykata ka theksuar se “...thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykoës, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar, se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje” (shih vendimin nr. 48, datë 30.07.1999 të Gjykatës Kushtetuese).”

¹¹⁷ Vendimi nr.8, datë 27.2.2014, kërkues Dhima.

¹¹⁸ “20. Gjykata vëren se në dispozitat e KPP-së ligjvënësi, në mënyrë të qartë, nuk ka parashikuar asnjë normë apo rast papajtueshmërie lidhur me pjesëmarrjen e gjyqtarit në gjykimin e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit. Vlerësimi që gjykata bën gjatë shqyrtimit në themel të çështjes (administrimi dhe vlerësimi i provave, analiza e elementeve të veprës penale me qëllim të dhënies së dënimit), është thellësisht i ndryshëm nga vlerësimi që bëhet në rastin e shqyrtimit të kërkesës për rivendosje në afat, i cili bazohet vetëm në vlerësimin e elementeve që kanë lejuar humbjen e afatit të paraqitjes së ankimit. Neni 15/1 i KPP-së parashikon papajtueshmërinë e gjyqtarit kur ai ka dhënë ose ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë tjetër të procedimit. Në rastin konkret, jo vetëm që nuk ndodhemi përpara një shkalle tjetër të procedimit, por ndodhemi para dy procedimeve të ndryshme, në të cilat gjyqtarit nuk i duhet të ndalet në të njëjtat vlerësime që kanë të bëjnë me përmbajtjen e të njëjtave fakte. Në këtë kuptim, qëllimi dhe natyra e veprimeve që këta gjyqtarë kanë kryer në të dy gjykimet, nuk janë të tilla që të vënë në dyshim paanshmërinë e gjykatës.

21. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatës, është i pabazuar.” (citimi sipas vendimit; shih, në të njëjtin vendim, edhe §A-16, 17, 19).

¹¹⁹ Vendimi nr.19, datë 2.4.2014, kërkues Beqiraj: “A) Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme

Si përfundim, lidhur me praktikën gjyqësore për rastet që lidhen me normën e vendosur nga neni 15.1, janë konstatuar paqartësi interpretuese, të cilat kanë diktuar ndërhyrjen e Gjykatës Kushtetuese, në disa raste. Zgjidhjet korrektuese të Gjykatës së ligjeve kanë qenë të sakta, ndonëse në disa vendime të fundit jurisprudenca e saj pasqyron paqëndrueshmëri parimore, duke e humbur koherencën e krijuar ndër vite. Shënojmë se, përmes vendimeve të marra me shumicë votash, kolegji penal ka orientuar drejt moslejimit të zëvendësimit të gjyqtarit të caktuar me short me anën e një akti administrativ të kryetarit. Pavarësisht debatit që nxiti mendimi i gjyqtarëve në pakicë, kjo zgjidhje ka mundur të orientojë, në vijim, praktikën gjyqësore të gjykatave më të ulta.

I.3-ii Le të vijojmë më tej me analizën e nenit 15.2 të Kodit. Në paragrafin 2, kjo dispozitë pengon pjesëmarrjen në gjykim të gjyqtarit “...që ka vleftësuar masën e sigurimit ose çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim.”

Norma synon që gjyqtari i themelit të vendoset në situatën psikike të mungesës së paragjyimit të fakteve objekt akuze dhe të çdo elementi me vlerë provuese që mund të shkojë si në favor të të pandehurit, ashtu edhe kundër interesave të tij. Për këtë arsye, ai nuk duhet të njihet që në fazën e hetimeve paraprake me faktet dhe provat, ato duhet t’ia paraqitin palët, në seancë gjyqësore, në barazi të plotë midis tyre. Kjo është arsyeja e normës, e cila pengon të marrë pjesë në gjykimin e themelit gjyqtarin që ka vlerësuar masën e sigurimit dhe, përgjithësisht, çdo kërkesë të prokurorit në fazën e hetimeve, me qëllim që të sigurohet paanësia e tij në gjykimin e themelit, si element shumë i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Kjo temë nuk ka qenë jashtë vëmendjes së Gjykatës së Strasburgut, e shprehur qartë në çështjen **Hauschildt kundër Danimarkës**¹²⁰, ku Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6.1 të Konventës për shkak se gjyqtari që kryesoi trupin gjykues në shkallë të parë dhe gjyqtarët që e shqyrtuan çështjen në apel, ishin investuar në fazat e mëparshme të procedimit duke disponuar mbi lirinë personale të kërkuarit.

Norma përjashton vetëm gjyqtarin që shqyrtonte kërkesat e paraqitura nga prokurori, por besojmë se e njëjta situatë do të ishte edhe kur gjykata do të investohej, në fazën e hetimeve paraprake, me kërkesë të njërit prej palëve në proces (b.fj., prej të pandehurit).

Norma bën një përcaktim domethënës, duke saktësuar se rregulli vlen kur kemi të bëjmë me “të njëjtin procedim”, ai nuk vepron në rastet kur procedimet ku merr pjesë gjyqtari janë të ndryshme. Ky është një përcaktim shumë i rëndësishëm, që duhet theksuar mirë sepse, siç do të shohim në vijim, jurisprudenca e Gjykatës së Lartë nuk ka mundur të krijojë një praktikë gjyqësore bindëse në këtë drejtim (*shih rastin në vijim*).

15. Kërkuari ka pretenduar, gjithashtu, se është cenuar e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme. Sipas tij, i njëjti gjyqtar ka qenë pjesë e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë në tri gjykime ndaj kërkuarit, për të njëjtën çështje, përkatësisht në lidhje me: masën e sigurimit (vendimi nr. 167, datë 12.09.2008), rekursin mbi themelin (vendimi nr. 00-2012-321, datë 20.03.2012) dhe kërkesën për rishikim (vendimi nr. 674, datë 17.05.2012). Gjithashtu, kërkuari ka pretenduar se i njëjti trup gjykues në Gjykatën e Lartë ka gjykuar dy herë në lidhje me kërkuarin.

16. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata, gjatë votimit të çështjes, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Në këto kushte, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, për këtë pretendim, vendosi refuzimin.” (*Votuan për pranimin gjyqtarët: B. Dedja, V. Kristo, S. Berberi dhe F. Hoxha. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: V. Tusha, A. Xhoxhaj, B. Imeraj dhe F. Lulo*).

¹²⁰ Affaire **Hauschildt c. Danemark**, Arrêt, Strasbourg 24 mai 1989, Requête n° 10486/83. *Tek* <http://cmiskp.echr.coe.int>, baza e të dhënave HUDOC e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Vendimi i kolegjit penal zgjidhi rastin e dy të pandehurve, të dënuar në mungesë, për krimin e vjedhjes me armë, kryer në bashkëpunim¹²¹. Në kryerjen e krimit, patën marrë pjesë edhe tre persona të tjerë, të arrestuar në flagrancë, çështja e të cilëve u veçua gjatë gjykimit në shkallë të parë, duke proceduar me gjykimin e shkurtuar. Gjatë gjykimit të dy të pandehurve në fjalë, në shkallë të parë, në përbërje të trupit gjykues bënte pjesë një gjyqtar, i cili pati caktuar masën e sigurimit ndaj tre të pandehurve të tjerë, të gjykuar sipas ritit të shkurtuar, kur procedimi ndodhej ende në fazën e hetimeve paraprake. Gjykata e Lartë, nuk e pranoi pavlefshmërinë absolute të konstatuar nga gjykata e apelit Shkodër për shkak të pjesëmarrjes në trupin gjykues të njërit prej gjyqtarëve që pati caktuar masën e sigurimit gjatë hetimeve paraprake për tre të pandehurit e tjerë (*nenet 128.1/a dhe 15.2 të KPP*), me argumentin se në rastin objekt gjykimi kemi të bëjmë me një “*procedim-çështje tjetër*”.

Në fakt, kemi të bëjmë me të njëjtin procedim; kriteri dallues i një procedimi nga një tjetër përftohet vetëm nga gjykimi nëse fakti kriminal objekt hetimesh (*ose gjykimi*) është i njëjtë apo i ndryshëm. Në rastin konkret, nëse i referohemi elementit material të krimit objekt gjykimi, në tre përbërësit e tij objektivë (*veprimi kriminal, pasoja e ardhur dhe lidhja shkakësore*), dalim në përfundimin e qartë se kemi të bëjmë me të njëjtin fakt kriminal, të kryer në kushte të njëjta të kohës e të vendit, nga të pestë personat e akuzuar. Ndaj, vijmë në përfundimin se interpretimi nga kolegji penal i togfjalëshit “*në të njëjtin procedim*”, në përbërje të nenit 15.2 të Kodit, është krejt i gabuar¹²².

Interes teorik dhe praktik paraqit edhe studimi i vendimit të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë Nr.544, datë 29.06.2007 (*të pandehur Hasani dhe Panariti*). Gjykata e Lartë vendosi të prishë një vendim të gjykatës së apelit Korçë, me argumentin se njëri nga anëtarët e trupit gjykues që kishte shqyrtuar në apel themelin e çështjes, pati marrë pjesë në përbërje të trupit gjykues që shqyrtoi aktin e apelit të të pandehurve kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë që kishte refuzuar konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit të vendosur ndaj tyre. Gjykata e Lartë konstatoi pavlefshmërinë absolute të vendimit, për mosrespektim të kushteve për të qenë gjyqtar në një çështje konkrete, duke iu referuar neneve 128.1/a dhe 15 të KPP (për saktësi, duhet theksuar se Gjykata citon si argument përmbajtjen e nenit 15.1 të Kodit, ndërkohë që rasti konkret nuk ka lidhje me këtë paragraf, por mund të interpretohet në këndvështrimin e paragrafit 2 të nenit 15).

Në planin e interpretimit na duket shumë interesant mendimi i gjyqtarëve në pakicë, të cilët vlerësojnë se vendimi i gjykatës së apelit duhej të lihej në fuqi. Pakica parashtron argumentet vijuese:

Së pari, konstaton faktin, të cilin sapo e cekëm, që neni 15.1 i Kodit nuk ka kurrfarë lidhjeje me çështjen objekt shqyrtimi, pasi bëhet fjalë për shqyrtim në të njëjtën shkallë, në apel. Gjithashtu, kuptohet që nuk jemi në rastet e rigjykimit pas prishjes;

Së dyti, paragrafi 2 i nenit 15 pengon pjesëmarrjen në gjykim të gjyqtarit që ka vlerësuar më parë masën e sigurimit ose *çdo kërkesë tjetër të prokurorit gjatë hetimeve paraprake*, në të njëjtin procedim. Pakica i mëshon faktit se kërkesa për shuarjen e masave të sigurimit nuk ishte kërkesë e prokurorit, por e të pandehurve dhe thekson se faza procesuale e paraqitjes së kërkesës nuk ka qenë ajo e hetimeve paraprake, sepse çështja ndodhej në fazën e shqyrtimit gjyqësor, madje të rishqyrtimit gjyqësor në shkallën e parë;

¹²¹ Nr.738 i Vendimit, datë 24.10.2005, Brija, Picari.

¹²² Një analizë më të thelluar të këtij vendimi mund ta gjeni tek: Ligori Henrik, «*Një vendim, tri probleme*», Jeta Juridike, Nr. 2, dhjetor 2007, faqe 33.

Së treti, pakica i referohet jurisprudencës së kolegjit penal, e cila mbështet me zgjidhjet e dhëna më parë mendimin e pakicës.

Në përfundim, mund të themi se mbështesim mendimin e gjyqtarëve të mbetur në pakicë. Interpretimi i shumicës jo vetëm tejkalon të quajturën *ratio* e normës, por është i paqartë dhe i paorientuar drejt dispozitës konkrete që shërben si referencë për të vendosur. Duhet theksuar se jemi para rastit kur çështja është duke u (ri)gjykuar në shkallën e parë dhe mbrojtja paraqet kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit. Gjykata kompetente për të shqyrtuar kërkesën ishte gjykata që po gjykonte çështjen¹²³; natyrisht, nuk ka pengesë ligjore që ankimi lidhur me vendimin e trupit gjykues, në lëndë të masave të sigurimit, të shqyrtohet nga një kolegji i apelit, i cili më pas do të mund të marrë pjesë në gjykimin e çështjes. Tashmë, nuk jemi më në fazën e hetimeve paraprake, kur një vendimmarrje lidhur me nevojat e sigurimit do ta vendoste gjykatën në një situatë paragjykimi në raport me akuzat e ngritura.

Kompetencën e shqyrtimit të çështjeve që lidhen me lirinë personale nga gjykata që gjykon çështjen, kolegji e ka konfirmuar edhe në vendime të mëvonshme¹²⁴.

Interes paraqit edhe rasti kur gjyqtari që mori pjesë në përbërje të kolegjit të gjykatës që gjykoi themelin e çështjes, pati qenë pjesë e trupit gjykues që shqyrtoi ankimin e prokurorit lidhur me masën e sigurimit të caktuar nga gjykata e shkallës së parë¹²⁵. Në një rast të zakonshëm, pengesa do të ishte e evidente, por në këtë rast nuk pati shqyrtim gjyqësor, sepse prokurori e tërhoqi ankimin. Me të drejtë, kolegji penal çmoi se nuk ndodhemi para rastit të pavlefshmërisë absolute, sipas nenit 15.2, ngaqë gjyqtari nuk i shqyrtoi faktet e çështjes për shkak të tërheqjes së ankimit nga përfaqësuesi i akuzës¹²⁶. Kjo zgjidhje u vlerësua si e drejtë edhe pas shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese¹²⁷

¹²³ Shih edhe Vendimin Unifikues nr.7, 14.10.2011, Kumbo.

¹²⁴ Nr.00-2012-1403 i Vendimit (277), datë 17.10.2012, Hasani.

¹²⁵ Nr.00-2011-437 i Vendimit (66), datë 28.4.11, Qosja.

¹²⁶ "Pretendimi i ngritur në rekurs se i njëjti gjyqtar (M.H.), që ka caktuar ndaj të gjykuarit masën e sigurimit, ka qenë edhe anëtar i trupit gjykues në vendimin e rekursuar, në kundërshtim me nenin 15/2 të K.Pr.Penale, nuk është i bazuar në ligj. ...

Pavarësisht qenies formalisht anëtar i trupit gjykues në vlerësimin e "masës së sigurimit" si dhe në gjykimin në apel, në rastin në shqyrtim nuk rezulton që kjo gjë përbën papajtueshmëri në frymën e dispozitës së nenit 15/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 15/2 i Kodit të Procedurës Penale kërkon domosdoshmërinë e marrjes pjesë në dhënie vendimi lidhur me "vleftësim të masës së sigurimit" në kuptimin e shqyrtimit gjyqësor të provave, fakteve, rrethanave dhe vlerësimit të tyre në gjykim, gjë e cila nuk rezulton të ketë ndodhur në rastin konkret. Trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë edhe gjyqtari në fjalë, pa filluar shqyrtimin gjyqësor të çështjes penale, pasi Prokuroria e apelit hoqi dorë nga ankimi, vendosi mospranimin e ankimit referuar nenit 420/1/ç të K.Pr.Penale.

Për sa më sipër, në interpretim të nenit 15/2 të Kodit të Procedurës Penale do të konsiderohet se gjyqtari nuk ka marrë pjesë në dhënie vendimi lidhur me "vleftësim të masës së sigurimit", e për rrjedhojë qenia e tij anëtar i trupit gjykues në dy raste nuk përbën papajtueshmëri në kuptim të këtij neni dhe për rrjedhojë kjo gjë nuk passjell pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, në kuptim të nenit 128/1-a të K.Pr.Penale." (citimi sipas vendimit)

¹²⁷ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 2.4.2012, kërkues Qosja: "14. Gjykata vëren se neni 15/2 i KPP-së shprehet se "nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar..." çka do të thotë se kjo dispozitë kërkon që gjyqtari të shprehet lidhur me themelin e masës së sigurimit. Në rastin konkret, pjesëmarrja e gjyqtarit të

Pavlefshmëria absolute që buron nga zbatimi i ndërlidhur i neneve 128.1/a dhe 15.2 të Kodit, ka qenë objekt i shqyrtimit dhe interpretimit gjyqësor, sidomos në rastet e **sigurimit të provës**, posaçërisht të dëshmisë, të marrë në fazën e hetimeve paraprake. Në disa raste, kjo problematikë kryqëzohet edhe edhe me vendimmarrjen në temën e masave të sigurimit Për interesin që paraqitin, kemi përzgjedhur për diskutim rastet në vijim:

1- Ky rast lidhet me procesin gjyqësor në ngarkim të dy subjekteve të akuzuar për krimin e trafikimit të femrave për qëllime prostitucioni¹²⁸. Në fazën e hetimeve paraprake, me kërkesën e prokurorit, u procedua me sigurimin e dëshmisë së viktimës së trafikimit. Sikurse dihet, procedura e sigurimit të provës kalon në dy stadi: fillimisht, pranimi ose jo i kërkesës për sigurimin e provës shqyrtohet nga një gjyqtar i vetëm. Mandej, në qoftë se kërkesa pranohet, marrja e provës bëhet para një kolegji gjyqësor. Kështu ka ndodhur edhe në rastin objekt shqyrtimi. Kërkesa është pranuar nga gjyqtari E.D., që ka marrë pjesë më pas edhe në marrjen e dëshmisë, në përbërjen e një kolegji prej pesë gjyqtarësh (*akuza e trafikimit është në kompetencën lëndore të gjykatës për krime të rënda*). Pas dërgimit të çështjes në gjyq, akuzat janë shqyrtuar nga një kolegji ku bënin pjesë edhe gjyqtarët L.B. e Xh.E., të cilët patën marrë pjesë edhe në dëgjimin e dëshmisë së të dëmtuarës. Kolegji penal i Gjykatës së Lartë prishi vendimin e gjykatës së apelit dhe atë të shkallës së parë dhe e ktheu çështjen për rigjykim, në shkallë të parë, me trup tjetër gjykues.

Vendimi i kolegjit iu referua neneve 128.1/a dhe 15.2 të KPP, me arsyetimin se dy gjyqtarët që morën pjesë në seancën e marrjes së dëshmisë, nuk mund të merrnin pjesë në shqyrtimin e mëpasëm gjyqësor të çështjes, sepse nuk ishin në pozita paanshmërie për gjykimin e drejtë dhe objektiv të saj.

Gjyqtari në pakicë bën një arsyetim paralel. Ai mendon se vendimet duhet të çenoheshin, por për një shkak tjetër: për faktin se gjyqtari E.D. që vendosi pranimin e kërkesës së prokurorit për sigurimin e dëshmisë, ishte pjesë e kolegjit që procedoi me marrjen e kësaj prove.

Sikurse do të argumentojmë në vijim, nuk mund të pajtohemi si me shumicën, ashtu edhe me mendimin e gjyqtarit në pakicë. Nuk konstatojmë cënim të rregullave që parashikon neni 15.2 i Kodit, por të rregullave që zbatohen në rastet e ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues. Për të mos rënë në përsëritje, këtij argumenti do t'i rikthehemi pas parashtrimit të rasteve të tjera.

2- Rasti i dytë është shumë i ngjashëm me të mëparshmin¹²⁹. Kërkesa për sigurimin e dëshmisë është pranuar nga gjyqtari G.B., i cili ka marrë pjesë më pas edhe në marrjen e dëshmisë, në përbërjen e një kolegji prej pesë gjyqtarësh (*edhe në këtë rast shqyrtohej akuza e trafikimit të femrave për qëllime prostitucioni*). Pas dërgimit të çështjes në gjyq, akuzat janë shqyrtuar nga një kolegji ku bënin pjesë katër gjyqtarët që patën marrë pjesë edhe në dëgjimin e dëshmisë së të dëmtuarës, por jo gjyqtari G.B. që pranoi kërkesën. Kolegji penal i Gjykatës së

Gjykatës së Apelit Shkodër në gjykimin e masës së sigurimit ka qenë formale dhe ai nuk ka dhënë asnjë mendim lidhur me thelbin e çështjes, duke qenë se prokurori i çështjes hoqi dorë nga ankimi i paraqitur në atë gjykatë. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se ky gjyqtar nuk gjendet në kushtet e papajtueshmërisë, të parashikuar në nenin 15/2 të KPP-së, dhe nuk kishte arsye për të hequr dorë nga gjykimi i çështjes konkrete në themel.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk gjendet para cenimit të parimit të paanshmërisë dhe ky pretendim i kërkesit është i pabazuar.” (citimi sipas vendimit).

¹²⁸ Nr. 418 i Vendimit, datë 18.04.2007, Buçpapaj.

¹²⁹ Nr. 104 i Vendimit, datë 27.02.2008, Hyskaj, Çela.

Lartë prishi vendimin e gjykatës së apelit dhe atë të shkallës së parë dhe e ktheu çështjen për rigjykim, në shkallë të parë, me trup tjetër gjykues.

Vendimi i kolegjit i referohet kërkesave të nenit 17.1, shkronja “e” të Kodit duke arsyetuar se katër gjyqtarët që kishin marrë pjesë në seancën e dhënies së dëshmisë ishin të detyruar të hiqnin dorë nga gjykimi, për shkak papajtueshmërie, sipas nenit 15, veprim të cilin nuk e kanë bërë as pas kërkesës së avokatëve për përjashtim nga trupi gjykues. Në vijim, kolegji i quan vendimet e gjykatave më të ulta “*të pavlefshme*” dhe me pasojë “*...cënimin e procesit të rregullt ligjor*”.

3- Në rastin e tretë, gjyqtari që mori pjesë në pranimin e kërkesës së prokurorit për të proceduar me sigurimin e provës së dëshmisë, ishte pjesë e kolegjit që procedoi me dëgjimin e dëshmisë së të dëmtuarës. Kolegji prishi vendimet e gjykatave më të ulta me argumentin se, i njëjti gjyqtar, pati marrë pjesë si në vlerësimin e kërkesës së prokurorit në fazën e hetimeve paraprake, ashtu edhe në gjykimin e çështjes¹³⁰. Një rast identik, vërejmë që përsëritet edhe në një vendim të vitit 2009¹³¹.

4- Rasti i katërt paraqet disa veçori me interes studimi. Pranimi i kërkesës së prokurorit për të proceduar me sigurimin e provës së dëshmisë nuk është vendosur nga gjyqtari i vetëm, por nga një kolegji prej tre gjyqtarësh. I njëjti kolegji ka proceduar me sigurimin e dëshmisë të tre dëshmitarëve të akuzës. Më pas, gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, janë ndryshuar dy prej anëtarëve të kolegjit, kurse gjyqtari i tretë ka marrë pjesë në gjashtë seancat e para, ndërsa më pas është dorëhequr për shkaqe papajtueshmërie. Kolegji penal i Gjykatës së Lartë konstaton pavlefshmëri absolute lidhur me faktin që e njëjta gjyqtare, ka marrë pjesë si në pranimin e kërkesës në fazën e hetimeve, ashtu edhe në gjykimin e çështjes¹³².

¹³⁰ Nr.00-2010-1180 i Vendimit (841), 22.9.2010, Bylyku: “Rezultoni e provuar se gjyqtarja Idush Maliqi ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për të siguruar si provë shpjegimet e dëshmitares A.Z. dhe, në kundërshtim me detyrimet që parashikon dispozita e nenit 15/2 të K.Pr.Penale, ajo ka marrë pjesë në seancën gjyqësore ku dëshmitarja ka dhënë shpjegime, duke bërë kështu që e njëjta gjyqtare të marrë pjesë edhe në vendimarrjen e kërkesave të prokurorit gjatë hetimeve paraprake edhe në gjykimin e çështjes, pasi, siç rezultoi edhe nga e drejta procedurale penale dhe një sërë vendimesh të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, procesi verbal i sigurimit të provës bën pjesë në fazën e gjykimin të çështjes.”

¹³¹ Nr.440 i Vendimit, datë 30.9.2009, Ejupi: “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, në gjykimin e kësaj çështje, ka vepruar ndesh me dispozitat e nenit 15/2 të K.Pr.Penale, e cila në mbështetje të nenit 128 /1-a të K.Pr.Penale, e bën vendimin e saj absolutisht të pavlefshëm për shkak se gjyqtari Astrit Haxhialushi nuk ka patur kushtet për të qënë gjyqtar në seancën për sigurimin e provës (dëshmia e të dëmtuarës A.Gj.).

... Papajtueshmëria krijohet ndërmjet qënies gjyqtar të gjyqtarit Astrit Haxhialushi në marrjen e provës, dëshmisë së shtetasës A.Gj. dhe njëkohësisht qënien e tij si gjyqtar në shqyrtimin e kërkesës së prokurorit në lidhje me sigurimin e provës, në mbështetje të nenit 317/2 të K.Pr.Penale.”

¹³² Nr.00-2010-1028 i Vendimit (557), datë 2.6.2010, Hoxha, etj.: “Në kundërshtim me kërkesat e nenit 15/2 të K.Pr.Penale, i njëjti trup gjykues i përbërë nga gjyqtarët Englantina Mikani, Etleva Cami dhe Miliana Muca ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë (një kërkesë e cila bën pjesë në kërkesat e prokurorit gjatë hetimit paraprak) për pyetjen e këtyre dëshmitarëve por edhe kanë marrë pjesë në seancën gjyqësore ku këta dëshmitarë kanë dhënë shpjegimet e tyre. Seanca gjyqësore në të cilën kanë dhënë shpjegime dëshmitarët L.M., P.M. dhe M.M. është një nga fazat e gjykimin, gjë e cila është analizuar hollësisht në vendimin nr.115, datë 21.05.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për më tepër që gjyqtarja Miliana Muca ka marrë pjesë dhe gjatë gjykimin të zhvilluar në 6 seancat e para gjyqësore gjatë të cilave janë marrë vendime për zhvillimin e gjykimin në mungesë dhe për caktim mbrojtësi të të pandehurve të ndryshëm dhe vetëm në seancën e datës 30.11.2007, ka konstatuar papajtueshmërinë e saj në gjykimin e kësaj çështje, prandaj dhe ka hequr dorë nga gjykimi. Edhe për këtë fakt, pra për pjesëmarrjen e saj në disa seanca gjyqësore, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë duhet të prishet, pasi është vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 15/2 të K.Pr.Penale, pasi pavarësisht se nuk ka marrë

Sikurse përmendëm më lart, jurisprudenca e kolegjit ofron disa raste tipike kur sigurimi i provës, ndërthurret edhe me vendimmarrjen në caktimin e masave të sigurimit. Le t'i shojmë në vijim:

5- Një rast tipik është regjistruar në vitin 2008¹³³, kur i njëjti gjyqtar ka pranuar kërkesën e prokurorit për sigurimit e provës, ka qenë pjesë përbërëse e kolegjit që procedoi me marrjen e provës dhe caktoi, më pas, masën e sigurimit personal ndaj të pandehurit. Kolegji konstatoi pavlefshmëri absolute për shkak se i njëjti gjyqtar caktoi masën e sigurimit ndaj të pandehurit dhe mori pjesë edhe në kolegjin që dëgjoi dëshminë¹³⁴. Një rast i ngjashëm regjistrohet edhe në vitin 2010¹³⁵; në këtë rast papajtueshmëria vërehet në qënien e njëkohshme gjyqtar që pranon kërkesën për sigurimin e provës dhe cakton masën e sigurimit, me praninë në përbërjen e trupit gjykues që dëgjoi provën e dëshmisë, kur kjo e fundit u krye nga një gjyqtar, ndërkohë që duhej të kryhej me tre gjyqtarë¹³⁶. Rasti i fundit, me tematikë të ngjashme, shënohet në vitin 2013¹³⁷, kur gjyqtari që pranoi kërkesën për marrjen e provës, caktoi masën e sigurimit dhe mori pjesë në trupin gjykues që dëgjoi dëshminë. Por, rasti pati edhe një tjetër veçori: tre nga gjyqtarët që morën pjesë në marrjen e provës së dëshmisë, ishin pjesë e kolegjit prej pesë gjyqtarësh që gjykoi çështjen në themel.

Sikundër e cekëm pak më sipër, duke i parë në tërësi të gjitha rastet e parashtruara, nuk mund të pajtohemi me zgjidhjet e dhëna nga ana e kolegjit penal të Gjykatës së Lartë. Interpretimi i tij e tejkalon qëllimin që ka dashur të realizojë ligjvënësi me anën e ndalimit të vendosur në përmbajtje të nenit 15.2, por duket se është edhe rezultat i paqartësive që shfaqen në veprimtarinë gjyqësore lidhur me institutin e sigurimit të provës në fazën e hetimeve paraprake. Që në fillim theksojmë se, në kuptim të nenit 15.2 të KPP, pengohet të marrë pjesë në gjykim vetëm gjyqtari i cili ka marrë në shqyrtim dhe ka vendosur pranimin e kërkesës për të siguruar dëshminë. Për të vendosur ai është i detyruar të njihet me një pjesë të akteve të procedimit, me faktet objekt hetimi, me argumentet e palëve dhe me të dhënat që vërtetojnë se marrja e asaj prove nuk mund të shtyhet deri në kohën e shqyrtimit gjyqësor, pa i shkaktuar dëm interesave të shtetasve dhe të drejtësisë penale. Ai vendoset në një pozitë të ngjashme me gjyqtarin që merr në shqyrtim kërkesat për vlefhtësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit. Me

pjesë në dhënien e vendimit vetëm pjesëmarrja e gjyqtarës që ka shqyrtuar më parë kërkesat e prokurorit gjatë hetimit paraprake disa seancë gjyqësore e bën të pavlefshëm vendimin.”

¹³³ Nr.115 i Vendimit, datë 21.5.2008, Sokolaj.

¹³⁴ “... Papajtueshmëria krijohet ndërmjet qënies gjyqtare të gjyqtarës Liljana Baku në marrjen e provës, dëshmise se shtetasës E.V. dhe njëkohësisht qënien e saj si gjyqtare në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj të pandehurit Sokolaj. Kolegji arrin në këtë përfundim, duke konsideruar marrjen e provës nga gjykata gjatë hetimit paraprak si pjesë e shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pavarësisht se çështja akoma nuk i ka ardhur gjykatës.”

¹³⁵ Nr.00-2010-353 i Vendimit (187), datë 3.3.2010, Rustemi, etj.

¹³⁶ “Papajtueshmëria krijohet ndërmjet qënies gjyqtar të gjyqtarit Albano Çepele në marrjen e provës, dëshmisë së shtetasës L.K. dhe njëkohësisht qënjen e tij si gjyqtar në shqyrtimin e kërkesës së prokurorit në lidhje me sigurimin e provës në mbështetje të nenit 317/2 të K.Pr.Penale, si dhe në vlefhtësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit. Kolegji arrin në këtë përfundim duke konsideruar marrjen e provës nga gjykata gjatë hetimit paraprak si pjesë të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pavarësisht se çështja akoma nuk i ka kaluar për gjykim gjykatës. ... Me marrjen e provës në kushtet e sigurimit të saj, gjyqtari nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka zhvilluar një pjesë të gjykimit të çështjes që duke qenë përbërës i gjykimit në të gjithë elementet e tij, e bën pjesëmarrjen e këtij gjyqtari të papajtueshëm me gjykimin prej tij të çdo kërkesë tjetër të paraqitur nga palet gjatë hetimeve paraprake.

... Ky Kolegj çmon se vlen të bëjë vërejtje për gjykatën e rrethit gjyqësor edhe në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, i cili ka marrë provën, pra dëshminë e shtetasës L.K., pasi marrja e provës në seancë gjyqësore është marrë nga një gjyqtar i vetëm, ndërkohë që vepra penale për të cilën akuzoheshin të gjykuarit ishte e tillë që parashikohet se gjykohet me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë.”

¹³⁷ Nr.00-2013-780 i Vendimit (37), datë 6.2.2013, Avduli.

një fjalë, në rrafshin subjektiv, ai nuk do të ishte asnjëanës lidhur me faktet objekt akuze për të cilat merr dijeni në rrugë incidentale dhe as me faktin nëse ato duhet t'i atribuohen ose jo një personi të caktuar.

Sikurse vihet re nga rastet e shqyrtuara, gjyqtarët që kanë vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e dëshmisë nuk kanë marrë pjesë në kolegjin që ka gjykuar akuzat në themel, ndaj nuk mund të ngrihet papajtueshmëri sipas nenit 15.2 të Kodit. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e tyre në dëgjimin e dëshmisë nuk i bën ata të papajtueshëm, pasi në këtë fazë nuk bëhet vlerësim i fakteve, gjyqtarët nuk shprehen, as lidhur me besueshmërinë e dëshmitarit dhe as mbi fuqinë provuese të fakteve që ai dëshmon para tyre. Duket se kolegji penal ka ndryshuar jurisprudencën e tij të krijuar në vitin 2003¹³⁸, kur nuk e ka pranuar rekursin e të pandehurit që mëtonte pavlefshmëri absolute për shkak se njëri nga anëtarët e trupit gjykues që kishte marrë pjesë në sigurimin e dëshmisë në shkallë të parë, pati marrë pjesë më pas në trupin gjykues që shqyrtoi çështjen në apel. Me kërkesë të të dënuarit, vendimi në fjalë u shqyrtua edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila nuk gjeti elementë të procesit të parregullt ligjor, duke arsyetuar: “... kërkesën për sigurimin e provës e ka vlerësuar dhe ka marrë vendimin përkatës një gjyqtare tjetër, kurse Meme Rexho ka marrë pjesë në trupin gjykues kur është dëgjuar dëshmitarja, procedurë në të cilën nuk bëhet ndonjë vlerësim dhe as merret ndonjë vendim. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se pjesëmarrja e gjyqtarës në seancën e marrjes së provës, nuk mund të influenconte në krijimin e bindjes në marrjen e vendimit nga Gjykata e Apelit Vlorë. Janë këto arsytet që pjesëmarrja e gjyqtarës Meme Rexho në gjykimin në shkallën e dytë nuk përbën rast të papajtueshmërisë, parashikuar nga neni 15 i Kodit të Procedurës Penale e as shkak njëanshmërie që do ta bënin gjykimin në gjykatën e apelit të parregullt dhe vendimet të cënueshme”¹³⁹.

Të njëjtën linjë arsyetimi ndjek edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen **Bulut kundër Austrisë**¹⁴⁰. Gjatë gjykimit të çështjes kundër z. Bulut, në trupin gjykues bënte pjesë edhe një gjyqtar, i cili në fazën e hetimeve paraprake kishte pyetur dy dëshmitarë. Kërkuesi e ngriti çështjen në këndvështrimin e nenit 6-1 të Konventës, për shkak të përbërjes së trupit gjykues. Pretendimi i kërkuesit u rrëzua, me këtë arsyetim: “Në fakt, nuk rezulton që ky magjistrat të ketë marrë ndonjë vendim gjatë procedurës. Roli i tij, i kufizuar në kohë, pati të bënte me marrjen në pyetje të dy dëshmitarëve. Kjo nuk solli si pasojë ndonjë vlerësim të elementëve të provës të grumbulluara deri atëhere dhe as ndonjë përfundim të nxjerrë prej tij lidhur me rolin e kërkuesit. Në këtë kontekst të kufizuar, nuk mundet që për shkak të kësaj veprimtarie të konsiderohet si objektivisht e përligjur droja e kërkuesit se gjykata rajonale e Innsbruck-ut nuk ka qenë një gjykatë e paanshme.” (§ 34; shqipërimi ynë).

Këtu mund të ngrihet një problem tjetër që nuk ka të bëjë me papajtueshmërinë dhe as me pavlefshmërinë absolute që buron prej saj: mendojmë se siguri i provës, sidomos i dëshmisë, duhet të bëhet para të njëjtit kolegji që do të shqyrtojë edhe themelin e çështjes. Në këtë aspekt, mënyra si kanë proceduar gjykatat në rastet e parashtruara, nuk është proceduralisht e saktë. Është e rëndësishme të theksojmë se siguri i provës nuk është gjë tjetër veçse një pjesëz e shqyrtimit gjyqësor që, për arsytet që parashikon ligji, realizohet qysh në fazën e hetimeve

¹³⁸ Nr.189 i Vendimit, datë 18.04.2003, Sulaj.

¹³⁹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 01.10.2003.

¹⁴⁰ Affaire Bulut c. Autriche (*Requête* no [17358/90](http://hudoc.echr.coe.int/fre#{)), Arrêt, Strasbourg, 22 février 1996; [http://hudoc.echr.coe.int/fre#{"fulltext":\["Bulut"\],"respondent":\["AUT"\],"article":\["6-1"\],"documentcollection2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-62530"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/fre#{), vizita e fundit, 10.12.2015.

paraprake. Në rastin e provës deklarative, sikurse është dëshmia, ka shumë rëndësi perceptimi i drejtpërdrejtë i gjyqtarit, për të gjykuar më pas lidhur me besueshmërinë e dëshmitarit. Pra, mendojmë se sigurimi i provës duhet të bëhet nga i njëjti koleg gjyqtarësh që do të shqyrtojë themelin e akuzave dhe këtu nuk konstatojmë jo vetëm papajtueshmëri, por as cënim të procesit të rregullt ligjor.

Mënyra si kanë proceduar gjykatat në rastet e analizuara më sipër, në fakt, krijojnë një problem procedural, por jo për shkaqet që ka konstatuar kolegji penal i Gjykatës së Lartë. Në rastet kur kolegji që procedon me sigurimin e provës nuk është i njëjtë me kolegjin që gjykon themelin e çështjes, krijohen probleme lidhur me procedurën që ndiqet në rastet kur ndryshon përbërja e trupit gjykues¹⁴¹. Në rastet që cituam, gjykimi duhet të fillonte nga e para, çka do të thotë se dëshmia e siguruar duhet të dëgjohej rishtazi nga gjykatat.

Në raste të tilla mund të ngrihet diskutimi nëse shkelja e procedurës për shkak të ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues shkakton pavlefshmëri absolute apo jo. Paragrafi 4 është shtuar në përmbajtje të nenit 342, me shtesat dhe ndryshimet që propozoi reforma e vitit 2002¹⁴², në përmbajtje të tij nuk ka sanksion në rast mosrespektimi të procedurës. Por, mendojmë se në këtë rast kemi të bëjmë me pavlefshmëri absolute, për shkak të cënimit të *“kushteve për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete”*, sepse në rastin kur përbërja ndryshon ndjeshëm (një gjyqtar në kolegjin që gjykon me tre gjyqtarë dhe më shumë se dy gjyqtarë në kolegjin që gjykon me pesë gjyqtarë), trupi gjykues i ri nuk plotëson kushtet për të gjykuar çështjen, në vështrim të neneve 128.1, shkronja “a” dhe 342.4 të KPP.

Duke përfunduar, shënojmë që jurisprudenca e Gjykatës së Lartë lidhur me interpretimin e nenit 15.2 të KPP është e pasaktë, e paargumentuar dhe hera-herës kundërthënëse, për shkak të luhatjes së zgjidhjeve të dhëna ndër vite dhe bie ndesh me këndvështrimin e GJEDNJ-së. Besojmë se ndodhemi në situatën kur zgjidhja duhet të jepet përmes një Vendim Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara.

I.3-iii Le të ndalemi në vijim në rregullat që normojnë nenet 15.3 dhe 16 të Kodit të Procedurës Penale. Paragrafi 3 i nenit 15 pengon ushtrimin e funksionit të gjyqtarit për personin fizik që, *në të njëjtin procedim*, ka kryer detyrën e prokurorit ose ka kryer veprime të policisë gjyqësore ose ka qenë mbrojtës, përfaqësues i një pale ose dëshmitar, ekspert ose ka paraqitur një kallëzim, ankim, kërkesë për procedim ose që ka dhënë apo ka marrë pjesë në dhënien e vendimit për autorizimin e procedimit.

Edhe kjo normë, e cila në rast mosrespektimi sanksionohet me pavlefshmëri absolute, synon ta vendosë gjyqtarin në pozicionin e të tretit, mbi palët në proces. Ajo mbështetet në rregullin që funksionet themelore procedurale duhet t’iu ngarkohen subjekteve të ndryshme, sepse nuk mund të bëhet fjalë për rol të gjyqtarit mbi palët kur, në të njëjtin procedim, ai mund të ketë kryer edhe funksione të tjera procedurale (*prokuror, oficer i policisë gjyqësore, ekspert, etj.*), apo në rastin kur ai thirret për të gjykuar çështjen e tij (*kallëzues, i dëmtuar, etj.*). Referimi në termin *“procedim”* orienton që rregulli nuk vlen vetëm për gjykimin në themel, por edhe për gjykimin e çdo kërkesë të palëve në fazën e hetimeve paraprake. Raste papajtueshmërie të kësaj

¹⁴¹ Neni 342. Gjykimi i pandërprerë - ... 4. Kur për shkaqe të përligjura ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari i ri duhet të njihet me përmbajtjen e procesit gjyqësor, përveç rastit kur kërkohet prej tij që çështja të shqyrtohet nga fillimi. Kur ndryshon më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me tre gjyqtarë dhe më shumë se dy nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me pesë gjyqtarë, gjykimi fillon nga e para.

¹⁴² Ligji nr.8813, datë 13.6.2002 *“Për disa shtesa e ndryshime në Kodin e Procedurës Penale...”*

natyre nuk kemi konstatuar në praktikën e gjykatave, mbase për shkak të qartësisë së normës, por edhe të traditës, pasi ky rregull pranohej edhe në sistemin e vjetër të procedurës¹⁴³.

Neni 16 i Kodit¹⁴⁴, pengon pjesëmarrjen në procedim të gjyqtarëve që, midis tyre ose me pjesëmarrësit e tjerë në proces, gjenden në lidhje familjare, gjinie ose krushqie.

Edhe ky ndalim, i sanksionuar me pavlefshmëri absolute në lidhje me nenin 128.1/a të Kodit, synon të sigurojë parimin e paanësisë së gjyqtarit në procedim. Në lidhje me përdorimin e termit “*procedim*” vlen e njëjta vërejtje e bërë më sipër. Edhe për hipoteza të kësaj natyre, qartësisht të shprehura nga norma procedurale, nuk kemi mundur të gjejmë raste ilustruese të praktikës gjyqësore.

§ 2.2.2 Rastet e pavlefshmërisë absolute që lidhen me prokurorin

Këto raste parashikohen nga neni 128.1, shkronja “b” i Kodit që sanksionon posaçërisht me pavlefshmëri absolute rastet kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me *të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim*. Nga ky formulim rezulton se pavlefshmëria absolute e lidhur me veprimtarinë e përfaqësuesit të akuzës, mund të ngrihet apo të konstatohet në dy raste:

- a) kur çënohet e drejta e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale;
- b) kur çënohet pjesëmarrja e tij në procedim.

Le t’i analizojmë në vijim këto dy mundësi, si në planin doktrinar, ashtu edhe në përfaqësimin me jurisprudencën e gjykatave.

a) Prokurori është subjekti i vetëm që Kushtetuta dhe ligji procedural penal i njohin pushtetin për të ushtruar ndjekjen penale. Por, edhe Kodi i ri nuk e zgjidhi në mënyrë të qartë dhe përfundimtare momentin e ushtrimit të ndjekjes penale, duke e lënë të hapur debatin e kahershëm lidhur me dallimin midis “*fillimit të çështjes penale*” dhe “*fillimit të ndjekjes penale*”¹⁴⁵. Një debat i ngjashëm ka qenë i pranishëm edhe në doktrinën italiane, por atij iu dha fund me miratimin e Kodit të ri, i cili e zgjidhi këtë çështje në mënyrë eksplicite: “... *Meritë e këtij kodi është shmangja e dyshimeve lidhur me çastin dhe modalitetet e ushtrimit të ndjekjes penale. Nga nenet 50 dhe 405 del se prokurori, me të përfunduar faza e hetimeve paraprake, kur nuk duhet të kërkojë pushimin ushtron ndjekjen duke formuluar akuzën në rastet e procedimeve të posaçme; propozon kërkesë për dërgimin në gjyq në rastin e procedimit të zakonshëm*”¹⁴⁶. Në Kodin tonë, problemi mbetet ende i hapur për faktin se ngritja e akuzës mund të bëhet në çdo moment kohor të fazës së hetimeve paraprake. Gjithashtu, ekziston mundësia e ndryshimit apo e plotësimit të saj¹⁴⁷ në dritën e të dhënave të reja që mund të rezultojnë nga hetimet. Ndërkohë, edhe pse mund

¹⁴³ Neni 111 i Kodit të vitit 1979.

¹⁴⁴ Neni 16. Papajtueshmëria për arsye lidhjeje familjare, gjinie ose krushqie - 1. Në të njëjtin procedim nuk mund të marrin pjesë si gjyqtarë personat që janë ndërmjet tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim, bashkëshortë, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave) ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjehërrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka).

¹⁴⁵ Leksione të së drejtës procedurale penale, Dispensë, UT, Fakulteti i Drejtësisë, 1992, faqe 4.

¹⁴⁶ Cavallari V., Commento al nuovo codice di procedura penale, a cura di M. Chiavario, Artt. 177-181, UTET 1990, faqe 297. Cituar nga Di Geronimo Paolo, *vep. e cit.*, faqe 61.

¹⁴⁷ Neni 34. Marrja e cilësisë së të pandehurit - 1. Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

të jetë ngritur akuzë, nuk ka pengesë që të vendoset pushimi i saj ose i çështjes. Veçoritë e mësipërme e vështirësojnë identifikimin e ushtrimit të ndjekjes penale me çastin procedural të formulimit të akuzës (*në vijim, ajo mund të ndryshojë ose të pushohet*). Ndaj, jemi të mendimit se ushtrimi i ndjekjes penale, sipas ligjit tonë procedural, mund dhe duhet të konceptohet si një proces dinamik që fillon me ngritjen e akuzës dhe materializohet me vendimin e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq.

Vërejmë se formulimi i pjesës së parë të nenit 128.1/b të Kodit i shmanget deri diku formulimit të ligjit italian. Ky i fundit sanksionon me pavlefshmëri të përgjithshme të natyrës absolute shkeljen e dispozitave që lidhen me “*nismën*” e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale, jo me “*të drejtën*” e tij për ushtrimin e saj¹⁴⁸. Pavarësisht nga ky ndryshim termash, kuptimi i dispozitës është i qartë: prokurori është subjekti i vetëm i procedimit penal që ka të drejtë të formulojë akuzë dhe të vlerësojë nëse, në përfundim të hetimeve, çështja duhet të dërgohet në gjyq apo duhet të pushohet. Për këtë arsye, është absolutisht i pavlefshëm çdo disponim i palëve në proces¹⁴⁹, edhe i gjyqtarit, në drejtim të cënimit të së drejtës dhe nismës së tij për të përmbushur funksionin akuzues.

Le të shohim, në vijim, disa vendime të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë që kanë krijuar praktikë gjyqësore lidhur me rastet kur është cënuar e drejta e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale:

1- Rasti i parë ilustrues lidhet me një subjekt të akuzuar nga prokuroria ushtarake për krimin e vrasjes së ushtarakut, parashikuar nga neni 77/1 i Kodit Penal Ushtarak¹⁵⁰. Në përfundim të rigjykimit, gjykata ushtarake e apelit e ka deklaruar të gjykuarin fajtor për veprat penale të vrasjes nga pakujdesia të ushtarakut dhe shkelje të rregullave të shërbimit të rojes, sipas neneve 78 dhe 41 të KPU. Lidhur me akuzën e dytë, kolegji penal vërejtë me të drejtë se “... *gjykata duke marrë atributet e organit të akuzës, ka akuzuar, deklaruar fajtor dhe dënuar të gjykuarin për një vepër e cila nuk përmendet në kërkesën për gjykim*”.

Rasti është i qartë: gjykata nuk ka të drejtë të gjykojë pa patur akuzë nga prokurori. E drejta e saj për t’i dhënë faktit, në përfundim të gjykimit, cilësim ligjor të ndryshëm nga ai i prokurorit nuk lejon zgjerimin e pushtetit të saj për të disponuar lidhur me fakte të vlerësuara si kriminale, për të cilat prokurori nuk ka ngritur akuzë. Në rastin konkret, është i pranueshëm ndryshimi i cilësimit ligjor nga vrasje me dashje në vrasje nga pakujdesia, por jo marrja prej gjykatës e pushteteve akuzuese lidhur me faktin e shkeljes së rregullave të shërbimit të rojes, për të cilin prokurori nuk pati formuluar akuzë.

Një rast i ngjashëm është zgjidhur nga kolegji penal në vitin 2011¹⁵¹. Në përfundim të gjykimit, gjykata e shkallës së parë procedoi me ndryshimin e cilësimit juridik të akuzës, sipas nenit 375 të KPP. Të pandehurit ishin akuzuar për kultivim të bimëve narkotike, kryer në bashkëpunim, sipas nenit 284, paragrafët 2 dhe 3 të KP. Gjykata ndryshoi formën e bashkëpunimit, nga bashkëpunim i thjeshtë në grup të strukturuar kriminal që, në thelb, do të

Kur pas marrjes së një personi si të pandehur dalin të dhëna të reja që ndryshojnë akuzën e paraqitur ose e plotësojnë atë, prokurori merr vendim, të cilin ia njofton të pandehurit...

¹⁴⁸ Art. 178 Nullità di ordine generale. – *È sempre prescritta a pena di nullità l’osservanza delle disposizioni concernenti: ...*

b) l’iniziativa del pubblico ministero nell’esercizio dell’azione penale e sua partecipazione al procedimento;

¹⁴⁹ Ka një dallim të qartë me të dëmtuarin akuzues në rastin e së ashtuquajturës “*akuzë private*”. Shih edhe vendimin nr.3, datë 06.02.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁵⁰ Nr.59 i Vendimit, datë 06.02.2008, Metko.

¹⁵¹ Nr.00-2011-1106 i Vendimit, datë 27.12.2011, Pllumbi, etj.

thotë shtimi i një akuze të re: krijimi dhe pjesëmarrja në grup të organizuar kriminal (neni 333/a i Kodit Penal). Me të drejtë, kolegji i prishi vendimet dhe e riktheu çështjen për rigjykim, me arsyetimin se gjykata nuk ka ndryshuar cilësimin ligjor, por ka ngritur akuzë të re¹⁵². Edhe pse në vendim nuk referohet shprehimisht tek neni 128.1, shkronja “b” i KPP, kuptohet që gjykata e shkallës së parë i ka veshur vetes pushtete të akuzës, duke cënuar të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes, me pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit.

2- Rasti që do të diskutojmë në vijim është ndër rastet më tipike që dëshmon se, në praktikën gjyqësore, ende vërehen moskuptime të rënda të rolit dhe të funksioneve të prokurorit në sistemin tonë të procedurës penale¹⁵³. Kjo do të thotë se këto moskuptime lidhen pazgjidhmërisht edhe me rolin dhe funksionet e gjyqtarit në sistem, paqartësi që besojmë se trashëgohen nga tradita e sistemit të vjetër të procedurës, ku gjyqtari ishte veshur me pushtete akuzatore. Rasti në shqyrtim i referohet një vendimi të gjykatës së apelit Tiranë¹⁵⁴, i cili prishi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor¹⁵⁵ dhe vendosi kthimin e çështjes për rigjykim duke argumentuar, ndër të tjera, se të pandehurve nuk u ishte komunikuar rrethana rënduese e kryerjes së krimit të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim, sipas nenit 50, shkronja “gj” të Kodit Penal. Në këndvështrimin e gjykatës së apelit, ky mosveprim i prokurorit dhe mungesa e vëmendjes të gjykatës së rrethit ndaj këtij mosveprimi, përbëjnë shkelje të ndërthurrur të neneve 373¹⁵⁶ dhe 428.1, shkronja ç)¹⁵⁷ të Kodit, të cilat diktojnë prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

¹⁵² “18. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se konflikti i kompetencës midis dy gjykatave ka lindur pas kualifikimit të ndryshëm që i ka bërë faktit penal Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër në bazë të nenit 374 të K.Pr.Penale, duke arritur në përfundimin se të pandehurit kanë vepruar si grup i strukturuar kriminal, si formë e veçantë bashkëpunimi e parashikuar në nenin 28/4 të K.Penal.

19. “Kolegji Penal vlerëson se, duke arritur në këtë konkluzion për ndryshimin e formës së bashkëpunimit, Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër ka vepruar në kundërshtim me funksionin që ajo ka si organ që jep drejtësi dhe duke marrë atributet që ka prokurori si organi që ngre akuzë. Ndryshe nga sa pretendon kjo gjykatë se faktit penal i ka dhënë një kualifikim tjetër ligjor sipas nenit 375 të K.Pr.Penale, vendimin e moskompetencës e ka ngritur në bazë të një akuze të re të ngritur prej saj. Kështu, përveç akuzës së ngritur nga prokurori për veprën penale të kultivimit të lëndëve narkotike të kryer në bashkëpunim sipas nenit 284/2 dhe 3 të Kodit Penal, gjykata i ka akuzuar dhe për veprën penale të krijimit të grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga neni 333/a të Kodit Penal. Gjykata nuk ka pasur parasysh në vendim kur ka ndryshuar formën e bashkëpunimit përcaktimin e nenit 28/5 të Kodit Penal, i cili e klasifikon krijimin dhe pjesëmarrjen në një grup të strukturuar kriminal si veprë penale dhe dënimin sipas parashikimit në pjesën e posaçme të Kodit Penal.” (theksimi sipas vendimit).

¹⁵³ Nr.24 i Vendimit, datë 31.01.2007, Vathi, etj.

¹⁵⁴ Vendim i gjykatës së apelit Tiranë nr.362, datë 30.09.2005.

¹⁵⁵ Vendim i gjykatës së shkallës së parë Tiranë nr.1289, datë 24.12.2004.

¹⁵⁶ Neni 373. Akuza për një veprë tjetër – 1. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del një veprë tjetër penale që ka lidhje me atë që gjykohet sipas nenit 79 gërma ”b”, ose një rrethanë rënduese që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim, prokurori i komunikon të pandehurit veprën penale ose rrethanën, por me kusht që gjykimi të mos jetë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

¹⁵⁷ Neni 428. Vendimi i gjykatës së apelit - 1. Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos: ...

ç - prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar ose ndihmësgjyqtar në çështjen konkrete, me numrin e gjyqtarëve dhe ndihmësgjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod, me ushtrimin e

Nuk ka dyshim që vendimi i gjykatës së apelit është kryekreje i gabuar, fakt që u konstatua nga kolegji penal, i cili tërhoqi vëmendjen se e drejta e prokurorit për t'i komunikuar të pandehurit veprën penale të re ose rrethanën rënduese, që nuk janë përmendur në kërkesën për gjykim, sipas nenit 373 të Kodit, "... është një e drejtë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve të tij për të cilën nuk mund ta detyrojë gjykata". Nëse prokurori nuk konteston një rrethanë rënduese, ky fakt edhe mund të konstatohet nga gjykata, por ai nuk përfshihet në rastet e pavlefshmërisë absolute që lidhen me të drejtën e ushtrimit të ndjekjes penale nga prokurori, ashtu sikundër vërejtja me të drejtë kolegji penal¹⁵⁸.

Natyrisht, nëse prokurori nuk formulon një ose disa akuza, ose nuk konteston një rrethanë rënduese, për shkaqe neglizhence, ai mund të përgjigjet, si rregull në rrugë disiplinore, pas një procesi të ndërmarrë në bazë të ligjit "*Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", por ligji nuk i njeh gjykatës pushtete korrektuese. Zgjedhja e ligjvënësit është parimore: një gjykatë që shton akuza apo rrethana rënduese nuk ofron garancitë e nevojshme të paanësisë, në një sistem të ndërtuar mbi parimet e procesit akuzator.

3- Është shumë e debatueshme zgjedhja që propozon një vendim i kolegjit penal, në vitin 2009¹⁵⁹. Një prokuror i prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Korçë kreu hetime, brenda të njëjtit afat kohor kur, nga Prokurori i Përgjithshëm ishin deleguar posaçërisht për të kryer hetime, lidhur me të njëjtin procedim, dy prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme. Përveç kësaj, ai prokuror pati deleguar për të kryer hetime edhe një oficer të policisë gjyqësore që ushtronte funksionet në prokurorinë e rrethit gjyqësor Pogradec që, sikurse dihet, i ushtron kompetencat e saj tokësore brenda një territori tjetër.

Kolegji penal vërejtja se aktet e kryera nga prokurori janë absolutisht të pavlefshme, për shkak të mungesës së të drejtës për ushtrimin e ndjekjes penale, e cila u ishte deleguar personave të tjerë, me akt të posaçëm të Prokurorit të Përgjithshëm¹⁶⁰.

ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të të dëmtuarit akuzues dhe të mbrojtësit të të pandehurit, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit.

¹⁵⁸ "Sikurse del nga përmbajtja e këtij neni, ndryshe nga sa përmend në vendim gjykata e apelit, nuk ndodhemi para shkeljeve që kanë të bëjnë me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe as me shkelje të dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja. Mosparaqitja e akuzave të reja apo e rrethanave rënduese që nuk janë përmendur në kërkesën e prokurorit për gjykim, nuk përbëjnë shkelje të nenit 373 të K.Pr.Penale, pasi kemi të bëjmë me ushtrimin e kompetencave dhe të drejtave të tij. Do të ndodheshim para shkeljeve të dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja në rastet kur ato nuk i komunikohen të pandehurit, ose kur nuk zbatohen kërkesat e nenit 374 të K.Pr.Penale".

¹⁵⁹ Nr.00-2009-499 i Vendimit (637), datë 25.11.2009, Prenga, etj.

¹⁶⁰ "...me Urdherin nr.2/1, date 09.01.2007, Prokurori i Pergjithshem Dhorë Sollaku ka deleguar z.Kasem Berberi dhe Isa Jata, te dy Prokurore prane Prokurorisë se Pergjithshme, per hetimin e ketij procedimi penal, te cilet ne baze te ketij urdheri ishin te vetmit te autorizuar per kryerjen e veprimeve hetimore dhe dergimin e cheshtjes per gjykim. Keta dy prokurore te komanduar kane kryer veprime hetimore deri me date 16.01.2007, nderkohe qe ne daten 14.01.2007 ka kryer veprime hetimore prokurori Hysen Kulla dhe nuk del nga asnje akt i dosjes hetimore se me çfare urdheri merr kompetencat ky prokuror dhe nuk ka asnje akt qe te tregojë qe dy prokuroret e komanduar te kene hequr dore nga hetimi i kesaj cheshtje. Po keshtu, nga aktet rezulton se prokurori Hysen Kulla, edhe pse nuk ka patur te drejten per kryerjen e veprimeve hetimore, i ka deleguar kompetencat per kryerjen e veprimeve hetimore oficerit te policise gjyqesore prane Prokurorisë se Rrethit Gjyqësor Pogradec, z. Ilir Hoxha, pra ka vepruar ne nje prokurori tjetër jashte juridiksionit ku kryen veprimtarine e tij ky prokuror.

Zgjidhja e kolegjit penal na duket e diskutueshme, edhe për shkak se nga leximi i vendimit disa rrethana të çështjes nuk rezultojnë të qarta (p.sh., rrethanat e delegimit të kompetencave një oficeri të një prokurorie tjetër). Nuk mendojmë se ka pasur cënim të së drejtës së prokurorëve të komanduar për ushtrimin e ndjekjes, sepse për shkak të rregullave të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë (*rregulli i centralizimit*), ndjekja ushtrohet nën autoritetin e drejtuesit të prokurorisë. Prokurori i Përgjithshëm pati deleguar dy prokurorë të zyrës së tij që të kryenin akte për llogari të prokurorisë së rrethit gjyqësor Korçë, ai nuk pati marrë përsipër hetimet (shih nenin 305 të KPP), duke ia hequr ato prokurorisë territoriale kompetente. Për këtë arsye, autoriteti i drejtuesit të prokurorisë, ku ishte regjistruar procedimi, mbi kontrollin dhe drejtimin e hetimeve mbetej i pacënuar. Në këto rrethana, dijenia dhe miratimi i tij, qoftë edhe në heshtje, për aktet e kryera nga një prokuror i zyrës së tij, u jep atyre legjitimitet. Nga ana tjetër, delegimi i kompetencave oficerit të prokurorisë fqinje, përbën shkelje të rregullave për kompetencën territoriale, që ligji nuk i sanksionon me pavlefshmëri absolute (neni 83.2 i KPP). Për këto arsye, na duket se vendimi i kolegjit penal nuk është i drejtë dhe i mirëargumentuar.

4- Dy raste interesante ofron jurisprudenca e viteve të fundit, sa i takon disponimit të prokurorit në lidhje me provat, në faza të ndryshme të procesit. Për shkak të interesit që paraqitin, po i trajtojmë në vijim:

Në rastin e parë¹⁶¹, kolegji krijoi praktikë, duke rrëzuar konstatimin e gjykatës së apelit për pavlefshmëri absolute, mbështetur në nenin 128.1/b të KPP, për shkak se prokurori nuk pati përfshirë në fashikullin e gjykimit një akt ekspertimi daktiloskopik dhe nuk kishte marrë nën hetim një subjekt tjetër, që sipas gjykatës rezultonte i përfshirë në veprime kriminale.

Lidhur me konstatimin e parë, kolegji penal nuk e mbështeti tezën e apelit, me të drejtë sipas gjykimit tonë, pasi mospërfshirja e aktit të ekspertimit në fashikullin e gjykimit është zgjedhje e prokurorit. Nëse mbrojtjes i cënohen të drejta nga ky veprim¹⁶², ajo mund të kërkojë që prova me natyrë shkencore të merret, veprim që u realizua nga gjykata e apelit, me kërkesë të mbrojtjes. Por, i takon prokurorit të çmojë nëse një provë vlen ose nuk vlen për të provuar pretendimet e akuzës dhe kjo nuk përbën cënim të së drejtës së tij për ushtrimin e ndjekjes penale¹⁶³. Në këtë pikë, problemi mund të shtrohet në planin e përgjegjësisë së prokurorit për të zbatuar parimet e ligjshmërisë dhe objektivitetit¹⁶⁴, pra, të parashtrimit edhe të provave që e

Nga sa sipër rezultojnë qarte se të gjitha veprimet procedurale të kryera nga ana e prokurorit Hysen Kulla janë akte absolutisht të pavlefshme, mbasi ky prokuror prane Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë nuk ka patur të drejten për ushtrimin e ndjekjes penale. Në zbatim të detyrimeve të parashikuara nga neni 131/1 të K.Pr.Penale, ky fakt sjell si pasoje pavlefshmerinë e vendimeve të gjykatave të faktit, vendime të cilat janë marre mbi akte absolutisht të pavlefshme.”

¹⁶¹ Nr. 00-2012-1333 i Vendimit (251), datë 03.10.2012; Kacolli

¹⁶² Prokurori është i detyruar që, në përfundim të hetimeve, ta njohë mbrojtësin me të gjitha aktet e hetimeve paraprake (shih nenet 50.2 dhe 327.2 të KPP).

¹⁶³ “28. ...Në kushtet kur ky veprim hetimor është kryer gjatë hetimeve paraprake, nuk mund të konsiderohet si mos ushtrim i ndjekjes penale, nga ana tjetër, nëse gjykata e apelit do ta kishte konsideruar të rëndësishëm për zgjidhjen e çështjes konform Nenit 427/3 të K.Pr.Penale, kryesisht mund të kishte urdhëruar përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e kësaj prove.” (nga përmbajtja e vendimit del që ky akt është marrë si provë nga gjykata e apelit, shih § 26 të vendimit).

¹⁶⁴ Ligji nr.8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: Neni 4 Ligjshmëria e veprimtarisë - 1. Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. 2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të njeriut.

shfajësojnë të akuzuarin, por sikundër theksuam më sipër, kjo është një çështje e etikës dhe e përgjegjësisë së tij disiplinore.

Përsa i takon mosmarrjes nën hetim të një personi tjetër, me të drejtë Kolegji ritheksoi jurisprudencën e mëparshme, se është e drejtë e prokurorit të formulojë akuzë dhe të ushtrojë ndjekjen, ndaj mosveprimi i tij nuk përbën shkak për pavlefshmëri absolute.

Në rastin tjetër¹⁶⁵, kolegji penal ka synuar të disiplinojë nismën e prokurorit për të marrë prova, ndërkohë që çështja nuk është zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në rastet kur gjykata e shkallës së parë vendos që aktet t'i kthehen prokurorit, por mbrojtja propozon apel, prokurori duhet të ndërpresë çdo nismë hetimore, përderisa nuk është shprehur me vendim gjykata e apelit. Zgjidhja e orientuar nga kolegji na duket e drejtë, sepse fakti që çështja është ende para gjykatës, çvlerëson çdo nismë të prokurorit për ushtrimin e ndjekjes, përfshi edhe aktet për marrjen e provave¹⁶⁶.

5- Në temën e pavlefshmërisë absolute që lidhet me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale, praktika gjyqësore ka shtruar për zgjidhje rastin kur rifillimi i hetimeve të një procedimi kryhet pa shfuqizuar vendimin e mëparshëm të pushimit, ndaj një personi ndaj të cilit janë zhvilluar hetime. Le ta parashtrajmë për diskutim këtë rast¹⁶⁷, duke e shqyrtuar paralelisht me një rast të ngjashëm:

Në kuadër të hetimeve të kryera për krimin e vrasjes me dashje, të kryer në dëm të dy personave, në datën 25.03.1999 prokuroria pati pushuar hetimet për personin e dyshuar, i cili ndodhej nën masën e sigurimit “arrest në burg”, të ekzekutuar në datën 10.12.1998. Në datën 17.04.1999 hetimi u pezullua në tërësi, për mosnjohje të autorit të veprës.

Në dritën e të dhënave të reja, më 23.09.2002, prokurori vendosi rifillimin e hetimeve, por pa disponuar fillimisht për shfuqizimin e vendimit të pushimit. Në vijim, ndaj personit të hetuar u formulua akuzë dhe çështja u dërgua për gjykim.

Gjykata e rrethit gjyqësor Fier, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, vendosi pushimin e çështjes me arsyetimin se ndjekja penale nuk duhet të kishte filluar dhe nuk mund të vazhdonte, pasi nuk mund të rifillonin hetimet pa u shfuqizuar, më parë, vendimi për pushimin e hetimeve ndaj të hetuarit. Ky vendim u la në fuqi nga gjykata e apelit Vlorë.

Çështja u shqyrtua nga Gjykata e Lartë në bazë të rekursit të prokurorit. U vendos prishja e të dy vendimeve dhe kthimi i çështjes për rigjykim në gjykatën e rrethit gjyqësor.

Vendimet e prishura, në thelb, lidhen me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale. Kolegji penal arsyetoi se mosshfuqizimi formal i vendimit të pushimit të hetimeve, në kushtet kur prokurori shprehu vullnetin për të rifilluar hetimet, madje në përfundim të tyre

¹⁶⁵ Nr.00-2011-87 i Vendimit (7), datë 12.1.2011, Shtëmbari.

¹⁶⁶ “Rezulton e provuar se me vendimin nr.136, datë 25.04.2008 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur kalimin e akteve prokurorit. Ky vendim është ankmuar nga i gjykuari në Gjykatën e Apelit Vlorë, por edhe pse në rrethanat kur çështja nuk ishte gjykuar nga kjo gjykatë, pra edhe pse vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk kishte marrë formë të prerë dhe çështja vazhdonte të ishte në juridiksion gjyqësor, nga ana e prokurorisë është vazhduar hetimi i çështjes dhe një prej provave të reja të marra gjatë hetimit paraprak është dhe dëshmia e L.Sh., marrë në seancë për sigurimin e provës së datës 23.06.2007. Duke qenë se kjo provë është marrë nga ana e organit të prokurorisë ndërkohë që ky organ nuk ka qenë kompetent për të zhvilluar hetime për këtë çështje e cila ishte duke u gjykuar, në vështrim të nenit 128/b të K.Pr.Penale ajo është e pa vlefshme dhe gjykata e shkallës së parë, bazuar në kërkesat e nenit 380 të K.Pr.Penale, nuk mund të merrte vendimin bazuar në prova absolutisht të pavlefshme apo të paverifikuara gjatë shqyrtimit gjyqësor.” (citimi sipas vendimit)

¹⁶⁷ Nr.237 i Vendimit, datë 15.03.2006, Bytyçi.

vendosi që ta akuzojë të dyshuarin, nuk përbën shkak për pavlefshmëri të akteve¹⁶⁸. Bashkohemi me arsyetimin e kolegjit se ligji procedural jo vetëm nuk parashikon shprehimisht ndonjë detyrim të kësaj natyre për prokurorin, por akti nuk lidhet as me shkeljen e ndonjë të drejte që, për këtë shkak, i hetuari nuk pati mundësinë që ta ushtronte. Pra, duket qartë se vendimet e gjykatave më të ulta kanë qenë të gabuara, në tejkalim të frymës dhe të shkronjës së ligjit procedural¹⁶⁹.

Në vijim, është e udhës të studjojmë edhe një rast tjetër¹⁷⁰, që paraqet ngjashmëri me rastin e mësipërm, në gjykimin tonë interesant dhe i debatueshëm, për të cilin vlen të diskutohet edhe mendimi i pakicës:

Rasti lidhet me hetimet ndaj dy personave të akuzuar për vjedhje me dhunë, të kryer në bashkëpunim. Të bashkëakuzuar në fazën e hetimeve paraprake, konstatohet se për njërin prej tyre procedimi penal u pushua nga prokurori. Dy muaj më pas, prokurori urdhëroi detyra për policinë gjyqësore, në drejtim të verifikimit të fakteve e rrethanave për të njëjtin subjekt, për shkak të administrimit të disa të dhënave të reja në ngarkim të tij. Pas kryerjes së disa akteve hetimore, përfshi edhe caktimin e masës së sigurimit, prokurori vendosi dërgimin e çështjes në gjyq. Gjykata e rrethit gjyqësor Lushnjë i deklaroi fajtorë të dy të pandehurit, vendim i cili u la në fuqi nga gjykata e apelit Vlorë.

Mbi rekursin e të pandehurve çështja u shqyrtua nga kolegji penal i Gjykatës së Lartë, i cili vendosi prishjen e vendimeve dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, me trup tjetër gjykues “... për shkelje të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale.”

Kolegji vërejti, me të drejtë sipas gjykimit tonë, se hetimet në ngarkim të njërit prej të pandehurve vijuan pa u shfuqizuar paraprakisht vendimi i pushimit të çështjes në ngarkim të tij. Pikërisht, ky akt do të bënte të mundur rifitimin e statusit procedural të të pandehurit¹⁷¹, të cilin ky person e pati humbur me vendimin e pushimit. Për pasojë, ky person është gjykuar pa akuzë formale në ngarkim të tij, që do të thotë se prokurori nuk ka ushtruar të drejtën e ndjekjes, duke prodhuar pavlefshmëri absolute të vendimeve të gjykatave.

Por, ndërsa bashkohemi me mendimin se vendimet ishin absolutisht të pavlefshme dhe duhet të prisheshin, zgjidhja e mëtejshme, e dhënë nga kolegji, gjykojmë se është e diskutueshme. Përmendëm se kolegji riktheu çështjen për rigjykim në shkallë të parë, ndërkohë që njëri prej “të pandehurve” ishte, në fakt, pa akuzë. Lidhur me këtë pikë, gjyqtari në pakicë ka bërë një vërejtje të zgjuar, duke mos u pajtuar me mendimin e shumicës për ta dërguar çështjen për rigjykim, për arsyen e thjeshtë se njëri prej të pandehurve nuk e gëzonte pozitën procedurale të të pandehurit. Ai propozoi zgjidhjen radikale të pushimit të çështjes penale në bazë të nenit 442.1, shkronja “a” të Kodit.

¹⁶⁸ “... ekzistenca e një vendimi pushimi nuk mund të shërbejë si pengesë për organin e akuzës për të rifilluar e vazhduar hetimet, apo për të ringritur një akuzë ndaj një personi për të cilin më parë është marrë një vendim pushimi” (citimi sipas vendimit).

¹⁶⁹ Shënojmë, gjithashtu, se rastet që lidhen me akuza të rënda (sikurse është rasti i vrasjes së dyfishtë që po diskutojmë) nuk janë rastet më të mira për të promovuar dhe për të përpunuar jurisprudencë të re, lidhur me zbatimin e normave procedurale.

¹⁷⁰ Nr.282 i Vendimit, datë 15.03.2007, Shahini, Hoxhallari.

¹⁷¹ Neni 34. Marrja e cilësisë së të pandehurit - ... 3. Cilësia e të pandehurit rimerret kur priset vendimi i pushimit ose kur vendoset rishqyrtimi i procesit.

Ndonëse bashkohemi me vërejtjen e saktë të pakicës, nuk mund të pajtohemi me zgjidhjen e dhënë prej saj, e cila do ta përjashtonte automatikisht nga përgjegjësia penale jo vetëm subjektin e ngelur pa akuzë, por edhe të bashkëpandehurin tjetër.

Quod juris? Gjykojmë se zgjidhja më e saktë do të ishte prishja e vendimeve të gjykatave dhe dërgimi i akteve prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor për të marrë masat e nevojshme (nenet 442.1, shkronja “b” dhe 442.2 të KPP). Kjo zgjidhje, e rregulluar shprehimisht nga ligji, do të kërkonte që prokurori të formulonte akuzat dhe ta ridërgonte çështjen për gjykim.

Në dallim nga rasti pararendës, vihet re se kolegji orienton vetëm shfuqizimin e vendimit të pushimit. Ai nuk shprehet nëse problemën do të mund ta zgjidhte edhe një vendim për rifillimin e hetimeve, duke nënkuptuar se kjo zgjidhje as që mund të shtrohej për diskutim, në rastin konkret. E mbështesim këtë zgjidhje, pasi rastet nuk janë identike. Në rastin e mëparshëm nuk ishte formuluar akuzë, ajo u ngrit pas rifillimit të hetimeve. Në rastin në shqyrtim subjekti ka qenë formalisht nën akuzë, por ky akt e humbi fuqinë me vendimin e pushimit. Rifitimin e cilësisë së të pandehurit ligji procedural e lidh me prishjen e vendimit të pushimit dhe jo me rifillimin e hetimeve. Me këtë akt mund të rifitohet pozita procedurale e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, por jo cilësia e të pandehurit, e cila riaktivizohet ose me anën e një akti formal të njoftimit të akuzës, ose me prishjen e vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes (*pa përfshirë rastin kur çështja kthehet për rigjykim, e cila e prezumon ekzistencën formale të një akuze*).

6- Në fund, le të marrim për diskutim një rast interesant¹⁷², i cili edhe pse nuk krijon jurisprudencë në temën e posaçme që po trajtojmë, lejon të vërehen disa paqartësi të pazakonshme të kolegjit penal, lidhur me parimet e përgjithshme që disiplinojnë dallimet midis pavlefshmërive të natyrave të ndryshme, përsa u takon rregullave formale të konstatimit dhe ngritjes së tyre. I pandehuri u deklarua fajtor nga gjykata e shkallës së parë Lushnjë për krimin e plagosjes së rëndë me pasojë vdekjen e të dëmtuarit dhe u dënua me tetë vjet burgim. Gjykata e apelit Vlorë e prishi këtë vendim dhe e ktheu çështjen për rigjykim me argumentin se, ndër të tjera, u shkelën edhe procedurat që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori, për shkak se vendimet për rifillimin e hetimeve dhe për shfuqizimin e vendimit të pushimit të akuzës u muarën në tejkalim të të drejtave që i njeh neni 24 i KPP prokurorit të rrethit. Kundër këtij vendimi paraqiti rekurs prokurori i apelit. Kolegji penal i Gjykatës së Lartë nuk pranoi të shqyrtojë bazueshmërinë në ligj të problemeve që ngriheshin në rekursin e prokurorit dhe as argumentet e vendimit të gjykatës së apelit, por e quajti të udhës të vendoste prishjen e tij për shkaqe procedurale dhe kthimin për rigjykim. Kolegji çmoi se gjykata e apelit nuk duhej të shqyrtonte problemet procedurale për të cilat ka mbajtur qëndrim pasi “... ato nuk janë ngritur në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 129 të K.pr.p. ... As mbrojtësi, as dhe i gjykuari, ... nuk figuron që të kenë paraqitur kërkesa dhe të kenë bërë pretendime për pavlefshmëri të akteve të hetimeve paraprake që u zhvilluan në çështjen penale në ngarkim të tij.”

Shkeljet e konstatuara nga gjykata e apelit lidhen me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale, të cilat shkaktojnë pavlefshmëri absolute që duhet të ngrihet edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit. Ato nuk janë të natyrës relative për të cilat ligji kërkon ngritjen nga ana e palës së interesuar dhe brenda afateve kufizuese me pasojë mospranimi, sikurse arsyeton kolegji penal. Ndaj vlerësojmë se ky vendim ka krijuar jo vetëm paqartësi për gjykatat, por edhe paqëndrueshmëri e pasaktësi të dukshme të atij kolegji për të bërë një dallim parimor, përsa i takon njërës prej kritereve dallues të dy llojeve të pavlefshmërive që parashikon ligji ynë procedural.

¹⁷² Nr.689 i Vendimit, datë 22.11.2006, Rrushi.

b) Në fillim të këtij paragrafi përmendëm se pavlefshmëria absolute e akteve që lidhen me veprimtarinë e përfaqësuesit të akuzës, mund të ngrihet apo të konstatohet edhe në rastin kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me *pjesëmarrjen e tij në procedim*. Vërejmë se ligjvënësi ynë i është shmangur modelit italian kur ka vendosur të sanksionojë me pavlefshmëri absolute edhe raste të kësaj natyre. Kemi përmendur më sipër (*shih § 1.3.2*) se, në ligjin italian të procedurës, raste të kësaj natyre sanksionohen me pavlefshmëri absolute, por të natyrës ndërmjetëse. Kjo do të thotë se pavlefshmëri të tilla janë të korrigjueshme dhe, megjithëse mund të konstatohen *ex officio* ose me kërkesë të palës, ngritja e tyre kushtëzohet me respektimin e afateve (*p.sh., pavlefshmëritë e konstatuara para shqyrtimit gjyqësor nuk mund të ngrihen pas dhënies së vendimit në shkallë të parë*). Besojmë se ligjvënësi ynë, në një moment historik të caktuar, që lidhet jo vetëm me reformën tërësore të procedurës, por edhe me disa mangësi që u konstatuan në administrimin e drejtësisë penale, në kushtet kur po merrte jetë me shumë ngërç një sistem i ri vlerash e parimesh, ka dashur ta lidhë përfaqësuesin e akuzës me procesin në mënyrë të pazgjidhshme, jo vetëm në aspektin e pjesëmarrjes fizike, por edhe detyrimit të tij për të mbajtur qëndrim të shprehur lidhur me të gjitha çështjet objekt shqyrtimi nga gjykatat.

Padyshim që zgjidhja origjinale e Kodit italian është më elastike. Ajo mishëron logjikën se akuzuesi, duke mbajtur detyrimin e barrës së provës, është i lirë të bëjë zgjedhjet e tij të përgjegjshme në lidhje me pjesëmarrjen në procedim, duke qenë i detyruar që të përmbushë nismat që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Sistemi ynë është më i ngurtë, ai nuk lejon hapësirë për zgjedhje dhe dikton pjesëmarrje të domosdoshme të prokurorit në procedim, edhe në ndonjë rast kur prania e tij nuk është e nevojshme, sikurse është, bie fjala, rasti i parashikuar nga neni 248¹⁷³ i Kodit të Procedurës.

Sigurisht që pjesëmarrja e prokurorit në procedim, në një proces palësh, është shumë e rëndësishme. Përveç rasteve kur gjykata shqyrton kërkesa të formuluar nga prokurori (*masat e sigurimit, kërkesa për marrje të provave, dëgjimi i konkluzioneve, etj.*), Kodi parashikon disa raste që normojnë marrjen e mendimit të prokurorit, p.sh., neni 37/a.3 (*kur do të vendoset lidhur me bashkëpunëtorin e drejtësisë*), neni 223.4 (*në rastin e fshirjes së regjistrimeve të telekomunikimeve*), neni 400.2 (*dhënia e pëlqimit për gjykimin e drejtpërdrejtë*), neni 405.1 dhe 6 (*dhënia e mendimit për pranimin e gjykimin të shkurtuar*), neni 471 (*pjesëmarrja e detyrueshme*

¹⁷³ Neni 248. Marrja në pyetje e personit të arrestuar - 1. Jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës, gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi.

2. Nëpërmjet marrjes në pyetje gjykata verifikon kushtet e zbatimit të masës së arrestit dhe nevojat e sigurimit. Kur këto kushte nuk ekzistojnë, gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës.

3. Në pyetjen e të arrestuarit marrin pjesë prokurori dhe mbrojtësi, të cilët lajmërohen nga sekretaria e gjykatës.

4. Kur pyetja e të arrestuarit duhet të bëhet në gjykatën e një rrethi tjetër, gjykata kërkon që pyetja të bëhet nga një gjyqtar i asaj gjykate.

Në raste të tilla gjykata e ka dëgjuar prokurorin dhe argumentet mbështetëse të kërkesës së tij dhe ka vendosur masën e sigurimit personal. *Ratio* e kësaj norme synon të rivendosë drejtpeshimin e prishur, duke krijuar mundësinë që të dëgjohet edhe pala tjetër, logjikë që mbështetet në parimin e njohur *audiatur et altera pars* (të dëgjohet edhe pala tjetër). Prandaj gjykojmë se pjesëmarrja e prokurorit në këtë seancë nuk është e nevojshme, por rreziku i sanksionit të rëndë procedural, në kushtet e zgjedhjes së bërë nga ligjvënësi, dikton praninë e tij të domosdoshme.

dhe dhënia e mendimit për çështje që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale), etj. Problemi që vihet në diskutim mund të formulohet si vijon: *mosshfaqja e mendimit nga ana e prokurorit a përbën shkak për pavlefshëri absolute?* Me fjalë të tjera, a mundet që mosshfaqja e mendimit të interpretohet si mungesë e “*pjesëmarrjes në procedim*”, në kuptim të nenit 128.1, shkronja “b” të Kodit? Praktika e viteve të fundit e kolegjit penal të Gjykatës së Lartë nuk ofron jurisprudencë lidhur me këtë temë, me siguri për mungesë rastesh. Kjo mund të shpjegohet mbase me natyrën hierarkike të organizimit të brendshëm të prokurorisë, për shkak të të cilit qëndrimet që do të mbajë prokurori në seancë gjyqësore paraprkisht diskutohen me drejtuesit dhe, zakonisht, inercia për t’u shprehur nuk ka mundur të krijojë praktikë.

Në mungesë të praktikës sonë gjyqësore, e gjejmë me vend të ndalemi shkurtimisht në jurisprudencën e Gjykatës së Kasacionit në Itali ku, sikundër e pamë pak më lart, ligji procedural nuk e lidh mospjesëmarrjen e prokurorit në procedim me sanksione pavlefshmërie të pakorrigjueshme. Shënojmë se doktrina italiane e trajton konceptin e pjesëmarrjes së prokurorit në procedim në kuptimin e ngushtë të tij, duke përfshirë në këtë koncept çdo nismë të prokurorit të ndryshme nga ushtrimi i ndjekjes penale. Pjesëmarrja e tij në procedim shpreh një vlerë mbetëse në raport me ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfshin “... të gjitha dispozitat që disiplinojnë rastet proceduese të prokurorit, të ndryshme nga ato që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale”¹⁷⁴. Koncepti i mësipërm shprehet, para së gjithash, me pjesëmarrjen e prokurorit në shqyrtimin gjyqësor të çështjes, por edhe në nismën e tij për vendosjen e masave të sigurimit, personal ose pasuror. Është interesant qëndrimi i jurisprudencës që nocionin e pjesëmarrjes së prokurorit në procedim dhe pavlefshmërinë që buron prej saj e lidh drejpërsëdrejti me detyrimin e njoftimit të tij, në mënyrë që të ketë mundësinë reale të ushtrojë funksionet, por jo edhe me rastet kur ai nuk dëshiron të përfitojë nga kjo mundësi. Ky koncept shtrihet si në tematikën e masave të sigurimit¹⁷⁵, ashtu edhe për çështjet e themelit¹⁷⁶. Pra, mosshfaqja e mendimit nga ana e prokurorit të njoftuar rregullisht, sipas jurisprudencës italiane, nuk përbën shkak për sanksione pavlefshmërie të llojit *tertium genus*. Kjo praktikë mund të përbente një interpretim të vlefshëm edhe për ligjin tonë procedural, në përgjigje të pyetjeve që ngritëm më lart, edhe për shkak të kujdesit që ka treguar ligjvënësi për të rregulluar hollësisht rastet e njoftimit të prokurorit (*shih nenet 43, 136, 249.4, 258.2, 333.2, 336.2, 414, 436.3, 442.2 dhe 446.1*). Gjithsesi, do të jetë praktika gjyqësore që mund të thirret të thotë fjalën e saj nëse mosveprimi i prokurorit do të duhet ose jo të konsiderohet mospjesëmarrje në procedim, me pasojë pavlefshmëri absolute sipas nenit 128.1, shkronja “a” të Kodit të Procedurës Penale.

Si përfundim, mund të theksojmë se ushtrimi i ndjekjes penale, sipas ligjit tonë procedural, mund dhe duhet të konceptohet si një proces dinamik që fillon me ngritjen e akuzës dhe materializohet me vendimin e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq; ai nuk normohet nga

¹⁷⁴ Dominioni Oreste, Tek Commento al nuovo codice di procedura penale, a cura di M. Chiavario, UTET, Torino 1990, faqe 267. Cituar nga Di Geronimo Paolo, *vep. e cit.*, faqe 74.

¹⁷⁵ Rasti i vendimit nr.8392, datë 28.02.2002 të Seksionit II të Gjykatës së Kasacionit. Prokurori, i pranishëm në seancë publike, nuk u shpreh lidhur me kërkesën e mbrojtjes për revokimin e masës së sigurimit (u largua nga seanca) dhe kërkesa u rrëzua nga gjykata. Bazuar në parimin e mësipërm, Gjykata e Kasacionit nuk konstatoi në këtë rast pavlefshmëri të vendimit (*Cass. Pen., Sez. II, 28 febbraio 2002, n. 8392, Clausi G. ed altro*). Tek Il codice di procedura penale, annotato con la giurisprudenza, a cura di Piermaria Corso, *tekst i cituar*, faqe 447.

¹⁷⁶ Rasti i vendimit nr.6916, datë 08.07.1996 të Seksionit II të Gjykatës së Kasacionit. Prokurori, ndonëse u ftua në gjykimin e apelit që të parashtronte kërkesat e tij lidhur me themelin, u shpreh se nuk konkludonte dot për to, por jepte pëlqimin lidhur me kërkesën e të pandehurit për pranimin e ritit alternativ. Gjykata e Kasacionit vërejtë se “... detyrimi i pjesëmarrjes në procedim, në fakt, nuk passjell detyrimin që prokurori patjetër të japë përfundimet e tij, me gojë ose me shkrim, për të gjitha çështjet që mund të zhvillohen në vendimarrjen e mëvonshme të gjyqtarit” (*Cass. Pen., Sez. II, 8 luglio 1996, n. 6916, Campanale*). *Ibidem*, faqe 448.

ligji si një çast i vetëm, i mirëpërcaktuar. Në praktikën gjyqësore, ende ka moskuptime të rënda të rolit dhe funksioneve të gjyqtarit në sistem, duke i veshur atij pushtete akuzuese të cilat nuk i gëzon më. Vërehet, gjithashtu, se edhe lidhur me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes konstatohen paqartësi të kolegjit penal për të bërë dallimin parimor që ndan kriteret dalluese të dy llojeve të pavlefshmërive që parashikon ligji ynë i procedurës. Së fundi, Kodi ynë, në dallim nga modeli italian, sanksionon me pavlefshmëri absolute edhe mungesën e pjesëmarrjes së prokurorit në procedim, duke dashur t'i atribuojë atij një rol më protagonist në procesin penal.

§ 2.2.3 Rastet e pavlefshmërisë absolute që lidhen me të pandehurin dhe mbrojtësin e tij

Këto raste parashikohen nga neni 128.1, shkronja “c” i Kodit, i cili sanksionon posaçërisht me pavlefshmëri absolute rastet kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me *thirrjen e të pandehurit dhe praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme*. Nga ky formulim rezulton se pavlefshmëria absolute e lidhur me subjektet procedurale të të pandehurit dhe mbrojtësit, mund të ngrihet apo të konstatohet në dy raste:

- a) kur nuk respektohen dispozitat për thirrjen e të pandehurit;
- b) kur çenohen rregullat që sigurojnë praninë e mbrojtësit, por vetëm në rastet kur kjo prani është e detyrueshme.

Këto dy mundësi, në vijim, do të studjohen në planin doktrinar dhe të jurisprudencës së gjykatave. Për shkak të rëndësisë së tyre në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, kjo tematikë do të studjohet edhe në referencë me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

a) Thirrja e të pandehurit për të marrë pjesë në procesin që zhvillohet kundër tij është materializim i të drejtës së tij për t'u vetëmbrojtur, e njohur në nivelin e një parimi të qëndrueshëm të së drejtës tonë, por edhe të një sërë dokumentesh e kartash ndërkombëtare, pjesë e së drejtës së brendshme të Republikës.

Kushtetuta parashikon të drejtën e kujtdo që akuzohet për t'u mbrojtur vetë ose me anën e mbrojtësit ligjor, garantimin e lehtësive të mjaftueshme për ta ushtruar realisht këtë të drejtë¹⁷⁷, si dhe sanksionon parimin e kontradiktoritetit me pohimin se “*kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet*”¹⁷⁸.

Parimi i të drejtës së mbrojtjes parashikohet edhe në nenin 6¹⁷⁹ të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore dhe në nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike¹⁸⁰.

¹⁷⁷ Neni 31. Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

...

b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

c) ...;

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; ...

¹⁷⁸ Neni 33.1 i Kushtetutës.

¹⁷⁹ Neni 6. E drejta për një proces të rregullt - ... 3. Çdo i akuzuar ka të drejtë pikërisht që:

Pra, si e drejta e brendshme, ashtu edhe Kartat ndërkombëtare sanksionojnë *parimin e vetëmbrojtjes të të akuzuarit*, përveç të drejtës që gëzon për t'u ndihmuar teknikisht nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij ose i caktuar nga shteti, kur ai nuk ka mjetet e nevojshme financiare. Realizimi efektiv i kësaj të drejte dikton domosdoshmërinë e thirrjes së të pandehurit në procedurën që zhvillohet kundër tij, e drejtë kjo që synon ta mbrojë pjesa e parë e nenit 128.1, shkronja "c" të Kodit.

Praktika jonë gjyqësore pati shfaqur moskuptime lidhur me detyrimin ligjor për thirrjen e të pandehurit gjatë gjykimit të çështjes së tij në gjykatën e apelit. Ky problem i zbatimit të ligjit u zgjidh me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.1, datë 15.02.2001, i cili trajton posaçërisht kuptimin e ndërlidhjes midis koncepteve "*thirrje*" dhe "*njoftim*" i të pandehurit, të lirë apo të paraburgosur, për t'u paraqitur në gjykatën e apelit, zgjidhje e cila është e vlefshme edhe për fazat e tjera të procedurës. Kolegjet e Bashkuara duke vërejtur se gjykatat bënin një ndarje artificiale midis dy nocioneve, orientuan interpretimin sipas një koncepti bashkues duke arritur në përfundimin "*... se urdhërimi për thirrje i të pandehurit të lirë apo të arrestuar në gjykimin në apel, nuk mund të kuptohet dhe të ndahet nga njoftimi i tij dhe rregullat procedurale që duhen zbatuar për këtë njoftim*". Ky interpretim, shumë i drejtë, është në të njëjtën linjë me doktrinën e huaj që komenton: "*Thirrja*" *përbën mjetin e vocatio in iudicium në shkallën e parë dhe të dytë dhe përfshin: a) dekretin e thirrjes në gjykim; b) komunikimin e tij përmes njoftimit*"¹⁸¹.

Megjithë kuptimin, në dukje të qartë, të normës dhe orientimet e sakta të vendimit unifikues të sipërcituar, nuk është bërë e mundur të shmangen gabimet e interpretimit në veprimtarinë praktike të gjykatave, lidhur me respektimin e dispozitave për thirrjen e të pandehurit. Në këtë temë vërehet një qëndrim koherent i kolegjit penal të Gjykatës së Lartë që, në disa vendime të tij, ka ritheksuar se pa u kryer procedurat e thirrjes dhe njoftimit të të pandehurit, nuk mund t'i hapet rruga gjykimit të tij në mungesë. Padyshim një qëndrim shumë i drejtë, pasi garantimi i parimit të kontradiktoritetit në gjykim është tejet i rëndësishëm. Vetëm kur realizimi i tij nuk është i mundur për shkak se i pandehuri dëshiron t'i shmangët gjykimit, mund të lejohen procedurat e gjykimit në mungesë: "*Duke gjykuar çështjen në mungesë të të gjykuarit S.S., pa e thirrur atë edhe pse ky ka qenë një detyrim që rrjedh nga dispozitat procedurale penale, gjykata e shkallës së parë Tiranë ka marrë një vendim, i cili në kuptim të nenit 128/1-c të K.pr.p. është absolutisht i pavlefshëm*"¹⁸².

Gjithashtu, në vijimësi, kolegji penal ka tërhequr vëmendjen drejt detyrimit për të respektuar procedurën që normojnë nenet 140 e vijues të Kodit, për njoftimin e të pandehurit të

...

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij dhe, ...;

¹⁸⁰ Është adoptuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutën 2200 A (XXI), datë 16.12.1966. Hyri në fuqi më 23.3.1976. Republika e Shqipërisë aderoi me ligjin nr. 7510, datë 8.8.1991:

Neni 14.3 – Çdo person i akuzuar për kryerjen e një vepre penale, në barazi të plotë, gëzon të paktën të drejtën e garancive vijuese: ... d) Të jetë i pranishëm në proces dhe të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një avokati të zgjedhur prej tij; ...

Konsultuar në internet në adresën www.unhchr.ch/french/html

¹⁸¹ Tonini Paolo, *vep. e cit.*, faqe 175.

¹⁸² Nr.158 i Vendimit, datë 02.04.2008, Sina.

libër, kur ai thirret për të gjykuar në shkallë të parë dhe në gjykatën e apelit; kjo procedurë duhet respektuar edhe në rastet kur ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal “*arrest në burg*” dhe ende nuk është ekzekutuar¹⁸³. Kjo është zgjidhja që propozohet edhe në disa vendime të mëvonshme¹⁸⁴.

Në rastet kur dihet që i pandehuri ndodhet jashtë shtetit, nuk mund të zbatohet procedura e njoftimit të të pandehurit që nuk gjendet (*neni 141*), por ajo e njoftimit të të pandehurit jashtë shtetit (*neni 142*)¹⁸⁵. Në raste të tilla, mosrespektimi i njoftimit përmes letrës rekomande me lajmërim-marrje, edhe gjatë gjykimit në gjykatën e apelit, e bën procedurën të parregullt, duke shkaktuar pavlefshmëri absolute¹⁸⁶.

Në një rast, kolegji ka prishur vendimet e gjykatave më të ulëta dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim me argumentin se gjykata e rrethit ka gabuar kur ka vendosur deklarin e ikjes së

¹⁸³ Nr.96 i Vendimit, datë 20.02.2008, Rakaj. Sipas Kolegjit, edhe pse ndaj të pandehurit mund të jetë vendosur masa e sigurimit “*arrest në burg*”, në kushtet kur ajo nuk është ekzekutuar, i pandehuri konsiderohet i lirë dhe për njoftimin e tij duhet të ndiqen procedurat që normojnë nenet 140 e vijues të KPP.

¹⁸⁴ Nr.00-2013-247 i Vendimit (35), 31.1.2013, Kurti, etj.: “16. Në bazë të akteve rezulton se, pas dërgimit të akteve të fashikullit për gjykim, gjykata kishte detyrimin ligjor në bazë të nenit 140 të K.Pr.Penale, që të njoftonte si organin e akuzës ashtu edhe të gjykuarën për të marrë pjesë në procesin penal të zhvilluar kundër tij. Rezulton se në fazën e hetimit ashtu edhe të gjykimit, Gj.(B.) V. ka pasur masë sigurimi “*Arrest në burg*” në mungesë, vendosur me vendimin nr.1418 akti, datë 07.12.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila nuk është ekzekutuar nga Policia Gjyqësore. Në këto kushte ky i gjykuar është hetuar dhe gjykuar në mungesë.

17. Në këto rrethana, njoftimi i tij duhet të bëhet sipas rregullave procedurale për të pandehurin në gjendje të lirë, sipas nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale.”

¹⁸⁵ Nr.00-2013-533 i Vendimit (93), datë 22.2.2010, Kraho: “Gjykata e apelit arsyeton në vendimin e saj se nuk është zhvilluar një proces i rregullt gjyqësor, sepse gjykata e shkallës së parë ka disponuar për t’i komunikuar njoftimin e të pandehurit sipas nenit 141 të K.Pr.Penale, që bën fjalë për njoftimin e të pandehurit kur nuk gjendet dhe jo kërkesat e nenit 142 të K.Pr.Penale, që bën fjalë për njoftimin e të pandehurit jashtë shtetit.

Sikurse u përmend, edhe gjykata e apelit arsyeton se gjykata e shkallës së parë, me disa shkresa të komisariatit të policisë në përgjigje të kërkesës së saj, është vënë në dijeni se i gjykuari Muhamet Kraho ndodhej jashtë shtetit, në Greqi, i arrestuar në burgun e Athinës, por në vazhdimësi njoftimet i ka bërë sipas nenit 141 të K.Pr.Penale e për pasojë vazhdon vendimi i gjykatës së apelit, rrjedh inekzistenca e njoftimit të urdhërit të thirrjes për gjykim me pasojë pavlefshmërinë absolute të akteve proceduriale sipas nenit 128/ç të K.Pr.Penale, konkluzion ky që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e gjen të drejtë.”

¹⁸⁶ Nr. 00-2012-1624 i Vendimit (312), datë 21.11.2012, Dogan: “22. Në këtë situatë të paqartë në lidhje me realizimin e njoftimit për të pandehurin, megjithëse ishte e dukshme se njoftimi për të nuk ishte i realizuar, pasi nuk ka të administruar në dosje letër-rekomande me lajmërim-marrje sipas nenit 142 të K.Pr.Penale, gjykata e apelit pavarësisht se kishte detyrim ta ndiqte këtë procedurë, në kundërshtim me ligjin ka deklaruar mungesën dhe ka zhvilluar gjykimin në mungesë.

23. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda në kundërshtim me nenin 142 të K.Pr.Penale, pa kryer procedurat fillestare të përcaktuara në këtë dispozitë, në lidhje me dërgimin e letër-rekomandesë ka vijuar procedurat drejtpërsëdrejti me njoftimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht.”

Si rast i zbatimit të rregullt të procedurës së njoftimit të të pandehurit jashtë shtetit (me anën e letërporosisë), mund të shihni: Nr.00-2013-1001 i Vendimit (128), datë 10.4.2013, Zaimi (§ II.1).

të pandehurit “... në një kohë që në dosje nuk ka asnjë thirrje në drejtim të tij”^{187,188,189}. Gjithashtu, njoftimi i mbrojtësit nuk mund të zëvendësojë njoftimin e të pandehurit personalisht¹⁹⁰. Pra, Gjykata e Lartë i mëshon nevojës së përmbushjes së dy elementeve: dokumentimit të faktit se i pandehuri është thirrur dhe se thirrja i është komunikuar përmes njoftimit.

Për kolegjin penal paraqet rëndësi respektimi i radhës së njoftimit të të pandehurit të lirë, sipas normës që vendos neni 140 i Kodit. Ligjvënësi parapëlqen që i pandehuri të njoftohet personalisht dhe, kur kjo nuk është e mundur, të ndiqet një radhë e caktuar, e cila jep sigurinë se kështu ai mund të vihet në dijeni efektivisht për aktin e thirrjes. Ky qëndrim i drejtë i kolegjit theksohet në disa vendime të tij¹⁹¹. Rëndësinë e respektimit të kësaj norme, në këndvështrimin e realizimit të së drejtës së mbrojtjes, e thekson edhe Gjykata Kushtetuese¹⁹².

¹⁸⁷ Nr.325 i Vendimit, datë 24.05.2006, Daja, etj.

¹⁸⁸ Nr.00-2010-503 i Vendimit (331), datë 7.4.2010, Halilaj, etj.: “Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është absolutisht i pavlefshëm, pasi nuk janë respektuar kërkesat procedurale në lidhje me njoftimin e të pandehurit S.H., pasi janë dërguar vetëm dy fletëthirrje, ku në fletëthirrjen e parë është vendosur shënimi se ndodhet në Itali, pa nënshkrimin e ftuesit dhe të personit të pranishëm, por kjo seancë gjyqësore nuk është zhvilluar për mosformim të trupit gjykues, ndërsa për seancën e datës 04.05.2000, në dosje gjëndet vetëm një fletëthirrje që nuk ka asnjë konfirmim, madje asnjë shënim se kujt i është dorëzuar. Gjykata, duke arsyetuar se nga aktet rezultojnë gjykim në mungesë, që sigurisht duhet të referohet tek hetimet paraprake, pa hetuar nëse ishte njoftuar apo jo ky i pandehur dhe për shkaqet e mosparaqitjes, ka deklaruar mungesën e të pandehurit duke i caktuar avokat kryesisht.”

¹⁸⁹ Nr.00-2011-584 i Vendimit (95), datë 13.7.2011, Tinaj, etj.: “Shqyrtimi gjyqësor i çështjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka filluar me datën 29.09.1999 dhe ka vazhduar 16 seanca, pa njoftuar në asnjë rast të gjykuar. Në nëntë seanca ose nuk përmendet fare i pandehuri ose është shënuar se nuk u paraqit avokati dhe i pandehuri, pa theksuar në asnjë rast nëse ai ka patur dijeni dhe shkaqet e mosparaqitjes.

Në proces-verbalin e seancës gjyqësore të datës 29.03.2000 është shënuar se nuk u paraqit i pandehuri F.T., përsëri pa vënë në dukje nëse kishte marrë njoftim dhe shkaqet e mosparaqitjes dhe gjykata ka deklaruar mungesën e të pandehurit, duke caktuar kryesisht avokat për mbrojtjen e tij.”

¹⁹⁰ Nr.00-2010-195 i Vendimit (138), datë 17.2.2010, Islami: “Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezultojnë se gjykimi i të pandehurit A.I. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor ka filluar me seancën gjyqësore të datës 25.05.2000 dhe deri në seancën gjyqësore të datës 11.10.2000 i gjykuari nuk është thirrur asnjëherë, por njoftimet i janë drejtuar vetëm mbrojtësit, av.Bujar Xhaxho, të caktuar nga gjykata me vendimin e deklarimit të ikjes nr.37, datë 14.04.2000. Madje në asnjërin nga seancat gjyqësore të zhvilluara në harkun kohor ndërmjet seancave të lartpërmendura, as formalisht nuk është thirrur dhe verifikuar marrja dijeni e të gjykuarit.”

¹⁹¹ Nr.00-2013-388 i Vendimit (50), datë 3.2.2013, Rabeli, Shyti: “19. Nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk janë respektuar rregullat për njoftimin e gjykimit për shkak të shkeljeve të rregullave procedurale, të parashikuara nga neni 140 i Kodit të Procedurës Penale, që kanë të bëjnë me procedurat penale për njoftimin e të pandehurit.

20. Rezultojnë se në fazën e hetimit ashtu edhe të gjykimit E.Sh. nuk i është caktuar masë shtrënguese personale duke u hetuar dhe gjykuar në gjendje të lirë. Në këto rrethana njoftimi i tij duhet të bëhet sipas rregullave procedurale për të pandehurin në gjendje të lirë sipas nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas kësaj dispozite rezultojnë se akti duhet t'i dorëzohet personalisht të pandehurit dhe nëse kjo nuk është e mundur atëherë ajo i dorëzohet personave që bashkëjetojnë me të ose në vendin e punës. Në rast se njoftimi nuk mund të realizohet në këtë mënyrë atëherë procedohet me kërkimin në vende të tjera nëpërmjet policisë gjyqësore. Në rast se edhe në këtë mënyrë nuk është bërë i mundur njoftimi, siç përcakton kjo dispozitë në paragrafin e katërt, akti depozitohet në qendrën administrative të lagjes apo të fshatit ku i pandehuri banon ose punon. Vetëm mbasi të jenë respektuar këto procedura gjykata mund të procedojë me deklarimin e mungesës të të pandehurit duke i caktuar një mbrojtës kryesisht.

Për kolegjin penal, gjithashtu, paraqet rëndësi cilësia e personit që i komunikohet thirrja, në kuptimin e afërsisë së tij me të pandehurin, kur ky i fundit nuk është e mundur të njoftohet personalisht. Vetëm komunikimi i thirrjes një personi të afërm, që banon ose bashkëjeton me të, krijon më shumë siguri se i pandehuri është vënë në dijeni të aktit të thirrjes. Ndaj, në këndvështrimin e kolegjit, njoftimi quhet i pakryer, me pasojë pavlefshmërinë absolute të aktit, kur nuk dihet kujt i është komunikuar thirrja¹⁹³, kur nuk dihet lidhja gjinore midis personit që i dorëzohet thirrja dhe të pandehurit¹⁹⁴, apo kur personi që nënshkruan për marrjen e njoftimit është kushëri i të pandehurit^{195, 196}.

Lidhur me detyrimin e njoftimit për të pandehurin gjatë gjyqimit në shkallë të parë, kolegji ka tërhequr vëmendjen që njoftimi i të pandehurit për seancën gjyqësore, që nuk zhvillohet për shkaqe të ndryshme, nuk e shkarkon gjykatën nga detyrimi për të bërë njoftimet për seancën pasardhëse. Mosrespektimi i kësaj procedure shkakton pavlefshmëri absolute: *“Pretendimin e prokurorit në seancën dëgjimore në Gjykatën e Lartë, sipas të cilit i gjykuari, në zbatim të nenit 140 të K.pr.p., ishte njoftuar njëherë më parë për seancën e planifikuar për datën 03.04.2000 dhe nuk kishte arsye që ta përsëriste në seancat e datave pasardhëse, ky Kolegj e gjen të pabazuar... Zhvillimi i seancave gjyqësore në datën pasardhëse 11.04.2000 dhe për më tepër më 28.04.2000 (kur u mor dhe vendimi për të vazhduar gjykimin në mungesë), pa zbatuar urdhërimet e ligjit për njoftimin e të gjykuarit për të marrë pjesë në to, në zbatim të nenit 128/c të K.pr.p., passjell pavlefshmërinë absolute ...”*¹⁹⁷.

Për të pandehurin e deklaruar *“i ikur”*, në fazën e hetimeve paraprake, kolegji me të drejtë vëren se është absolutisht i pavlefshëm njoftimi pranë mbrojtësit, i cili nuk është prokuruar prej të pandehurit, por prej familjarëve të tij¹⁹⁸. Në raste të tilla, nuk ka siguri se i pandehuri ka marrë dijeni lidhur me procesin që zhvillohet në ngarkim të tij.

21. Mos respektimi i këtyre procedurave për njoftimin sjell edhe pavlefshmërinë e njoftimit sipas nenit 143¹⁹¹ të Kodit të Procedurës Penale dhe për pasojë pavlefshmërinë e gjithë procesit penal...”

Shih, gjithashtu: Nr.00-2013-871 i Vendimit (119), datë 3.4.2013, Goxhaj (§ 19-20).

¹⁹² Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.06.2010, kërkues Gjykata e Lartë (Kolegjet e Bashkuara): *“Dispozitat procedurale për njoftimet vendosin një rend të caktuar për mënyrën e njoftimit të akteve për të pandehurin, prandaj duhet respektuar rendi sipas preferencës ligjore për këtë qëllim. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigorozë të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë kur janë respektuar në mënyrë rigorozë dispozitat për njoftimin.”*

¹⁹³ Nr.00-2013-871 i Vendimit (119), datë 3.4.2013, Goxhaj, *i paracituar*.

¹⁹⁴ Nr.00-2012-938 i Vendimit (197), datë 4.7.2012, Shehaj.

¹⁹⁵ Nr.00-2011-788 i Vendimit (112), 21.9.2011, Zeqo (§ 21, 24).

¹⁹⁶ Nr.00-2013-867 i Vendimit (135), 17.4.2013, Kamaj (§ 24, 26, 29).

¹⁹⁷ Nr.100 i Vendimit, datë 20.02.2008, Sula.

¹⁹⁸ Nr.00-2013-1117 i Vendimit (217), datë 10.7.2013, Lita, Çejku: *“24. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kundërshtim me dispozitat procedurale, duke e konsideruar të mirëqenë njoftimin, pavarësisht se ndaj këtij të pandehuri gjykata në fazën e hetimeve kishte deklaruar – vendim ikje (vendimi nr.586 akti, datë 27.06.2002) dhe prokura nuk ishte nënshkruar prej tij, por prej familjarëve, e merr të mirëqenë njoftimin për seancën e datës 03.09.2004. Gjykata në veprimet paraprake, kishte detyrimin që të përsëriste njoftimin, sipas N.349 të K.Pr.Penale, por ajo nuk e ka vënë në dyshim vërtetësinë e nënshkrimit të fletëthirrjes.”*

Kolegji penal ka çelur një praktikë domethënëse, në këndvështrimin e sigurimit të kontradiktoritetit të procesit, në rastet kur, me kërkesë të të dëmtuarit, shqyrtohet në gjykatë ligjshmëria e vendimit të pushimit të çështjes nga prokurori. Në raste të tilla, personi ndaj të cilit janë zhvilluar hetime, duhet të thirret si palë në proces, për të parashtruar pretendimet e tij¹⁹⁹.

Sikurse përmendëm më sipër, praktika gjyqësore ofron diskutime interesante lidhur me mosrespektimin e dispozitave për thirrjen e të pandehurit gjatë gjykimit në gjykatën e apelit. Duken të pashpjegueshme gabimet e zakonshme gjatë gjykimit në shkallë të dytë, në kushtet kur jurisprudenca e kolegjit penal na duket e qartë dhe e mirëorientuar. Përveç sa thamë, le të ndalemi në vijim në disa nga orientimet bazë të praktikës gjyqësore lidhur me temën që po trajtojmë:

- i. Gjykata e apelit duhet të krijojë siguri nëse i pandehuri ose subjektet që parashikon ligji (*familjarët, të afërmit, etj.*) kanë marrë efektivisht njoftim për aktin e thirrjes në gjykim dhe këta subjekte duhet të identifikohen me saktësi^{200,201}.
- ii. Njoftimi i mbrojtësit të të pandehurit *in absentia* nuk mund të zëvendësojë detyrimin për thirrjen e të pandehurit^{202,203}.

¹⁹⁹ Nr.00-2011-465 i Vendimit (78), datë 25.5.2011, Sulaj: “Ky Kolegj vlerëson se mos njoftimi i të pandehurit, prokurorit, apo të dëmtuarit përbën shkelje procedurale dhe pavlefshmëri në kuptim të nenit 128/1-c. Personi për të cilin është vendosur pushimi i akuzës jo vetëm që duhet të njoftohet për ankimin kundër këtij vendimi dhe gjykimin e çështjes, por duhet t’i krijohen mundësi efektive për të marrë pjesë, për t’u përfaqësuar me avokat, apo për t’u ankuar kundër vendimeve.”

²⁰⁰ Nr.76 i Vendimit, datë 11.02.2004, Ndrejoni: “Në dosjen gjyqësore është administruar një fletëthirrje, ..., për gjykimin që do të zhvillohej në datën 20.11.2000. Në fund të fletëthirrjes është shënuar: “Ndodhet në Arabinë Saudite”, por **pa u konfirmuar se kush e ka marrë në dorëzim këtë njoftim, pasi në të nuk ka firmosur as marrësi dhe as ftuesi.**” (*theksimi ynë*)

²⁰¹ Nr.686 i Vendimit, datë 31.10.2007, Koçi: “Duke qene se, **si njoftimi i të gjykuarit ... ashtu dhe njoftimi i mbrojtësit të tij ishin të dyshimtë, për shkak të nënshkrimeve në të të personave që nuk identifikohen se ç’lidhje kanë me vetë ata**, si deklarimi i mungesës ashtu dhe zëvendësimi i avokatit të zgjedhur me një avokat të caktuar kryesisht (i cili për më tepër nuk kërkon as dhe një afat minimal për t’u njohur me materialet e çështjes), tregon qartë se të gjykuarit nuk i është krijuar mundësia për një mbrojtje sa më të efektshme nga kjo gjykatë. Ashtu siç parashikon dhe neni 6/b i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, gjykata ka detyrim ligjor për t’ia krijuar këtë mundësi të gjykuarit në mungesë, gjë e cila në rastin konkret nuk është bërë nga gjykata e apelit, duke vepruar kështu dhe në kundërshtim me nenet 49 e 51 të K.pr.penale” (*theksimi ynë*).

²⁰² Nr.48 i Vendimit, datë 16.01.2008, Xhemaj, etj.: “... gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Vlorë, janë lejuar shkelje të cilat kanë sjellë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të kësaj gjykate, pasi nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me thirrjen e të pandehurit ndërkohë që kjo ka qenë e detyrueshme, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e nenit 426/1 dhe 140 të K.Pr.Penale.

I pandehuri ... nuk është njoftuar për zhvillimin e gjykimit në gjykatën e apelit, e cila është mjaftuar vetëm me njoftimin e mbrojtësit të caktuar prej tij...” (*theksimi ynë*).

²⁰³ Nr.103 i Vendimit, datë 27.02.2008, Zuna, etj.: “Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është marrë në kundërshtim me kërkesat procedurale për njoftimin e të pandehurit dhe thirrjen në gjyq e, për pasojë duhet të priset, pasi ndodhemi para veprimeve që i bëjnë aktet absolutisht të pavlefshme. ... gjykata nuk mund të pranojë qoftë edhe me vendim që njoftimi i të pandehurit të bëhet nga mbrojtësi, siç është vepruar në rastin në shqyrtim. Neni 426 i K.Pr.Penale përcakton qartë që “kryetari i kolegjit të gjykatës së apelit urdhëron thirrjen e të pandehurit” dhe në asnjë rast në K.Pr.Penale nuk parashikohet që njoftimi i të pandehurit të bëhet nga mbrojtësi” (*theksimi ynë*).

iii. Edhe në rastet kur i pandehuri është deklaruar në mungesë, thirrja tij për t'u paraqitur në gjykimin në apel është e detyrueshme. Kolegji penal pati rrezuar arsyetimin, krejt të pambështetur, të gjykatës së apelit për krime të rënda se “...ndjekja nga gjykata e apelit e hapave procedurale të parashikuara nga neni 140 i K.Pr.Penale dhe arritja në përfundimin se i pandehuri (i deklaruar i ikur) nuk gjendet, siç ndodh rëndom, është një shpërdorim i kohës procesore sepse përsëriten të njëjtat procedura që janë në fuqi për zbatimin e urdhërit të arrestit, pra në kundërshtim me ekonominë gjyqësore”, duke arsyetuar se gjykatave ligji nuk u jep të drejtën për të gjykuar lidhur me oportunitetin e zbatimit të normave procedurale. Ato janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë subjektet e procedimit penal, sidomos kur janë në lojë interesa thelbësore, sikurse është e drejta e mbrojtjes në procesin penal²⁰⁴.

iv. Në asnjë rast procedura e parashikuar nga ligji për njoftimin e të pandehurit të lirë nuk mund të zëvendësohet nga njoftimi me shpallje²⁰⁵.

v. Përbën mohim të së drejtës së mbrojtjes gjykimi i të pandehurit, në mungesë, i panjoftuar ritualisht, me një mbrojtës të caktuar kryesisht, në vend të mbrojtësit të zgjedhur prej tij²⁰⁶.

Rregullat e njoftimit të të pandehurit për procesin që zhvillohet kundër tij, në gjykatën e apelit, nuk ka kuptim të zbatohen kur i pandehuri ka pajisur me prokurë të posaçme mbrojtësin e zgjedhur prej tij; ky veprim nënkupton se ai ka dijeni për procesin që zhvillohet ndaj tij dhe shpreh vullnetin që të përfaqësohet me anën e mbrojtësit, duke hequr dorë nga mbrojtja vetjake. Gjithashtu, rregullat në fjalë janë vepruese në fazën e gjykimit, ato vlejnë për të pandehurin, ndaj nuk mund të shtrihen edhe për fazën përmbyllëse të vënies në ekzekutim të vendimit të formës së prerë, pra, edhe për të dënuarin. Përmendim se prania e personit të dënuar në procedurat e ekzekutimit të vendimit, është thjesht fakultative: ai dëgjohej nga gjykata, drejtpërsëdrejti ose me letërporosi, vetëm kur e kërkon vetë²⁰⁷. Në këtë aspekt, jurisprudenca e krijuar nga Gjykata e

²⁰⁴ Nr.61 i Vendimit, datë 06.02.2008, Bajramaj.

²⁰⁵ Nr.00-2010-1208 i Vendimit (843), 22.9.2010, Abdi: “Gjykata e apelit ka filluar gjykimin e çështjes dhe në seancën e datës 26.02.2008 nga trupi gjykues, pasi ka konstatuar se i pandehuri nuk ka marrë dijeni, sepse në fletë-thirrje ishte vënë shënimi “larguar jashtë shtetit”, është vendosur të njoftohet me shpallje i gjykuari.

Në seancën pasardhëse ka vazhduar gjykimi në mungesë të të gjykuarit, duke e konsideruar të njoftuar me shpallje.

... Në lidhje me gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit, vendimi i marrë prej kësaj gjykate është i pavlefshëm, pasi nuk janë respektuar rregullat procedurale në lidhje me njoftimin e të pandehurit të lirë.”

²⁰⁶ Nr.00-2012-1463 i Vendimit (255), datë 10.10.2012, Balliu, Xhezo: “12. Nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë nuk janë zbatuar drejtë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që kanë lidhje me njoftimin e të pandehurit.

13. Kjo shkelje procedurale reflektohet në vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, ku nuk është argumentuar në asnjë moment mungesa e të gjykuarit, njoftimi i të gjykuarit dhe caktimi i një mbrojtësi kryesisht nga ana e kësaj gjykate.

14. Nga aktet në dosje rezulton se, i gjykuari nuk ka marrë dijeni për datën dhe orën e seancës. Gjykimi në gjykatën e apelit, është bërë në mungesë të të gjykuarit dhe jo me avokatin e caktuar nga i gjykuari, por me avokat të caktuar kryesisht, duke i mohuar kështu të drejtën e mbrojtjes.”

²⁰⁷ Shih nenin 471.4 të KPP.

Lartë na duket aspak bindëse, ndërkohë që mendimi i gjyqtarit në pakicë gjykojmë se është më i saktë dhe më i argumentuar²⁰⁸.

Një vëmendje të posaçme meriton rasti i mosdeklarimit të mungesës së të pandehurit, gjatë gjykimit në gjykatën e apelit. Në raste të kësaj natyre, vetëm për mosrespektimin e këtij formaliteti, kolegji konkludon se ndodhemi para një pavlefshmërie me natyrë absolute, përfundim që na duket i gabuar²⁰⁹. Në këtë rast, na duket se kolegji penal nuk ka mbajtur parasysh faktin se deklarimi i mungesës është thjesht një formalitet që i hap rrugën krijimit të një raporti të ri procedural - vazhdimit të gjykimit pa praninë e të pandehurit. Siç kemi vërejtur (*shih § 2.1*), pavlefshmëria e akteve në procedurën penale i bindet parimit të taksativitetit; nuk mund të ngrihet pavlefshmëri në rastet kur ligjvënësi nuk e sanksionon shprehimisht shkeljen me një pasojë të tillë. Në rastin që po studjojmë, procedura ka qenë e rregullt, mbrojtësi i legjitimuar dhe të pandehurit nuk i është cënuar ndonjë e drejtë, përfshi edhe kontradiktoritetin e procesit. Mosdeklarimi formal i mungesës së të pandehurit është një parregullsi procedurale, e cila nuk shkakton pavlefshmëri, aq më pak pavlefshmëri absolute. Pra, në këtë rast, gjykojmë se kolegji ka gabuar, duke e zgjeruar tej vullnetit të ligjvënësit fushën e veprimit të sanksionit të pavlefshmërisë absolute²¹⁰.

²⁰⁸ Nr.00-2012-1404 i Vendimit (242), datë 26.9.2012, Reçi, “Nga aktet në dosje rezultojnë se kërkuesi nuk ka marrë dijeni për datën dhe orën e seancës, gjë që pranohet edhe nga vetë gjykata e apelit, e cila, në kundërshtim me nenin 142/1 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka njoftuar të pandehurin me letër rekomande me njoftim marrje, megjithëse në prokurën e hartuar prej tij është përcaktuar adresa e tij e saktë në shtetin grek.”

Mendimi i pakicës: “Siç rezultojnë nga aktet kërkuesi G.R., më datën 12 korrik 2010, përpara noterit në Athinë i ka lëshuar prokurë të posaçme avokatit Xhelal Bajraktarit duke i dhënë atij tagra të plota dhe në mënyrë të precizuar të përfaqësimit në proces për këtë objekt gjykimi (faqe 46 i dosjes gjyqësore), gjë të cilën ai e ka realizuar me korrektësi. Duhet theksuar se as në rekursin e paraqitur nga kërkuesi dhe as gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë ata nuk kanë paraqitur asnjë pretendim për mos njoftimin e tij në gjykimin e çështjes në apel, por kanë parashtruar vetëm pretendime në lidhje me themelin e çështjes.

Gjithashtu duhet theksuar se në rastin në shqyrtim i dënuari G.R. nuk është në pozitë të gjykimit si i pandehur ku ligji procedural kërkon të zbatohen në mënyrë specifike njoftimet përkatëse. Ai është kërkues në fazën e ekzekutimit të vendimit, pra në një proces administrativ penal dhe në prokurën e dhënë, edhe në mungesën e tij i realizon të gjitha interesat e ligjshme.”

²⁰⁹ Nr.00-2011-208 i Vendimit (37), 16.2.2011, Sukaj: “..., rezultojnë se në Gjykatën e Apelit Shkodër, shqyrtimi gjyqësor i çështjes u çel në seancën gjyqësore të datës 28.10.2003. Në këtë seancë, trupi gjyqësor, në zbatim të detyrimit të njohur nga dispozita e nenit 348 të K.Pr.Penale ka verifikuar praninë e subjekteve të gjykimit.

Në kundërshtim me dispozitën e nenit 351 të K.Pr.Penale, pasi ka konstatuar mungesën e të gjykuarve dhe përfaqësimit të tyre nga një avokat i caktuar prej tyre me prokurë, rezultojnë se Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka disponuar me vendim të posaçëm deklarimin e mungesës së të gjykuarve, duke lejuar kështu një mangësi të tillë që në vështrim të parashikimit të nenit 128 të K.Pr.Penale, të përmendur më lart, të sjellë si pasojë pavlefshmërinë e të gjithave akteve të këtij gjykimi, përfshirë dhe vendimin përfundimtar.”

²¹⁰ Vërejmë se të njëjtin qëndrim mban edhe jurisprudenca e Kasacionit në Itali: “Mosdeklarimi i mungesës nuk përbën shkak pavlefshmërie të vendimit, përderisa nuk parashikohet nga ligji dhe nuk mund të përfshihet në sferën e pavlefshmërive të natyrës së përgjithshme, ngaqë nuk shkakton asnjë pasojë në dëm të pjesëmarrjes dhe të asistencës së të pandehurit... nga mosdeklarimi i mungesës së të pandehurit, kur rezultojnë të përmbushura kushtet

Duke përmbledhur sa parashtuam më sipër, mund të nxjerrim përfundimin se detyrimi i thirrjes së të pandehurit në gjykim, mosrespektimi i të cilit sanksionohet me pavlefshmëri absolute, synon të kënaqë dy parime themelore të procedurës: sigurimin e kontradiktoritetit në proces dhe garantimit e të drejtës së të pandehurit për t'u vetëmbrojtur nga akuzat që rëndojnë mbi të. Megjithëse jurisprudenca e Gjykatës së Lartë lidhur me këtë temë, përgjithësisht, ka qenë e saktë dhe koherente, ndonëse ka edhe një vendim unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, shumë vendime të gjykatave vazhdojnë të prishen për shkelje që lidhen me thirrjen dhe njoftimin efektiv të të pandehurit për t'u paraqitur në proces. Mendojmë se, duke mbajtur parasysh edhe qartësinë e normës, kjo dukuri duhet të lidhet me moskuptimin e parimeve që synojnë të mbrojnë dispozitat për thirrjen e të pandehurit në procesin që zhvillohet kundër tij dhe rëndësinë e tyre në procesin penal modern.

b) Më sipër parashtuam se ligjvënësi ka sanksionuar me pavlefshmëri absolute edhe rastet kur nuk respektohen dispozitat që synojnë të sigurojnë praninë e mbrojtësit, në rastet kur ajo është e detyrueshme. Pjesëmarrja e të pandehurit në proces është e pandashme nga e drejta e mbrojtjes teknike, e cila merret përsipër dhe realizohet nga subjekte që kanë njohuritë e duhura profesionale në të drejtën penale. Ligji procedural penal sanksionon me pavlefshmëri absolute jo çdo rast të shkeljes së dispozitave që sigurojnë praninë e mbrojtësit, por vetëm rastet kur prania e tij “...është e detyrueshme” (neni 128.1, shkronja “c”). Kodi ynë të drejtën e mbrojtjes, si rregull, e lidh me vullnetin e të pandehurit. Pra, i pandehuri që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose që, për shkaqe të ndryshme ka ngelur pa shërbimet e tij, ndihmohet teknikisht nga një mbrojtës i caktuar kryesisht “... në qoftë se e kërkon atë”²¹¹.

Kodi i procedurës penale parashikon vetëm dy raste kur prania e mbrojtësit është e detyrueshme, edhe në qoftë se i pandehuri nuk e kërkon atë: *1- rasti i të pandehurit të mitur ose me të meta fizike a psikike që nuk e lejojnë të realizojë të drejtën e mbrojtjes* (neni 49.2²¹²) dhe *2- rasti i marrjes në pyetje të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime nga policia gjyqësore* (neni 296.1²¹³). Rasti i fundit nuk është kuptuar në këtë mënyrë dhe nuk ka gjetur mbështetje në praktikën gjyqësore, ndonëse logjika garantuese e normës është e qartë: në kontaktin e parë me policinë gjyqësore, jashtë vëmendjes dhe kontrollit të prokurorit, marrja në pyetje e personit të hetuar mund të lejohet vetëm në praninë e detyrueshme të mbrojtësit, edhe kur ai nuk e kërkon atë²¹⁴. Mbrojtja e detyrueshme, në rastet kur procedohet me marrjen në pyetje të personit ndaj të

për zhvillimin e procesit në mungesë të tij, nuk çënohet kontradiktoriteti i procesit.” (Cass. Sez.VI, 6.2.1998, n.1444, etj. – përkthimi ynë); tek Di Geronimo Paolo, *vep. e cit.*, faqe 130.

²¹¹ Neni 49. Mbrojtësi i caktuar - 1. I pandehuri që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose që ka mbetur pa të, ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar nga organi që procedon, në qoftë se e kërkon atë.

²¹² Neni 49. Mbrojtësi i caktuar - ... 2. Kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike a psikike që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme.

²¹³ Neni 296. Të dhëna mbi personin ndaj të cilit zhvillohen hetimet - 1. Oficerët e policisë gjyqësore marrin të dhëna nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet në praninë e detyrueshme të mbrojtësit të tij. Kur mbrojtësi nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, policia gjyqësore kërkon nga prokurori që të caktojë një mbrojtës tjetër.

²¹⁴ Në praktikën gjyqësore janë të shpeshta rastet kur personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime, të pyetur nga policia pa praninë e mbrojtësit, vetëakuzohen dhe japin deklarime fajësuese ndaj personave të tjerë, të cilat i mohojnë sa vihen në kontakt me prokurorin ose me gjykatën, duke mëtuar se pyetja e tyre është bërë nën presion dhe pa u bërë të ditura të drejtat që gëzojnë.

cilit zhvillohen hetime, mbështetur në nenin 296.1 të KPP, tashmë është konfirmuar me vendimin nr.3, datë 19.5.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë²¹⁵.

Prania e mbrojtësit është e detyrueshme, edhe në mungesë të vullnetit të të pandehurit ose personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, në seancën e vleftësimit të arrestimit ose ndalimit (*neni 259.1*²¹⁶). Në këtë rast, në vend të termit “*e detyrueshme*” ligjvënësi përdor përcaktorin “*e domosdoshme*”. Në logjikën e normës asgjë nuk ndryshon, në këtë seancë mbrojtja teknike e të pandehurit është e detyrueshme, pasi është në lojë e drejta e patjetërsueshme e lirisë.

Kodi parashikon në mënyrë taksative edhe dy raste të tjera të pranisë së detyrueshme të mbrojtësit: në procedurën e marrjes së provës gjatë sigurimit të saj paraprak (*neni 321.1*²¹⁷) dhe gjatë shqyrtimit të çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale (*neni 471.4*²¹⁸).

Në rastet e tjera, kur i pandehuri ka zgjedhur një mbrojtës ose, kur i mbetur pa të, ndihmohet nga një mbrojtës *ex officio*, prania e tij duhet të sigurohet gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes (*nenet 333 e vijues*), gjatë gjyqimit në apel (*nenet 425 e vijues*) dhe në Gjykatën e Lartë (*nenet 436 e vijues*²¹⁹), në procedurat e ekstradimit (*neni 492.2*²²⁰) dhe, si dhe në procedurën e zbatimit të masave shtrënguese gjatë ekzekutimit të vendimeve penale të huaja (*neni 515*²²¹).

Kolegji penal i Gjykatës së Lartë ka krijuar një praktikë gjyqësore të qartë në drejtim të sigurimit të pranisë së mbrojtësit në proces, në të gjitha rastet kur ligji e parashikon atë si të detyrueshme. Vërejmë se edhe Gjykata Kushtetuese ka krijuar një jurisprudencë të qëndrueshme në rastet kur Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, në vështirim të nenit 415.2 të KPP. Me të drejtë, çmohet se përpara se të vendosë mospranimin e rekursit, kolegji duhet të sigurohet për garantimin e së drejtës së mbrojtjes duke verifikuar dy elemente: *së pari*, përmbushjen e detyrimit të sekretarisë gjyqësore për ta vënë në dijeni të pandehurin lidhur me faktin se rekursi duhet të nënshkruhet nga

²¹⁵ “Ne veshtrim të interpretimit si me siper të nenit 296 të K.Pr.Penale, duke qene se ne çeshtjen objekt gjykimi, procesverbali i dates 01.06.2000 i deklarimeve të personit nën hetim, të gjykuarit M.N., është një veprim i kryer me nismën e oficerit të policisë gjyqësore, në zyrën e këtij të fundit dhe rreth dy muaj pas kryerjes së veprës penale, Kolegjet e Bashkuara vijne në perfundimin se jemi përpara rastit të parashikuar nga pika 1 e nenit 296. Por, njëkohësisht, Kolegjet çmojnë se marrja e të dhenave është kryer në shkelje të kushtit thelbësor të kesaj dispozite, pra në mungesë të pranisë së detyrueshme të mbrojtësit. Keto të dhena janë të paperdorshme për efekte provuesmerie në gjykim në kombinim me nenin 370 të K.Pr.Penale. Prandaj, vendimi i gjykates se apelit në pjesen që ka vendosur perdorimin si prove të ketyre të dhenave është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit.” (citimi sipas vendimit të Kolegjeve të Bashkuara).

²¹⁶ Neni 259. Seanca e vleftësimit - 1. Seanca e vleftësimit zhvillohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe të mbrojtësit. Kur mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar kryesisht nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, gjykata cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër (theksimi ynë).

²¹⁷ Neni 321. Marrja e provës. - 1. Seanca për marrjen e provës zhvillohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe të mbrojtësit të të pandehurit. Ka të drejtë të marrë pjesë edhe përfaqësuesi i të dëmtuarit (theksimi ynë).

²¹⁸ Neni 471. Mënyra e procedimit nga gjykata. - ... 4. Seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësve. I interesuari, kur e kërkon, dëgjohet personalisht ose me letërporosi (theksimi ynë).

²¹⁹ Në Gjykatën e Lartë i pandehuri dhe palët private nuk përfaqësohen personalisht, por me anën e mbrojtësve (neni 437.3 i KPP). Shih edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 04.03.2008, cituar në vijim (pika c).

²²⁰ Procedurat e zbatimit të masave të përkohshme shtrënguese për këtë qëllim, kërkojnë praninë e detyrueshme të mbrojtësit, pasi dispozita referon në Titullin V të Kodit (*neni 493.2*).

²²¹ Nuk është e kuptueshme logjika e ligjvënësit për të mos e normuar shprehimisht si të detyrueshme praninë e mbrojtësit në këto procedura (*shih nenin 515.2*).

mbrojtësi, në mënyrë që ai të ketë mundësi që ta plotësojë atë²²² dhe, *së dyti*, nëse i pandehuri mbetet pa mbrojtës, përmbushjen e detyrimit nga kryetari i kolegjit për t'i caktuar një mbrojtës kryesisht²²³. Në thelb, Gjykata Kushtetuese orienton një interpretim elastik të nenit 435.2²²⁴ të KPP.

Përveç rasteve të sipërpërmendura, që kanë kërkuar ndërhyrjen korrigjuese të Gjykatës Kushtetuese, nuk kemi vënë re kundërshti në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë lidhur me garantimin e pranisë së mbrojtësit në proces; në vijim, çmojmë të ndalemi vetëm në disa vendime të kolegjit, të cilat pasqyrojnë veçori interesante lidhur me zbatimin e parimit.

Kolegji penal i ka qëndruar parimit se mbrojtësi i zgjedhur nga i pandehuri nuk mund të zëvendësohet me mbrojtës të caktuar kryesisht nga organi që procedon, nëqoftëse nuk provohet se atij i është njoftuar thirrja, por nuk është paraqitur. Në rastin objekt shqyrtimi, ndonëse i pandehuri ka shprehur vullnetin e tij për zgjedhjen e mbrojtësit, gjykata e ka zëvendësuar këtë të fundit me një mbrojtës të caktuar kryesisht, edhe pse për atë seancë nuk dokumentohej njoftimi i tij. Për këtë arsye, kolegji penal i prishi vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor dhe të gjykatës së apelit Vlorë, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim, me trup tjetër gjykues²²⁵.

Interesant është edhe rasti kur mbrojtësi i zgjedhur nga i pandehuri, për arsye të ndryshme, vendos që të heqë dorë nga mbrojtja. Kolegji penal, në interpretim të nenit 55.1²²⁶ të Kodit të Procedurës Penale, i mëshon detyrimit të mbrojtësit që për heqjen dorë të njoftojë jo vetëm organin që procedon, por edhe të pandehurin. Sigurisht, një interpretim i saktë që mbështetet në arsyen se, pa u njoftuar për këtë fakt, i pandehuri do të ishte në pamundësi të ushtrimit të së drejtës së tij për të prokuruar një mbrojtës tjetër. Përkundër kësaj logjike, gjykata e apelit pa u siguruar për njohjen e të gjykuarit me dorëheqjen e mbrojtësit, procedoi me caktimin e një mbrojtësi kryesisht, duke e bërë vendimin e saj të cënueshëm për shkak të pavlefshmërisë absolute që lidhet me praninë e detyrueshme të mbrojtësit të zgjedhur nga i pandehuri²²⁷.

²²² Shih vendimin nr.5, datë 15.9.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

²²³ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr.38, datë 30.12.2010, Perati (§ 3); nr.2, datë 25.1.2012, Bukaçi (§12, 13, 14); nr.22, datë 23.4.2012, Balliu (§ 14-18).

²²⁴ Neni 435 – Paraqitja e rekursit ... 2. Akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi nga mbrojtësit. Kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të zgjedhur, kryetari i kolegjit cakton një mbrojtës kryesisht dhe në këtë rast lajmërimet i bëhen edhe të pandehurit.

²²⁵ Nr. 629 i Vendimit, datë 08.11.2006, Demiri: “Gjykata cakton avokatin kryesisht në bazë të nenit 49/1 të K.Pr.P. kur i pandehuri nuk ka zgjedhur mbrojtës, ose ka mbetur pa të. Në rastin konkret provohet se i pandehuri B.D. ka caktuar si mbrojtës të tij av.Luan Xhuveli duke u shprehur se “nuk njoh avokat tjetër”. Lidhur me njoftimin e këtij avokati rezultoi se ai është njoftuar e ka qenë i pranishëm vetëm në seancën e datës 01.03.2004 dhe meqenëse nuk është paraqitur në seancën e zhvilluar më datë 16.03.2004, për të cilën ka patur dijeni, gjykata në bazë të nenit 49/5 të K.Pr.P. ka caktuar avokat kryesisht. Për në seancat e mëpasme thirrje të dërguar në adresë të av. Luan Xhuveli nuk ka të administruar në dosje dhe gjykata ka vazhduar gjykimin me avokatët e caktuar kryesisht kur gjykimet janë zhvilluar pa praninë e të pandehurit, për të cilin gjykata ka marrë vendim për deklarimin e mungesës së tij. Ndërsa në ato seanca kur i pandehuri ka qenë i pranishëm ka kërkuar që të mbrohet me avokatin e zgjedhur prej tij dhe nuk ka pranuar që të mbrohet me avokatët e caktuar nga gjykata. Në rastin konkret mbrojtësi i këtij të pandehuri, sipas deklarimeve të këtij të fundit, është av.Luan Xhuveli, kurse gjykata në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 49 të K.Pr.P. ka caktuar kryesisht av.Delo Meçani.”

²²⁶ Neni 55. Mospranimi, dorëheqja ose revokimi i mbrojtësit - 1. Mbrojtësi që nuk pranon detyrën që i është besuar ose që heq dorë prej saj njofton menjëherë organin procedues dhe atë që e ka caktuar.

²²⁷ Nr. 612 i Vendimit, datë 03.10.2007, Hyseni: "... seanca e fundit (01.02.2006) u zhvillua jo vetëm pa pjesëmarrjen e të gjykuarit A. por edhe pa pjesëmarrjen e mbrojtësit të zgjedhur prej tij, por të një mbrojtësi tjetër, që u caktua kryesisht, duke mos u respektuar kërkesat e nenit 55 të K.Pr.Penale.

Ngjashmëri me rastin pararendës paraqet situata kur i pandehuri shpreh vullnetin që të mbrohet nga një mbrojtës i caktuar dhe, ky i fundit, kërkon kohë që të njihet me aktet dhe të bisedojë paraprakisht me klientin e tij. Kolegji ka vërejtur cënim të së drejtës së mbrojtjes, me pasojë pavlefshmërinë absolute të aktit dhe proces të parregullt ligjor sepse gjykata, pa i dhënë mbrojtësit të zgjedhur kohën e nevojshme, procedoi me caktimin e një mbrojtësi kryesisht, duke vazhduar gjykimin me pjesëmarrjen e tij²²⁸.

Interes të veçantë paraqit edhe rasti kur i pandehuri ka kërkuar të mbrohet me avokat të caktuar kryesisht dhe gjykata nuk ia siguroi mbrojtjen, me argumentin se nuk mund të provohej pamundësia ekonomike e të gjykuarit për të mbuluar shpenzimet e mbrojtjes. Me të drejtë, kolegji penal i dha përparësi të drejtës së mbrojtjes, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit²²⁹. Por, në rast se i pandehuri kërkon kohë për të zgjedhur mbrojtësin, merr dijeni për datën

U arrit në përfundimin e mësipërm, pasi nga aktet rezultoi se, ndërsa nga njëra anë, në procesverbalin e mbajtur gjatë zhvillimit të kësaj seance është shënuar që mbrojtësi i zgjedhur nuk është paraqitur pasi "... rezultoi se ka hequr dorë nga mbrojtja pasi ka patur presion nga pala e viktimës", nga ana tjetër nuk është pasqyruar nëse ai (mbrojtësi i zgjedhur), në zbatim të pikës 1 të nenit 55 të K.Pr.Penale, kishte njoftuar veç organit procedues edhe të gjykuarin që e kishte emëruar me prokurë atë.

Vetëm mbas plotësimit edhe të kësaj kërkesë të ligjit dhe nëse i gjykuari apo familjarët e tij nuk do të kishin caktuar (përkatësisht) apo zgjedhur një mbrojtës tjetër, gjykatës i lindte e drejta e caktimit të një mbrojtësi kryesisht për realizimin e mbrojtjes edhe në këtë shkallë gjykimi" (theksimi sipas vendimit).

²²⁸ Nr.00-2013-864 i Vendimit (124), 10.4.2013, Toshi: "26. Në seancën e datës 20.06.2012 i gjykuari nuk është paraqitur dhe ka shprehur dëshirën të mbrohej nga av.Sami Velçani. Ky avokat mbrojtës është paraqitur në seancë dhe ka deklaruar se: "Unë nuk jam avokat i të pandehurit por do të kontaktoj me të dhe kërkoj shtyrjen e seancës për t'u njohur me materialet e dosjes". Gjykata në këtë seancë ka marrë vendim për t'i caktuar një mbrojtës kryesisht dhe ka caktuar av. Nasibi Gaxholli, i cili është njoftuar për seancën e datës 04.07.2012.

27. Për seancën e datës 04.07.2012 i gjykuari, në njoftimin në burg, ka deklaruar se kërkon të përfaqësohet nga av.Sami Velçani dhe ka konfirmuar dijeninë e tij si dhe dëshirën për të mos marrë pjesë vetë në seancë gjyqësore dhe nuk është paraqitur personalisht. Gjykata e apelit ka vazhduar gjykimin në mungesë me avokat kryesisht të caktuar atij dhe po atë ditë ka dhënë dhe vendimin. ...

31. ... Nga sa më sipër, gjykata ka vepruar ndesh me dispozitat e sipërcituara duke i caktuar një avokat kryesisht këtij të gjykuari, kur avokati Sami Velçani deklaroi një seancë më parë se do të kontaktonte me të gjykuarin dhe donte të njihej me aktet e dosjes.

32. Gjykata e apelit në këtë rast nuk kishte refuzim nga ky mbrojtës (av.Sami Velçani) për të përfaqësuar të gjykuarin D.T., nuk duhej të kryente zëvendësimin e tij e t'i caktonte avokat kryesisht sikundër ka vepruar. Gjykata, meqenëse seanca ishte zhvilluar pa praninë e të gjykuarit, duhej të njoftonte të gjykuarin për qëndrimin e mbrojtësit të kërkuar prej tij në seancë e t'i linte afatin ligjor për zëvendësimin e tij (nëse mbrojtësi nuk do binte dakord për marrjen përsipër të mbrojtjes).

²²⁹ Nr.00-2013-856 i Vendimit (129), 17.4.13, Piperi: "15. Gjatë gjykimit në apel, në seancën e datës 01.06.2010 kjo mbrojtëse është paraqitur dhe ka deklaruar se heq dorë nga mbrojtja e mëtejshme, pasi i gjykuari A.P. nuk e ka paguar. I gjykuari dhe bashkëshortja e tij, e pranishme në seancë, kanë deklaruar se nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të paguar një avokat mbrojtës. Seanca është shtyrë për të paraqitur i gjykuari prova për gjendjen e tij ekonomike.

e gjykimit kur duhet të paraqitet së bashku me mbrojtësin e zgjedhur, por nuk paraqitet, natyrisht, gjykata ka të drejtë të vazhdojë gjykimin me një mbrojtës të caktuar kryesisht²³⁰. Mosparaqitja e të pandehurit, në raste të tilla, barazohet me heqjen dorë nga e drejta për të zgjedhur mbrojtës dhe për të marrë pjesë në gjykim.

Sigurimi i mbrojtjes së të pandehurit nuk nënkupton thjesht praninë e tij fizike në seancë; përndryshe, mbrojtja teknike do të ishte e paefektshme. Kolegji penal ka theksuar jo vetëm rëndësinë e sigurimit të pranisë së mbrojtësit, por edhe marrjen përsipër të mbrojtjes teknike efektive²³¹.

c) Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

16. Në seancën e datës 30.06.2010 gjykata e apelit ka administruar një çertifikatë të përbërjes familjare si dhe një vërtetim nga Bashkia Pogradec se, i gjykuari nuk trajtohet me ndihmë ekonomike. Gjykata e apelit ka konkluduar se, me këto prova nuk mund të provohet pamundësia ekonomike e të gjykuarit për të mos paguar një avokat dhe ka vazhduar gjykimin pa avokat mbrojtës.

17. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vëren se gjykata e apelit nuk ka respektuar një nga parimet bazë të Kodit të Procedurës Penale duke i mohuar një të drejtë ligjore personit të arrestuar i cili po gjykohet për një vepër të rëndë penale, e cila kërkon një mbrojtje të specializuar dhe ai (i gjykuari) nuk ka mjete të mjaftueshme për të siguruar vetë mbrojtjen e tij.”

²³⁰ Nr.00-2014-811 i Vendimit (86), datë 19.3.2014, Seferi: “Nga aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore rezultojnë se i gjykuari V.S. është paraqitur në seancën e parë gjyqësore, atë të datës 29.01.2013. Në këtë seancë ai ka kërkuar që të mbrohet me avokat dhe për këtë shkak ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore për një datë tjetër. Kjo kërkesë është pranuar dhe seanca është shtyrë për me datë 06.02.2013. Në këtë seancë ai nuk është paraqitur, megjithë dijeninë e rregullt dhe për këtë shkak gjykata ka deklaruar mungesën e tij, duke i caktuar një avokat kryesisht.

Kolegji Penal çmon se kjo mungesë është deklaruar konform nenit 351 të K.Pr.Penale sipas të cilit: “1. Kur i pandehuri i lirë ose i paraburgosur nuk paraqitet në seancë ndonëse është njoftuar dhe nuk ka patur shkaqe të ligjshme për t’u paraqitur, gjykata, pasi dëgjon palët, deklaron mungesën e tij. Në këtë rast ai përfaqësohet nga mbrojtësi”.

Ndryshe nga sa arsyeton Gjykata e Apelit Tiranë, rezultojnë se dijenia e të gjykuarit ka qenë e rregullt. Ai ka marrë dijeni personalisht për datën e seancës gjyqësore dhe nuk është paraqitur në seancat në vijim, duke treguar një mosinteresim për procesin penal në ngarkim të tij.”

²³¹ Nr.00-2010-1027 i Vendimit (431), datë 7.5.2010, Fejzulla, etj.: “Për më tepër ky mbrojtës ka pranuar të vazhdojë gjykimin pa u njohur realisht me dosjen gjyqësore e cila përbëhet nga një material voluminoz prej disa mijëra faqesh, e për rrjedhojë ka realizuar një mbrojtje formale dhe jo efektive të këtij të gjykuari (nga procesverbali gjyqësor nuk rezultojnë as t’i jetë komunikuar e drejta për t’u njohur me aktet dhe provat dhe as ky mbrojtës nuk ka kërkuar ushtrimin e një të drejte të tillë, sipas nenit 57 të K.Pr.Penale). Rrjedhimisht në asnjë seancë gjyqësore, ndryshe nga kolegjet e tij, ky mbrojtës nuk ka paraqitur asnjë kërkesë paraprake, pretendim apo prapësim, pyetje për ekspertë e dëshmitarë apo kundërshtim të akteve gjyqësore, duke u mjaftuar në mohimin e akuzës për të cilën akuzohej “klienti” i tij dhe në 5 faqe material të shkruar në konkluzionet përfundimtare. Një mbrojtje të tillë jo efektive e ka konsideruar inekzistente dhe në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të individit, në disa raste, edhe Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj dhe Gjykata Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Strasburg.”

Gjykata Kushtetuese në procesin e kontrollit kushtetues të vendimeve të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, vitet e fundit, ka krijuar një jurisprudencë të qartë dhe solide, veçanërisht lidhur me detyrueshmërinë e sigurimit të pranisë së mbrojtësit gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Prania e mbrojtjes në vendimet e Gjykatës Kushtetuese është vështruar e lidhur ngushtë me kënaqjen e parimeve të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, të cilat sigurojnë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka theksuar rëndësinë e mbrojtjes së detyrueshme në rastin e të pandehurit të mitur²³² dhe të kontrollit të rregullsisë së njoftimit për palën mbrojtëse²³³, si dhe rëndësinë e mbrojtjes teknike efektive gjatë gjykimit për çështje të ligjit²³⁴. Kjo Gjykatë ka theksuar, gjithashtu, rëndësinë e mbrojtjes së të pandehurit që në fazën e hetimeve paraprake²³⁵, jo vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Kjo është shumë e rëndësishme, pasi vendosen rregulla të qarta për ta kuptuar procedimin dhe procesin si një tërësi

²³² Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.13, datë 10.06.2005: “Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundim se, Gjykata e Lartë, krahas parimeve të tjera, është e detyrues të respektojë kontradiktoritetin e barazinë e palëve në gjykim. Zbatimi i këtyre parimeve në gjykimin penal kërkon që, i pandehuri, i mitur, nëpërmjet mbrojtësit të tij, të paraqitet e të dëgjohet njëllëj si prokurori. Zbatimi me korrektësi i këtyre parimeve, do të përjashtonte dizavantazhin e një pale ndaj tjetrës. Në çështjen konkrete, nga Gjykata e Lartë, i ka shkelur parime edhe pse shqyrtohej një rekurs që nëpërmjet ndryshimit të vendimeve të shkallëve të tjera të gjykimit rëndonte pozitën e të pandehurit të mitur... Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese për shkak të moszbatimit të principeve themelore të gjykimit, e vlerëson vendimin 565, datë 10.11.2004 të Gjykatës së Lartë antikushtetues.”

²³³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 19.02.2007: “Gjykata Kushtetuese vlerëson se njoftimi i bërë jo në përputhje me ligjin, përfshihet në shqyrtimin kushtetues vetëm kur pala ndërgjyqëse, për shkak të mosnjoftimit, është penguar të ushtrojë të drejtën e mbrojtjes, e cila i garantohet nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese konstatoi se, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë, ka bërë njoftimin e datës së gjykimit të kësaj çështjeje me pasaktësi... Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duke zhvilluar gjykimin e çështjes pa verifikuar më parë shkaqet e mosparaqitjes së përfaqësuesit të të pandehurit, nuk ka ndërmarrë hapat e duhura për të siguruar që ai të gëzojë të drejtat e njohura.”

²³⁴ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 04.03.2008: “Gjykimi në Gjykatën e Lartë, në dallim nga procedurat strikte të gjykimit që zhvillohen në gjykatat e zakonshme, ka si veçori paraqitjen vetëm të argumenteve ligjorë. Kompleksiteti i procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë konfirmohet edhe nga dispozitat ligjore që sanksionojnë, se palët, duhet të përfaqësohen në këtë gjykim nga avokati. Prandaj, shqyrtimi nga Gjykata e Lartë kryesisht i çështjeve të ligjit, jo vetëm që e justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat në seancat dëgjimore, por për më tepër, bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale. Nisur nga specifika e rastit në shqyrtim, kur çështja gjykohej mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, i cili kishte kërkuar rëndimin e pozitës së të pandehurit, dhe faktit që as i pandehuri dhe as avokati nuk ishin të pranishëm në gjykim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej të zhvillonte gjykimin pa i dhënë mundësi palës së akuzuar për të realizuar mbrojtjen ligjore. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë dilte e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejonte zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, sepse ishte e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të realizonte të drejtën për tu mbrojtur.” (shih edhe vendimin nr. 23, datë 13.10.2005).

²³⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 20.07.2005: “Është shkelur parimi kushtetues që garanton të drejtën e mbrojtjes në hetimet paraprake. Vërtetohet se kërkuesi është hetuar e gjykuar në mungesë. Hetimi i çështjes ka filluar në datën 10.06.1997, dhe deri në datën 25.03.1998, nuk është caktuar avokat në mungesë, për mbrojtjen e të pandehurit. Vendimi për njoftimin e akuzës mban datën 13.02.1998, por nuk i është komunikuar avokatit sepse deri në këtë datë nuk ishte caktuar avokat mbrojtës. Edhe procesverbali mbi njohjen e materialeve të çështjes, vendimi për dërgimin e çështjes në gjykatë dhe kërkesa për gjykim nuk rezultojnë t’i jenë njoftuar avokatit. Këto veprime të kryera në fazën e hetimeve paraprake i kanë mohuar krejtësisht të pandehurit të drejtën e mbrojtjes, duke cënuar standartet kushtetuese dhe ato të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

e pandarë, me detyrimin e organit që procedon për të siguruar, që në krye të herës, praninë e mbrojtësit kur ligji e parashikon atë si të detyrueshme. Mospërbushja e kësaj procedure do të shkaktonte pavlefshmëri absolute të akteve dhe gjithë procesi do të bëhej i parregullt për shkak të cënimit të parimit kushtetues të mbrojtjes.

Sikurse përmendëm më sipër, Gjykata Kushtetuese ka dhënë disa vendime shumë të rëndësishme lidhur me kriteret për të vendosur mospranimin e rekursit, në rastet kur ai nuk nënshkruhet nga mbrojtësi²³⁶. Gjykata e ligjit ka dhënë disa vendime interesante në lëmin e gjykimit në mungesë të të pandehurit; si në drejtim të saktësisimit të kriterëve që lejojnë gjykimin në mungesë²³⁷, ashtu edhe në drejtim të kriterëve për rivendosjen në afat të ankimit²³⁸, vendim që passolli shfuqizimin e pjesshëm të nenit 147.6 të KPP.

Ndërhyrja e Gjykatës Kushtetuese ka qartësuar konceptet e paanshmërisë së gjykatës, në rrafshin objektiv dhe subjektiv, koncept i lidhur ngushtë me pavlefshmërinë absolute, për shkak të përbërjes së trupit gjykues. Kemi kritikuar faktin se ajo Gjykatë ka demonstruar edhe luhajtje të papërligjura në jurisprudencën e saj²³⁹ lidhur me këtë temë delikate; nëse në çështjen Beqiraj, në votim, nuk u arrit shumica e anëtarëve që kërkon neni 133/2 i Kushtetutës²⁴⁰, në një vendim të mëpasëm, ajo Gjykatë iu rikthye jurisprudencës së mëparshme në këtë temë: u pohua cënimi i parimit të paanshmërisë objektive kur të njëjtët gjyqtarë të Gjykatës së Lartë që rrëzuan kërkesën për rishikim, patën vendosur edhe mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi²⁴¹.

Lidhur me temën e njoftimit të të pandehurit për të marrë pjesë në procesin kundër tij, si dhe të drejtën e mbrojtjes efektive ndaj akuzave, interes të veçantë paraqit jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut. Këto të drejta Gjykata Europiane i sheh në këndvështrimin e nenit 6 të

²³⁶ Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.38, datë 30.12.2010, Perati (§ 3); nr.2, datë 25.1.2012, Bukaçi (§12, 13, 14); nr.22, datë 23.4.2012, Balliu (§ 14-18), *të paracituar*.

²³⁷ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.26, datë 8.5.2012, Boriçi: “19. Si konkluzion, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri duhet të ketë dijeni në se ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Gjykata ka arritur në këtë përfundim, për arsye se heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar, duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimmarrjeje prej tij (shih vendimet nr.30, datë 17.06.2010; nr. 45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Në paragrafin 20, Gjykata citon nëntë kriteret minimale që cakton Rezoluta (75) 11 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, për gjykimin në mungesë të të pandehurit.

Vërejmë se kriteri i parë është cituar në mënyrë të cingërt; citimi i saktë do të ishte: “(i) askush nuk mund të gjykohet nëse nuk është njoftuar paraprakisht, në kohën e duhur, në mënyrë që të ketë mundësinë të paraqitet dhe të përgatisë mbrojtjen, përveç rasteve kur provohet se me ndërgjegje i shmanget drejtësisë.” Shih: Conseil de l’Europe, Comité des Ministres, Résolution (75) 11, “Sur les critères à suivre dans la procédure de jugement en l’absence du prévenu” (adoptée le 21 mai 1975, lors de la 245^e réunion des Délégués des Ministres). Shih edhe vendimin nr.33, datë 24.5.2012, Aliaj.

²³⁸ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.31, datë 17.5.2012, kërkuese Gjykata e Lartë.

²³⁹ Shih § I.3-i, çështja Dhima, vendim nr.8, datë 27.2.2014, *i paracituar*.

²⁴⁰ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 2.4.2014, Beqiraj, *i paracituar*: dallime kaq të ndjeshme për një çështje të mirëtrajtuar në jurisprudencën evropiane, ngrejnë kritika të pashmangshme për vendimmarrjen e asaj Gjykate.

²⁴¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.70, datë 17.11.2015, Doda, *i paracituar* (shih § I.3-i).

Konventës (e drejta për një proces të rregullt), si shkelje të procesit të rregullt ligjor apo si dhunim i së drejtës të mbrojtjes në procesin penal, në rast mosrespektimi të tyre.

Njoftimi i të pandehurit për të marrë pjesë në procesin që zhvillohet kundër tij përbën një element të domosdoshëm të procesit të rregullt ligjor dhe siguron parimin e rëndësishëm të kontradiktoritetit në proces. Në çështjen e hershme **Poitrimol kundër Francës**, Gjykata e Strasburgut vëren: “*Paraqitja e të pandehurit merr rëndësi të posaçme për arsye si të së drejtës së tij për t’u dëgjuar, ashtu edhe domosdoshmërisë për të kontrolluar saktësinë e pohimeve të tij dhe për t’i ballafaquar ato me thëniet e viktimës...*”²⁴². Në këtë vendim, Gjykata pohon gjithashtu edhe të drejtën e mbrojtjes efektive të të akuzuarit, e cila edhe pse joabsolute, është element themelor i procesit të drejtë: “*Edhe pse joabsolute, e drejta e çdo të akuzuari për t’u mbrojtur efektivisht me avokat, sipas nevojës edhe i caktuar kryesisht, figuron ndër elementët themelore të procesit të drejtë. I akuzuari nuk e humbet këtë favor thjesht për faktin e mungesës së tij në debatin gjyqësor.*”

Këtij problemi Gjykata e Strasburgut iu rikthye në çështjen **Belziuk kundër Polonisë**²⁴³, ku theksoi rëndësinë e kuptimit të procedurës si një e tërë, e cila nuk mund të quhet e përmbushur me sigurimin e pranisë së të pandehurit vetëm gjatë gjykimit në shkallë të parë. Gjykata ka vërejtur se: “*... Në radhë të parë, nocioni i procesit të drejtë nënkupton, në parim, të drejtën e të akuzuarit për të marrë pjesë në debatin gjyqësor...*”, e cila përfshin edhe të drejtën për t’u paraqitur në gjykatën e apelit me qëllimin “*... për të siguruar vetë mbrojtjen e tij.*” Dhe më tej: “*Procedura penale formon një të tërë dhe mbrojtja e nenit 6 nuk mbaron me gjykimin në shkallë të parë. Një shtet ka detyrimin për të vigjëlur që të gjykuarit të gëzojnë garancitë themelore që mbron kjo dispozitë, edhe gjatë gjykimit në apel.*”

Të njëjtat parime, Gjykata e Strasburgut i ritheksoi edhe në çështjen **Asciutto kundër Italisë**²⁴⁴: “*Gjykata kujton që prania e të pandehurit merr rëndësi kapitale në interes të një procesi penal të barabartë dhe të drejtë ... Neni 6, i lexuar si një i tërë, i njeht pra të akuzuarit të drejtën për të marrë pjesë realisht në procesin e tij.*” Pasi ritheksoi të drejtën e çdo të akuzuari për t’u mbrojtur në mënyrë efektive nga një avokat, që mund të caktohet edhe kryesisht (duke ricituar çështjen **Poitrimol**), Gjykata e Strasburgut vërejt: “*... Në fakt, ka një rëndësi vendimtare për barazinë e sistemit penal që i akuzuari të mbrohet në mënyrë të përshtatshme si në shkallë të parë, ashtu edhe në apel.*”

Në frymën e Rezolutës (75) 11 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, Gjykata e Strasburgut përpunoi një jurisprudencë të qartë të parimeve të gjykimit në mungesë të të pandehurit, duke filluar nga viti 1985 me çështjen **Colozza kundër Italisë**. Për rëndësinë që paraqesin për procesin tonë penal, po ndalemi në disa nga vendimet kryesore, të viteve të fundit, në këtë lëmë.

Në çështjen **Sejdoviç kundër Italisë**²⁴⁵, Dhoma e Madhe pranoi se ka shkelje të nenit 6 të Konventës, atëherë kur dënohet në mungesë i pandehuri që nuk është njoftuar, në mënyrë efektive, për procesin në ngarkim të tij dhe nuk ka hequr dorë shprehimisht nga e drejta për të qenë i pranishëm në seancë; ka shkelje të nenit 6 edhe kur, pas dhënies së vendimit në mungesë,

²⁴² Affaire Poitrimol c. France, Arrêt, Strasbourg 23 novembre 1993, Requête n° 14032/88. Tek <http://cmiskp.echr.coe.int>, Baza e të dhënave HUDOC e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

²⁴³ Affaire Belziuk c. Pologne, 45/1997/829/1035, Arrêt, Strasbourg 25 mars 1998. Po aty.

²⁴⁴ Affaire Asciutto c. Italie, Requête n° 35795/02, Arrêt, Strasbourg 27 novembre 2007, définitif 07/07/2008. Po aty.

²⁴⁵ Grande Chambre, Affaire Sejdovic c. Italie, Requête n° 56581/00, Arrêt, Strasbourg, 1^{er} mars 2006, <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-72622>, vizita e fundit, 16 mars 2015.

procedura penale në fuqi nuk parashikon një mekanizëm efektiv që të sigurojë se juridiksioni gjyqësor do të shprehet *ex novo* mbi akuzat, pasi ta ketë dëgjuar të pandehurin, në respektim të kërkesave të nenit 6 (§§ 82-85, 87-88, 99-101).

Të njëjtat parime ritheksohen në çështjen **Stoichkov kundër Bullgarisë**, duke theksuar se refuzimi i rigjykimit të të pandehurit të dënuar *in absentia*, kur nuk provohet se ai i ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u mbrojtur nga akuzat, përbën "*mohim flagrant të drejtësisë*"²⁴⁶ (§§ 54, 56).

Në çështjen **Hu kundër Italisë**²⁴⁷, Gjykata iu rikthye qëndrimeve të mëparshme për rëndësinë e njoftimit zyrtar të të akuzuarit për procesin kundër tij, sigurisë që duhet të krijojë gjykata se i pandehuri mori dijeni efektivisht për aktin dhe se thjesht mosgjetja e të pandehurit, në vendin ku qëndron zakonisht apo tek të afërmit e tij, nuk mjafton për të provuar se ai ka si qëllim t'i shmanget ballafaqimit me drejtësinë (§§ 53-56).

Në çështjen **Abdelali kundër Francës**²⁴⁸, Gjykata e Strasburgut pasi iu referua qëndrimeve të mëparshme të jurisprudencës së saj, theksoi se nuk mjafton vetëm që të pandehurit të gjykuar në mungesë t'i jepet mundësia të rigjykohe sërish; atij duhet t'i garantohet e drejta të kundërshtojë provat në ngarkim të tij. Përndryshe, mbrojtja do të ishte shpërpjestimore në raport me akuzën dhe e zhveshur nga kuptimi i procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 6 i Konventës (§§ 54-56).

Me këtë paraqitje të përmbledhur të jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, lidhur me rëndësinë e pranisë së të pandehurit në proces dhe të mbrojtjes së tij efektive, të siguruara nga neni 6 i Konventës, e mbyllim trajtimin e temës së pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale, për të trajtuar shkurtimisht kuptimin e mosqënies juridike të aktit.

§ 2.3 Kuptimi i mosqënies juridike të aktit

Kur trajtuam temën e pavlefshmërisë absolute që lidhej me gjyqtarin (*shih § 2.2.1*) cekëm pak nocionin doktrinar të mosqënies (*mosekzistencës*) juridike të aktit, i cili përbën një formë patologjike të aktit procedural penal më të rëndë se pavlefshmëria absolute. Ky nocion, i njohur dhe i trajtuar gjerësisht nga doktrina e huaj, ende nuk ka fituar të drejtën e qytetarisë në doktrinën dhe jurisprudencën tonë. E gjykuam me vend të ndaleshim, fare shkurt, tek ky koncept thjesht për interesin teorik që ai paraqet. Doktrina e huaj të ashtuquajturin akt të paqenë²⁴⁹ e përcakton si akt veset e të cilit, për shkak të përmasave shumë të mëdha, makroskopike, lehtësisht të dallueshme, jo vetëm nuk është nevoja të kodifikohen nga ligjvënësi, por nuk lejojnë që akti të prodhojë asnjë pasojë juridike²⁵⁰. Sipas një burimi autoritar²⁵¹, kategoria e mosqënies juridike ngrihet në të gjitha ato raste kur akti, për shkak të mungesës së disa elementeve strukturale që e

²⁴⁶ Case of Stoichkov v. Bulgaria, Application n° 9808/02, Judgment, Strasbourg, 24 March 2005, Final 24/06/2005, <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-68625>, vizita e fundit, 16 mars 2015.

²⁴⁷ Affaire Hu c. Italie, Requête n° 5941/04, Arrêt, Strasbourg, 25 septembre 2006, définitif 28/12/2006, <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-77068>, vizita e fundit, 16 mars 2015.

²⁴⁸ Affaire Abdelali c. France, Requête n° 43353/07, Arrêt, Strasbourg, 11 octobre 2012, définitif 11/01/2013, <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-113406>, vizita e fundit, 16 mars 2015.

²⁴⁹ (it.) *atto inesistente*.

²⁵⁰ Tonini Paolo., *vep. e cit.*, fq. 187; Lozzi Gilberto., *vep. e cit.*, fq. 167, Conso Giovanni, Grevi Vittorio, *Compendio di procedura penale*, 3^a edizione, CEDAM, 2006, fq. 271.

²⁵¹ Spangher Giorgio, *La pratica del processo penale*, Volume III, CEDAM 2014, Epub, 8.10 Le altre ipotesi di invalidità, faqe 270.

dallojnë, vendoset tërësisht jashtë sistemit të normave në fuqi dhe është absolutisht i paaftë të prodhojë pasoja, si në procesin penal ashtu edhe jashtë tij. Aktet të paqena krijohen në rastet e mungesës së pushtetit juridiksional ose të mungesës së një raporti procesual, si b.fj., vendimi i dhënë nga një subjekt që nuk është gjyqtar ose i shqiptuar jashtë juridiksionit penal, vendimi i dhënë ndaj një personi që nuk ekziston, që ka vdekur, penalisht i papërgjegjshëm ose i mbrojtur nga imuniteti, aktet e vesuara nga mungesa e ndërgjegjes e vullnetit, etj. Në raste të tilla, thuhet se juridikisht akti nuk ekziston, është i paqenë.

Në praktikën tonë gjyqësore nuk kemi mundur të hasim raste të akteve që, në kuptimin e sipërshpjeguar, do të quheshin mirëfilli akte të paqena. Por, kemi vërejtur disa vendime ku ky koncept ngatërrohet me rastet e pavlefshmërive, sikurse do të argumentojmë në vijim. Kolegji penal i Gjykatës së Lartë e konsideron akt të paqenë (nul) vendimin për rivendosjen në afat të rekursit, të marrë nga gjykata e apelit, ndërkohë që këtë të drejtë ligji procedural ia jep gjykatës së rrethit gjyqësor, për më tepër kur kërkesën e pati bërë një person i palegjitimuar²⁵². Një rast të ngjashëm propozon për diskutim edhe një vendim i vitit 2009²⁵³. Rastet e cituara, në fakt, janë raste të pavlefshmërisë absolute që lidhen me gjyqtarin, për shkak të mungesës së kushteve për të qenë gjyqtar (neni 128.1, shkronja “a”), si pasojë e moskompetencës lëndore.

Rasti që do të diskutojmë në vijim mund të konsiderohet rast i mosqënies juridike të aktit, ngaqë në datën kur është dhënë vendimi nuk del të jetë zhvilluar seancë gjyqësore, pasi seanca nuk u riçel dhe, në përmbajtje të procesverbalit, nuk figuron dispozitivi i vendimit të marrë nga gjykata²⁵⁴. Në fakt, një rast i tillë nuk përfshihet në rastet e pavlefshmërive të parashikuara nga

²⁵² Nr.424 i Vendimit, datë 25.4.2007, Bytyçi: “Ne lidhje me kete vendim, Kolegji Penal i Gjykates se Larte konstaton:

Se pari, se kerkesa per rivendosje ne afat eshte bere nga nje person i pa legjitimuar. Ne baze te nenit 147/2 te K.Pr.Penale, neqoftese vendimi eshte dhene ne mungese te te pandehurit, vetem ai mund te kerkoje rivendosjen ne afat per te bere ankim kur provon se nuk ka marre dijeni per vendimin. Ne interpretim te dispozites ne fjale edhe Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte me vendimin 2, date 14.10.2002 kane konkluduar se subjekti qe mund te kerkoje rivendosjen ne afat per te bere ankim kunder vendimit te dhene ne mungese, eshte vetem i pandehuri.

Se dyti, Gjykata e Apelit Shkoder nuk ka qene kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosje ne afat.

Kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen ne afat te ankimit eshte gjykata e shkalles se pare. Ne kete perfundim kane arritur Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ne vendimin unifikues te mesiperm.

Sa ma lart, vendimi i Gjykates se Apelit Shkoder me nr.7, date 17.05.2005 per rivendosjen e afatit te ankimit (rekursit) te te gjykuarit B.B, te gjykuar ne mungese, eshte akt absolutisht i pavlefshem dhe si i tille konsiderohet i paqene (nul).”

²⁵³ Nr.100 i Vendimit, datë 18.3.2009, Bushgjokaj: “... vendimi nr. 463, date 08.06.2007 i Gjykates se Apelit Tirane eshte rezultat i zbatimit te gabuar te kerkesave te ligjit procedural penal e si i tille, duke qene akt absolutisht i pavlefshem ne veshtrim te nenit 128/2 te K.Pr.Penale, duhet konsideruar i paqene, per rrjedhoje duhet vendosur mospranimi i rekursit te paraqitur nga i gjykuari ...”

²⁵⁴: “... përfaqësuesi i prokurorisë ... pretendoi se, ndërsa në seancën e fundit gjyqësore (datë 16.12.2005) të gjykimit në apel, sipas procesverbalit, me vendim të ndërmjetëm gjykata vendosi të shtyjë seancën për datën

Kodi, ndaj vendimi mund të konsiderohet si një akt juridikisht i paqenë²⁵⁵, ndonëse Kolegji e sanksionon si pavlefshmëri relative, por pa cituar referencën ligjore.

Pas kësaj paranteze lidhur me nocionin e mosqënies juridike të aktit, le të kalojmë në trajtimin e kuptimit dhe të rasteve që propozon praktika gjyqësore lidhur me pavlefshmërinë relative të akteve procedurale penale.

23.12.2005 për të shpallur vendimin, seanca e kësaj date (23.12.2005) nuk figuron që të jetë zhvilluar, kështu që vendimi i marrë prej saj nuk është shpallur.

Mbas verifikimit të këtij pretendimi, Kolegji Penal i Gjykatës së lartë konstatoi se pretendimi si më sipër qëndron dhe duhet pranuar. ... seanca gjyqësore e datës 23.12.2005, të cilën mban edhe vendimi nr.460 i gjykatës së apelit, nuk është zhvilluar dhe, për rrjedhojë, jo vetëm që dispozitivi i tij nuk është pasqyruar në procesverbalin gjyqësor, por as është bërë shpallja e tij në prani të palëve, detyrim ky, i cili rrjedh nga përmbajtja urdhëruese e dispozitës së nenit 384 të K.Pr.Penale. Po kështu, edhe seanca gjyqësore që u zhvillua për gjykimin e çështjes në apel, de jure, mbeti e pa mbyllur (e hapur).

Ndodhur para kësaj shkelje procedurale, për shkak të së cilës ky Kolegj çmon se, në zbatim të nenit 129 të K.Pr.Penale, gjykimi në apel duhet deklaruar i pavlefshëm,...”.

²⁵⁵ Ky akt më mirë mund të cilësohej si “jashtë normave” (it. *abnorme*), një tjetër kategori juridike e përpunuar nga jurisprudenca e Kasacionit në Itali; Spangher Giorgio, *po aty*, faqe 271.

KREU 3

PAVLEFSHMËRIA RELATIVE E AKTEVE

§ 3.1 Kuptimi i pavlefshmërisë relative të akteve.

Pavlefshmëritë relative janë pavlefshmëri të natyrës së posaçme, të parashikuara shprehimisht nga dispozita konkrete e Kodit, të cilat sanksionojnë vese më pak të rëndësishme të aktit procedural penal se sa pavlefshmëritë e natyrës absolute. Pavlefshmëritë relative nuk u përgjigjen drejtpërsëdrejti kërkesave për të mbrojtur interesa thelbësore të caktuara që lidhen me parime themelore të procesit penal, por nevojës për të sanksionuar shkelje të veçanta procedurale, të cilat mund të ndikojnë në dhënien e vendimit. Si rregull, ato *ngrihen nga pala e interesuar*, duke iu nënshtruar një regjimi që parashikon *kufizime lidhur me çastin kohor të ngritjes dhe mundësinë e korigjimit* të tyre, në dallim nga pavlefshmëritë e natyrës absolute të cilat ngrihen kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit dhe që karakterizohen nga pakorigjueshmëria e tyre²⁵⁶.

Pra, pavlefshmëritë relative të akteve procedurale penale, në dallim nga pavlefshmëritë absolute, i nënshtrohen një regjimi juridik që karakterizohet nga këto tipare thelbësore:

- 1) Ngrihen, si rregull, nga pala e interesuar;
- 2) Ngrihen brenda afateve kohore të paracaktuara nga ligji;
- 3) Ekziston mundësia e korigjimit të tyre.

Deklarimi i tyre bëhet nga gjyqtari, me veçorinë që në fazën e hetimeve paraprake çmuarja dhe deklarimi i tyre bëhet nga prokurori²⁵⁷.

Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë paraqit paqartësi të dukshme lidhur me konceptin që përcakton neni 128.2 i Kodit të Procedurës Penale. Kemi theksuar se ligji procedural nuk e lidh me afate çastin e ngritjes së pavlefshmërive absolute. Por, vërejmë se kolegji penal ka krijuar konfuzion në praktikën gjyqësore duke mos e bërë këtë dallim. Në rastin që do të sjellim për ilustrim²⁵⁸, duke konstatuar disa pavlefshmëri në mbajtjen e procesverbalit gjyqësor, ai kolegji nxjerr përfundime përgjithësuese krejt të gabuara duke u shprehur: “... *gjithë aktet e saj, pra dhe vendimi, ..., janë të pavlefshme, gjë që del edhe nga përmbajtja e nenit 128, pika 2 e K. Pr. Penale sipas të cilit një akt i cilësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm.*” Sikurse dihet, shkelja e rregullave për mbajtjen e procesverbalit nuk mund të shkaktojë kurrë pavlefshmëri absolute, por vetëm relative.

Në shumë raste, vërejmë se terminologjia e përdorur është e papërshtatshme, në dallim nga saktësia e gjuhës së zgjedhur nga ligjvënësi. Në praktikën gjyqësore qëllon që hasen termat “*pavlefshmëri e procedurave të gjykimit*”²⁵⁹, “*proces i pavlefshëm*” apo “*proces gjyqësor i parregullt*”²⁶⁰, “*gjykim nul*”²⁶¹, etj., të cilët jo vetëm nuk gjejnë pasqyrim në institutet e Kodit, por edhe nuk sjellin as risi në planin doktrinar.

²⁵⁶ Neni 128. Pavlefshmëria absolute - ... 2. Një akt i cilësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm.

²⁵⁷ Neni 130. Çmuarja e pavlefshmërisë - ... 4. Gjatë hetimeve paraprake çmuarja e pavlefshmërisë bëhet nga prokurori.

²⁵⁸ Nr.239 i Vendimit, datë 26.04.2006, Pasholli, Zhulegu.

²⁵⁹ Nr.00-2013-530 i Vendimit (91), datë 13.3.2013, Merkaj: “18... Mosnjoftimi i të gjykuarit dhe mosmarrja e vendimit për gjykimin në mungesë sjellin pavlefshmëri të procedurave të mëtejshme të gjykimit.”

²⁶⁰ Nr.00-2013-389 i Vendimit (44), datë 6.2.2013, ankim kundër vendimit të pushimit: “12. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi nr.12, datë 26.04.2011 i Gjykatës së Apelit Korçë është marrë në shkelje të ligjit

Pas këtij konstatimi, në vijim, do të ndalemi më gjerë në trajtimin dogmatik të tipareve thelbësore të regjimit të pavlefshmërisë relative të akteve, duke e përqsuar atë me praktikën gjyqësore të mishëruar në jurisprudencën e kolegjit penal të Gjykatës së Lartë.

§ 3.2 Mënyra e ngritjes së pavlefshmërive relative

Kemi trajtuar që regjimi i pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale penale normohet shprehimisht në nenin 128 të Kodit (*shih* § 2.2). Ligjvënësi nuk i përcakton në mënyrë të drejtpërdrejtë pavlefshmëritë e natyrës relative, por me anën e një dispozite referuese, duke konsideruar të tilla vetëm ato që janë të ndryshme nga “... ato të parashikuara nga neni 128, ...”²⁶². Me një fjalë, sistemi ynë i pavlefshmërive të akteve procedurale penale, që sikurse kemi përmendur është një sistem i tipit binar, përcakton si relative pavlefshmëritë e ndryshme nga ato absolute, të parashikuara në mënyrë të shprehur nga neni 128.1 i Kodit. Pavlefshmëritë relative, për nga natyra e tyre janë të posaçme, theksuam se gjenden të shpërndara në tekstin e Kodit, ndaj është detyrë e palëve në proces që t’i identifikojnë dhe t’i ngrajnë ato, rast pas rasti.

Në të njëjtën dispozitë, ligjvënësi normon që pavlefshmëritë relative “... mund të deklarohen mbi kërkesën e palëve”. Kjo normë përcakton, në thelb, regjimin e pavlefshmërive relative, duke shërbyer si kriteri i parë dallues i tyre nga kategoria e pavlefshmërive absolute. Ligjvënësi ynë ka përshtatur modelin italian²⁶³, por duke përjashtuar të quajturat pavlefshmëri “të llojit të tretë” (ndryshe pavlefshmëritë e llojit *tertium genus*). Norma përmban në vetvete mundësinë e deklarimit të pavlefshmërive relative (*nga gjykata*), por duke ia lënë nismën e ngritjes së tyre vetëm palës së interesuar, sakaq me një kufizim të rëndësishëm: të mos ketë vepruar ende mekanizmi i korrigjimit automatik të tyre (*shih në vijim* § 3.4).

Kemi theksuar se jurisprudenca e Gjykatës së Kasacionit në Itali i qëndron parimit se pavlefshmëritë relative mund të ngrihen vetëm nga pala e interesuar dhe brenda afateve të paracaktuara, shkëlja e të cilave sanksionohet me pasojë mospranimi. Por, nga ana tjetër, pranohet mundësia që gjyqtari të procedojë kryesisht për korrigjimin *de plano* të një pavlefshmërie relative, të shkaktuar në prani të tij, edhe pas përfundimit të gjykimit (b.f., të vendosë që nëpunësi gjyqësor të nënshkruajë procesverbalin e mbajtur prej tij dhe që mund të jetë vënë në dispozicion të palës i panëshkruar)²⁶⁴.

procedural penal duke i hapur rrugë një procesi të pavlefshëm, dhe si i tillë duhet të priset dhe çështja të kthehet për rishqyrtim...

17. Në kushtet kur vendimi i gjykatës së Apelit Korçë është në kundërshtim me N.380 të K.Pr.Penale, dhe me nenin 3 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale ku parashikohet se: “...2. Gjykata jep vendim në bazë të provave që shqyrtohen e verifikohen në seancë gjyqësore”, e bën procesin gjyqësor të parregullt pasi gjykimi dhe arsyetimi janë bërë mbi bazën e provave hipotetike të cilat nuk i janë nënshtruar debatit gjyqësor.”

²⁶¹ Nr.00-2011-859 i Vendimit (125), datë 6.10.2011, Aliu: “28. Në kushtet kur gjykimi në gjykatën e apelit është nul, për të pandehurin A.A. ngelet në fuqi masa e sigurimit “arrest në shtëpi” e vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.633 akti, datë 17.05.2011, si gjykatë kompetente.”

²⁶² Shih nenin 129.1 të KPP.

²⁶³ Art. 181. Nullità relative - 1. Le nullità diverse da quelle previste degli artt. 178 e 179 comma 2 **sono dichiarate su eccezione di parte** [theksimi ynë].

²⁶⁴ Seksioni VI i Gjykatës së Kasacionit, vendim n.11415, 20 maj 2002 (seanca 4 mars 2002), e pandehur Staller Elena Anna: “*Neni 181 i KPP* [i përkon neni 129 të Kodit tonë – shënimi ynë] *duke parashikuar që pavlefshmëritë relative deklarohen me kërkesën e palëve, nuk pengon aspak që ato të korrigjohen kryesisht nga gjyqtari, për aq*

Logjika e kufizimit të mundësisë për të ngritur pavlefshmëritë relative, duke ua lënë këtë të drejtë vetëm palëve në proces, mbështetet në nevojën për të drejtpeshuar interesat e tyre me dobinë e zgjidhjes së procesit brenda një afati të arsyeshëm. Sikurse shihet, në zgjedhjen e ligjvënësit italian, vlerat e efektivitetit mbizotërojnë në krahasim me vlerat e garancive që sistemi merr përsipër t'u sigurojë palëve, në rastet kur në lojë janë vese të natyrës relative, që nuk prekin vlera thelbësore të procesit, zgjedhje e cila është pranuar parimisht edhe nga ligjvënësi ynë, me reformën e procedurës penale të vitit 1995.

§ 3.3 Afatet për ngritjen e pavlefshmërive relative

Afatet për të ngritur ose për të kundërshtuar pavlefshmëritë e natyrës relative, ligjvënësi i ka ndërtuar në bazë të parimit të dekadencës (*humbjes*) të së drejtës, i cili në tekstin e Kodit shprehet me termin "*afatet që nuk mund të zgjaten*". Për këto afate vlen parimi i taksativitetit, por ato mund të zgjaten, si përjashtim nga rregulli, atëhere dhe vetëm atëhere kur ligji e parashikon shprehimisht²⁶⁵.

Pamundësia e zgjatjes së afatit për ngritjen e pavlefshmërive relative është rregull që normohet shprehimisht në nenin 129.4 të Kodit të Procedurës Penale, me këtë formulim: "*Afatet për të ngritur ose për të kundërshtuar pavlefshmërinë* (lexo relative – shënimi ynë) *nuk mund të zgjaten.*" Për të mënjeluar zgjatjen e pavend të procesit apo instrumentalizimin e tij në dëm të drejtësisë, ligjvënësi ka vendosur rregullin e parandalimit të kryerjes së akteve të pavlefshme, kur pala është e pranishme, duke normuar kundërshtimin e pavlefshmërisë *para se akti të kryhet*. Por, kur kjo nuk është e mundur, pavlefshmëria duhet të ngrihet *menjëherë pas kryerjes së aktit*²⁶⁶.

Por, formulimi i dispozitës është i metë, sepse ligjvënësi nuk sanksionon me pasojë mospranimi rastet kur rregullat e mësipërme shkelen nga pala e pranishme, çka përbën edhe *ratio*-n e normës. Me fjalë të tjera, në paragrafin 5 të nenit 129 ligjvënësi ka vendosur një normë sjelljeje deklarative, por pa sanksion të shprehur në rast shkeljeje të saj. Në fakt, jurisprudenca e kolegjit penal ka pranuar që pala e humbet të drejtën e ngritjes së pavlefshmërisë së akteve, nëse ka qenë e pranishme në kryerjen e aktit dhe nuk e ka ngritur atë, të paktën, menjëherë pas kryerjes. Në rastin që po sjellim për ilustrim, mbrojtja pati kërkuar para kolegjit penal të Gjykatës së Lartë pavlefshmërinë absolute të procesverbalit për paraqitjen për njohje të personit të akuzuar. Kolegji, pasi rrëzoi me të drejtë mëtimin për pavlefshmëri absolute, duke pranuar se rasti përfshihej në pavlefshmëritë e natyrës relative, arsyetoi se pavlefshmëria e aktit duhej të ishte ngritur menjëherë pas bërjes së tij, ngaqë pala e interesuar pati qenë e pranishme²⁶⁷. Madje,

kohë sa aktet janë në dispozicion të tij." Tek Corso Piermaria (a cura di), Il codice di procedura penale, annotato con la giurisprudenza, *vep. e cit.*, faqe 474.

²⁶⁵ Neni 145. Afatet që nuk mund të zgjaten. – 1. Afatet që nuk mund të zgjaten janë ato që parashikohen nga ligji për për raste të caktuara. Këto afate mund të zgjaten vetëm kur me ligj disponohet ndryshe.

²⁶⁶ Neni 129. Pavlefshmëria relative. - ... 5. Kur pala është e pranishme, pavlefshmëria e një akti duhet të kundërshtohet para se ai të bëhet ose, kur kjo nuk është e mundur, menjëherë pasi është bërë.

²⁶⁷ Nr.60 i Vendimit, datë 06.02.2008, Shemuni: "Në lidhje me zbatimin e dispozitës së nenit 129, është i drejtë konkluzioni që nxjerr gjykata kur arsyetohet se pavlefshmëria e aktit do të duhej të ishte kërkuar menjëherë pasi ai është bërë. Në procedurën e njohjes nga ana e shtetasit E.D., procesverbali në fjalë është nënshkruar nga ky i fundit, prokurori, OPGJ, i gjykuari Shemuni dhe nga avokati i tij, persona këta që kanë qenë prezentë. Në referencë të nenit 129/5, 171/3 të K.Pr.Penale, kërkesa për pavlefshmërinë e veprimit procedural të njohjes do të duhej të ishte bërë nga i gjykuari apo mbrojtësi i tij në momentin e caktuar nga ligji, pra menjëherë pas përpilimit të aktit."

në këtë rast, arsyetimi mund të ishte më rigoroz: pala e pranishme që pretendoi cënimin e të drejtave nuk duhet të lejonte kryerjen e aktit të vesuar.

Shënojmë se ligjvënësi nuk ka mundur të ndërtojë mekanizmin e duhur procedural që do të shmangte krijimin e pavlefshmërive të qëllimshme, me synimin për të konsumuar afate procedurale në interes të palës që vepron me keqbesim (*in mala fides*). Gjithashtu, nuk ka arsye që pavlefshmëria relative të mund të ngrihet edhe nga pala që nuk ka asnjë interes, për arsyen e thjeshtë se instituti i pavlefshmërisë synon të mbrojë cënimin e një të drejte apo të një situatë juridike që ka rëndësi për palën e që dispozita përkatëse synon ta mbrojë. Bie fjala, i pandehuri nuk ka asnjë interes të thirret në gjykim paditësi civil, ndaj ngritja e një pavlefshmërie të tillë nga ana e tij nuk do të kishte kuptim. Por, sikurse përmendëm, situata të tilla Kodi ynë nuk ka mundur dot t'i zgjidhë.

Nga një vështrim krahasues, vërejmë se ligjvënësi ynë i është shmangur pa arsye formulimit të Kodit italian²⁶⁸, i cili normon saktë që nuk mund të ngrihen pavlefshmëritë relative nga pala që:

- ka marrë pjesë në kryerjen e aktit të pavlefshëm dhe nuk e ka ngritur pavlefshmërinë menjëherë (*para se akti të kryhej ose menjëherë pas kryerjes*);
- e ka shkaktuar apo ka bashkëpunuar në kryerjen e aktit të pavlefshëm;
- nuk i cënohet asnjë interes nga kryerja e aktit të pavlefshëm.

Kodi ynë i rregullon afatet e ngritjes së pavlefshmërive edhe në lidhje me fazën procesuale ku është kryer akti relativisht i pavlefshëm²⁶⁹:

a) pavlefshmëria lidhur me aktet e kryera gjatë hetimeve paraprake dhe për sigurimin e provës nuk mund të ngrihen pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor;

b) pavlefshmëria e vërtetuar në gjykim, *mund* të kundërshtohet bashkë me vendimin përfundimtar.

Rasti i dytë (*shkronja "b"*) meriton të analizohet në përqasje me modelin²⁷⁰, për shkak të përdorimit të pavend të termit "*mund*", në vend të termit "*duhet*". Në fakt, dispozita merr kuptim kur ankimi së bashku me vendimin përfundimtar normohet si detyrim, jo si mundësi. Interpretimi bëhet në raport me parimin e përgjithshëm që pavlefshmëritë relative duhet të kundërshtohen brenda afatesh të shkurtëra. Kështu, një pavlefshëmri relative e konstatuar gjatë

²⁶⁸ Art. 182. Deducibilità delle nullità — 1. Le nullità previste dagli articoli 180 e 181 non possono essere eccepite da chi vi ha dato o ha concorso a darvi causa ovvero non ha interesse all'osservanza della disposizione violata.

2. Quando la parte vi assiste, la nullità di un atto deve essere eccepita prima del suo compimento ovvero, se ciò non è possibile, immediatamente dopo. Negli altri casi la nullità deve essere eccepita entro i termini previsti dagli articoli 180 e 181 commi 2, 3 e 4.

3. I termini per rilevare o eccepire le nullità sono stabiliti a pena di decadenza.

²⁶⁹ Neni 129. Pavlefshmëria relative - ... 2. Pavlefshmëria lidhur me aktet e hetimeve paraprake dhe me ato të kryera për sigurimin e provës duhet të kundërshtohet para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor.

3. Pavlefshmëria e vërtetuar në gjykim mund të kundërshtohet bashkë me ankimin kundër vendimit përfundimtar.

²⁷⁰ Art. 181. Nullità relative — ... 4. Le nullità verificatesi nel giudizio devono essere eccepite con l'impugnazione della relativa sentenza (theksimi ynë).

gjykimit në shkallë të parë, duhet të ngrihet së bashku me apelimin e vendimit përfundimtar. Nuk ka vend që ajo të ngrihet në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, në qoftë se pala nuk e ka ngritur në apel, pasi kështu do të rriteshin mundësitë për zgjatje, edhe të qëllimshme, të procesit nga pala e interesuar. Normimi i këtij rregulli nga ligjvënësi ynë thjesht si mundësi shkon në favor të krijimit të paqartësive apo dykuptimësive që bashkëshoqërojnë, në shumë raste, dispozitat e Kodit tonë lidhur me pavlefshmërinë e akteve procedurale penale.

Përsa i përket çastit të ngritjes së pavlefshmërive relative të krijuara në fazën e hetimeve paraprake, praktika gjyqësore e kolegjit penal të Gjykatës së Lartë është e qartë teksa orienton ngritjen e tyre para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Në rast se pala e interesuar nuk e ushtron këtë të drejtë brenda afatit, sikurse përmendëm më sipër, vepron parimi i humbjes së saj; kështu, pavlefshmëritë relative të shkaktuara në fazën e hetimeve paraprake nuk mund të ngrihen drejtpërsëdrejti me aktin e apelit, ngaqë duhej të ishin ngritur para se të fillonte shqyrtimi gjyqësor në shkallë të parë²⁷¹.

Por, krahas zgjidhjeve të drejta, vërejmë edhe raste kur jurisprudenca e kolegjit orienton zgjidhje të pasakta. Kështu, ndonëse pavlefshmëritë relative ngrihen vetëm me kërkesë të palës së interesuar, kolegji vlerëson se ato mund të ngrihen edhe kryesisht nga gjykata²⁷².

Si ilustrim zgjidhjesh të gabuara, kemi shkëputur edhe dy raste të tjera nga praktika gjyqësore e kolegjit penal: rasti i parë²⁷³ ka të bëjë me mosngritjen në kohë të pavlefshmërisë së

²⁷¹ Nr.00-2010-267 i Vendimit (140), datë 17.2.2010, Yzeiraj, etj.: “Kolegji gjen te pabazuar edhe pretendimin e ngritur nga mbrojtja se gjykata e apelit ka vepruar ne kundershtrim me ligjin duke mospranuar kerkesen per deklarimin e pavlefshem te disa akteve procedurale e pasi, sikurse arsyeton edhe gjykata e apelit ne vendimin e saj, ne baze te nenit 129/2 te K.Pr.Penale, pavlefshmeria lidhur me aktet e hetimeve paraprake duhet te kundershtohet para se te filloje shqyrtimi gjyqesor e me qe kjo kerkese nuk eshte realizuar para fillimit te shqyrtimit gjyqesor ne gjykatën e rrethit, nuk mund te behej ne gjykatën e apelit.”

²⁷² Nr.280 i Vendimit, datë 4.6.2008, Zeneli, etj.: “Vete proces-verbali i sigurimit te proves paraqet parregullsi procedurale, te cilat megjithese ne veshtrim te nenit 129 te K.Pr.Penale, nuk jane ngritur ne momentin e kerkuar me ligj nga ana e mbrotjes, nga ana e gjykates duheshin vleresuar ne raport me provat dhe aktet e tjera.”

²⁷³ Nr.663 i Vendimit, datë 5.10.2005, Kulla, i paracituar: “Në rekursin e paraqitur është pretenduar se akti i ekspertimit mbi të cilin janë mbështetur gjykatat në dhënien e vendimit (pretendim që është ngritur edhe në gjykatën e rrethit e të apelit) është absolutisht i pavlefshëm pasi vendimi për kryerjen e ekspertimit nuk i është njoftuar të pandehurit ose mbrojtësit të tij. Referuar akteve të administruara, rezulton i pa bazuar ky pretendim. Në bazë të nenit 129/2 të K.Pr.Penale, pretendimet për pavlefshmërinë e akteve të realizuara gjatë hetimit paraprak duhet të ngrihen para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes gjë që nuk është bërë e nuk jep të drejtën mbrojtësit apo të pandehurit të ketë pretendime në Gjykatën e Lartë, pasi mos kërkimi i pavlefshmërisë e bën aktin të ligjshëm” (theksimi sipas vendimit).

Arsyetimi nuk na duket i saktë, sepse mbrojtja pati mëtuar pavlefshmëri absolute që lidhej me mosnjoftimin e të pandehurit lidhur me një akt ekspertimi të urdhëruar nga akuza. Ndaj Kolegji, në radhë të parë, duhet të arsyetonte pse rasti në fjalë nuk përfshihet në rastet e pavlefshmërive absolute, mandej të përfundonte lidhur me bazueshmërinë e pretendimit.

aktit të ekspertimit të kryer në fazën e hetimeve, kurse rasti i dytë²⁷⁴ lidhet me kërkesën e mbrojtjes për deklarimin e pavlefshmërisë së disa akteve të hetimeve paraprake.

Pra, në jurisprudencën e kolegjit penal ka mungesë orientimi dhe paqartësi të palejueshme lidhur me një problem parimor: Kodi disiplinon afate vetëm kur palët synojnë të ngrejnë pavlefshmëri të natyrës relative. Kemi theksuar (*shih* § 2.2) që pavlefshmëritë absolute mund të ngrihen edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, pra, nuk ka kuptim që të flitet për afate të ngritjes së tyre. Si ilustrim i këtij përfundimi shërben vendimi i porsacituar Nr.663, datë 5.10.2005, por edhe vendimi i mëvonshëm Nr.533, datë 20.6.2007²⁷⁵. Mëtimeve të mbrojtjes për pavlefshmëri absolute të akteve nuk mund t'u jepet përgjigje duke referuar në nenin 129.2 të Kodit, i cili rregullon vetëm pavlefshmëritë e natyrës relative.

§ 3.4 Mekanizmi i korrigjimit të pavlefshmërive relative

Në paragrafin e mësipërm theksuam që mosngritja në kohë e pavlefshmërive relative shkakton humbjen e të drejtës së palës për t'i ngritur ato në një kohë të mëvonshme. Ky pohim, në fakt, është njëra nga format e korrigjimit të pavlefshmërive relative. Por, ligjvënësi ka parashikuar në nenin 130.1 dy raste të përgjithshme të korrigjimit të pavlefshmërive që veprojnë kur:

- 1) pala e interesuar heq dorë shprehimisht nga kundërshtimi i pavlefshmërisë ose i pranon pasojat që prodhon akti i pavlefshëm (*shkronja "a"*);
- 2) pala ka përfituar nga e drejta për ushtrimin e së cilës akti i pavlefshëm është urdhëruar më parë (*shkronja "b"*).

Instituti i korrigjimit të pavlefshmërisë së akteve, në doktrinë, përcaktohet si një "*figurë procedurale që formohet në mënyrë progresive*"²⁷⁶, sepse konstatimi fillestar i pavlefshmërisë pasohet nga një akt i mëvonshëm që, të çmuar së toku, e rregullojnë elementin e vesuar të aktit në atë mënyrë që pavlefshmëria të mos merret parasysh. Me t'u kryer korrigjimi, pasojat e aktit fillimisht të pavlefshëm bien, edhe për periudhën kohore para se të kryhej korrigjimi.

Sikurse kemi përmendur, Kodi vendos një kufizim të përgjithshëm lidhur me korrigjimin e pavlefshmërisë në nenin 128.2: "*Një akt i cilësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm.*" Ky kufizim nuk lejon korrigjimin e pavlefshmërisë absolute të akteve. E vetmja formë e korrigjimit të tyre është shterimi i procedurave gjyqësore që e bëjnë vendimin penal normalisht të pakthyeshëm²⁷⁷. Vetëm në raste të tilla, edhe në qoftë se janë kryer akte absolutisht të pavlefshme, ato nuk merren më parasysh, pra quhen të korrigjuara.

²⁷⁴ Nr.532 i Vendimit, datë 20.6.2007, Zefi, etj.: "Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i gjen të pambështetura pretendimet e të gjykuarit lidhur me pavlefshmëritë e akteve të hetimeve paraprake, pasi ato duheshin të ishin kundërshtuar para se të fillonte shqyrtimi gjyqësor, konform kërkesave të nenit 129/2 të K.Pr.Penale."

Theksojmë se mbrojtja ngriti pretendimin se vendimi i gjykatës së rrethit Shkodër ishte marrë në kushtet e pavlefshmërisë absolute, pasi ishin shkelur dispozitat në lidhje me kushtet për të qenë gjyqtar, neni 128, pika 1, shkronja a) i KPP.

²⁷⁵ Nr.533 i Vendimit, datë 20.6.2007, Kuqi, Halili: "Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë gjen të pambështetura pretendimet e ngritura në rekurs lidhur me pavlefshmërinë absolute (theksimi ynë) të një sërë aktesh procedurale të administruara gjatë hetimeve paraprake, pasi kjo kërkesë, sipas dispozitës së nenit 129/2 të K.Pr.Penale duhet të ishte ngritur përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor."

²⁷⁶ Di Geronimo Paolo, *vep. e cit.*, faqe 276.

²⁷⁷ Zakonisht kjo ndodh pas përfundimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë. Por, një sërë rastesh dëshmojnë se mund të ndërhyjë edhe Gjykata Kushtetuese dhe çështja të kthehet për rigjykim në Gjykatën e Lartë, pa përmendur rastet kur

Në vijim, po ndalemi pak më gjatë në dy rastet e përgjithshme të korrigjimit të pavlefshmërive relative të përmendura më sipër:

1) Rasti i parë përmban në vetvete dy nënraste: *i) heqjen dorë në mënyrë të shprehur nga kundërshtimi i pavlefshmërisë dhe ii) pranimin e pasojave të aktit*. Të dy nënrastet paraqitin rëndësi të posaçme në teorinë e përgjithshme të aktit procedural penal, por, për fat të keq, nuk kemi mundur të gjejmë raste ilustruese të praktikës sonë gjyqësore.

Në pikëpamje doktrinare nuk paraqit probleme rasti i heqjes dorë në mënyrë të shprehur nga kundërshtimi i aktit të pavlefshëm, sepse është e kuptueshme që vullneti i shprehur i palës e korrigjon fill aktin e vesuar nga pavlefshëmëri relative. Probleme të interpretimit paraqit rasti kur pala i pranon pasojat e aktit në mënyrë të heshtur, pra kur vullneti i saj deduktohet me *facta concludentia*. Shprehjen e vullnetit të heshtur të palës mund ta nxjerrim nga papajftueshmëria e synimit për të ngritur pavlefshëmëri relative, në raport me faktin e sjelljes së saj procedurale. Rast tipik mund të ishte ai i parashikuar nga neni 158 i Kodit. Të afërmeve të të pandehurit nuk u bëhet e njohur e drejta për të mos dëshmuar, fakt që e bën dëshminë e tyre të pavlefshme (neni 158.2). Por, në rast se dëshmia e pavlefshme shkon në favor të të pandehurit dhe ai e pranon përmbajtjen e saj (*pranim i shprehur*) ose nuk e kundërshton atë (*pranim me facta concludentia*), akti i dëshmisë paraprakisht i vesuar korrigjohet, duke u shndërruar në një akt plotësisht të vlefshëm.

Rastet e trajtuara më sipër, në doktrinë, njihen si rastet e korrigjimit të pavlefshmërisë me *pranimin e pasojave të aktit*.

2) Rasti i dytë i korrigjimit të përgjithshëm të pavlefshmërive, i parashikuar nga neni 130.1, shkronja “b”, paraqit vështirësi interpretimi për shkak të përkthimit të gabuar të dispozitës simotër të Kodit italian²⁷⁸. Shqipërimi i saktë, i cili sqaron njëherësh edhe kuptimin e kësaj dispozite, do të ishte: “*kur pala ka përfituar nga e drejta, ushtrimin e së cilës akti i pavlefshëm synon të mbrojë*”. Me fjalë të tjera, pala nuk mund të përfitojë për të ngritur një pavlefshëmëri të natyrës relative, kur të drejtën që synon të mbrojë dispozita e cënuar, në interes të palës, ajo ka mundur ta realizojë. Rast tipik do të ishte rasti i parashikuar nga neni 171, kur nuk respektohen rregullat për njohjen e personave: në qoftë se personi i thirrur për të bërë njohjen nuk e njeh të pandehurin, atëherë vetë rezultati i njohjes (*i pandehuri përfiton në rast mosnjohjeje*) është i vlefshëm dhe i korrigjon veset e procedurës së njohjes.

Rastet e korrigjimit të pavlefshmërisë, të parashikuara nga shkronja “b” e nenit 130.1, në doktrinë, njihen si rastet e korrigjimit për shkak të arritjes së qëllimit të aktit.

Përveç rasteve të përgjithshme të korrigjimit të pavlefshmërisë relative, të sipërtrajtuara, Kodi parashikon edhe *rastin e posaçëm* të korrigjimit të pavlefshmërisë së lajmërimeve, komunikimeve dhe njoftimeve. Parimisht, edhe ky rast mbështetet në nevojën e ekonomisë procesuale, e cila sigurohet me përmbushjen e qëllimit të aktit. Pavlefshëmëria e aktit të njoftimit (*ose mungesa e njoftimit*) korrigjohen në qoftë se pala e interesuar, paraqitet ose refuzon të paraqitet, pasi realizimi i qëllimit të aktit rezulton i përmbushur. Mund të diskutohet nëse ky rregull, i cili vlen për të gjitha palët në proces, a mund të vlejë edhe për të pandehurin, ngaqë më

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstaton cenim të procesit të rregullt ligjor dhe procesi lipset të rishikohet.

²⁷⁸ Art. 183. Sanatorie generali delle nullità — 1. Salvo che sia diversamente stabilito, le nullità sono sanate: ... b) se la parte si è avvalsa della facoltà al cui esercizio l'atto omesso o nullo è preordinato [nënvizimi ynë].

sipër theksuam se shkelja e rregullave për thirrjen e tij shkakton pavlefshmëri absolute, të pakorrigjueshme. Le të marrim rastin kur akti i thirrjes të tij është i pavlefshëm (p.sh., i është komunikuar një personi të papërshtatshëm), por i pandehuri është vënë në dijeni dhe paraqitet në gjyq. A do të kishte kuptim që procesi të shtyhej për pavlefshmëri absolute, të pakorrigjueshme të aktit të thirrjes? Sensi i së drejtës të thotë se ky do të ishte një veprim i pakuptimtë. Në fakt, neni 128.1, shkronja “c”, sanksionon me pavlefshmëri absolute rastin e mosthirrjes së të pandehurit në proces; në raste të tilla bëhet fjalë për mosekzistencën e aktit të thirrjes. Por, në praktikë, mund të vërehen raste kur akti i thirrjes kryhet, por përmbajtja e tij është me ves, që gjithsesi, nuk e pengon të pandehurin të marrë dijeni për përmbajtjen e tij. Natyrisht, këto raste duhet të përfshihen në sferën e pavlefshmërive relative, që korrigjohen me paraqitjen e të pandehurit në proces. Pas disa luhatjesh, këtë zgjidhje ka pranuar edhe jurisprudenca italiane, me anën e një vendimi unifikues të vitit 2004²⁷⁹.

§ 3.5 Zgjerimi i pavlefshmërisë së akteve dhe kuptimi i pavlefshmërisë së prejardhur. Ribërja e akteve dhe kthimi prapa i procedimit

Gjyqtari dhe prokurori (*ky i fundit gjatë hetimeve paraprake*) janë subjektet që ligji procedural penal ngarkon për të deklaruar pavlefshmërinë relative të akteve, kur nuk ka kufizime për ngritjen e saj dhe kur nuk kanë vepruar mekanizmat e korrigjimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, të cilat u trajtuan më sipër.

Ndërkohë, ligji procedural zgjidh edhe dy probleme të tjera thelbësore:

- 1) *Shtrirjen e pasojave të pavlefshmërisë;*
- 2) *Ribërjen e akteve të pavlefshme.*

§ 3.5.1 *Shtrirja e pasojave dhe pavlefshmëria e prejardhur* – Neni 131.1 i Kodit parashikon: “*Pavlefshmëria e një akti i bën të pavlefshme aktet e mëpasme që varen nga ai i deklaruar i pavlefshëm.*” Sipas këtij formulimi, që pavlefshmëria e një akti të shtrihet mbi një akt tjetër të procedimit duhet të plotësohen dy kushte:

i) Akti në rendin kronologjik procedural duhet të vijë pas aktit të vesuar, pra, mund të preken nga pavlefshmëria vetëm aktet që janë kryer në një kohë të mëvonshme nga akti i deklaruar i pavlefshëm;

ii) Akti duhet të varet nga akti i vesuar, në kuptimin logjik dhe juridik. Kështu, ka lidhje logjike midis arsytimit dhe vendimit gjyqësor, çka do të thotë se mungesa e arsytimit e bën vendimin të pavlefshëm. Nga ana tjetër, ky koncept përfshin edhe varësinë në kuptimin juridik të lidhjes së premisave me aktin e pavlefshëm. Vleftësimi i arrestimit në flagrancë nuk është premisë e domosdoshme për caktimin e një mase sigurimi. Janë akte që ndjekin njëri-tjetrin në kuptimin kronologjik, por jo në atë juridik, sepse nuk kanë varësi funksionale nga njëri-tjetri. Ndaj, pavlefshmëria e aktit të vleftësimit të arrestimit në flagrancë nuk i shtrin pasojat e tij edhe mbi vendimin për caktimin e masës së sigurimit, i cili mund të jetë plotësisht i vlefshëm.

²⁷⁹ Cass. Sez. Un., 27.10.2004, n.119, Palumbo: “*Në temën e njoftimit të thirrjes së të pandehurit, pavlefshmëria absolute e pakorrigjueshme e parashikuar nga neni 179 i KPP lidhet vetëm me rastin kur thirrja nuk është kryer, ose është kryer në formë të ndryshme nga ato që parashikon ligji dhe nuk mund të realizojë vënien në dijeni efektivisht të të pandehurit mbi përmbajtjen e aktit; kjo pavlefshmëri nuk ka të bëjë me rastet kur vërehet vetëm shkelje e rregullave për njoftimin e aktit, për të cilat zbatohet korrigjimi sipas nenit 184 të KPP.*”; tek Di Geronimo Paolo, *vep. e cit.*, faqe 296.

Me një fjalë, për zgjerimin e pavlefshmërisë ligji kërkon që akti i pavlefshëm të jetë kusht i domosdoshëm për kryerjen e aktit të mëpasëm që preket nga pavlefshmëria e prejudhur.

Vërejmë se praktika jonë gjyqësore gati nuk operon, në mënyrë të shprehur, me nocionin e pavlefshmërisë së prejudhur në vendimet e saj, duke parapëlqyer t'iu referohet dispozitave të veçanta për pavlefshmërinë e akteve procedurale penale. Në disa raste të shkëputura për ilustrim, vërejmë edhe mangësi të arsytimit që e lëkundin forcën argumentuese të vendimeve të kolegjit penal në këtë temë.

Në rastin që do të paraqitim në vijim²⁸⁰, mbrojtja mëtoi në të dy shkallët e gjykimit pavlefshmërinë e procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes (*pretendimi i saj për pavlefshmëri absolute nuk gjen asnjë mbështetje ligjore*), i cili ishte nënshkruar vetëm nga eksperti kriminalist, por nuk ishte nënshkruar nga oficeri i policisë gjyqësore dhe nga personat e pranishëm. Ky pretendim u pranua si i drejtë nga kolegji duke arsyetuar: "... I tërhiqet vëmendja gjykatave për mospranimin e kërkesës së mbrojtësit për deklarimin e pavlefshëm të procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, pavarësisht se sa mund të ndikonte ai për të arritur në fajësinë e të gjykuarit." Nga ana tjetër, kolegji çmoi se ky akt "... nuk ka patur asnjë lloj ndikimi në marrjen e vendimit." Padyshim një përfundim krejt i gabuar, që u shmanget rregullave procedurale për zgjerimin e pavlefshmërisë, pasi me aktin e këqyrjes është fiksuar gjetja e shtatë gëzhjojave, elemente të pashmangshme me vlerë provuese për të deklaruar të pandehurin fajtor për krimet e parashikuara nga nenet 78 dhe 278/II të Kodit Penal. Është tjetër diskutim, mandej, nëse pavlefshmëria e aktit, do të ndikonte në papërdorshmërinë e provës së siguruar përmes tij (*shih në vijim, § 4.4*).

Në planin e zgjerimit të pavlefshmërisë është interesante të studjohet edhe një vendim tjetër i kolegjit, i cili pati prishur vendimin e gjykatës së apelit për krime të rënda për faktin se prova e bashkëpunimit të bashkëtëpandehurve buronte prej procesverbalit të këqyrjes së tabulateve telefonike dhe të përpunimit të të dhënave të tyre me anën e programit "i2 Analyse"²⁸¹. Kolegji vërejti se, si procesverbali i këqyrjes, ashtu edhe fletët e stampuara me skemat e përpunimit të të dhënave, nuk ishin nënshkruar në çdo fletë nga oficeri i policisë gjyqësore. Në këtë kuptim, këto u konsideruan akte të pavlefshme që vesojnë edhe vendimin përfundimtar²⁸² (*ndonëse kolegji nuk iu referua nenit 131.1 të Kodit*).

²⁸⁰ Nr.483 i Vendimit, datë 13.9.2006, Bitanji.

²⁸¹ Software, i cili ndihmon që një numër i madh të dhënash, të grupohen sipas subjekteve që paraqitin interes për hetimin, duke ndërtuar një skemë të lidhjeve komunikuese ndërmjet tyre. Software-i shkurton jashtëzakonisht shumë kohën e përpunimit analitik të të dhënave dhe shërben si dokument pune.

²⁸² Nr.702 i Vendimit, datë 31.10.2007, Ahmetaj, etj.: "... oficeri i policisë gjyqësore A. Muçaj, ..., hartoi një akt të emërtuar "Procesverbal të këqyrjes së tabulateve të fluksit të bisedave telefonike të numrave mobil". Ky akt, së bashku edhe me fletët e tabulateve, ka shërbyer për gjykatën e apelit si një ndër provat për të argumentuar bashkëpunimin midis të gjykuarve në kryerjen e veprës penale për të cilën ata u deklaruan fajtorë dhe u dënuan prej saj.

Mirëpo gjatë verifikimit të pretendimit të mbrojtësve të të gjykuarve për parregullsinë, sipas tyre, të marrjes dhe administrimit të këtyre akteve si provë, u konstatua që ai qëndron dhe..., padrejtësisht nuk është marrë për bazë nga gjykata e apelit. Kolegji arriti në këtë përfundim, bazuar në dispozitat e neneve 151 e 117 të K.Pr.Penale, të cilat përmbajnë urdhërime qartësisht të shprehura, si për mënyrën se si procedohet për marrjen e provave nga organi procedues, ashtu edhe për nënshkrimet që duhet të shoqërojnë çdo lloj procesverbali, që shërben për dokumentimin e veprimeve procedurale të kryera prej tij. Ky element mungon, si në fletët e tabulateve telefonike, në fletën e paraqitjes grafike të bisedave telefonike të kryqëzuara midis të pandehurve, ashtu edhe në

Gjykojmë se ky është një rast i përkundërt me rastin e sipërshqyrtuar, sepse aktet në fjalë nuk kanë patur asnjë ndikim në marrjen e vendimit. Prova e bashkëpunimit nuk buronte nga akti i këqyrjes, as nga përpunimi i të dhënave (*ky përbën thjesht një dokument pune dhe jo akt procedural*), por nga prova dokumentare elektronike e tabulateve telefonike, të cilat ishin të fiksuara në mbartës magnetik (*compact disk*), më pas, edhe në fletë të printuara. Nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë logjike dhe juridike midis procesverbalit të këqyrjes dhe vendimit, në mënyrë që veset e të parit t'i transmetohen këtij të fundit. Lidhja e vetme mbetet ajo midis dokumentit elektronik - provë e fakteve historike dhe vendimit të fajësisë të gjykatës së apelit për krime të rënda, në gjykimin tonë plotësisht i ligjshëm.

Rasti i mësipërm ka ngjashmëri me një rast të vitit 2009, kur mungesa e nënshkrimit të procesverbalit të transkriptimit të përgjimit të bisedave, u korrigjua duke dëgjuar drejtpërsëdrejti bisedën e përgjuar në sallën e gjyqit, zgjidhje me të cilën pajtohemi plotësisht²⁸³.

Praktika gjyqësore propozon për diskutim një larmi rastesh lidhur me kuptimin dhe mënyrën e zbatimit të rregullit që normon neni 131 i Kodit. Gjykata e Lartë ka pranuar konkluzionin kategorik se pavlefshmëria absolute e një seance, për shkak të numrit të papërshtatshëm të gjyqtarëve që formojnë kolegjin²⁸⁴, e bën të pavlefshëm edhe vendimin e saj. Lidhja kohore egziston, por nga teksti i vendimit nuk kuptohet lidhja funksionale mes dy akteve. Nëse gjatë seancës së pavlefshme nuk është kryer asnjë akt, por b.fj., vetëm është shtyrë gjykimi duke caktuar seancën e radhës, nuk do të kishim pavlefshmëri të prejardhur që veson vendimin përfundimtar, pasi mungon lidhja përmbajtësore juridike mes akteve. Pra, zgjidhja duhet parë rast pas rasti dhe jo në këndvështrimin kategorik që orienton kolegji penal, jashtë studimit të lidhjes funksionale juridike.

Në rastin vijues lidhja juridike qëndron²⁸⁵. Njëra nga seancat e gjykimit në shkallë të parë pranohet se ka qenë akt absolutisht i pavlefshëm, për shkak të zëvendësimit të mbrojtësit të

proçesverbalin e këqyrjes së fluksit të tyre, hartuar nga oficeri i policisë gjyqësore, veprime këto, të cilat duhej të kryhen në përputhje me kërkesat e ligjit, gjatë rigjyqimit.”

²⁸³ Nr.147 i Vendimit, datë 1.4.2009, Brushtulli: “Eshte e vertete se proçes verbaleve te transkriptimit te bisedave te pergjuara ndermjet deshmitareve N.B. dhe B.B. (e para gruaja dhe tjetra kunata e te pandehurit P.) dhe N.B. e A.Z., ne datat 06 - 07.10.2002 ne ambientet e Komisarariatit te Policise Shkoder, i mungon neneshkrimi i oficerit te policise gjyqesore qe i ka mbajtur, por Gjykata e Apelit Shkoder, duke konstatuar kete fakt, ne pranine e paleve, ka realizuar degjimin ne salle te bisedave te mesiperme.”

²⁸⁴ Nr.00-2010-1222 i Vendimi (809), datë 15.9.2010, Meta: “Nga studimi i akteve të dosjes gjyqësore, Kolegji Penal ka konstatuar se në përbërje të trupit gjykues në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka gjykuar çështjen në ngarkim të të gjykuarit Meta, kanë qënë gjyqtarët Shefkie Demiraj (kryesuesja), Fehmi Petku e Ridvan Hado (anëtarë). Por në seancën gjyqësore të datës 22.05.2007, çështja rezultoi se është gjykuar me një gjyqtar, vetëm nga kryesuesja, pasqyruar në faqe 120 të dosjes gjyqësore. Për pasojë kjo seancë gjyqësore është absolutisht e pavlefshme, në bazë të nenit 128, pika “1”, gërma “a” të K.Pr.Penale, pasi nuk janë respektuar rregullat procedurale në lidhje me numrin e gjyqtarëve të domosdoshëm për formimin e Kolegjit në zbatim të nenit 13, pika “3” të K.Pr.Penale. Pavlefshmëria e aktit që pasqyron seancën gjyqësore, në mbështetje të nenit 131/1 të K.Pr.Penale, bën të pavlefshëm të gjithë veprimet e mëpasshme, pra të gjithë gjykimin e zhvilluar në gjykatën e rrethit dhe vendimin e kësaj gjykate.”

²⁸⁵ Nr.00-2010-531 i Vendimit (367), datë 21.4.2010, Kroji: “Vazhdimi i seancës gjyqësore të datës 28.6.2006 nga ana e gjykatës së shkallës së parë në kushtet kur i pandehuri ka qënë në mungesë, kur mbrojtësi i tij është zëvendësuar në kundërshtim me rregullat procedurale nga një mbrojtës i caktuar kryesisht, e bëjnë këtë seancë një akt absolutisht të pavlefshëm, pasi sipas nenit 128, pika 1/c të Kodit të Proçedurës Penale, i cili në mënyrë taksative parashikon se akti është absolutisht i pavlefshëm kur nuk respektohen dispozitat “... për thirrjen e të pandehurit ose praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme...”.

zgjedhur me një mbrojtës kryesisht, në kundërshtim me rregullat. Në këtë seancë u pyet një dëshmitar. Gjykata e apelit synoi ta korrigjonte pavlefshmërinë, duke ripyetur dëshmitarin. Kjo zgjidhje u rrëzua nga kolegji penal, sipas mendimit tonë me të drejtë, ngaqë prova e marrë ka lidhje juridike me vendimin e dhënë në shkallë të parë, i cili, si akt i prejardhur, ka qenë absolutisht i pavlefshëm dhe nuk mund të korrigjohej nga apeli.

Një rast interesant i praktikës gjyqësore të kolegjit, sqaron raportin mes akuzës penale dhe padisë civile në procesin penal dhe pamundësisë së kësaj të fundit që pavlefshmëritë e saj t'i transferojë, duke diktuar edhe rigjykimin e akuzës penale. Me dy fjalë, rasti mund të përmblihet si vijon: gjatë gjykimit të padisë civile në procesin penal, gjykata e rrethit gjyqësor është shprehur vetëm për një kërkim të padisë civile, duke ometuar për dy kërkimet e tjera. Nëse ato do të shqyrtoheshin, për shkak të rritjes së vlerës së padisë, çështja nuk duhej të gjykohej me një gjyqtar, sikundër u gjykua, por me trup gjykues. Duke konstatuar këtë mangësi, gjykata e apelit e prishi vendimin dhe e ktheu çështjen për rigjykim, ndërkohë që nuk u konstatua asnjë pavlefshmëri në gjykimin e akuzës penale. Gjykata e Lartë, me të drejtë, nuk e mbështeti këtë zgjidhje, duke theksuar parimin e autonomisë së dy gjykimeve brenda të njëjtit proces, që do të thotë se veset e procesit civil nuk mund t'i vishen edhe procesit penal, në formën e një pavlefshmërie të prejardhur²⁸⁶.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se edhe përsëritja e pjeshme e shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së apelit, duke pyetur dëshmitarin Z.P., nuk mundet të riparonte pavlefshmërinë e seancës së datës 28.06.2006 mbasi në kuptim të nenit 131/1 të Kodit të Procedurës Penale "...pavlefshmeria absolute e një akti i bën të pavlefshme aktet e mëpasme...", siç është edhe vetë vendimi përfundimtar i gjykatës së shkallës së parë. Për këtë arsye, gjykata e apelit, në detyrim të parashikimeve të nenit 428/ç të Kodit të Procedurës Penale, ka qënë e detyruar të vendoste prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë duke e dërguar çështjen për rigjykin në po atë gjykatë."

²⁸⁶ Nr.00-2012-1117 i Vendimit (224), datë 12.09.2012, Shtëpani, etj.: "16. Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar mundësinë e gjykimit njëkohësisht brenda procesit penal dhe të padisë civile nga personi që pretendon se i është shkaktuar dëm nga vepra penale. Në këtë rast, kur padia civile pranohet, ajo do të shqyrtohet së bashku me akuzën penale. Pra në këtë rast do të kemi shkrirjen në të njëjtin gjykim të dy proceseve.

17. Megjithëse shqyrtimi është i përbashkët secili prej tyre ruan karakteristikat e veçanta sipas dispozitave që i rregullojnë, por për shkak të elementeve të përbashkët bashkohen në një procedim (Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr.284, datë 06.10.2000).

18. Konkluzioni për shkelje në shqyrtimin e padisë civile nuk mund të kushtëzojë ecurinë e procesit për aq kohë sa nuk ka shkelje të cilat çojnë në pavlefshmërinë e gjykimit penal. Gjykata e apelit për një shkelje të vërejtur në padinë civile në mënyrë të gabuar ka bërë të pavlefshëm të gjithë procesin, duke iu referuar nenit 428, gërma "ç" të K.Pr.Penale.

19. Pavarësisht se kemi një shkrirje të dy proceseve të natyrave të ndryshme, në vetvete ato ruajnë autonominë e gjykimit. Kjo autonomi konsiston në mundësinë e ndarjeve e proceseve dhe gjykimin më vete duke i dërguar aktet e padisë gjykatës civile. Parregullsitë që konstatohen në gjykimin e padisë civile nuk e kondicionojnë dhe nuk e bëjnë të parregullt procesin penal për aq kohë sa nuk vërehen shkelje që e bëjnë atë të pavlefshëm sipas K.Pr.Penale...

20. Gjykata e apelit duke mos respektuar parimin e autonomisë së proceseve për shkelje që kanë të bëjnë me padinë civile në interpretim të gabuar të ligjit pa marrë në shqyrtim nëse procesi penal ka patur shkelje ka prishur të gjithë vendimin, duke dhënë një vendim të gabuar."

§ 3.5.2 *Ribërja e akteve të pavlefshme. Regresi i procedimit* – Në rastet kur deklarohet ekzistenca e pavlefshmërive relative dhe aktet e vesuara prej saj, shtrohet problemi i rregullimit të pasojave që rrjedhin nga deklarimi i pavlefshmërisë. Neni 131.2 i Kodit normon: “Gjykata që deklaron pavlefshmërinë e një akti udhëron përsëritjen e tij, kur është e nevojshme dhe e mundshme, duke ia ngarkuar shpenzimet atij që ka shkaktuar pavlefshmërinë, me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.”

Sikurse vërehet nga teksti i normës, jo gjithmonë mund të ketë vend për përsëritjen e akteve të pavlefshme. *Së pari*, duhet të jetë e nevojshme që kjo të bëhet, në interes të dhënies së drejtësisë penale dhe, *së dyti*, duhet që ribërja të jetë e mundshme. Nuk është e mundshme që të ribëhen të ashtuquajturat akte të papërsëritshme (*siç mund të ishte rasti i procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, në vendimin e kolegjit që cituam për ilustrim*), por është plotësisht e mundshme rimarrja e një dëshmie, e deklaruar e pavlefshme për shkak të shkeljes së rregullave për paraqitjen dhe betimin e dëshmitarit (*neni 360*).

Domosdoshmëria e ribërjes së akteve procedurale të deklaruara të pavlefshme, kur kjo është e mundshme, shkakton pasoja të rënda për gjithë ecurinë e procedimit, sidomos kur ajo konstatohet gjatë gjykimit në apel ose në Gjykatën e Lartë. Në raste të tilla rrezikohet shumë mundësia për përmbylljen e procesit penal brenda një afati të arsyeshëm, pasi mund të shtrohet problemi i rikthimit prapa të tij në shkallët e mëparshme. Si rregull, Gjykata e Lartë kur prish një vendim ia dërgon aktet gjykatës që ka dhënë vendimin e prishur (*neni 443.1*). Një pushtet i gjerë për kthimin prapa të procedimit i është dhënë edhe gjykatës së apelit (*neni 428.1, shkronja “ç”*), por vetëm në rastet taksative që lidhen me pavlefshmëri absolute, kur parashikohet pavlefshmëria e vendimit, apo kur shkelen dispozitat lidhur me akuzat e reja. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë ka qenë shumë e kujdesshme në drejtim të kufizimit të gjykatave të apelit për rikthimin e procedimit në shkallë të parë, edhe kur nuk kanë qenë arsyet për ta bërë këtë, me arsyetimin se gjykata e apelit, kur është rasti, vepron si gjykatë fakti²⁸⁷.

Lidhur me temën e ribërjes së akteve dhe rikthimit të procedimit në gjendjen procesuale ku është shkaktuar pavlefshmëria e aktit, kemi veçuar për ilustrim një rast interesant të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë²⁸⁸. Ndër shkeljet e tjera, kolegji ka konstatuar edhe pavlefshmërinë e vendimit për pranimin e kërkesës për sigurimin e provës dhe “... për pasojë edhe të procesverbalit të sigurimit të provës si akt i pasardhur nga një akt tjetër i pavlefshëm.” Përfundimisht, kolegji ka vendosur rimarrjen e dëshmisë së të dëmtuarës (*pra, ribërjen e aktit të pavlefshëm*), duke e rikthyer procedimin në shkallë të parë, me këtë arsyetim: “... me të drejtë gjykatat kanë konstatuar pavlefshmërinë e procesverbalit të sigurimit të provës, por ato nuk kanë patur parasysh kërkesën e nenit 131.2 të K.Pr.Penale sipas të cilit “Gjykata që deklaron pavlefshmërinë e një akti, urdhëron përsëritjen e tij kur është e nevojshme dhe e mundshme ...”

§ 3.6 Disa probleme të praktikës gjyqësore për pavlefshmërinë relative

Në vijim, e shohim të udhës të ndalemi tek disa probleme të posaçme të praktikës gjyqësore lidhur me pavlefshmërinë e procesverbalit, të vendimit gjyqësor dhe të shtrirjes së konceptit në temën e masave të sigurimit personal dhe në gjykimin e shkurtuar.

§ 3.6.1 *Pavlefshmëria e procesverbalit*. – Procesverbali, si formë e dokumentimit të akteve në procedurën penale, sidomos procesverbali i seancës gjyqësore, është një akt i rëndësishëm i

²⁸⁷ Shih vendimin nr.764, datë 19.12.2007, Spahiu.

²⁸⁸ Nr.238 i Vendimit, datë 26.04.2006, Hoxhallari.

procesit: ai shërben për verifikimin e rregullsisë së kryerjes së akteve, kontrollin e tyre nga palët, gjykata dhe të tretët, si dhe shërben si bazë për vendimmarrjen e organit që procedon. Kodi i Procedurës Penale parashikon pavlefshmërinë e tij në dy raste (neni 122.1):

- i) kur ka dyshime rreth personave që kanë marrë pjesë;
- ii) kur mungon nënshkrimi i nëpunësit që e ka përpiluar.

Sanksioni i pavlefshmërisë në rastet e mësipërme është i natyrës relative. Praktika gjyqësore ka pranuar, nisur nga parimi i taksativitetit të pavlefshmërive relative, se mospasqyrimi në procesverbal i tekstit të plotë të formulës së betimit nuk përbën shkak për pavlefshmëri të procesverbalit; gjithashtu, mospasqyrimi i emrit të sekretares gjyqësore, madje edhe i emrit të gjyqtarit në hyrje të tij, kur rezulton se ata e kanë nënshkruar procesverbalin, nuk mund të shkaktojë pavlefshmëri për shkak se nuk mund të ketë dyshime lidhur me personat që kanë marrë pjesë, përderisa provohet vendosja e nënshkrimit prej tyre²⁸⁹.

Kolegji penal, ka pranuar pavlefshmërinë e procesverbalit në rastet kur ai nuk është nënshkruar në çdo fletë nga nëpunësi që e ka mbajtur²⁹⁰; nisur nga parimi i taksativitetit, pavlefshmëria nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë në rastet kur mungon vistimi i kryetarit në çdo fletë të tij²⁹¹.

²⁸⁹ Nr.00-2011-549 i Vendimit (79), datë 8.6.2011, Dushku, etj.: “Në gjendjen që janë aktet, Kolegji vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë Mat dhe sekretarja gjyqësore në këtë proces gjyqësor kanë përmbushur detyrimin e tyre sipas nenit 360/1/2 i K.Pr.Penale, duke i bërë të ditur secilit dëshmitari detyrimin për të thënë të vërtetën, po kështu ju është lexuar edhe formula e betimit pasi vetë shprehja “Dëshmitari ... si u betua tha:...”, të çon në këtë përfundim. Kjo nuk e bën të pavlefshëm veprimin e kryer në kuptim të paragrafit “3” të nenit 360 të Kodit të Procedurës Penale, për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet shkelje e rëndë procedurale. Pasqyrimi në këtë mënyrë nga ana e sekretares gjyqësore i këtij momenti procedural në procesverbalin e seancës gjyqësore nga ana e këtij Kolegji konsiderohet një mangësi e sekretarit gjyqësor, e cila duhet të mbahet parasysht dhe mos të përsëritet në veprimtarinë e përditëshme të sekretarisë gjyqësore, por, nuk mund të përbëjë shkelje të rëndë procedurale as shkak për prishjen e vendimit.

Shkeljen tjetër procedurale të evidentuar nga ana e gjykatës së apelit, lidhur me mos pasqyrtimin e sekretares gjyqësore në hyrje të procesverbalit gjyqësor apo në një rast të kryesuesit të seancës, Kolegji e vlerëson jo si të tillë që mund të passjellë pavlefshmëri të tij, pasi konstatohet se në përfundim të seancave gjyqësore përkatëse këto procesverbale janë nënshkruar rregullisht si nga ana e sekretares gjyqësore dhe nga kryesuesi i seancës gjyqësore.”

²⁹⁰ Nr.00-2010-818 i Vendimit (246), datë 17.3.2010, Qato: “Gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Vlorë është konstatuar se procesverbali gjyqësor, i mbajtur në gjykatën e rrethit, nuk ishte nënshkruar në çdo fletë nga personi që e kishte mbajtur e për pasojë, meqë ai sipas nenit 122 të K.Pr.Penale është i pavlefshëm, me vendimin nr.85, datë 27.02.2007 është vendosur prishja e vendimit të gjykatës së rrethit e dërgimi i akteve për rishqyrtim po asaj gjykate.”

²⁹¹ Nr.00-2013-665 i Vendimit (70), datë 27.2.13, Kelmendi, i paracituar, shih § 2.1: “... sipas vendimit të gjykatës së apelit janë lejuar shkelje në lidhje me proces-verbale të seancave gjyqësore sepse ato nuk janë mbajtur në formën e kërkuar nga ligji, pasi fletët e proces-verbalit janë nënshkruar vetëm nga sekretarja e nuk janë vistuar një për një nga kryetari i seancës, gjë që sipas nenit 345/2 të K.Pr.Penale është kusht për vlefshmërinë e tij.

... Gjykata e apelit, duke mos pasur parasysht e interpretuar në mënyrë të gabuar kërkesat procedurale, gjen të pavlefshëm proces-verbalin me arsyetimin se ai nuk është nënshkruar në çdo fletë nga kryetari i seancës, neni 117 përcakton qartë se proces-verbali nënshkruhet në çdo fletë në përfundim të seancës nga personi që e ka mbajtur dhe nga ai që procedon (kryetari i seancës), por pavlefshmërinë e tij e përcakton neni 122 i K.Pr.Penale, sipas të cilit procesverbali është i pavlefshëm kur mungon nënshkrimi i personit që e ka mbajtur dhe jo kur ai nuk është nënshkruar në çdo fletë nga kryetari i seancës siç pranon gjykata e apelit...”

Vlen të diskutohet edhe një rast, i vitit 2013, kur kolegji penal ka dhënë zgjidhje të drejtë, por arsyetimi na duket i gabuar: gjykata e apelit Vlorë pati prishur vendimin e shkallës së parë, sepse në procesverbalin e njëjës nga seancat mungonte nënshkrimi i gjyqtarit, vendim që u çmua i padrejtë nga Gjykata e Lartë, me arsyetimin se kjo seancë nuk ka prodhuar pavlefshmëri, pasi nuk u krye asnjë akt, përveçse u caktua data e seancës pasardhëse²⁹². Zgjidhja qëndron, por arsyetimi duhet të ishte krejt i ndryshëm: *së pari*, në raste të tilla Kodi nuk i sanksionon me pavlefshmëri, *së dyti*, kjo pavlefshmëri nuk mund të jetë absolute, dhe *e treta*, edhe sikur vërtet të ekzistonte pavlefshmëria, duke qenë se nuk është absolute, ajo nuk mund të konstatohej nga gjykata, përderisa nuk e pati ngritur pala e interesuar.

§ 3.6.2 *Pavlefshmëria në temën e masave të sigurimit personal*. – Në temën e masave të sigurimit personal, kolegji penal i ka qëndruar zgjidhjes, sipas gjykimit tonë të gabuar, se në gjykime të kësaj natyre nuk mund të ngrihen pretendime për pavlefshmëri të akteve apo të provave²⁹³. Kolegji nuk arsyeton pse pavlefshmëria duhet ngritur vetëm në fazën e shqyrtimit gjyqësor të çështjes (*sqarojmë se në rastin ilustrues pretendimi i mbrojtjes për pavlefshmëri absolute të paraqitjes për njohje, gjithsesi, është i gabuar; pavlefshmëria është vetëm relative*). Për të caktuar një masë sigurimi personal ligji normon kritere; ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, të mbështetur në prova, se i hetuari e ka kryer veprën penale (*neni 228.1 i KPP*), është kusht pa të cilin nuk mund të vendoset masë sigurimi personal. Nëse akti i njohjes do të ishte i pavlefshëm, atëherë do të mungonte prova që buronte prej tij dhe, nëse akuza nuk do të ishte në gjendje të paraqiste prova të tjera, mund të vihej në dyshim vetë ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm. Pra, nuk gjejmë arsye pse gjatë shqyrtimit të masave të sigurimit gjykata nuk duhet të çmojë vlefshmërinë e akteve dhe përdorshmërinë e provave që përligjin ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, sikundër orienton Kolegji.

Një problem të rëndësishëm ka shtruar për diskutim një vendim i kolegjit penal i vitit 2011. Po përmbledhim me dy fjalë rastin: gjykata e rrethit gjyqësor Kurbin pati vendosur masën e sigurimit personal “arrest në burg” ndaj një të mituri dhe, duke konstatuar moskompetencën e saj lëndore, ia pati përcjellë aktet gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë. Mbrojtja u ankua në gjykatën e apelit Tiranë, e cila e ndryshoi masën, duke vendosur “arrest në shtëpi”. Rreth një muaj pas vendimit të apelit, për shkak të vonësive burokratike në lëvizjen e fashikullit, çështja u shqyrtua

²⁹² Nr.00-2013-988 i Vendimit (194), datë 12.06.2013, Telushi, etj.: “30. Konstatimi që ka bërë gjykata e apelit se “proces-verbali i seancës gjyqësore të datës 23.07.2009 është akt absolutisht i pavlefshëm. Atij akti i mungon nënshkrimi i gjyqtarit...” gjendet i pabazuar nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si shkak për prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Në seancën e datës 23.07.2009 rezultoi që nuk është kryer asnjë veprim procedural që do të pas sillte pavlefshmërinë e gjithë procesit, por vetëm është vendosur të shtyhet seanca për datën 03.09.2009, ora 10.00.”

²⁹³ Nr.309 i Vendimit, datë 17.12.2008, Sefa: “Te dyja gjykatat, me të drejte, duke konstatuar se ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova se i pandehuri mund ta ketë kryer veprën për të cilën akuzohet, dhe pse ky dyshim bazohet në një proces verbal për paraqitjen për njohje që nga mbrojtja pretendohet se është absolutisht i pavlefshëm, kanë pranuar kërkesën e prokurorisë për caktimin ndaj tij të një mase sigurimi personal, pasi janë kushtet që parashikon dispozita e nenit 228/1 të K.Pr.Penale.

... Është hetimi dhe gjykimi në vazhdim të çështjes, i cili do t'i japë zgjidhje pretendimeve të mbrojtjes lidhur me vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e provave.”

nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, e cila në bazë të nenit 88 të KPP²⁹⁴, caktoi, gjithashtu, “arrest në shtëpi”. Pas shqyrtimit të rekursit të prokurorit kundër vendimit të gjykatës së apelit, kolegji penal i Gjykatës së Lartë vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe pushimin e çështjes, duke orientuar rregullin vijues: kundër vendimit për caktimin e masës së sigurimit nga gjykata jokompetente në lëndë nuk mund të ushtrohet apel, pasi kjo mund të sillte dy gjykime paralele dhe, në rast vendimesh të ndryshme, cënim të parimit të ligjshmërisë²⁹⁵.

²⁹⁴ Neni 88. Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata jokompetente - 1. Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata, e cila në të njëjtën kohë ose më vonë shpallet jokompetente për çdo lloj shkak, i humbasin efektet, në qoftë se brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit.

²⁹⁵ Nr.00-2011-859 i Vendimit (125), datë 6.10.2011, Aliu, *i paracituar*: “23. Vendimi i gjykatës kompetente nuk është një vendim formal i cili ligjëron masën e vendosur nga gjykata, por një shqyrtim gjyqësor i hollësishëm i nevojave të sigurimit dhe një rivlerësim i kushteve dhe kriterëve të zbatuara për caktimin e masës së sigurimit nga gjykata jokompetente. **Ky interpretim të çon në konkluzionin se vendimi i gjykatës kompetente për ligjërimin e masës së sigurimit do të konsiderohet vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit për efekt të së drejtës së ankimit në bazë të nenit 249 të K.Pr.Penale, ndërkohë që ndaj vendimit për caktimin e masës së sigurimit nga gjykata jokompetente nuk lejohet ankimi.**

24. Në bazë të akteve të fashikullit të gjykimit rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin me vendimin nr.317/28, datë 01.04.2011 në kushtet e “urgjencës” ka vendosur ndaj personit nën hetim A.A. masën e sigurimit “arrest në burg” dhe njëkohësisht ka konstatuar moskompetencën e saj lëndore duke ia dërguar aktet seksionit për të miturit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykatë kompetente. Njëkohësisht në të njëjtin vendim gjykata i ka dhënë të drejtën e ankimit palëve në Gjykatën e Apelit Tiranë.

25. Gjykata e Apelit Tiranë, pa pritur që më parë të shprehet gjykata kompetente për ligjërimin në bazë të nenit 88 të K.Pr.Penale, me vendimin nr.237, datë 21.04.2011 ka marrë në shqyrtim ankimin e personit nën hetim A.A. duke ndryshuar masën e sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest në shtëpi”. Ndërkohë në bazë të informacionit të paraqitur nga prokurori pranë Prokurorisë së Përgjithshme në seancë gjyqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.633 akti, datë 17.05.2011, në bazë të nenit 88 të K.Pr.Penale si gjykata kompetente, mbasi ka marrë aktet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka vendosur caktimin si masë siguri “arrest në shtëpi” për personin nën hetim të miturin A.A.

26. Kolegji Penal, për sa arsyeton më sipër në vendim, konstaton se në mënyrë të gabuar gjykata e shkallës së parë i ka dhënë të drejtën e ankimit ndaj masës së sigurimit të vendosur nga gjykata jokompetente për një vendim ndaj të cilit nuk lejohet ankimi, duke i hapur rrugë një procesi gjyqësor të pavlefshëm në gjykatën e apelit. Gjykata e apelit mund ta marrë në shqyrtim ankimin e të pandehurit vetëm mbasi gjykata kompetente të shprehet në lidhje me masën e sigurimit. Në mënyrën se si ka proceduar gjykata e apelit në kundërshtim me ligjin ka krijuar konfuzion, duke lejuar që karakteri i përkohshëm i masës së vendosur nga gjykata jokompetente të ligjërohet prej saj. Ky qëndrim në lidhje me respektimin nga gjykata të kompetencës dhe të pasojave në procesin penal është analizuar dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (vendimi nr.11, datë 23.04.2009)...

27. Në rast se do ta interpretonim al contrario, ankimi ndaj vendimit të gjykatës jokompetente për caktim të masës së sigurimit do të sillte paralelisht dy gjykime në gjykatën e apelit dhe mundësinë e dy vendimeve kontradiktore ç’ka do të cënonte parimin e ligjshmërisë.

28. Në kushtet kur gjykimi në gjykatën e apelit është nul, për të pandehurin A.A. ngelet në fuqi masa e sigurimit “arrest në shtëpi” e vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.633 akti, datë 17.05.2011, si gjykatë kompetente.” [theksimet sipas vendimit].

Arsyetimi nuk na duket bindës dhe kjo praktikë nuk besojmë se propozon ndonjë zgjidhje që duhet të pranohet, për disa arsye: ligji procedural nuk vendos ndonjë normë penguese për apelimin e vendimit të gjykatës, të vetëdeklaruar më pas jokompetente në caktimin e masës së sigurimit. Po ashtu, vendimi për shpalljen e moskompetencës nuk është vendim i pakontrollueshëm; gjykata e apelit ka të drejtë ta shfuqizojë atë nëse nuk e gjen në përputhje me ligjin, ndaj kjo instancë kontrolli nuk mund të shmanget. Situata e konfliktit të kompetencave që mëton të zgjidhë kolegji penal është një situatë imagjinare, sepse procesi është nën kontrollin e palëve: pala e interesuar ka mundësi që të kundërshtojë para gjykatës faktin e dy gjykimeve paralele. Ka dhe një argument praktik: në rastin konkret, procedura sipas nenit 88 të KPP, është kryer nga gjykata kompetente gati dy muaj pas caktimit të masës së sigurimit nga gjykata e vetëdeklaruar si jokompetente. Personi nën masë siguri nuk mund të qëndrojë për një kohë kaq të gjatë në gjendje pasigurie për lirinë e tij. Për më tepër, në rastin që po diskutojmë, gjykata e apelit ishte gjykatë kompetente, ishte sakaq edhe gjykatë më e lartë, ndaj gjykimi në shkallë të parë, në zbatim të nenit 88, mbetet një gjykim pa lëndë dhe duhej të pushohej.

§ 3.6.3 *Pavlefshmëria e vendimit.* – Më lart theksuam se pavlefshmëritë relative i nënshtrohen parimit të taksativitetit. Kjo zgjedhje parimore e ligjvënësit nuk i përjashton nga ky regjim edhe rastet e pavlefshmërisë së vendimit gjyqësor, i cili nuk përfshihet ndër rastet e pavlefshmërive absolute. Natyrisht, gjykata e apelit ka të drejtë të prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe t'i kthejë aktet për rishqyrtim “*në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit*” (neni 428.1, shkronja “ç”), por kjo nuk i jep veseve të vendimit natyrë absolute. Vërejmë se Gjykata e Lartë ka të drejtë të vendosë prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim kur “*vendimi është i pavlefshëm ...*” (neni 442.1, shkronja “b”), çka do të thotë se pavlefshmëria e vendimit mund të korrigjohet nga Gjykata e Lartë, bie fjala, në rastin e mungesës së arsyesimit.

Ky regjim juridik i qartë gjykojmë se u deformua me ndryshimet e pastudjuara që propozoi ligji nr.8813, datë 13.6.2002, i cili i zgjeroi rastet e rekursit edhe për “*për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit*” (neni 4232.1, shkronja “c”). Ndryshimi i mësipërm jo vetëm kalli në sistem një term të papërcaktuar (“*shkelje procedurale*”) të huazuar nga sistemi procedural i shfuqizuar, por i hapi rrugën lejimit të shqyrtimit në Gjykatën e Lartë të çdo shkeljeje të procedurës, mjaft që të demonstrohej lidhja e saj me vendimmarrjen e gjykatës. Kjo ndërhyrje, praktikisht, e bëri të paefektshme normën e parashikuar nga shkronja “b” e së njëjtës dispozitë, e cila kufizon rastet e rekursit vetëm në rastet e pavlefshmërive absolute.

Natyrisht, koncepti “*shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit*” ka natyrë të përgjithshme dhe e përfshin në vetvete konceptin “*pavlefshëmri e vendimit*”; ndaj themi se ndryshimet e vitit 2002 i zgjeruan tejmasë mundësitë për rekurs para Gjykatës së Lartë, me pasojë në drejtim të kohëzgjatjes së procesit penal tej afatit të arsyeshëm. Për këtë arsye, reforma aktuale e procedurës penale duhet ta prekë detyrimisht këtë pikë delikate, me synimin e qartë që Gjykata e Lartë të rikthehet në rolin e saj natyror, pa u investuar në çështje të procedurës që nuk prekin interesa të qenësishme të procesit.

Rasti që do të paraqesim në vijim, ilustron situatën se, pavarësisht nga fakti që pavlefshmëria e vendimit gjyqësor ka natyrë relative, ajo është çështje shumë e rëndësishme e ligjit, që duhet të shihet kryesisht nga gjykata dhe që përbën shkak për prishjen e vendimit. Gjykata e Lartë ka të drejtë ta zgjidhë çështjen pa e kthyer për rishqyrtim sa herë që konstaton se “*vendimi është i pavlefshëm për rastet e parashikuara në këtë Kod*” (neni 442.1, shkronja b). Rasti paraqitet si vijon: në rekursin e paraqitur ndaj vendimit të gjykatës së apelit Shkodër,

mbrojtja e të gjykuarit, që u gjend fajtor për krimin e parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal, ngriti pretendime për pavlefshmëri absolute, lidhur me papajtueshmëri të gjyqtarëve për shkak të pjesëmarrjes në procedim (*neni 15 i KPP*), të cilat kolegji penal i rrëzoi si të pathemelta. Por, ai kolegji i prishi vendimet e gjykatave më të ulta dhe e ktheu çështjen për rigjykim në shkallë të parë, për mungesë arsyetimi të vendimit²⁹⁶.

Pra, në rastin e paraqitur kemi të bëjmë me një pavlefshmëri të natyrës relative, e cila nuk u ngrit nga pala e interesuar, fakt që nuk e pengoi kolegjin që ta konstatonte atë kryesisht. Por, nuk mund të pajtohem me disponimin e gabuar për kthimin e çështjes për rigjykim, madje në shkallë të parë, sepse jemi para rasteve kur çështja duhet të zgjidhej nga vetë Gjykata e Lartë.

Jurisprudenca e kolegjit penal ka orientuar se jemi para pavlefshmërisë së vendimit kur ai nënshkruhet vetëm nga kryesuesi dhe jo edhe nga dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues²⁹⁷, referuar nenit 383.3 të KPP²⁹⁸.

Në hipotezën e pavlefshmërisë së vendimit për shkak të arsyetimit, doktrina e huaj e shtron problemin jo vetëm në planin formal (*mungesa grafike e pjesës arsyetuese*), por sidomos në planin përmbajtësor, i cili përfshin logjikën e arsyetimit, plotësinë dhe korrektësinë e tij²⁹⁹. Janë shumë të rëndësishme elementet e përmbajtjes së arsyetimit. Kështu, mund të goditen për pavlefshmëri vendimet e arsyetuara në dukje, por pa përmbajtje³⁰⁰, ose vendimet që vetëm parafrazojnë normat e ligjit, apo që përdorin stilizime ose ornamente pa përmbajtje të fjalive³⁰¹.

²⁹⁶ Nr.162 i Vendimit, datë 2.4.2008, Gosturani: "... përsa i përket argumentimit të fajësisë së të gjykuarit për krimin e vrasjes, pjesa arsyetuese e vendimit përmban vetëm konkluzione, pa parashtruar se cilat janë konkretisht shpjegimet apo pjesë të tyre të personave të pyetur (në hetim dhe/ose gjate shqyrtimit gjyqësor të çështjes), të cilat përmbajnë njoftime mbi fakte e rrethana konkrete që lidhen me vrasjen e shtetasit R.O., ...

Mangësitë e vërejtura më lart, u konstatuan edhe përsa i përket, si pjesës arsyetuese, ashtu edhe dispozitivit të vendimit të gjykatës së apelit, e cila shqyrtoi çështjen mbi ankimin e mbrojtësit të të gjykuarit H., mangësi, të cilat, për të njëjtat shkaqe që u renditën në lidhje me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, shpjen në përfundimin që edhe vendimi i saj është i pavlefshëm dhe duhet të priset."

²⁹⁷ Nr.00-2012-1330 i Vendimit (253), datë 10.10.2012, Baçi: "25. Siç provohet nga aktet e fashikullit të gjykimit rezulton se pas hedhjes së shortit, në bazë të nenit 13 të K.Pr.Penale, në përbërje të trupit gjykues janë caktuar gjyqtarët Arben Micko, Artur Gaxhi dhe Ilir Çeliku.

26. Ky trup gjykues mbasi ka përfunduar shqyrtimin gjyqësor të zhvilluar në disa seanca, në seancën gjyqësore të datës 15.02.2001, mbasi ka dëgjuar konkluzionet përfundimtare të prokurorit dhe të mbrojtësit të caktuar kryesisht, është tërhequr për vendim dhe në po atë seancë ka shpallur dhe vendimin përfundimtar.

27. Vendimi përfundimtar, ndryshe nga sa është pasqyruar në procesverbalin gjyqësor ku trupi gjykues përbëhet nga tre gjyqtarë, në pjesën hyrëse të vendimit është shënuar vetëm emri i kryesuesit dhe për më tepër vendimi është nënshkruar vetëm nga kryesuesi i trupit gjykues, ndërkohë që mungon pasqyrimi dhe nënshkrimi nga dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues."

²⁹⁸ Neni 383. Elementet e vendimit - ... 3. Vendimi është i pavlefshëm kur mungon dispozitivi ose nënshkrimi i anëtarëve të trupit gjykues.

²⁹⁹ Di Geronimo Paolo, *vep.e cit.*, faqe 217.

³⁰⁰ Gjykata e Kasacionit në Itali shprehet se jemi para vendimesh të arsyetuara për dukje (it. *motivazione apparente*), "... në të gjitha rastet kur arsytimi i gjykatës në mbështetje të vendimit të saj është vetëm fiktiv dhe, për këtë shkak, në thelb inekzistent.", Cass. Sez.I, 8.2.1993, Maiale, *C.E.D. Cass.* 193328, *po aty*, faqe 219.

³⁰¹ Nr.00-2012-1685 i Vendimit (329), datë 5.12.2012, Shquti: "18. Kolegji Penal pa pretenduar në çështjen konkrete një "*elegantia juris*" vlerëson se ... 22. Në aspektin ligjor (*factum*) luajnë një rol kryesor dhe analizimi i tyre është thjesht procesi i zbatimit të ligjit përkundrejt fakteve..."

Ky është një nga rastet kur gjykata përdor formula stili që nuk thonë asgjë në drejtim të arsyetimit.

Në drejtim të rregullave që duhen mbajtur parasysh në arsyetimin e vendimit është shprehur mëse njëherë, me shumë qartësi, Gjykata Kushtetuese³⁰².

Kolegji penal i Gjykatës së Lartë ka mbështetur vendimin e gjykatës së apelit, i cili pati deklaruar të pavlefshëm vendimin e gjykatës së shkallës së parë, për mungesë të arsyetimit, sepse gjykata ishte mjaftuar me citimin në ligjëratë të drejtë të thënieve të dëshmitarëve, pa i analizuar ato në raport me provat dhe rrethanat e tjera të çështjes³⁰³, rast tipik i një vendimi të arsyetuar për dukje.

Arsyetimi, si kriter për vlefshmërinë e vendimit, vlen edhe për vendimet e ndërmjetme³⁰⁴, madje edhe për vendimet e marra nga prokurori, në fazën e hetimeve paraprake ose në përfundim të saj. Natyrisht, vendimi i gjykatës duhet të jetë i arsyetuar, me pasojë pavlefshmërinë e tij, edhe në temën e masave të sigurimit. Në këtë rast duhen arsyetuar si kriteret për caktimin³⁰⁵, ashtu edhe përshatshmëria me nevojat e sigurimit³⁰⁶.

§ 3.6.4 Pavlefshmëria relative dhe gjykimi i shkurtuar. – Kjo temë është do të trajtohet posaçërisht në vijim (*shih § 4.4.3*)

§ 3.7 Papranueshmëria

³⁰² Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 19.02.2013: “19. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe në funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradikcion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr.20, datë 13.4.2012 dhe nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

³⁰³ Nr.00-2013-988 i Vendimit (194), 12.6.2013, Telushi, etj., i paracituar: “11. Gjykata e Apelit Vlorë mes të tjerave arsyeton: Rezulton se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i paarsyetuar. Atij vendimi në pjesën përshkruese-arsyetuese i mungon analiza e provave të marra dhe të shqyrtuara gjatë gjykimit. Konkretisht, në vendimin e asaj gjykate vetëm ka cituar në ligjëratë të drejtë dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët e pyetur në gjykim, pa analizuar këto dëshmi në raport me rrethanat të tjera fakti të rezultuara gjatë gjykimit dhe të provuara me aktet e ndodhura në fashikullin e gjykimit.”

³⁰⁴ *Po aty.*

³⁰⁵ Nr.00-2010-1210 i Vendimit (32), datë 29.9.2010, Kreka: “Gjykata e apelit ... nuk mund të shfuqizojë vendimin kur ai është “i pavlefshëm”, sipas saj, për arsyetim të pamjaftueshëm, pasi nëse vendimi është i paarsyetuar ai është i pavlefshëm në bazë të nenit 112/3 të K.P.Penale. Me konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit për këtë shkak, gjykata e apelit duhet të prishë dhe të kthejë çështjen për rishqyrtim.

Pra, gjykata e apelit duhet të kishte marrë në shqyrtim shkaqet e kundërshtimit të vendimit, të paraqitura nga ana e prokurorit dhe të vendoste në lidhje me kërkesën për caktimin e masës ndaluese, ose nëse e gjente të pavlefshëm vendimin për shkak të paarsyetimit duhet ta prishte e kthente për rigjykim.”

³⁰⁶ Nr.00-2011-489 i Vendimit (81), datë 8.6.2011, Disha: “9. Gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit Durrës janë mjaftuar në arsyetimin e vendimeve të tyre vetëm me listimin e akteve dhe të provave të administruara në dosjen gjyqësore.

Në të dy vendimet mungon analiza e fakteve dhe provave, pranimi apo mospranimi i kushteve të ndalimit dhe, të caktimit të masës së sigurimit.”

Shih edhe: Nr.00-2011-1075 i Vendimit (120), datë 5.10.2011, Milla: në këtë rast vendimi i apelit prishet për mungesë arsyetimi të përshatshmërisë me nevojat e sigurimit, por, në fakt, në këtë drejtim na rezultojnë i paarsyetuar edhe vendimi i kolegjit penal.

Është një shkak pavlefshmërie dhe sanksion procedural që, si rregull, godet kërkesat e palëve. Ajo synon të pengojë shqyrtimin e themelit të tyre, në qoftë se ato nuk plotësojnë elementët e domosdoshëm të aktit që Kodi i sanksionon "me pasojë papranueshmërie".

Këto elemente mund të kenë të bëjnë me kohën brenda të cilit duhet të kryhet akti (afati i paraqitjes së ankimit kundër vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, nenet 415.1, 420.1/ c të KPP), me përmbajtjen e tij (*prokura duhet të tregojë shkaqet e përjashtimit të gjyqtarit, neni 19.4*), me aspekte formale të aktit (*forma e prokurës së posaçme, neni 109.1*), apo me legjitimitetin e palës për kryerjen e aktit (*nuk pranohet ankimi nga pala që ligji nuk ia jep këtë të drejtë, neni 420.1/a*)³⁰⁷. Papranueshmëria mund të deklarohet me kërkesën e palës së interesuar ose kryesisht nga gjykata.

Praktika gjyqësore nuk propozon shumë raste për diskutim në temën e papranueshmërisë. Për ilustrim sjellim rastet e mospranimit të rekursit kur nuk tregohen shkaqet³⁰⁸, apo mospranimi i apelit të prokurorit për shkak të kalimit të afatit 10-ditor të parashikuar nga ligji³⁰⁹. Por, edhe në këtë temë, nuk mungojnë rastet e jurisprudencës kundërthënëse të Gjykatës së Lartë. Neni 420.1, shkronja "c" i KPP normon se ankimi nuk pranohet, ndër të tjera, edhe kur ai nuk i është njoftuar palës tjetër, për arsye sepse kështu do të çenohej parimi i kontradiktoritetit në gjykim. Në një vendim të vitit 2011 kolegji penal, me të drejtë, mosnjoftimin e të pandehurit për ankimin e paraqitur nga prokurori kundër masës së sigurimit të caktuar ndaj tij, e ka konsideruar si shkak për papranueshmërinë e tij³¹⁰; në një gjykim të mëvonshëm, një ves të tillë, tashmë të konstatuar

³⁰⁷ Tonini Paolo, Manuale di procedura penale, Undicesima Edizione, Giuffrè Editore, Milano 2010, faqe 186-187.

³⁰⁸ Nr.00-2010-126 i Vendimit (87), datë 3.2.2010, Daja, etj.: "Në lidhje me të gjykuarin D.D., ky Kolegj ka konstatuar se në rekursin e paraqitur prej tij, brenda afatit ligjor, nuk ka të parashtruara shkaqet e paligjshmërisë së vendimit të rekursuar. Madje nuk ka as ndonjë shtesë të mëvonshme të rekursit. ...

Pra, rekursi i të gjykuarit D. vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 435/1 të K.Pr.Penale. Duke qenë rekursi një nga mjetet e ankimit sipas nenit 407 të K.Pr.Penale, ai nuk pranohet kur nuk është paraqitur në formën dhe përmbajtjen e caktuar, përcaktuar kjo në nenin 420, pika 1, gërma "c" i K.Pr.Penale."

³⁰⁹ Nr.00-2013-575 i Vendimit (64), 27.2.2013, Agushi: "21. Gjykata e apelit ka gabuar kur ka marrë në shqyrtim ankimin e organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, pasi ky ankim është ushtruar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 415 të K.Pr.Penale. (Neni 415/1,3 i K.Pr.Penale parashikon se, afati për të bërë ankim është 10 dite, ky afat fillon nga dita e nesërme e shpalljes ose njoftimit të vendimit. Afatet e parashikuara nga ky nen nuk mund të zgjaten për asnjë shkak, përveç rasteve të parashikuara me ligj).

22. Verifikohet nga materialet e dosjes gjyqësore se, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë është shpallur më datë 24.12.2010, ndërsa ankimi i prokurorit është dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë më datë 04.01.2011, pra një ditë jashtë afatit 10 ditor. Nuk rezulton që ankimi i prokurorit të jetë dorëzuar në ditë pushimi zyrtar apo feste që të shtyhej afati i ankimit."

³¹⁰ Nr.00-2011-550 i Vendimit (98), datë 13.7.11, Lushaj: "31. Rezulton nga aktet e gjykimit që personi nën hetim, A.L., nuk ka ardhur në dijeni jo vetëm të vendimit të ankimuar që caktonte masën e sigurimit ndaj tij, por edhe të ankimit të prokurorit, ndaj këtij vendimi...

32. Kjo rrethanë ka cenuar procesin ligjor të marrjes së masës së sigurimit, deri në pavlefshmëri të gjykimit në apel. Gjykata e apelit, në rrethanat e çështjes duhej të vendoste mospranimin e ankimit të prokurorit, sepse në kuptimin procedural ky ankim nuk i është njoftuar të pandehurit ("Mospranimi i ankimit I. Ankimi nuk pranohet: c- kur nuk janë respektuar dispozitat për formën, paraqitjen, dërgimin, njoftimin dhe afatin e ankimit;" - neni 420, pika 1, shkronja "c" e Kodit të Procedurës Penale)."

nga gjykata e apelit për krime të rënda, nuk e ka konsideruar shkak për mospranimin e ankimit, pa parashtruar ndonjë arsytim bindës³¹¹.

Jurisprudenca e Kolegjit ofron, gjithashtu, dy raste interesante, kur me të drejtë është konstatuar paligjshmëria e gjykatës së apelit për mospranimin e ankimit ngaqë pala nuk pati arsytuar shkaqet; por, kjo mangësi ishte pasojë e paligjshmërisë të gjykatës së rrethit gjyqësor, e cila nuk pati vënë në dispozicion të palëve vendimin e arsytuar^{312, 313}.

³¹¹ Nr. 00-2012-1624 i Vendimit (312), datë 21.11.2012, Dogan, i paracituar: “31. Gjukata e Apelit për Krime të Rënda në shkelje të procedurave të njoftimit për të pandehurin A.D. gjatë gjykimit ka konstatuar se procedurat e njoftimit të vendimit dhe të ankimit për të gjykuarin nuk kanë qenë të rregullta duke qenë se ai i është komunikuar mbrojtësit të caktuar kryesisht dhe jo personalisht të pandehurit në adresën e tij. Për këtë shkak ajo e ka deklaruar ankimin e prokurorit të papranueshëm. Ky arsytim është i gabuar dhe në keqinterpretim të ligjit procedural penal. Kjo gjykatë e ka mbështetur vendim marrjen e saj në nenin 420 të K.Pr.Penale, i cili përcakton rastet se kur ankimi është i papranueshëm dhe konkretisht në paragrafin e parë, gërma “c”, në të cilin parashikohet se”1. Ankimi nuk pranohet :...c) kur nuk janë respektuar dispozitat për formën, paraqitjen, dërgimin, njoftimin dhe afatin e ankimit”...

34. Gjukata e Apelit për Krime të Rënda ka gabuar kur moskomunikimin e ankimit nga sekretaria gjyqësore e shkallës së parë për krime të rënda e ka vlerësuar si shkak për mospranim të ankimit. Rastet e mospranimit të parashikuara në nenin 420 të K.Pr.Penale i referohen vlerësimit të vetë ankimit si akt procedural dhe mënyrës se si është ushtruar kjo e drejtë nga secila palë pjesëmarrëse në procesin penal.” [theksimi ynë, për të nxjerrë në pah pakuptueshmërinë e arsytimit].

³¹² Nr.00-2013-337 i Vendimit (38), datë 06.02.2013, Limushaj, etj.: “12. Kolegji Penal i Gjukatës së Lartë vlerëson se, gjykata e apelit nuk ka patur asnjë pengesë formale për ta marrë në shqyrtim çështjen, për të dëgjuar pretendimet e të pandehurit dhe për të vendosur në lidhje me meritat e çështjes. Gjukata e apelit, përpara se të vendoste mospranimin e ankimit për shkak të mungesës së formës, duhet të verifikonte nëse efektivisht i pandehuri (gjykuari) e ka patur mundësinë e bërjes së një ankimi efektiv, të cilin mund ta realizonte vetëm nëse ka pasur mundësi të njihej me vendimin përfundimtar të arsytuar. Shpallja e vendimit përfundimtar të arsytuar është detyrim ligjor me pasojë pavlefshmërinë e tij. Në nenin 112 të K.Pr.Penale përcaktohet se: “...Vendimi dhe urdhri arsyetohen, ndryshe janë të pavlefshëm”. Në lidhje me vendimin përfundimtar në nenin 383 të K.Pr.Penale janë përcaktuar edhe elementët që duhet të përmbajë ky vendim ku, një ndër to është edhe parashtrimi i përmbledhur i rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta. ...

15. Megjithëse i gjykuari në ankimin e shkurtër ia ka bërë me dije gjykatës së apelit faktin se, objektivisht nuk ka pasur mundësi t’i paraqesë shkaqet e ankimit për shkak se vendimi përfundimtar nuk i është vënë në dispozicion ashtu siç e kërkon ligji, kjo gjykatë jo vetëm që nuk e ka verifikuar këtë shkak por, në kundërshtim me ligjin, pa analizuar rrethanat, ka vendosur mospranimin duke cënuar të drejtat e të pandehurit dhe duke mohuar në kundërshtim me ligjin të drejtën e gjykimit.

16. Gjukata e apelit, duke mos e pranuar për shqyrtim ankimin, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat procedurale, pasi nuk ka qenë para rastit për të vendosur mospranimin, por duhet ta merrte në shqyrtim dhe të shprehej me vendim në lidhje me themelin e ankimit. Duke mos pranuar ankimin për shqyrtim, pa ndonjë shkak ligjor, i ka cenuar ankuesit një të drejtë themelore siç është e drejta për t’u ankuar ndaj një vendimi gjyqësor, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës.”

Së fundi, po parashtrojmë edhe një rast kur heqja dorë nga apeli prej mbrojtësit, pa tagër përfaqësimi nga i pandehuri, u ngrit nga mbrojtja para kolegjit penal si rast pavlefshmërie. Pavarësisht se bashkohemi me zgjidhjen e drejtë, vërejmë se kërkesa për heqje dorë nga apeli duhej të ishte goditur nga sanksioni i papranueshmërisë dhe Gjykata e Lartë duhej ta kishte bërë këtë vërejtje në mënyrë të shprehur dhe jo thjesht si një *”zbatim të gabuar të ligjit procedural”* nga gjykata e apelit³¹⁴.

³¹³ Nr.00-2013-385 i Vendimit (47), datë 13.02.2013, ankues prokuroria: “22. Vendimi përfundimtar i shkallës së parë nuk rezulton të jetë shpallur i arsyetuar ashtu siç përcaktohet në nenin 112/3 të K.Pr.Penale me qëllim që palëve t’iu bëhej me dije shkaqet ligjore në analizë të provave që çuan gjykatën në këtë vendim-marrje.

23. Prokurori, duke mos qenë dakord me vendimin e gjykatës në disponim të së drejtës së tij kushtetuese ka ushtruar të drejtën e ankimit. Në mungesë të vendimit përfundimtar të arsyetuar, 9 (nëntë) ditë pas shpalljes së vendimit, shumë pranë afatit kohor të lejuar, ka paraqitur në sekretarinë e gjykatës së shkallës së parë një ankim të shkurtuar në të cilin parashtron se shkaqet ku bazohet ankimi do t’i parashtrojë në një plotësim që do t’i bëjë ankimit pasi t’i vihet në dispozicion vendimi i arsyetuar. Ndërkohë që në dosje nuk ka ndonjë akt apo shënim se kur është depozituar në sekretarinë e gjykatës vendimi për të llogaritur kohën që ka patur në dispozicion ankuesi (prokurori) për të reaguar brenda afatit kohor të caktuar në ligj për të bërë ankim. Me pranimin nga ana e sekretarisë së gjykatës së ankimit të shkurtuar provohet se vendimi përfundimtar nuk ka qenë i depozituar, ç’ka e ka vënë në pamundësi objektive ankuesin që të parashtrojë në ankim shkaqet për të cilat ai e kundërshton këtë vendim.”

³¹⁴ Nr.00-2013-1010 i Vendimit (202), datë 12.6.2013, Lulja: “Në këtë kontekst, kur ndaj një vendimi është ushtruar ankim, e drejta e heqjes dorë nga ankimi në një shkallë më të lartë gjykimi është nga ato të drejta të cilat i rezervohen personalisht të pandehurit dhe si e tillë kjo tagër duhet t’i jepet mbrojtësit të zgjedhur nga i pandehuri në mënyrë të shprehur.

Në çështjen në shqyrtim, ndryshe nga përmbajtja e kërkesës për heqje dorë nga ankimi, në të cilën avokati ka cituar se e ka të shprehur këtë tagër të dhënë nga i mbrojturi prej tij, në fakt nga shqyrtimi i akteve nuk rezulton një gjë e tillë.

... Për sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se vendimi nr.748, datë 27.11.2012 i Gjykatës së Apelit Durrës është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal, ...”

KREU 4

PAPËRDORDSHMËRIA E PROVAVE TË MARRA NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN

§ 4.1 Provat jotipike dhe provat e paligjshme.

Tradita jonë e procedurës penale mbështetet në parimin e taksativitetit të mjeteve të të provuarit, sepse ligji parashikonte shprehimisht burimet e provave në procesin penal³¹⁵. Ai ligj nuk lejonte mundësinë që në proces të përfshiheshin burime prove të ndryshme nga ato të parashikuara shprehimisht nga ligji.

Kodi në fuqi i procedurës penale, në nenin 151.3³¹⁶ normon të ashtuquajturin parim të lirisë së provave, i cili lejon marrjen dhe vlerësimin edhe të provave të pakodifikuara (të quajturat *prova jotipike*), mjaft që ato të vlejnjë për të provuar faktet objekt prove, të mos çënojnë lirinë e vullnetit të personit dhe të dëgjohen palët mbi mënyrën e marrjes së tyre (*sigurimi i parimit të kontradiktoritetit*). Norma e sipërcituar shtrun për diskutim një problem parimor: *a mund të themi se ligjvënësi ka hequr dorë nga parimi i përcaktimit shterues të mjeteve të të provuarit (parimi i taksativitetit) në favor të parimit të lirisë së tyre? Le të ndalemi pak tek ky problem.*

Pranohet se parimi i taksativitetit është shumë i ngurtë, sepse pengon përdorimin në procesin e të provuarit të mjeteve provuese të cilat krijohen si pasojë e zhvillimit bashkëkohor të shkencave dhe të teknologjisë³¹⁷. Edhe për këtë arsye, sistemet moderne të procedurës kanë hequr dorë nga ky parim duke pranuar *parimin e lirisë së provave*. Duket se ligjvënësi ynë nuk ka dashur të shkëputet tërësisht nga parimi tradicional i taksativitetit, përderisa në nenin 149 cakton rregullin se provat, që të gëzojnë këtë cilësi, duhet të “... merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, ...”. Por, nga ana tjetër, i ka lejuar mundësinë gjykatës që të marrë edhe prova të papërcaktuara shprehimisht nga ligji (*prova jotipike*), por vetëm kur plotësohen, njëherësh, tri kushtet që përmendëm më sipër.

Parimi i lirisë së provave (apo parimi i lirisë së mjeteve për të provuar fakte në procesin penal) është shumë i rëndësishëm. Prej tij buron rregulli se faktet mund të provohen me çdo mjet prove, edhe me anën e provave të pakodifikuara. Si shembull i provës jotipike mund të shërbejë rasti i njohjes së personit me anën e fotografisë (*tregimi i albumit të fotografive nga policia gjatë marrjes në pyetje për të identifikuar autorin e krimit*), procedurë që nuk parashikohet shprehimisht në dispozitat për njohjet (*nenet 171–175*).

Si përfundim, mund të themi se ligjvënësi ynë nuk është shkëputur dot nga sistemi i vjetër i taksativitetit të burimeve, sipas përcaktimit të nenit 149. Megjithatë, në ligjin tonë procedural është i pranishëm dhe veprues edhe parimi i lirisë së provave, i parashikuar shprehimisht në nenin 151.3 të Kodit.

Por, ndërsa lejohet të merret çdo provë që vlen për të vërtetuar faktet (*pa paragjykuar lirinë e vullnetit të personit*), procedura e marrjes rregullohet nga ligji. Kjo do të thotë se parimi i lirisë së provave vepron njëkohësisht me parimin e ligjshmërisë së procedurës së marrjes së tyre, madje këto parime kanë karakter plotësues.

³¹⁵ Kodi i Procedurës Penale i RPSSH, 1980.

Neni 16. Burimet e provave - ... 1) thëniet e dëshmitarëve, 2) thëniet e të pandehurve, 3) mendimet e ekspertëve, 4) provat materiale dhe 5) dokumentet.

³¹⁶ Neni 151. Marrja e provave – ... 3. Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë në qoftë se ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk çënon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj.

³¹⁷ Tonini Paolo, Manuale di procedura penale, *i paracituar*, faqe 236.

Në marrjen e provave Kodi kërkon respektimin e disa parimeve të përgjithshme, të vlefshme për të gjitha llojet e tyre. Në radhë të parë, provat nuk mund të merren me mjete e metoda të papranueshme në një rend demokratik. Kështu, pohimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mund të vlejë për të provuar fakte, por ndalohet kategorikisht që ai të sigurohet përmes torturës, apo mjeteve të tjera që çenojnë lirinë morale të personit. Gjithashtu, mënyra e përfshirjes së tyre në proces i nënshtrohet disa rregullave të përcaktuara, shkelja e të cilave e bën provën të papërdorshme (*p.sh., respektimi i kontradiktoritetit, rregullat për leximet e lejueshme, etj.*).

Respektimi i ligjshmërisë në procedurën e kërimit dhe marrjes së provave garantohet, para së gjithash, nga Kushtetuta, e cila në nenin 32.2 sanksionon ndalimin vijues: “*Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*”. Kodi i procedurës penale vendos sanksionin e përgjithshëm procedural të papërdorshmërisë së provave, kur në nenin 151.4 normon: “*Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren*”. Madje, edhe në rast mosveprimi të palëve, kjo normë e detyron gjykatën që t’i konstatojë rastet e papërdorshmërisë edhe kryesisht: “*Papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit*”.

Duhet të bëhet dallimi i provës të siguruar në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji, e cila shpesh njihet si *prova e paligjshme*, nga prova që nuk parashikohet nga ligji - *prova jotipike*, por që lejohet të merret kur përmbushen kushte të caktuara. Prova jotipike nuk është e paligjshme, vërtet natyra dhe lloji i saj nuk parashikohen shprehimisht në ligjin procedural, por ajo lejohet të merret duke u shprehur paraprakisht palët për mënyrën e marrjes së saj (*neni 151.3*). Kurse prova e paligjshme mund të jetë tipike, mund të parashikohet nga ligji si provë, por goditet për paligjshmëri procedura e marrjes së saj *contra legem*³¹⁸.

Problemi i provave të paligjshme është një ndër problemet më të vështira dhe më të debatueshme, edhe në doktrinën e huaj³¹⁹.

Në Kod është i normuar qartë rasti kur veprimi i paligjshëm që bën të mundur marrjen e provës përbën shkelje të ligjit procedural penal. Në këtë rast, të dhënat me vlerë provuese ose provat janë të papërdorshme, për shkak të ndalimit të parashikuar në nenin 151.4. Le të marrim ndalimin e parashikuar nga neni 37 i KPP: deklarimet prej nga buron përgjegjësi penale të personit që ende nuk ka marrë cilësinë e të pandehurit (*as cilësinë ndërmjetëse të personit nën hetim*)³²⁰ nuk mund të përdoren kundër tij. Po kështu, pyetja e njërit prej bashkëtëpandehurve në cilësinë e dëshmitarit e bën provën të papërdorshme (*neni 36 i KPP*).

Provën e bën të papërdorshme jo vetëm shkelja e një ndalimi të parashikuar nga ligji, në procesin e marrjes së saj, por edhe shkelja e normave të posaçme lidhur me formën e aktit, kur ky dhunim çënon të drejta subjektive themelore. Kështu, komunikimet telefonike të përgjuara, në kushtet dhe sipas të gjitha procedurave ligjore, “... *regjistrohen dhe për veprimet e kryera mbahet procesverbal*” (*neni 223.2*). Në rast se regjistrimet fshihen në një kohë të mëpasme, prova që buron nga përmbajtja e bisedave të transkriptuara nuk mund të përdoret, për mungesë të njëjës nga format e dokumentimit. Pra, në një rast të tillë, ndonëse nuk është shkelur asnjë ndalim i parashikuar nga ligji për përgjimin e komunikimeve, mangësia formale e sipërpërmendur e bën provën të papërdorshme.

³¹⁸ *Contra legem* (lat.) - në kundërshtim me ligjin. Term që përdoret shpesh në doktrinën për të cilësuar procedurën e paligjshme të marrjes së provave.

³¹⁹ Spangher Giorgio, La pratica del processo penale, Epub, Volume III, CEDAM 2014, i paracituar, faqe 337 e vijuese.

³²⁰ Shih nenin 34.4 të KPP.

§ 4.2 Kuptimi dhe format e papërdorshmërisë.

Përmendëm se në temën e provave vepron *parimi i ligjshmërisë*, i shprehur në ndalimin e përgjithshëm të parashikuar nga neni 151.4 i KPP: “*Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit*”.

Këtë parim ligjvënësi e ka ndërtuar në tre plane:

Së pari, ka krijuar sanksionin e papërdorshmërisë së provave, në rastet kur ato janë marrë në shkelje të ndalimeve ligjore;

Së dyti, për shkak të rëndësisë së këtij parimi, ligjvënësi e ka shtrirë konstatimin dhe ngritjen e papërdorshmërisë “*në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit*”;

Së treti, konstatimin dhe ngritjen e papërdorshmërisë së provave nuk i ka lidhur vetëm me nismën e palëve, por i ka ngarkuar gjykatës të drejtën dhe detyrimin që, në rast mosveprimi të palëve, të veprojë *ex officio*.

Këto rregulla, rrjedhimisht, janë edhe shprehje e natyrës garantuese të procesit penal lidhur me mënyrën e marrjes së provave. Mjaftohemi të përmendim se Kodet tona të Pasçlirimit nuk e njihnin institutin e papërdorshmërisë së provave të marra në kundërshtim me ligjin.

Papërdorshmëria përbën një *ves* të aktit procedural penal që mishëron marrjen e provës, madje një nga veset më të rënda të tij. Nga ana tjetër, papërdorshmëria vepron edhe si *sanksion procedural* që godet provat e marra në kundërshtim me ndalimet e parashikuara nga ligji. Në këtë kuptim, papërdorshmëria nuk përbën një pavlefshmëri të natyrës së përgjithshme, por një sanksion procedural të mëvetësishëm që godet vetëm provat, pra, nuk godet aktin në aspektin formal, por vlerën e tij provuese, me një fjalë, aspektin e tij thelbësor.

Për këtë arsye, ajo nuk përfshihet në Titullin III (Seksioni V) të Kodit që normon institutin e pavlefshmërisë të akteve procedurale. Kjo natyrë e dyfishtë e papërdorshmërisë (*ves dhe sanksion*), sikurse vërehet nga studjuesit, nuk lejon që prova të përdoret, ndonëse vesi i aktit të marrjes mund të korrigjohet³²¹. Kështu, mosrespektimi i rregullave procedurale të aktit të njohjes së personit përbën shkak që njohja të konsiderohet e pavlefshme (*neni 172.3*). Veprimi mund të përsëritet duke e kryer formalisht sipas ligjit, por prova e njohjes së personit nuk mund të bëhet e përdorshme, për shkak se përsëritja e veprimit në një kohë të dytë e bën atë të pabesueshme.

Mundësia që konstatimi dhe ngritja e papërdorshmërisë së provës të bëhet edhe kryesisht, si dhe pamundësia e korrigjimit të saj, i jep këtij vesi, si rregull, natyrë absolute. Në mënyrë kategorike janë formuluar shumica e dispozitave të Kodit për papërdorshmërinë e provave të marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji. Përmendim nenet 36.1 (*ndalimi i përdorimit si dëshmi të deklarimeve të të pandehurit*), 52.6 (*ndalimi i përdorimit të mjeteve të kërkimit të provës dhe i rezultatit të tyre, kur shkelen procedurat e veprimeve kundër mbrojtësit, ose në zyrën ku ai ushtron detyrën*), 209.3 (*ndalimi i përdorimit të objekteve që nuk hyjnë në korrespondencën e sekuestrueshme*), 226.1 (*ndalimi i përdorimit të rezultateve të përgjimit, në rastet kur shkelen procedurat që normon ligji*), etj.

Kodi parashikon edhe dy raste kur provat jo vetëm nuk mund të përdoren, por ato ndalohet edhe që të merren. Në këto raste, ligjvënësi ka përdorur një formulim më të prerë: “... *nuk mund të merren dhe as të përdoren...*”. Nuk mund të merren dhe as të përdoren *të dhënat e mbledhura nga informatorët* (neni 160.5) dhe *as dokumentet anonime* (neni 194.1).

³²¹ Spangher Giorgio, *vep. e cit.*, faqe 340.

Papërdorshmëritë e kësaj natyre cilësohen nga doktrina³²² si “*papërdorshmëri patologjike*”. Ajo godet, para së gjithash, provat e marra në shkelje të vlerave absolute të mbrojtura nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, sikundër janë pohimet e marra nën torturë apo si rezultat i një trajtimi çnjerëzor ose poshtëruës. Si shembull tipik shërben çështja **Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë**³²³. Gjykata vërejt se pohimet vetëakuzuese të kërkuarit të parë, të marra si rezultat i dhunës policore dhe pa praninë e mbrojtësit, në kohën kur ai ndodhej në kushtet e kufizimit të lirisë, duke qenë se ishin edhe prova e vetme e fajësisë në ngarkim të tij, e bëjnë procesin të parregullt, në tërësinë e tij. Procesi bëhet i parregullt edhe për shkak se atribuimet e tij akuzuese, të cilat ishin prova vendimtare e fajësisë së kërkuarit të dytë, ishin marrë nëpërmjet ushtrimit të dhunës³²⁴. Pra, Gjykata e Strasburgut pranoi shkeljen e neneve 3 dhe 6§1 të Konventës. Ky shembull është rasti tipik për ilustrimin e papërdorshmërisë patologjike të provës së marrë në shkelje të vlerave për të cilat Konventa ka normuar ndalime të natyrës absolute.

Papërdorshmëria mund të ngrihet edhe për faktin se, në zbatim të parimit të ndarjes së fazave të procesit, akte të ndryshme kanë vlerë provuese të ndryshme në faza të ndryshme të procedurës. Kështu, deklaratimet e dhëna në fazën e hetimeve paraprake nga persona që kanë dijëni lidhur me rrethanat të dobishme për qëllimet e hetimit (*nenet 297, 312*) janë plotësisht të përdorshme për të mbështetur kërkesën për caktimin e një mase sigurimi, për të arsyetuar kërkesën për lejimin e kontrollit të banesës, etj., por si rregull, janë të papërdorshme gjatë gjykimit të zakonshëm³²⁵, ndaj qëndrojnë në fashikullin e prokurorit. Përfshirja e tyre në fashikullin e gjykimit mund të bëhet vetëm në rastet e kundërshtimit të dëshmisë (*neni 362*) ose të leximeve të lejueshme (*neni 369.2.3*). Pra, këto akte mund të jenë marrë sipas ligjit, por përdorimi i tyre në gjykim, në shkelje të rregullave procedurale, i bën ato të papërdorshme për të provuar fakte të caktuara. Ajo gjen mbështetje normative në ndalimin e përgjithshëm që parashikon neni 380.1 i Kodit: “*Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor.*” Ky formulim, përjashton nga vlerësimi ato prova që nuk janë pranuar dhe diskutuar gjatë debatit gjyqësor,

³²² Tonini Paolo, *vep.e cit.*, faqe 181; shih edhe Gaito Alfredo (diretto da), *La prova penale*, Wolters Kluwer, 2008, faqe 113.

³²³ Case of Kaçiu and Kotorri v. Albania (Applications nos. 33192/07 and 33194/07), FORMER FOURTH SECTION, STRASBOURG, 25 June 2013, [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"respondent":\["ALB"\],"kpthesaurus":\["445"\],"documentcollectionid":\["GRANDCHAMBER"\],"chamber":\["CHAMBER"\],"itemid":\["001-121770"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{), vizita e fundit më 2.12.2015.

³²⁴ Gjykata e Strasburgut vërejt se “...Konventa ndalon në mënyrë absolute torturën ose trajtimet çnjerëzore apo poshtëruese, pavarësisht nga sjellja e viktimës. ...Kurse keqtrajtimi, për t’u trajtuar nën prizmin e nenit 3, duhet të ketë një minimum niveli ashpërsie dhe kjo çmohet duke mbajtur parasysh të gjitha rrethanat e rastit, përfshi këtu kohëzgjatjen e keqtrajtitimit, pasojat e tij fizike apo mendore dhe, në disa raste, seksin, moshën dhe gjendjen shëndetësore të viktimës” (§87-88). Gjykata theksoi, gjithashtu, se “...pohimet e marra si rezultat i torturës ose i ndonjë lloji tjetër keqtrajtimi, në shkelje të nenit 3, si provë për të vërtetuar fakte vendimtare në procesin penal, e bëjnë gjykimin, në tërësinë e tij të padrejtë dhe ato nuk mund të përdoren si provë për dënimin e të pandehurit... Për më tepër, pohimet vetëfajësuese kërkuari i dha në mungesë të një mbrojtësi ...dhe ato u përdorën në gjyq dhe shërbyen si prova e vetme për dënimin e të pandehurit”. (§117, 119-120); Po aty [shqipërimi ynë].

³²⁵ Duhet patur parasysh se këto deklarime janë plotësisht të përdorshme për të vërtetuar faktet objekt prove kur procedohet me gjykimin e shkurtuar (*nenet 403-406*).

përfshi këtu edhe aktet me vlerë provuese të hetimeve paraprake, të cilat nuk janë bërë pjesë e fashikullit të gjykimit.

Kjo lloj papërdorshmërie, e njohur në doktrinë si “*papërdorshmëria fiziologjike*”³²⁶, në pikëpamje të pasojave që prodhon, ka natyrë relative dhe mund të korrigjohet duke rregulluar procedurën e marrjes.

Papërdorshmëri të kësaj natyre përbëjnë edhe rastet e dispozitave të ndërtuara në formën e një kushti përjashtimor. Kështu, dëshmia e tërthortë është e papërdorshme në qoftë se burimi prej nga janë mësuar faktet nuk thirret të dëshmojë në gjyq, *me përjashtim të rasteve* kur pyetja e tij është e pamundur për shkak se *ka vdekur, është i sëmurë rëndë ose nuk gjendet* (neni 154.2). Mjafton të provohet njëri prej këtyre rasteve që sanksioni të bjerë dhe dëshmia e tërthortë të bëhet e përdorshme. Gjithashtu, për subjekte që janë të detyruar të ruajnë sekretin për shkak të profesionit ose të detyrës, ligji ndalon përdorimin si provë të përgjimeve të bisedave ose të komunikimeve. Por, ky ndalim bie, kur faktet që burojnë nga bisedat këta persona i kanë deponuar ose i kanë përhapur me ndonjë mënyrë tjetër (neni 226.2).

§ 4.3 Ngritja e papërdorshmërisë në fazën e hetimeve paraprake.

Papërdorshmëria godet edhe aktet e hetimeve paraprake. Në këtë fazë, çmuarja e papërdorshmërisë së provave të grumbulluara nga policia gjyqësore bëhet nga prokurori, kurse goditja për papërdorshmëri e akteve me vlerë provuese të kryera nga prokurori bëhet nga prokurori më i lartë. Prokurori, në respekt të parimit të ligjshmërisë, nuk mund të vendosë dërgimin në gjyq të çështjes kur provat në ngarkim të të pandehurit janë siguruar në shkelje të ndalimeve që parashikon ligji.

Rast tipik është ai që parashikon neni 324.4 i Kodit, i cili normon sanksionin e papërdorshmërisë për veprimet hetimore të kryera pas mbarimit të afatit të hetimeve paraprake³²⁷. Është e rëndësishme të theksohet se nuk mund të përdoren vetëm ato veprime hetimore të cilat prodhojnë prova sepse, sikundër u theksua më sipër, papërdorshmëria është sanksion procedural që godet vetëm provat.

Duke përmbledhur sa parashtruar më sipër, mund të përfundojmë që papërdorshmëria është *ves* i aktit procedural me natyrë provuese dhe, njëkohësisht, *sanksion* procedural autonom që godet provën që buron prej tij. Ajo ka natyrë absolute, ndaj nuk mund të korrigjohet në rastin e provave të marra në kundërshtim me ligjin (rastet e papërdorshmërisë patologjike). Por, në disa raste papërdorshmëria ka natyrë relative, pikërisht kur bëhet fjalë për zhvendosjen e vlerës provuese të akteve të kryera gjatë hetimeve paraprake në fazën e shqyrtimit gjyqësor të çështjes ose në rastin kur është i pavlefshëm (*por, jo i paligjshëm*) akti i marrjes së provës (rastet e papërdorshmërisë fiziologjike).

§ 4.4 Papërdorshmëria dhe praktika gjyqësore.

Në vijim, do të shqyrtojmë disa nga rastet më tipike të praktikës gjyqësore në temën e papërdorshmërisë së provave të marra *contra legem*. Përqasja e zgjidhjeve të dhëna ndër vite, shpeshherë të debatueshme, me doktrinën dhe jurisprudencën e huaj, do të na ndihmojë të kuptojmë problemet e ligjit dhe të interpretimit të tij, për të propozuar zgjidhjet më të

³²⁶ Tonini Paolo, *Ibidem*, faqe 186.

³²⁷ Neni 324. Zgjatja e afatit - ... 4. Veprimet hetimore të kryera pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren. *Siç do ta shohim në vijim, kjo është njëra nga normat më të debatuar në praktikën gjyqësore.*

pranueshme. Pak më sipër, përmendëm se koncepti i papërdorshmërisë së provave ka natyrë garantiste; Kodet e mëparshme, të ndërtuara mbi bazën e modelit inkuizitor të procedimit, nuk e njihnin këtë institut. Kjo duhet të jetë një nga arsyet që në praktikën gjyqësore ka paqartësi dhe ngatërtime të konceptit të papërdorshmërisë me institute të tjera të procedurës penale.

Sikundër do ta shohim në vijim, edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, papërdorshmëria e provave ngatërrohet me pavlefshmërinë e akteve, ndonjëherë edhe me pavlefshmërinë e natyrës absolute. Bie fjala, marrja e provës së dëshmisë, përmes sigurimit të saj në fazën e hetimeve paraprake, ndërkohë që çështja e vendimmarrjes së gjykatës për kthimin e akteve prokurorit ndodhej ende në shqyrtim para gjykatës së apelit, konsiderohet si pavlefshmëri e natyrës absolute³²⁸; në fakt, nuk është e tillë, por papërdorshmëri fiziologjike e provës së prodhuar në shkelje të dispozitave për kompetencën. Gjithashtu, kolegji përdor termat “*provë e pavlefshme*”, në rastin e mosrespektimit të procedurës për njohjen me fotografi³²⁹, si dhe “*akte absolutisht të pavlefshme*” për veprimet hetimore të kryera pas përfundimit të afatit të hetimeve paraprake³³⁰. Në të dyja rastet e mësipërme, termi i përshtatshëm do të ishte “*provë e papërdorshme*”, e marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji (mosrespektim i procedurës së njohjes së personit dhe i kufizimeve kohore që normon ligji për marrjen e provave).

³²⁸ Nr.00-2011-87 i Vendimit (7), datë 12.1.11; Shtëmbari, i paracituar: “Rezulton e provuar se me vendimin nr.136, datë 25.04.2008 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur kalimin e akteve prokurorit. Ky vendim është ankimuar nga i gjykuari në Gjykatën e Apelit Vlorë, por edhe pse në rrethanat kur çështja nuk ishte gjykuar nga kjo gjykatë, pra edhe pse vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk kishte marrë formë të prerë dhe çështja vazhdonte të ishte në juridiksion gjyqësor, nga ana e prokurorisë është vazhduar hetimi i çështjes dhe një prej provave të reja të marra gjatë hetimit paraprak është dhe dëshmia e L.Sh., marrë në seancë për sigurimin e provës së datës 23.06.2007. Duke qenë se kjo provë është marrë nga ana e organit të prokurorisë ndërkohë që ky organ nuk ka qenë kompetent për të zhvilluar hetime për këtë çështje e cila ishte duke u gjykuar, në vështrim të nenit 128/b të K.Pr.Penale ajo është e pavlefshme dhe gjykata e shkallës së parë, bazuar në kërkesat e nenit 380 të K.Pr.Penale, nuk mund të merrte vendimin bazuar në prova absolutisht të pavlefshme apo të paverifikuara gjatë shqyrtimit gjyqësor.”

³²⁹ Nr. Nr.00-2013-1005 i Vendimit (196), datë 12.6.13, Oruçi: “19. ... në gjykimin e çështjes nga gjykata e faktit është provuar qartë se, procedura e njohjes së personit me fotografi, sipas të cilës dëshmitarja K.P.A. ka njohur të gjykuarin I.O., është bërë vetëm nëpërmjet fotografisë së paraqitur nga policia greke, e cila nuk dihet se në ç’rrugë është siguruar, pa fotografi të tjera të ngjashme, pa praninë e mbrojtësit të personit ndaj të cilit zhvillohej njohja, duke e bërë këtë provë të pavlefshme dhe pa vlerë provuese në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.”

³³⁰ Nr.00-2011-579 i Vendimit (101), datë 13.7.11, Shahini, etj.: “Ky Kolegj konstaton se ushtrimi i ndjekjes penale dhe kryerja e veprimeve hetimore deri në datë 18.12.2008, përtej afatit të hetimeve, i cili ka përfunduar në datë 28.11.2008, është një shkelje e rëndë procedurale e cila bie ndesh me dispozitat e nenit 323 të K.Pr.Penale, e cila përcakton se brenda afatit të hetimeve paraprake prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj. Në kuptim të nenit 128/1 (b) të gjitha aktet e nxjerra përtej datës së mësipërme do të konsiderohen si “absolutisht të pavlefshme” për shkak të mosrespektimit të dispozitave urdhëruese të ligjit procedural penal që lidhen me “të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim”.

Pas kësaj vërejtjeje në lidhje me terminologjinë e përdorur, le të vijmë tek rastet më domethënëse të praktikës gjyqësore.

§ 4.4.1 Problemi i papërdorshmërisë së dëshmisë së pavlefshme (nenet 158, 154 të KPP)

Rasti i dëshmisë së subjekteve që ligji i përjashton nga detyrimi për të dëshmuar ka qenë objekt i një jurisprudence të pasur, por edhe kundërthënëse të kolegjit penal. Megjithë kundërshtitë ende nuk kemi një vendim unifikues që të njësojë praktikën gjyqësore.

Rastet lidhen, sidomos, me dëshminë e vajzave të trafikuar për qëllime shfrytëzimi në tregun e prostitucionit, të cilat pasi paraqitnin kallëzim ndaj tutorëve të tyre, thirreshin nga gjykata për të dëshmuar, në proces ose përmes sigurimit të provës së dëshmisë në fazën paragjyqësore. Gjykata, në disa raste, i referohet nenit 158.1, shkronja “ç” të KPP, i cili përjashton nga detyrimi për të dëshmuar personin “... që edhe pse nuk është bashkëshort i të pandehurit, bashkëjeton ose ka bashkëjetuar me të.” Nisur nga ky këndvështrim, në një sërë vendimesh, qëndrimin së bashkë nën një strehë në territorin e shtetit të huaj, Gjykata e ka konsideruar “bashkëjetesë” në kuptimin e Kodit të Familjes. Për këtë arsye, ometimin e gjykatës së faktit për t’i bërë të njohur të dëmtuarës mungesën e detyrimit për të dëshmuar, e kanë

konsideruar shkak për pavlefshmërinë e dëshmisë³³¹. Të njëjtin arsyetim ka ndjekur kolegji edhe në disa vendime të mëvonshme³³².

³³¹ Nr.00-2008-102 i Vendimit (555), datë 3.12.2008, Kane, etj.: "... vendimet gjyqesore jane marre ne shkelje te ligjit procedural penal, posacerisht dispozitave te nenit 158/ç/2 e 151/4 te K.Pr.Penale.

Sikurse u verejt gjate shqyrtimit te akteve, procedimi penal ne ngarkim te te gjykuarit A.K. filloi me administrimin e kallezimit te shtetases H.Xh.. Ne kete akt, kjo shtetase, ne cilesine e te demtuares, ka pranuar se me te gjykuarin A.K. ka bashkejetuar.

Kete rrethane, konstatohet se e demtuara e ka pranuar dhe gjate administrimit te deshmise se saj gjate seances gjyqesore ne date 02.11.2006. Rezulton se deshmia e saj ka perbere një ndër provat kryesore, fuqia provuese e te ciles solli gjykaten ne individualizimin e fajesise per te gjykuarin A.K. dhe denimin e tij sipas nenit 114/b-1 te Kodit Penal.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte cmon se vendimet e gjykatave te faktit jane bazuar mbi nje prove, e cila per shkak se eshte marre ne kundershkrim me ligjin nuk mund te perdorej si e tille, ne veshtrim te nenit 151/4 e 380 te K.Pr.Penale."

³³² Nr.11 i Vendimit, datë 4.2.2009, Duda: "Ne rastin konkret, Kolegji Penal i Gjykates se Larte vlereson se ka qene detyrim i gjykates qe zhvilloi seancen e sigurimit te proves (deshmise), qe konform nenit 158/ç te K.Pr.P., ne momentin kur mori dijeni per lidhjen mes te pandehurit dhe te demtuares, t'i bente te njohur kesaj te fundit te drejten qe ajo kishte per te mos deshmuar. Mosrespektimi i kesaj dispozite ligjore nuk u konstatua as nga gjykata qe mori ne shqyrtim ceshtjen pas perfundimit te hetimeve paraprake, e per rrjedhoje kjo shkelje e ligjit nuk u arrit te riparohet nga gjykatat e faktit. Per shkaqet e mesiperme, deshmia e te demtuares A.S. perben nje prove te administruar ne shkelje te ligjit (neni 151/4 i K.Pr.P.), e per rrjedhoje vendimet gjyqesore te cilat u bazuan ne te duhet te prishen."

Nr.00-2010-863 i Vendimit (559), datë 2.6.2010, Etemaj, etj.: "...Siç rezulton nga aktet e administruara në gjykim, e dëmtuara dhe i gjykuari E. kanë bashkëjetuar për një periudhë prej rreth 3 vjetësh. Që kjo periudhë, në rastin objekt gjykimi, duhet të konsiderohet si bashkëjetesë edhe në kuptim të interpretimit që i bën bashkëjetesës neni 163 i Kodit të familjes sipas të cilit e tillë duhet të interpretohet situata e faktit, rezulton qartë nga vetë spjegimet e dhëna prej të dëmtuarës sipas të cilës ajo ka shkuar në shtetin italian, e shoqëruar nga i gjykuari F. prej të cilit i është kërkuar të ushtronte prostitucion ndërkohë që ajo vetë gjatë qëndrimit në itali do bashkëjetonte me të gjykuarin E. me të cilin edhe do të martohej."

"...Edhe pse gjatë periudhës së bashkëjetesës e dëmtuara ka pretenduar se është detyruar prej të gjykuarve të ushtronte prostitucion, kjo nuk mohon faktin e bashkëjetesës me të gjykuarin E., bashkëjetesë e cila në kuptim të dispozitës së nenit 158/2 të K.Pr.Penale e bën të pavlefshme dëshminë e të dëmtuarës J.A. bërë para gjykatës në datën 20.05.2004. Kjo dëshmi e pavlefshme është një prej provave kryesore të përdorura në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Berat dhe që e bën këtë vendim të cënueshëm mbasi në kundërshtim me kërkesat e nenit 380 të K.Pr.Penale rezulton se kjo gjykatë, për të marrë vendimin ka përdorur prova të pashqyrtuara apo verifikuara në shqyrtimin gjyqësor."

Nr.00-2010-1180 i Vendimit (841), datë 22.9.2010, Bylyku: "Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se ka qenë detyrim i gjykatës së shkallës së parë që, në momentin kur mori dijeni për lidhjen mes të gjykuarit dhe të dëmtuarës, të mos përdorte dëshminë e saj në sigurimin e provës, por t'a thërriste me cilësinë e dëshmitares dhe pasi konform dispozitës së nenit 158/ç/2 të K.Pr.Penale t'i bënte të njohur kësaj të fundit të drejtën që ajo kishte për të mos deshmuar, të mernte shpjegimet e saj. Për shkaqet e mësipërme, dëshmia e të dëmtuarës A.Z. përbën një provë

Sikundër vërejtëm më sipër, në vendimmarrjen e kolegjit vërehen edhe raste kur zgjidhja jepet në kahjen e kundërt, me arsyetimin se mungojnë elementet e bashkëjetesës *more uxorio* në kuptimin e ligjit³³³, por edhe sepse subjekti që paraqet kallëzim apo që del në proces si subjekt i dëmtuar nuk përjashtohet nga detyrimi për të dëshmuar³³⁴, pavarësisht raportit të afërsisë, në rend gjinie apo krushqie. Padyshim, kjo e fundit është një zgjidhje e drejtë, jo vetëm për faktin se nga detyrimi për të dëshmuar nuk përjashtohen kallëzuesi dhe personi i dëmtuar, sikundër thekson edhe Gjykata Kushtetuese, në një vendim të vitit 2011³³⁵, por edhe sepse jetesa e

të administruar në shkelje të nenit 151/4 i K.Pr.Penale e për rrjedhojë vendimi i gjykatës së shkallës së parë, i cili është bazuar mbi prova të papërdorshme, duhet të ishte prishur nga ana e Gjykatës së Apelit Durrës, bazuar në detyrimin që rrjedh nga dispozita e nenit 428/ç të K.Pr.Penale.”

³³³ Nr. 92 i Vendimit, datë 4.3.2009, Laze, etj.: “Kolegji Penal gjen të pambështetur pretendimin e mbrojtësve të të gjykuarve për mosrespektim të përcaktimeve të nenit 158 të K.Pr.Penale, për shkak se te dëmtuarës nuk i është bërë i qartë përjashtimi nga detyrimi për të dëshmuar për arsye të bashkëjetesës me të gjykuarin P.Ç. Nga aktet e dosjes gjyqësore dhe nga deklaratimet e vetë të dëmtuarës, për asnjë moment nuk rezulton se e dëmtuara dhe i gjykuari P.Ç. kanë bashkëjetuar në kuptimin ligjor, të përcaktuar në nenin 163 të K.Familjes.”

Nr. 00-2013-780 (37) i Vendimit, datë 6.2.2013, Avduli, i paracituar: “I gjykuari si në ankim dhe në rekurs ka pretenduar se dëshmia e dëshmitares V.K. nuk mund të përdorej si provë, mbasi në bazë të nenit 151/4 të Kodit të Procedurës Penale, ajo është e papërdorshme, sepse sipas nenit 158/ç paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale, asaj nuk i është bërë e ditur e drejta për të mos dëshmuar.

Ashtu siç e pranon edhe gjykata, ka rezultuar se dëshmitarja V.K. ka jetuar me të gjykuarin rreth 3 vjet, një pjesë të kohës në Shqipëri dhe pjesën më të madhe në Itali. Jetesa e tyre nuk është karakterizuar asnjëherë nga stabiliteti dhe vazhdimësia si një jetesë në çift. Në këtë rast nuk bëhej fjalë as për një qëndrim stabël në një shtëpi banimi, për punë të caktuar, apo elemente të tjerë që tregojnë stabilitet, por kemi të bëjmë me ndryshime të shpeshta të vendqëndrimit dhe qëndrime për një kohë të gjatë në hotele, fakte këto që tregojnë se i gjykuari e ka shfrytëzuar të dëmtuarën me qëllim fitimi.

... me të drejtë gjykata e apelit nuk e konsideron dëshmitaren (kallëzuesen) V.K. si bashkëjetuese të të gjykuarit në kuptimin ligjor të këtij termi, por si një viktimë trafikimi e shfrytëzimi nga prostitucioni, prandaj dhe kërkesat e nenit 158/ç paragrafi i 2^ë të Kodit të Procedurës Penale nuk janë të detyrueshme që të respektohen në rastin në shqyrtim.”

³³⁴ Nr.87 i Vendimit, datë 21.2.2007, Misiri: “Kolegji Penal i Gjykatës se Larte i gjen te pambeshtetura ne ligj pretendimet e tjera te ngritura ne rekurs nga ana e te gjykuarit. Pyetja e te demtuares gjate sigurimit te proves nuk vjen ndesh me kerkesat e nenit 158 te K.Pr.Penale, jo vetem per faktin se ne gjykim nuk ka rezultuar qe e demtuara te kete bashkejetuar me te gjykuarin, por edhe sepse nga rregullimi i parashikuar ne kete dispozite perjashtohen personat qe kane bere vete kallzim per kryerjen e vepres penale, sic eshte edhe rasti i te demtuares.”

³³⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 22.9.2011, Kota: “18. Nga dosja gjyqësore rezulton se procedimi penal në ngarkim të kërkuesit A.K. ka filluar mbi bazën e kallëzimit të shtetases N.C., në cilësinë e bashkëjetueses me të pandehurin. Duke qenë se është kjo shtetase që ka vënë në lëvizje procedimin penal kundër kërkuesit, paraqitja e saj para gjykatës për sigurimin si provë të dëshmisë dhe thirrja e saj për të dëshmuar, në gjykimin në gjykatën e apelit, janë bërë në cilësinë e kallëzueses dhe jo në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat apo faktet që kanë të bëjnë me ngjarjen. Në këto kushte, Gjykata vëren se nuk gjen zbatim parashikimi i nenit 158/2 të KPP-së, me pasojën që kjo shtetase kishte detyrimin të dëshmonte dhe se për gjykatën nuk lindte asnjë detyrim për ta njoftuar atë për mundësinë/të drejtën për të hequr dorë nga dhënia e dëshmisë.

Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenim të nenit 32/2 të Kushtetutës është i pabazuar.”

përbashkët nuk është bashkëjetesë, në kuptimin e ligjit, por *modus operandi* për realizimin e qëllimit kriminal, mundësia e vetme për tutorin që të mbajë nën kontroll viktimën dhe të përvetësojë të ardhurat e siguruar nga shfrytëzimi i saj.

Në fakt, në interes të argumentit që po trajtojmë, më tepër na intereson çështja e raportit mes aktit të pavlefshëm dhe përdorshmërisë së provës që buron prej përmbajtjes së dëshmisë. Edhe në një rast tjetër, pasojën e cënimit të rregullave për marrjen e dëshmisë kolegji e ka shtrirë në drejtim të papërdorshmërisë së saj për të provuar fakte të caktuara³³⁶, duke referuar tek parimi i ligjshmërisë së provës (neni 151.4 i KPP).

Diskutimi ka të bëjë me ndërthurjen mes dy instituteve, pavlefshmërisë së aktit të dëshmisë dhe papërdorshmërisë së provës që buron nga përmbajtja e saj. Ai mund të shtrohet si vijon: nëse ndodhemi para rasteve kur cënimi i formaliteteve për marrjen e dëshmisë sanksionohet me pavlefshmëri të natyrës së posaçme, do të zbatohet sanksioni i papërdorshmërisë së provës, apo rasti do të trajtohet si një pavlefshmëri relative, e parashikuar shprehimisht nga ligji. Zgjidhja e kësaj dileme nuk aq e thjeshtë, ajo ka qenë objekt debati edhe në doktrinën e huaj, që duket se çështjen nuk e shtron në mënyrë aq radikale sa kolegji ynë i Gjykatës së Lartë³³⁷. Një interpretim më realist nisët nga parakushti që papërdorshmëria nuk ka të bëjë me çfarëdo cënimi të disiplinës që rregullon marrjen e provave, por sanksionon, vetëm dhe përjashtimisht, marrjen e provave “*të ndaluara nga ligji*”. Pra, kjo pjesë e doktrinës na fton të dallojmë ndalimet për marrjen e provave, në kuptimin e ngushtë të fjalës, nga cënimet e formalitetit të marrjes së tyre. Këto të fundit cilësohen thjesht si pavlefshmëri të natyrës relative, të cilat mund të korrigjohen sipas rregullave të përgjithshme (nenet 129, 130.1 të KPP). Dallimi mes papërdorshmërisë dhe pavlefshmërisë, ndërsa është i qartë në rastin e pavlefshmërive të posaçme, të parashikuara në mënyrë taksative, mund të paraqesë vështirësi interpretimi vetëm në prani të veseve që mund të përbëjnë një pavlefshmëri të natyrës së përgjithshme (absolute), që ligji nuk e parashikon në mënyrë të shprehur³³⁸. Me fjalë të tjera, në rastet kur në mënyrë të qartë formaliteti i kryerjes së aktit sanksionohet me pavlefshmëri të posaçme të natyrës relative, mund të shtrohet vetëm problemi i një ndalimi të përkohshëm për marrjen e kësaj prove, por jo pamundësia e përdorimit të saj për të provuar fakte në procesin penal.

³³⁶ Nr.00-2010-516 i Vendimit (342), datë 14.4.2010, Vathaj: “... Së treti: konform nenit 312/1 të K.Pr.Penale, në marrjen e të dhënave nga persona që tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit duhet të respektohen rregullat për marrjen e dëshmisë (pra ato të cituara më sipër të parashikuara në nenet 153 dhe 154 të K.Pr.Penale). Në pyetjen e këtyre dy shtetasve nuk janë respektuar këto rregulla, pasi si deklaruesi P.V., ashtu dhe deklaruesi B.P. shprehen për gjëra të dëgjura në publik pa treguar burimin konkret të dijenisë dhe gjithashtu ata japin vlerësime personale të tyre, sipas arsyes së tyre. Mosrespektimi i këtyre rregullave i bën këto deklarime, konform nenit 151/3 të K.Pr.Penale, të papërdorshme.”

³³⁷ “*Prova e pavlefshme, ndonëse nuk mund të përdoret, nuk është e papërdorshme në kuptimin ngushtësisht teknik... Prova e pavlefshme mund të rifutet në procedim në rastet e një pavlefshmërie të korrigjueshme, kur ajo mund të korrigjohet;... Përkundrazi, papërdorshmëria nuk korrigjohet, ndaj prova e papërdorshme nuk mund të rifutet në proces përmes mekanizmit të korrigjimit; ... Kështu, pavlefshmëria e një akti provues nuk shkakton, si rregull, papërdorshmëri në kuptimin e vërtetë të fjalës.*” Shih Grifantini, F.M., *Inutilizzabilità*, in *Dig. Pen.*, VII, 1993, 242. *Cituar nga Di Geronimo Paolo, vep. e cit.*, faqe 194 [përkthimi ynë].

³³⁸ Di Geronimo Paolo, *ibidem*, faqe 196.

Në këtë këndvështrim e ka zgjidhur dilemën e parashtruar edhe Gjykata e Kasacionit të Italisë, e cila bën një dallim të qartë mes “*shkeljes së ndalimeve të parashikura nga ligji*” për marrjen e provave dhe “*cënimit të formaliteteve të paracaktuara për kryerjen e aktit*”³³⁹.

Nga ana tjetër, në jurisprudencën e huaj, theksohet fakti se nocioni i pavlefshmërisë së prejardhur (neni 131.1 i KPP) nuk mund të shtrihet edhe për institutin autonom të papërdorshmërisë³⁴⁰, ngaqë ligjvënësi nuk e ka parashikuar një mundësi të tillë. Pra, pavlefshmëria e formës së aktit nuk passjell detyrimisht papërdorshmërinë e provës që përmbahet në të.

Po t’i rikthehemi zgjidhjes së propozuar ndër vite nga Gjykata e Lartë, duhet të pohojmë se ajo është rrjedhojë e një interpretimi tepër të ngushtë të normës. Shtrirjen automatike e pavlefshmërisë relative të aktit në asgjësimin e vlerës së tij provuese, përmes mekanizmit të përjashtimit për shkak papërdorshmërie, nuk e shohim si zgjidhje realiste dhe në përputhje me vullnetin e ligjvënësit. Në rastin specifik të dëshmisë, nuk ka dyshim që shkelja e rregullave të parashikura nga ligji, sanksionohet me pavlefshmëri relative, e cila duhet të ngrihet nga pala e interesuar dhe brenda afateve prekluzive që parashikon Kodi. Në rast të kundërt, kjo pavlefshmëri korrigjohet dhe nuk mund të shtrohet për diskutim problemi i papërdorshmërisë së përmbajtjes së dëshmisë. Në rastet që sollëm për ilustrim, pavlefshmëria e pretenduar nuk është kundërshtuar para se akti të bëhej (neni 129.5), as para fillimit të shqyrtimit gjyqësor (neni 129.2), ndaj kolegji duket se ka dalë nga hullia e ligjshmërisë, duke zgjatur afate që ligji i konsideron prekluzive (neni 129.4).

Në rastin e dëshmisë indirekte (çështja Vathaj, *e paracituar*), zgjidhja e dhënë nga kolegji nuk lë shteg për diskutime, sepse norma sanksionon shprehimisht me papërdorshmëri thëniet mbi faktet, të mësuara nga persona të tjerë, nëse këta të fundit nuk thirren për të dëshmuar (neni 154.2 i KPP).

Duke përfunduar, mund të themi se interpretimi i ngushtë që i bën kolegji bashkëjetesës mes dy instituteve në rastin e dëshmisë të parashikuar nga neni 158 i KPP, nuk është bindës dhe duket se e zgjeron sferën e veprimit të sanksioneve të pakorrigjueshme, me pasojë kohëzgjatjen e papërligjur të procesit. Ky interpretim nuk është përkrahur si nga doktrina, ashtu edhe nga jurisprudenca e huaj, prej nga kemi huazuar pikërisht modelin e instituteve që po diskutojmë.

§ 4.4.2 Problemi i vlerës provuese të akteve të marra me anën e letërporosisë drejtuar autoriteteve të huaja gjyqësore (nenet 509-511 të KPP)

Problemet e përdorshmërisë së akteve të krijuara nga organet juridiksionale të huaja, prej vitesh janë bërë pjesë e praktikës sonë gjyqësore. Rastet e marrjes dhe përdorimit si provë të dokumenteve të prodhuara nga organet e një shteti të huaj, në rastet kur ato nuk kanë ardhur në

³³⁹ “Papërdorshmëria e një prove, sikurse parashikon neni 191.1 i KPP (përkon me nenin 151.4 të Kodit tonë – shënimi ynë), mund të ngrihet vetëm kur prova merret “*në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji*” dhe jo atëhere kur marrja, ndonëse lejohet nga ligji, kryhet pa mbajtur parasysh disa formalitete të paracaktuara. Në rastin e fundit gjen zbatim vetëm instituti tjetër i pavlefshmërisë së aktit.” (Cass. Sez. I, 11.5.1992, n. 6922, Cannarozzo; Cass. Sez. I, 29.12.1993, Cimei; etj.), *ibidem*, faqe 195.

³⁴⁰ “*Parimi që vendos neni 185, paragrafi i parë i KPP* [përkon me nenin 131.1 të Kodit tonë – shënimi ynë], sipas të cilit pavlefshmëria e një akti i bën të pavlefshme aktet e mëpasme që varen prej tij, nuk gjen zbatim në lëndë të papërdorshmërisë, që ka të bëjë vetëm me provat e marra në shkelje të ndalimeve ligjore dhe jo me të tjerat, që janë marrë në mënyrë të pavarur dhe në forma që ligji i lejon.” (C. Cost. ord. n. 332 del 2001, I, 19 ottobre 1993, Messina),

tek <http://www.cortecostituzionale.it/actionSchedaPronuncia.do>, vizita e fundit: 28.10.2015.

ekzekutim të letërporosisë për ndihmë juridike në fushën penale³⁴¹, nuk janë lejuar. Kështu, rastin e dokumentit mjekësor të përdorur për të ngritur një alibi (*qënia i shtruar në një spital të huaj në ditën e ngjarjes*), kolegji e ka konsideruar provë të papërdorshme, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor³⁴².

Kolegji ka marrë në shqyrtim edhe raste të komunikimit të drejtpërdrejtë mes autoriteteve gjyqësore, si një formë e ligjshme e ndihmës së ndërsjellë³⁴³. Në raste të kësaj natyre, nuk është pranuar pretendimi për papërdorshmëri të provave të marra³⁴⁴, kur komunikimi i drejtpërdrejtë është pasuar nga njoftimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe prej saj nuk është shfaqur vullnet pengues për t'i dhënë rrugë ekzekutimit.

Veç dy rasteve të sipërcituara, të papërdorshmërisë së natyrës patologjike, pjesë e jurisprudencës së gjykatave janë bërë edhe disa raste, të cilat kanë prodhuar papërdorshmëri të natyrës fiziologjike, gjithmonë në temën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë. Në ekzekutimin e letërporosisë, autoritetet e huaja zbatojnë rregullat e së drejtës së brendshme, por kur shtrohet problemi i përdorshmërisë së provave të marra, procedura nuk duhet të vijë ndesh me rregullat që normon Kodi ynë i Procedurës Penale. Kështu, kolegji penal ka vendosur rregullin sipas të cilit deklarimet e marra me letërporosi, në fazën e hetimeve paraprake, nuk

³⁴¹ Letërporosia për ndihmë juridike në fushën penale funksionon mbështetur në Konventën e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale”, hapur për nënshkrim në Strasburg, në vitin 1959 (Konventa e Strasburgut). Konventa u ratifikua nga Shqipëria më 4.4.2000.

³⁴² Nr.145 i Vendimit, datë 28.2.2007, Kodra, etj.: “Provohet se gjate fazes se hetimeve paraprake, nga ana e mbrojtjes se te gjykuarit H.K. eshte paraqitur si prove nje shkrese e leshuar nga nje spital i shtetit Turk, sipas te cilit ky i gjykuar ditën e ngjarjes ka qene i shtruar ne kete spital. Nderkohe qe Gjykata e Rrethit Durres kete shkrese nuk e ka permendur fare si prove, nga ana e Gjykates se Apelit Durres, shkresa eshte çmuar si e tille edhe pse ajo nuk eshte marre ne formen e kerkuar nga ligji. Sipas parashikimeve te nenit 151/1 te K.Pr.Penale, provat gjate hetimeve paraprake merren nga organi qe procedon, sipas rregullave te caktuara ne kete Kod dhe ne nenin 509 te ketij Kodi eshte percaktuar si menyra per marrjen e provave nga autoritete te huaja, leterporosia. ... si gjykata ashtu edhe prokurorite leterporosite jane te detyruara t’ia drejtojne Ministrise se Drejtesise, e cila merr masa per ta nisur. Nderkohe rezulton se shkresa e leshuar nga spitali turk nuk eshte marre sipas rregullave te caktuara ne Kod. Nga detyrimet qe rrjedhin prej parashikimeve te nenit 151/4 te K.Pr.Penale, kjo shkrese nuk mund te perdoret si prove.

Duke qene nje prove e paperdoreshme, por e perdorur dhe e cmuar ne vendimin e Gjykates se Apelit Durres, kjo e ben kete vendim te pavlevshem pasi vjen ndesh me kerkesat e nenit 152 dhe 380 te K.Pr.Penale.”

³⁴³ Komunikimi i drejtpërdrejtë mes autoriteteve gjyqësore u mbështet sidomos nga Protokollin i Dytë Shtesë i Konventës (ratifikuar nga Shqipëria më 20.6.2002, në fuqi nga data 1.2.2004). Në fakt, me anën e deklaratës së depozituar me instrumentet e ratifikimit, më 4.4.2000, vendi ynë njihte si “*autoritet gjyqësor*” vetëm Ministrinë e Drejtësisë. Kjo klauzolë, e cila pati krijuar një lloj barriere burokratike në shpejtësinë e komunikimit të ndërsjellë, ndryshoi me deklaratën e Misionit të Përhershëm të datës 27.7.2006, sipas së cilës Shqipëria njeh si autoritete gjyqësore edhe prokuroritë e gjykatat.

³⁴⁴ Nr.00-2011-590 i Vendimit (92), datë 6.7.2011, Harizaj: “Ky Kolegj konstaton se pretendimet e të pandehurit se vendimet e të dyja gjykatave nuk janë bazuar mbi prova dhe se provat e administruara në dosje janë marrë në kundërshtim me dispozitat e K.Pr.Penale (nenet 151 e vijues) janë të pabazuara dhe nuk mund të pranohen.

Siç rezultojnë prej akteve të administruara në dosjen gjyqësore, veprimet e kryera prej prokurorisë kanë qenë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, ... Të gjitha provat e administruara në dosje dhe mbi të cilat gjykatat kanë bazuar arsyetimin e tyre janë dërguar drejtpërsëdrejti nga autoritetet e huaja gjyqësore të palës kërkuese autoriteteve gjyqësore të palës shqiptare, por në çdo rast kopje të letërporosisë i janë dërguar njëkohësisht edhe Ministrisë së Drejtësisë. Në të gjitha rastet e komunikimit të drejtpërdrejtë, për shkak të urgjencës, midis autoriteteve shqiptare dhe atyre të huaja është dhënë konfirmimi nga Ministria e Drejtësisë për dhënien rrugë të letërporosisë (provave të administruara).”

mund të përdoren në gjykim për të provuar fakte³⁴⁵; gjithashtu, janë të papërdorshme dëshmitë e dhëna para prokurorit³⁴⁶, ose para gjyqtarit hetues³⁴⁷, kur përmes letërporosisë gjykata pati kërkuar pyetjen e dëshmitarëve para gjykatës. Në tri rastet e sipërcituara, është cënuar thelbi i procesit gjyqësor, parimi i kontradiktoritetit dhe i përballjes së të akuzuarit me dëshmitarët e akuzës. Si në rastin e deklarimeve të marra në fazën e hetimeve paraprake, ashtu edhe në rastin e dëshmive të marra në mënyrë të njëanshme, para një organi që kryen funksione hetimore (*prokurori, gjyqtari hetues*), nuk është siguruar kontradiktoriteti në proces, i akuzuari nuk ka mundur të ballafaqohet me dëshmitarët e akuzës, ndaj kolegji, me shumë të drejtë, i ka konsideruar të dhënat që buronin nga akte të tilla si prova të papërdorshme. Natyrisht, kjo është një papërdorshmëri relative, e natyrës fiziologjike, e cila mund të rregullohet duke korrigjuar vesin e marrjes.

³⁴⁵ Nr.571 i Vendimit, datë 17.12.2008, Peqini, etj.: “Kolegji Penal i Gjykatës se Lartë gjen të drejtë konkluzionin e Gjykatës se Apelit për Krime të Renda, pasi siç edhe ajo arsyeton, vendimi i Gjykatës se Shkalles se Pare për Krime të Renda ka në themel të tij deklarime të shtetasve të huaj gjatë fazës së hetimeve paraprake, pa ezauruar thirrjen e tyre në gjykim në kuptim të nenit 167/a të K.Pr.Penale, pra mbeshtetet në prova të papërdorshme në kuptim të nenit 151/4 të K.Pr.Penale.”

³⁴⁶ Nr.00-2009-20 i Vendimit (14), datë 4.2.2009, Shira: “Si gjykata e Shkalles se Pare për Krime të Renda, ashtu dhe ajo e apelit, ndër të tjera e kanë bazuar vendimin e tyre në deklaratimet e dëshmitarëve dhe prova të tjera të marra në zbatim të letërporosisë, konform nenit 509 të K.Pr.Penale, letërporosi e cila nuk është ekzekutuar në gjykatë, ..., meqenese pyetja e tyre është bërë përpara autoritetit të Prokurorisë së Ipsalas dhe jo para gjykatës. Realizimi i një procedure të tillë në marrjen e provës vjen në kundërshtim të hapur me procedurat e parashikuara në nenin 360 të K.Pr.Penale, për rrjedhojë, në veshtrim të nenit 360/3 të K.Pr.Penale, mosrespektimi i ketyre rregullave sjell pavlefshmeri të këtij veprimi hetimor të kryer. Gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me kerkest e nenit 3/2, 152 dhe 380 të K.Pr.Penale, pasi përveçse e kanë mbeshtetur vendimin e tyre në prova që nuk i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor i kanë dhënë provave vlerë të paracaktuar.”

Sikundër vihet re, ndonëse zgjidhja duket e drejtë, arsyetimi lë për të dëshiruar në drejtim të termave të përdorura; në këtë rast gjykata i është referuar vetëm pavlefshmërisë (relative) që shkakton moskryerja e procedurës së betimit të dëshmitarit. Në fakt, jemi para papërdorshmërisë fiziologjike që buron nga mosrespektimi i procedurës kontradiktore.

³⁴⁷ Nr.00-2012-1582 i Vendimit (299), datë 14.11.12, Kaçi: “17. Është pretenduar, gjatë rekursit dhe seancës dëgjimore nga Prokurori se, Gjykata e Apelit për Krime të Renda ka shkelur ligjin procedural penal duke quajtur të papërdorshëm deklaratimin marrë nën betim të datës 31.03.2009 nga shtetasi grek, A.M. i bërë para hetueses Ana Zairi në Greqi, si veprim që bie ndesh me Kushtetuten dhe ligjet Shqiptare.

18. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në rastin konkret, në interpretim dhe të Konventës Europiane “Për ndihmë të ndërsjelltë juridike në fushën penale” të dy protokolleve shtesë të saj ratifikuar me ligjet nr.8495, datë 10.06.1999 dhe nr.8883, datë 18.04.2002, Kushtetutës së Shqipërisë (neneve 31/d e 32 të saj), Kodit të Procedurës Penale, (nenet 149, 150, 151/2 152, 153, 154, 360 e 509) kjo pyetje, është realizuar jo nga një organ i drejtësisë Greke (gjykata) por nga një hetuese, pa praninë e të pandehurit apo mbrojtësit të tij dhe prokurorit (neni 4 i Konventës), pa u betuar dëshmitari dhe si e tillë me të drejtë gjykata e apelit e ka vlerësuar si të papërdorshme në kuptim të nenit 151 e 152 të K.Pr.Penale.”

Interes të veçantë, në temën që po diskutojmë, paraqet rasti kur duhet të kryhet një ekspertim dhe subjekti që zotëron njohuri të posaçme është shtetas i huaj. Me anën e një vendimi që shkaktoi shumë polemika, kolegji pranoi kërkesat paraprake të mbrojtjes, duke deklaruar përdorshmërinë e të dhënave që buronin nga akti i ekspertimit, me argumentin se, në raste të tilla, eksperti duhet caktuar përmes letërporosisë për autoritetet e huaja gjyqësore, duke iu referuar normave që vendos Kodi dhe Konventa e posaçme³⁴⁸.

Vendimi në fjalë nuk na duket i mbështetur në ligj dhe duket se krijon një precedent të panevojshëm. Dihet që eksperti është një person që gëzon njohuri të posaçme, në një fushë të caktuar të dijes; rëndësi ka kompetenca e tij teknike dhe aspak shtetësia e tij. Kodi nuk kërkon që eksperti të ketë me patjetër shtetësi shqiptare. Përfundimet e tij ai i paraqit me shkrim dhe i mbron para gjykatës, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të mbrojtjes, sipas një procesi kontradiktor. Nuk ka asnjë arsye të shëndoshë që të mbështesë procedurën e caktimit të ekspertit dhe marrjes së aktit përkatës përmes letërporosisë, në rastet kur eksperti është shtetas i huaj apo banon jashtë shtetit. Sikundër dihet, letërporosia diktohet nga nevoja e respektimit të sovranitetit të shtetit të kërkuar, në rastet kur një provë duhet të merret në territorin e tij, ku “...*asnjë autoritet tjetër nuk tagër të ushtrojë funksione të pushtetit gjyqësor mbi të (parimi i sovranitetit territorial)*.”³⁴⁹ Në fakt, prova ishte krijuar në Shqipëri, kurrfarë prove nuk kërkohej të merrej në shtetet ku kishin vendbanimin ekspertët; ata patën dhënë mendimin e tyre teknik dhe do t’u duhej ta mbronin para gjykatës, në seancë gjyqësore debatuese.

Konventa në fjalë, pikërisht Titulli VII i saj, të cilit i referohet kolegji, nuk ka asnjë lidhje me ekspertët dhe procedurat e ekspertimit³⁵⁰; nga ana tjetër, nuk qëndron argumenti se kësisoj

³⁴⁸ Nr.8 i Vendimit, datë 12.1.2012, Meta: “Caktimi i ekspertit në një procedim penal rregullohet nga dispozitat e seksionit të VI të K.Pr.Penale me titull “ekspertimet”. Në rastet kur eksperti është shtetas i huaj, përveç referimit në dispozitat e të Kodit të Procedurës Penale, duhet vepruar në përputhje edhe me “Konventën Europiane për Ndhimë Juridike në Fushën Penale”, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8498, datë 10.06.1999. ... Konventa në titullin VII të saj rregullon, ndër të tjera, edhe thirrjen e ekspertëve të huaj nga dhe në shtete palë të kësaj konvente.

... Duke pranuar si ekspertë persona privatë të huaj, si dhe duke u ngarkuar detyra e marrë mendimin e tyre në rrugë jo zyrtare, jashtë detyrimeve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe në Konventën Europiane për Ndhimë Juridike në Fushën Penale, organi i akuzës i ka përjashtuar ekspertët realisht nga çdo përgjegjësi, aq më tepër nga përgjegjësia penale që mund të mbajnë sipas ligjeve përkatëse në rastin e veprës penale të ekspertimit të rremë.

Nëse organi i akuzës do të kishte ndjekur rrugën ligjore të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale, në Konventën Europiane për Ndhimë Juridike në Fushën Penale, si dhe në ligjin nr.10193, datë 03.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridikionale me Autoritetet e Huaja në Çështje Penale”, ekspertët e huaj duhej të bënin betimin dhe të merrnin përgjegjësinë përpara organit kompetent të shtetit të tyre, gjë që do të shërbente si garanci që ekspertimi do të ishte i saktë.”

³⁴⁹ Omari Luan, Parime dhe institucione të së drejtës publike, Shtëpia botuese Elena Gjika, Tiranë, 1993, faqe 53.

³⁵⁰ Titulli VII bën fjalë për detyrimin e ndërsjellë të shteteve palë për këmbimin e informacionit lidhur me vendimet e dënimit dhe çdo masë tjetër që shënohet në regjistrin e gjendjes gjyqësore të personit (**Chapter VII – Exchange of information from judicial records;** <http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/09000016800656ce>, vizita e fundit: 28.9.2015)

ekspertët janë përjashtuar nga përgjegjësia penale për ekspertim të rremë³⁵¹. Gjithashtu, nuk kishte arsye pse ekspertët duhet të bënin betimin para autoriteteve të huaja, si garanci e saktësisë së ekspertimit, kur Kodi normon se ata duhet të thirrshin dhe të bënin betimin para kolegjit penal të Gjykatës së Lartë.

Në përfundim, mund të themi se mosrespektimi i procedurës për marrjen e provave jashtë shtetit përmes letërporosisë shkakton papërdorshmëri të provës së marrë, e cila mund të jetë e natyrës patologjike ose fiziologjike dhe, në këtë aspekt duket se jurisprudenca e kolegjit penal ka orientuar një zgjidhje të drejtë. Por praktika e kolegjit nuk na duket e saktë në rastet kur nevojat e procesit diktojnë caktimin dhe thirrjen e ekspertëve të huaj. Në raste të tilla, orientimi për të proceduar përmes letërporosisë, nuk ka mbështetje ligjore e logjike, çalon në planin argumentues dhe bie ndesh me arsyen ligjore mbi të cilën ngrihet instituti i ndihmës juridike ndërkombëtare në lëndë penale (*respektimi i sovranitetit të shtetit*).

§ 4.4.3 Problemi i papërdorshmërisë së provës në rastin e gjykimit të shkurtuar (nenet 403-406 të KPP)

Gjykimi i shkurtuar, si gjykim në gjendjen e akteve të ndodhura në fashikullin e prokurorit, është një rit gjykimi, me zgjedhjen e të cilit i pandehuri heq dorë nga debati mbi provat, duke pranuar që të gjykohet mbi bazën e të dhënave të marra në fazën e hetimeve paraprake. Natyrisht, sipas këtij riti, barra e akuzës për të provuar faktet objekt prove lehtësohet, ndaj të pandehurit i jepet favor i uljes së dënimit për 1/3, kurse dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me dënimin më të lartë me burgim që parashikon Kodi.

Pra, i akuzuari heq dorë nga procesi kontradiktor, kjo është një zgjedhje e tij dhe gjykatës nuk i mbetet gjë tjetër veçse ta rrëzojë ose të pranojë atë. Në temën që po diskutojmë problemi shtrohet si vijon: nëse i pandehuri pranon të heqë dorë nga garancitë e procedurës kontradiktore, mos do të thotë kjo se ai ka pranuar, njëherësh, të gjykohet mbi bazën e akteve të pavlefshme apo të provave të marra *contra legem*?

Sipas një jurisprudencë të gjerë të kolegjit penal, të pranosh të gjykohesh në gjendjen që janë aktet, do të thotë të heqësh dorë nga pretendimet për akte të pavlefshme dhe prova të papërdorshme³⁵². Sipas kolegjit, nëse kjo kërkohet, gjykata duhet të revokojë vendimin për pranimin e ritit të shkurtuar dhe të procedojë me gjykimin e zakonshëm. Nuk kemi ndonjë kundërshti lidhur me sugjerimin e fundit, por problemi shtrohet si duhet të veprohet kur pretendimet ngrihen gjatë diskutimit përfundimtar.

³⁵¹ Kodi Penal: Neni 7/I. Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj - Shtetasi i huaj, që kryen vepër penale në territorin e Republikës së Shqipërisë, përgjigjet në bazë të ligjit penal të Republikës së Shqipërisë.

³⁵² Nr.00-2013-413 (1), datë 9.1.2013, Mallkuçi: "Duke qenë një marrëveshje e pranuar nga gjykata, gjykimit të shkurtuar i mungon faza e marrjes së provave, e debatit mbi to dhe duke qenë aktet të pranuar në gjendjen që janë nga gjykata dhe i pandehuri, nuk mund të bëhen kërkesa për pavlefshmërinë apo papërdorshmërinë e tyre. Nëse ka pretendime për paligjshmërinë e akteve dhe të pandehurit e kërkojnë këtë atëherë gjykata për t'i dhënë zgjidhje pretendimeve dhe kërkesave duhet të revokojë vendimin që ajo ka marrë mbi kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar dhe të urdhërojë vazhdimin e zhvillimit gjyqësor me gjykim të zakonshëm."

Problemi i pavlefshmërive të natyrës relative besojmë se nuk ngre diskutime, pasi duke pranuar aktet në gjendjen që janë, në fakt, është korrigjuar vetvetiu pavlefshmëria e tyre³⁵³. Problemi shtrohet për pavlefshmëritë e natyrës absolute dhe për përdorimin e provave të marra në kundërshtim me ligjin, madje edhe me Kushtetutën, të cilat kanë natyrë të pakorrigjueshme³⁵⁴. Në këtë pikë nuk mund të pajtohem me këtë praktikë gjyqësore, edhe pse ajo referon tek vendimi unifikues³⁵⁵, i cili nuk orienton fare lidhur me rastin e papërdorshmërisë. Nga ana tjetër, nuk mund të pajtohem me vendimin unifikues edhe përse i takon regjimit të njëjtë që orienton si për pavlefshmëritë absolute, ashtu edhe për ato të natyrës relative³⁵⁶.

Vite më parë, e njëjta çështje u shtrua në Itali, ku jurisprudenca e Gjykatës së Kasacionit pati ecur në dy drejtime të kundërta, sa i takon mundësive për të ngritur pavlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave, në rastet kur procedohej me gjykimin e shkurtuar. Qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara ishte shumë i qartë kur pohoi se, në rastin e gjykimit të shkurtuar, gjyqtari nuk mund ta themelojë vendimin mbi bazën e akteve provuese të vesuara nga pavlefshmëri ose papërdorshmëri absolute, nisur nga arsyeja se të pranosh të gjykolesh sipas rritit të shkurtuar, nuk do të thotë të heqësh dorë nga e drejta për të ngritur veset më të rënda të aktit dhe të provave ku mbështetet akuza, pasi nuk mund të çenohet e drejta dhe detyrimi i gjyqtarit që, edhe gjatë gjykimit të shkurtuar, të jetë “*garanti i procedimit provues*”³⁵⁷. Kolegjet qartësuan edhe konceptin e gjykimit të bazuar “*në gjendjen e akteve*”, ku duhet të përfshihen “*...të gjitha dhe vetëm ato akte me vlerë provuese që nuk janë prekur nga patologji të rënda dhe të pakthyeshme, si papërdorshmëria dhe pavlefshmëria absolute, të cilat karakterizohen nga pakorrigjueshmëria dhe mundësia e ngritjes, edhe kryesisht, në çdo gjendje e shkallë të procedimit.*”³⁵⁸

Me dy fjalë, Kolegjet e Bashkuara të Kasacionit, me vendimin unifikues të sipërcituar, gjatë gjykimit të shkurtuar, përjashtuan mundësinë e ngritjes së pavlefshmërive relative të akteve dhe të papërdorshmërisë fiziologjike (*relative*) të provave, mbështetur në arsyen se ato korrigjohen automatikisht me paraqitjen e kërkesës për gjykim të shkurtuar.

Si përfundim, mund të themi se vendimi unifikues nr.2, datë 29.1.2003, është i paorientuar drejt lidhur me të drejtat që i pandehuri lëshon në rastet kur zgjedh gjykimin e shkurtuar, duke cënuar parimin e ligjshmërisë në formimin e provës dhe funksionin garantues të gjyqtarit. I pandehuri vërtet heq dorë nga garancitë e gjykimit kontradiktor, por fajësia e tij në përfundim të rritit të shkurtuar, nuk mund të mbështetet në akte absolutisht të pavlefshme, as mbi prova

³⁵³ Shih Nr.00-2013-632 i Vendimit (101), datë 20.3.2013, Medinaj; Nr.00-2013-531 i Vendimit (82), datë 6.3.2013, Quni.

³⁵⁴ Përfytyroni, bie fjala, një dëshmi të marrë nën torturë, e cila mund të vlerësohet si provë fajësie vetëm për shkak të faktit se i pandehuri ka zgjedhur ritin e shkurtuar.

³⁵⁵ Vendim i Kolegjeve të Bashkuara, nr.2, datë 29.1.2003, Zaharia, etj.

³⁵⁶ Ibidem: “Ne rast se palet kane pretendime lidhur me pavlefshmerine e akteve, qofshin pavlefshmeri absolute apo relative dhe kerkojne konstatimin apo deklarimin e kesaj pavlefshmerie, gjykata duhet te revokojë vendimin per gjykim te shkurtuar dhe te urdheroje vazhdimin e procedimit me gjykim te zakonshem.

Kur ligji parashikon se gjykata vendos te procedoje me gjykim te shkurtuar ne gjendjen qe jane aktet, nenkupton se gjykata ka detyrimin qe perpara se te marre vendimin per pranimin e kerkeses, duhet te shqyrtoje me imtesi aktet dhe ne qofte se ajo konstaton paraprakisht pavlefshmeri te tyre dhe e vene ate perpara pamundesise per te dhene nje vendim te bazuar, ajo duhet te mos e pranoje qe ne fillim kerkesen per gjykim te shkurtuar. » [*theksimi sipas vendimit*]

³⁵⁷ Cass. Sez. Un., sentenza 21.6.2000, n.16, Tammaro; tek Di Geronimo Paolo, *vep. e cit.*, faqe 283.

³⁵⁸ *Po aty*, faqe 285.

patologjikisht të papërdorshme, të cilat gjykata ka detyrimin t'i konstatojë edhe kryesisht. Nisur nga ky këndvështrim, jurisprudenca jonë ka nevojë të ngutshme të lëvizë në drejtimin e duhur.

§ 4.4.4 Problemi i përgjimit të telekomunikimeve dhe papërdorshmëria për shkak të cënimit të sovranitetit shtetëror

Në praktikën e hetimeve paraprake dhe të gjykimit të çështjeve, sidomos në rastin e trafikimit të lëndëve narkotike dhe të armëve, rëndom diskutohet përdorshmëria e provave të marra nga autoritetet gjyqësore të huaja dhe të përcjella në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor, në këndvështrimin e parimit të ligjshmërisë së provës. Disa vendime gjyqësore, të cilave do t'u referohemi në vijim, shtrojnë për diskutim pikërisht problemin e provave të marra në shkelje të autoritetit sovran të shtetit mbi territorin ku organet e tij ushtrojnë funksione juridiksionale.

Rastet që përbëjnë precedentë gjyqësorë në këtë lëmë lidhen me hetimet e autoriteteve të huaja, të cilat qëllon të përgjojnë komunikimet e thirrura nga numra që u përkasin operatorëve telefonikë që veprojnë në Shqipëri dhe që i përdorin organizatorët e trafikut. Të dhënat me vlerë provuese që burojnë prej tyre bëhen pjesë e fashikullit të gjykimit, përmes mekanizmit të letërporosisë. Problemi i shtruar për diskutim zë fill me një vendim të vitit 2008 të gjykatës së apelit për krime të rënda, Tiranë³⁵⁹. Ky vendim i deklaroi pjesërisht të papërdorshme aktet e përcjella me letërporosi nga autoritetet gjyqësore italiane, pikërisht dekretet që patën autorizuar përgjimin e numrave telefonikë që u përkisnin shtetasve shqiptarë, “...në përdorim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”. Ajo gjykatë konstatoi “...shkelje të sovranitetit të shtetit shqiptar, me pasojë papërdorshmërinë e akteve që kanë të bëjnë me përgjimet e bisedave telefonike të shtetasve shqiptarë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”. Për rrjedhojë, gjykata e apelit konkludoi se provat e siguruara përmes kësaj procedure ishin të papërdorshme për të provuar fakte në këtë proces penal, si prova të marra *contra legem*, në shkelje të sovranitetit të shtetit shqiptar. Kjo zgjidhje u konsiderua e drejtë nga kolegji penal i Gjykatës së Lartë³⁶⁰.

Rasti i dytë u regjistrua një vit më pas dhe i referohet një vendimi të marrë nga e njëjta instancë gjyqësore³⁶¹, por nga një kolegji tjetër. Vendimmarrja themelohet mbi të njëjtat argumente. Pos tyre, theksohet se autoritetet e huaja gjyqësore, duke autorizuar përgjimin e numrave të telefonisë fikse dhe të lëvizshme të përdorur nga shtetas shqiptarë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i kanë veshur vetes “...funksione ekskluzive të shtetit shqiptar, siç është funksioni publik i ndjekjes penale, ...”³⁶².

Gjykatat e vunë theksin tek “vendndodhja” e numrave telefonikë të përgjuar (natyrisht, edhe të pajisjes fundore³⁶³ që përdorte ato numra), në çastin e nisjes së thirrjeve prej përdoruesit, pavarësisht se në cilin territor ndodhej bashkëkomunikuesi i tij. Vetëm kur vendndodhja e

³⁵⁹ Vendimi nr.28, datë 19.5.2008, Fejzulla, etj., faqe 33-36.

³⁶⁰ Nr.00-2010-1027 i Vendimit (431), datë 7.5.2010, Fejzulla, etj., i paracituar.

³⁶¹ Gjykata e apelit për krime të rënda, vendim nr.27, datë 19.5.2009, E.SH., etj. Ky rast nuk u shqyrtua në Gjykatën e Lartë sepse, pas rigjykimit në shkallë të parë dhe në apel, palët nuk paraqitën rekurs.

³⁶² *Po aty*, faqe 30.

³⁶³ “...çdo pajisje në përdorim nga subjekti i përgjimit që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me një pike fundore të rrjetit të telekomunikacioneve për të realizuar telekomunikimin.” (neni 3, paragrafi 4 i ligjit nr.9157, datë 4.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikimeve”, i ndryshuar).

përdoruesit rezultonte në Shqipëri, gjykatat çmuan se çënohet sovraniteti i shtetit mbi territorin në zotërim të tij.

Në fakt, ky përfundim i gjykatave na rezulton i gabuar. Vërtet komunikimet telefonike subjektet i patën kryer duke qëndruar fizikisht në territorin shqiptar, por autoritetet e huaja nuk kanë ndërhyrë në transmetimet elektronike të kryera në hapësirën mbi këtë territor. U regjistruan prej tyre vetëm ato komunikime ndërkombëtare të cilat fizikisht kalonin në hapësirën e huaj, duke shfrytëzuar qelizat ndërmjetëse të transmetimit, të ngritura në hapësirën italiane dhe nën sovranitetin e plotë të atij shteti. Pra, prova që buronte nga përmbajtja e bisedave të përgjuara rezulton se është marrë në territorin italian, jo në territorin tonë, sikundër argumentojnë vendimet gjyqësore që po diskutojmë³⁶⁴.

Vlen të përmendet se, si gjykata e apelit për krime të rënda, ashtu edhe kolegji penal i Gjykatës së Lartë, në një rast të mëvonshëm, krejt të ngjashëm në pikëpamje të modaliteteve të ekzekutimit të përgjimit, provat që buruan prej tij i konsideruan plotësisht të përdorshme³⁶⁵. Ndonëse papërdorshmëria nuk rezulton të jetë ngritur nga mbrojtja, ishte detyrë e gjykatave ta konstatojnë atë kryesisht, edhe gjatë gjyqimit në Gjykatën e Lartë, për të konfirmuar jurisprudencën e mëparshme.

Nëse do t'i referoheshim praktikës gjyqësore të huaj, në raste të ngjashme, për përcaktimin e territorit ajo është orientuar duke iu referuar vendit ku realizohet fizikisht përgjimi³⁶⁶. Kjo linjë arsyetimi është mbështetur në vijimësi edhe nga vendime të mëvonshme³⁶⁷.

Si përfundim, mund të themi se procedura e ndjekur për marrjen e provave të fajësisë nga autoritetet e huaja gjyqësore ka qenë tërësisht e ligjshme. Për rrjedhojë, provat e siguruara kanë qenë plotësisht të përdorshme për të provuar fakte në ato procese. Argumentet e përdorura nga gjykatat për cënim të sovranitetit të shtetit shqiptar na duken të tepruara dhe të pambështetura në një analizë logjike dhe juridike bindëse, kurse rasti i ngjashëm, i zgjidhur në mënyrë kundërtëne, cënon parimin e sigurisë juridike dhe vë në dyshim drejtësinë e vendimmarrjeve të mëparshme të asaj gjykate³⁶⁸.

§ 4.4.5 *Problemi i papërdorshmërisë së akteve të kryera pas përfundimit të afatit të hetimeve paraprake (neni 324.4 i KPP)*

³⁶⁴ Përgjimi kryhet në bazë të teknikës së kanalizimit të fluksit të komunikimeve drejt të ashtuquajturave “nyje” apo “qeliza” transmetimi, të cilat ndodhen në territorin e shtetit që autorizon përgjimin e telekomunikimeve (teknika e quajtur “*intradamento-convogliamento*”).

³⁶⁵ Gjykata e apelit për krime të rënda, vendim nr.71, datë 17.12.2009, L.SH., etj.

³⁶⁶ “...kanalizimi i thirrjeve të nisura nga një zonë e caktuar jashtë shtetit tek një “qelizë” e ndodhur në Itali nuk passjell shkeljen e normave mbi letërporositë ndërkombëtare, përderisa duke vepruar kështu e gjithë veprimtaria e përgjimit, kapjes dhe regjistrimit të telefonatave kryhet tërësisht në territorin italian.” Cass. pen., sez.V, 21 ottobre 1998, n. 4401 (c.c. 2 luglio 1998), Assisi ed altri. [RV211520]. *Tek Corso Piermaria* (a cura di), *Il codice di procedura penale*, annotato con la giurisprudenza, III Edizione, CELT, 2004, faqe 643.

³⁶⁷ Cass.pen., sez.I, 31-03-2009 (04-03-2009), n.13972, B.F. ed altri.

(<http://www.gadit.it/aggiornamento.asp?id=3885&idAgg=2>);

Cass.pen., sez.VI, sent., (ud.19-01-2011) 11-03-2011, n.10088, A.L. ed altri.

(<http://www.gadit.it/aggiornamento.asp?id=27133&idAgg=2>);

Cass.pen., sez.I, sent. 5 luglio 2011, n.816, Bega ed altri.

(<http://www.penalecontemporaneo.it/upload/Cass.%20201134686.pdf>).

³⁶⁸ Për më tepër hollësi mund të lexoni: Ligorì Henrik, “*Legalità dell’intercettazioni e il principio della sovranità dello Stato*”, *Cultura e Diritti*, numero 2, aprile-giugno 2014, Pisa University Press, faqe 71-78.

Kodi normon rregullin e papërdorshmërisë së veprimeve hetimore të kryera pas përfundimit të afatit të hetimeve³⁶⁹. Kjo është një nga dispozitat më të keqkuptuara nga praktika gjyqësore, edhe për shkak të paqartësisë së zgjidhjeve të ofruara nga jurisprudenca e gjykatave ndër vite.

E ndodhur kundrejt kërkesave të pabazuara të mbrojtjes për pavlefshmëri të akteve të kryera pas përfundimit të afatit, duke përfshirë këtu edhe të ashtuquajturat akte propulsive, si njoftimi i akuzës, vendimi i dërgimit të çështjes në gjyq, etj., kolegji duket se është orientuar drejt, duke theksuar se me termin “*veprime hetimore*” duhet të kuptohen ato veprime që synojnë “*grumbullimin e provave*”³⁷⁰ dhe se sanksioni i përshtatshëm që vepron në këtë rast është “*papërdorshmëria*” dhe jo “*pavlefshmëria*”³⁷¹. Në këto vendime, theksohet ideja se provat që nuk mund të merren dot për shkak të përfundimit të afateve, gjykata nuk pengohet që t’i marrë gjatë gjykimit, si prova të reja.

Gjithashtu, kolegji e ka bërë dallimin mes veprimeve që prodhojnë prova dhe akteve që sigurojnë ecurinë e procedimit (*aktet propulsive*)³⁷², por pa u shtyrë më tej në ndonjë analizë të thelluar.

³⁶⁹ Neni 324. Zgjatja e afatit- ... 4. Veprimet hetimore të kryera pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren.

³⁷⁰ Nr.430 i Vendimit, datë 16.7.2003, Dashi, etj.: “Nga ana e këtij Kolegji cmohen si te pabazuara ne ligj pretendimet e ngritura ne rekursin e te gjykuarit S.V. per pavlefshmeri te vendimit te njoftimit te akuzes, vendimit per perfundimin e hetimeve dhe njohjen e te pandehurit me materialet e ceshtjes, kerkeses per gjykim si dhe per shkak te tyre edhe te vendimeve gjyqesore, me pretendimin se i gjykuari V. nuk eshte vene ne dijeni te vendimeve per zgjatjen e hetimeve paraprake te datave 29.1.2001, 29.04.2001 dhe 21.07.2001.

... Me termin veprime hetimore te perdorur ne nenin 324/4 te K.Pr.Penale, duhen kuptuar te gjitha ato veprime qe konsistojne ne grumbullimin e provave nga ana e organit procedues dhe se veprimet hetimore te kryera (provat e grumbulluara) pas perfundimit te afatit hetimor apo pas perfundimit te afatit hetimor te zgjatur nuk mund te perdoren nga ana e gjykates, cka nuk do te thote se ne shqyrtimin gjyqesor gjykata nuk mund t’i marre ato edhe kryesisht, ne perputhje ne ligjin, si prova te reja.”

Nr.67 i Vendimit, datë 4.2.2004, Allamani: “Kolegji Penal i Gjykates se Larte ashtu si edhe me pare sqaron se, me permbajtjen e pikes 4 te nenit 324 te K.Pr.P. duhen kuptuar te gjitha ato veprime qe konsistojne ne grumbullimin e provave nga ana e organit procedues (te hetimit) dhe se veprimet hetimore te kryera (provat e grumbulluara) pas perfundimit te afatit hetimor, apo pas perfundimit te afatit hetimor te zgjatur nuk mund te perdoren nga ana e gjykates. Por, kjo nuk do te thote se, gjate shqyrtimit gjyqesor gjykata nuk mund t’i marre ato edhe kryesisht, ne perputhje me ligjin, si prova te reja.”

³⁷¹ Po aty: “... Per rrjedhoje, si gjykata e shkalles se pare, ashtu edhe ajo e apelit nuk duhej t’i konsideronin te pavlefshme aktet procedurale te kryera pas perfundimit te afatit te hetimeve, por te paperdorshme. Ndryshe nga sa ka arsyetuar gjykata e apelit, gjykata e shkalles se pare duhej ta gjykonte ceshtjen ne themel mbeshtetur ne ato akte qe nuk jane te paperdorshme dhe ne rast kerkeses te paleve, ose edhe kryesisht gjate shqyrtimit gjyqesor, te merrte prova apo akte te reja.”

³⁷² Nr.536 i Vendimit, datë 13.7.2005, Hila: “Eshte e vertete qe disa prej veprimeve hetimore ne kete ceshtje jane kryer pas mbarimit te afatit te hetimit, siç jane vendimi i marrjes si te pandehur, vendimi i dergimit te ceshtjes per gjykim dhe kerkesa per gjykim, ... Keto veprime procedurale ne kuptim te kerkesave te nenit 324/4 te K.Pr.Penale nuk mund te trajtohen si veprimet e tjera hetimore sikurse jane marrja dijeni per vepren penale, sigurimi i burimit te provave, te cilat nuk mund te perdoren nese jane kryer pas mbarimit te afatit,...”

Në një vendim të mëvonshëm, kolegji ka hedhur idenë e gabuar se sanksioni i papërdorshmërisë së veprimeve të kryera jashtë afatit, nuk vepron kur gjykata vendos t'i pranojë aktet e papërdorshme në cilësinë e provës³⁷³, duke i veshur gjykatës të drejtën e korrigjimit të papërdorshmërisë, të cilën ligji procedural nuk ia lejon. Gjithashtu, në jurisprudencën e kolegjit, shprehen dukshëm paqartësitë për dallimin mes papërdorshmërisë së provave dhe pavlefshmërisë absolute të akteve³⁷⁴.

Në një rast tjetër, praktika gjyqësore u orientua në një drejtim diametralisht të kundërt, teksa pranoi se me përfundimin e afateve të hetimit, procedimi mbetet “pezull”; gjithçka goditet nga pavlefshmëria: ftesa për paraqitje, akti i njoftimit të akuzës, vendimi i dërgimit në gjyq, etj.³⁷⁵

Pas këtij parashtrimi të luhatjeve të praktikës gjyqësore lidhur me papërdorshmërinë e veprimeve hetimore të kryera pas përfundimit të afatit, duhet të theksojmë edhe njëherë se papërdorshmëria është një sanksion procedural autonom që godet aktet me vlerë prove. Si e tillë ajo nuk mund të veprojë mbi aktet propulsive të procedimit; madje, me termin “veprime hetimore”, sipas nenit 324 të KPP, nuk mund të kuptohen as kërkesa për caktimin e masave të sigurimit³⁷⁶, apo kërkesa për vendosjen e sekuestros preventive, të cilat nuk janë akte me fuqi provuese në drejtim të akuzës, ndaj nuk mund të veprojë sanksioni i parashikuar nga kjo normë.

Papërdorshmëria e provave të marra jashtë afatit të hetimeve paraprake është papërdorshmëri relative, e natyrës fiziologjike; ajo nuk mund të barazohet tërësisht me provat e

³⁷³ Nr.237 i Vendimit, datë 15.3.2006, Bytyçi: “Edhe arsyetimi tjetër i ketyre gjykatave se te gjitha aktet procedurale te kryera pas rifillimit te hetimit date 23.09.2002 jane te paperdorshme mbasi nuk eshte bere zgjatja e afatit te hetimit, eshte i gabuar. Edhe sikur te qendroje pretendimi se ne rastin konkret kane kaluar afatet e hetimit dhe me rifilimin e hetimeve duhet te behet zgjatja e ketyre afateve, keto akte pamvaresisht nga ç'fare arsyeton gjykata, per deri sa i jane nenshtuar shqyrtimit gjyqesor dhe jane administruar nga gjykata, kane vleren e plote procedurale,...”

³⁷⁴ Nr. 00-2011-579 i Vendimit (101), datë 13.7.2011, Shahini, etj.: “Ky Kolegj konstaton se ushtrimi i ndjekjes penale dhe kryerja e veprimeve hetimore deri në datë 18.12.2008, përtej afatit të hetimeve, i cili ka përfunduar në datë 28.11.2008, është një shkelje e rëndë procedurale e cila bie ndesh me dispozitat e nenit 323 të K.Pr.Penale, e cila përcakton se brenda afatit të hetimeve paraprake prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj. Në kuptim të nenit 128/1 (b) të gjitha aktet e nxjerra përtej datës së mësipërme do të konsiderohen si “absolutisht të pavlefshme” për shkak të mosrespektimit të dispozitave urdhëruese të ligjit procedural penal që lidhen me “të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim”.”

³⁷⁵ Nr.Akti 1623, datë 15.12.2008, vendim i gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë: “... rezulton se afati per kryerjen e veprimeve hetimore dhe perpilim i akteve procedurale nga prokuroria ..., ka qene data 06.11.2008, pas kesaj date prokurorit nuk mund te kryente asnje veprim hetimor, apo te perpilonte akte te tjera procedurale ...”

“... rezulton se aktet procedurale te ndermara pas perfundimit te afatave te hetimeve paraprake ..., sic jane flete -thirrja e dates 24.11.2008, si dhe Akti I njoftimit te Akuzes dates 27.11.2008, ..., perpiluar pasi kishin perfunduar afatet e hetimeve paraprake, ne keto kushte del qarte se dy aktet procedurale jane te pavlefshme.” (citimi sipas vendimit, pa korrigjime).

³⁷⁶ Me veprime hetimore duhet të kuptojmë vetëm ato akte që kanë fuqi provuese në drejtim të akuzës: kështu, p.sh., nuk mund të quhet veprim hetimor kërkesa për caktimin e masës së sigurimit, e cila synon marrjen e një vendimi incidental lidhur me sferën e lirisë vetjake të të hetuarit (*Vendim i Gjykatës së Kasacionit, 12.1.2000/215306*), ose sekuestroja preventive, që synon vetëm ndërprerjen e sjelljes së ndaluar nga ligji (*Vendim i Gjykatës së Kasacionit, 7.2.1994/196636*); tek Borrelli G., etj. (*a cura di*), Codice di procedura penale operativo, Annotato con la dottrina e giurisprudenza, VI Edizione, Edizioni giuridiche Simone, 2010, faqe 731.

marra *contra legem*, që sanksionon neni 151.4 i KPP. Si e tillë ajo nuk ngrihet kryesisht, por mbi kërkesë të palës që akuzuar, që cënohet nga vlera e saj provuese, ndaj sanksioni nuk vepron në rastet kur i pandehuri zgjedh gjykimin e shkurtuar. Doktrina dhe jurisprudenca e huaj, që i referohet të njëjtit rregullim ligjor, ka qenë shumë e qartë në drejtim të regjimit të papërdorshmërisë së provave të marra pas përfundimit të afatit të hetimeve paraprake³⁷⁷.

Nga sa parashtruar vijmë në përfundimin se praktika gjyqësore ka pasur luhajtje dhe zgjidhje gati kontroverse, sa i takon natyrës së vesit dhe pasojave që shkakton përfundimi i afatit të hetimeve në lidhje me provat. Ndaj, është nevojë e ngutshme mbledhja e Kolegjeve të Bashkuara për t'i dhënë një zgjidhje të arsyeshme problemit që sapo diskutuam.

§ 4.4.6 Problemi i regjistrimit të komunikimeve nga njëri prej të pranishmëve (inter praesentes)

Në praktikën gjyqësore, prej vitesh, është debatuar lidhur me vlerën provuese të të dhënave që burojnë prej regjistrimit të bisedave, nga njëri prej të pranishmëve në bisedë. Çështja është ngritur në planin e cënimit të privatësisë së komunikimeve, për shkak se regjistrimi i kryer nuk ka qenë i autorizuar prej gjyqtarit; për rrjedhojë, prova është marrë në kundërshtim me ligjin procedural, madje, edhe me Kushtetutën, ndaj është e udhës të veprojë sanksioni i papërdorshmërisë së provës (neni 151.4 i KPP)³⁷⁸.

Në disa raste të mëparshme, në fakt, kolegji nuk e pati ngritur një problem të tillë; është fjala për regjistrimin, me zë dhe me pamje, të bisedave jo më nga personi i pranishëm, por nga gazetarët investigativë (*emisoni i njohur "Fiks Fare"*). Në këto raste³⁷⁹, kolegji ka vendosur mospranimin e rekursit, fakt që do të thotë se nuk ka konstatuar probleme të kushtetutshmërisë apo të ligjshmërisë së provës.

Nëse do t'i rikthehemi rastit të cituar më parë³⁸⁰, kolegji nuk e ka pranuar kërkesën e mbrojtjes për papërdorshmërinë e regjistrimit të kryer nga njëri prej të pranishmëve në bisedë, të

³⁷⁷ "Njëra nga karakteristikat e veçanta të papërdorshmërisë së parashikuar nga neni 407.3 (përkon me nenin 324.4 të Kodit tonë – shënimi ynë), në dallim nga ajo që parashikon neni 191 (përkon me nenin 151.4 të Kodit tonë), e cila ngrihet edhe kryesisht, në çdo gjendje e shkallë të procedimit, është konstatimi dhe ngritja e saj me nismën eskuzive të palës së interesuar... Ky qëndrim përlligjet nga fakti se, duke qenë një sanksion që u referohet rezultateve të hetimeve dhe jo provave, pala mund të jetë e interesuar që veprimi i kryer jashtë afatit të mund të përdoret."; tek Spangher Giorgio (*diretto da*), *Atti processuali penali, patologie, sanzioni, rimedi*, Wolters Kluwer, 2013, faqe 2138.

³⁷⁸ Nr.00-2008-116 i Vendimit (570), datë 17.12.2008, Dibra: "...ky Kolegj vlereson se me te drejte gjykata e shkalles se pare i ka konsideruar te paperdoreshme si prova ato kaseta filmike, pasi konstaton gjithashtu se jane marre ne shkelje te neneve 221, 222, 223 te K.Pr.Penale e ne baze te nenit 226/1 te K.Pr.Penale perdorimi i tyre eshte ligjerisht i ndaluar, aq me teper po te kemi parasysh ate cfare saksionon neni 32/2 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, se "askush nuk mund te deklarohet fajtor mbi bazen e te dhenave te mbledhura ne menyre te paligjshme".

³⁷⁹ Shih vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë: nr.227, datë 3.3.2005, Dosti; nr.797, datë 11.7.2005, Dushi, etj.; nr.34, datë 24.1.2006, Toto; nr.897, datë 6.10.2006, Myftari, etj.

³⁸⁰ Nr.8 i Vendimit, datë 12.1.2012, Meta, i paracituar (§ 4.4.2), par. 8, me ç'rast Kolegji vendosi, me vendim të ndërmjetëm: "Rrëzimin e kërkesës paraprake për papërdorshmërinë e videoregjistrimit të realizuar nga shtetasi D.P. sepse është bërë në shkelje të nenit 221 e vijues të Kodit të Procedurës Penale mbi "Përgjimet", me arsyetimin se videoregjistrimet e realizuara jo nga organet e procedimit por nga subjektet private nuk përfshihen në rastet dhe kriteret që përmbahen në Titullin IV, Kreu III, Seksioni IV "Përgjimet" (nenet 221 e vijues) të Kodit të Procedurës Penale." [nënvizimi sipas vendimit – shënimi ynë].

ngritur në këndvështrimin e cënimit të normave mbi përgjimet; çështja është trajtuar vetëm në këndvështrimin e papërdorshmërisë së aktit të ekspertimit për arsye të cënimit të normave mbi letërporositë ndërkombëtare.

Pra, megjithë luhatjet në vite, kolegji duket se është orientuar drejt, duke theksuar se normat ndaluese për përgjimin e telekomunikimeve dhe formave të tjera të komunikimit, nuk shtrihen mbi privatët, por mbi organet shtetërore. Vlen të theksojmë se, përmes rregullave për përgjimet, ligjvënësi ka synuar të mbrojë privatësinë e komunikimeve nga ndërhyrjet e pakontrolluara të organeve shtetërore; në rastin e regjistrimit të bisedës nga personi i pranishëm në të nuk ka kuptim të flitet për privatësi, pasi bashkëbiseduesi, me vullnet të lirë, pranon të ndajë me personin që regjistron bisedën, pa dijeninë e tij, fakte të jetës së vet, që mund të kenë edhe karakter privat. Këtu nuk ka kurrfarë paligjshmërie: sikundër vëren doktrina³⁸¹, nuk ka asnjë ndalim për përdorimin e të dhënave të regjistruara, edhe për faktin se personi i pranishëm nuk pengohet që faktet e dëgjua t'i sjellë para gjykatës përmes mjetit të dëshmisë. Nëse do të ishte ndryshe, mbrojtja e sekretit të komunikimeve do të krijonte një situatë absurde, ngaqë nuk do të lejohej as dëshmia lidhur me faktet e perceptuara drejtpërsëdrejti.

Problemi i regjistrimit të bisedës nga njëri prej të pranishmëve (*inter praesentes*) është plotësisht i përdorshëm si provë. Jurisprudenca e huaj ka qenë shumë e qartë lidhur me këtë çështje. Kështu, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit në Itali, pasi japin kuptimin e përgjimit të bisedimeve dhe telekomunikimeve (*përkufizim që nuk e jep KPP*)³⁸², vijnë në përfundimin se regjistrimi fonografik i një bashkëbisedimi ose komunikimi, i kryer nga njëri prej personave të pranishëm në bisedë, pa dijeninë e tjetrit (ose të tjerëve) “... nuk përbën përgjim, sepse i mungon tipari themelor, pikërisht prania e të tretit që nga jashtë ndërfitet në mjedisin privat të padhunueshëm, duke regjistruar bisedën.”. Sipas Gjykatës, ky regjistrim përbën provë dokumentare dhe është plotësisht i përdorshëm për të provuar fakte, nëse nuk dhunon rregullat e veçanta për marrjen e provave³⁸³.

Si përfundim, megjithë luhatjet që konstatohen ndër vite, së fundi, jurisprudenca jonë është orientuar drejt pranimit si provë të fakteve që burojnë nga bisedat apo komunikimet e regjistruara nga njëri prej të pranishmëve në bisedë.

§ 4.4.7 Mbi disa probleme të tjera të praktikës gjyqësore lidhur me papërdorshmërinë e provave.

Sikurse kemi përmendur problemi i provave të marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji dhe çështja e përdorimit të tyre në procesin penal, është një problem i ndërlikuar. Vështirësia e interpretimit lidhet me faktin se papërdorshmëria është sanksion me natyrë të përgjithshme, ndaj duhet trajtuar rast pas rasti. Në vijim, do të sjellim disa probleme të praktikës gjyqësore për papërdorshërinë, të cilat nuk janë përfshirë tek rubrikat e trajtuara më sipër.

Një rast interesant sjell praktika gjyqësore sa i takon aktit të paraqitjes për njohje të personit. Sikundër dihet ka disa rregulla të formës, mosrespektimin e të cilave Kodi e sanksionon

³⁸¹ Lozzi Gilberto, *vep. e cit.*, faqe 208.

³⁸² “Përgjimi “ritual” ka të bëjë me kapjen e fshehtë, në kohë reale, të përmbajtjes së një komunikimi ose bashkëbisedimi, mes dy ose më shumë personave, nga ana e subjekteve të tjera, që nuk kanë lidhje me komunikimin” (La Corte Suprema di Cassazione, Sezioni Unite Penali, Sentenza n.11, del 28.5.2003, Torquasio); *tek Diritto Penale e Processo*, Nr.10-2009, faqe 1274: “Revirement sulle registrazioni effettuate con mezzi forniti dalla Polizia Giudiziaria”, commento di Francesca Decaroli.

³⁸³ Shih edhe: Spangher Giorgio (diretto da), *vep. e cit.*, faqe 1227.

me pavlefshmëri të njohjes³⁸⁴. Një njohje e pavlefshme, natyrisht, nuk mund të përdoret për të provuar fakte në proces. Sigurisht që, nuk kemi të bëjmë me një provë të ndaluar nga ligji, pavlefshmëria është relative dhe papërdorshmëria – fiziologjike, por, për shkak të veçorisë së aktit, pasojat janë thujse të pakthyeshme (*përsëritja e aktit të njohjes, si rregull, e kompromenton rezultatin, duke e bërë provën e njohjes të pabesueshme*).

Por, megjithëse akti është delikat, jurisprudenca paraqit raste gabimesh shumë të rënda. Ndonëse njohja kërkon kushte të përafërta të personave të paraqitur, në rastin në fjalë i dyshuari, i veshur me kostum të bardhë u vendos mes tri personave të veshur me të zeza. Kjo njohje është e pavlefshme, por kolegji e ka pranuar si të mirëqenë me disa argumente tërësisht alogjike³⁸⁵: nuk ka fare rëndësi nëse i dyshuari e ka pasur apo jo cilësinë e të pandehurit (të hetuarit) në çastin e njohjes, përderisa kjo cilësi iu atribua, edhe falë këtij akti. Të bën përshtypje fakti se jemi para një versioni të ri të çështjes **Laska dhe Lika kundër Shqipërisë**³⁸⁶ që, Gjykata e Strasburgut e konsideroi si një rast tipik kur shkelja flagrante në procesin e marrjes së një prove, e bën procesin e parregullt në tërësinë e tij (prova e paraqitjes për njohje ishte prova vendimtare

³⁸⁴ Shih nenin 171.3 të KPP.

³⁸⁵ Nr.00-2011-1141 i Vendimit (149), datë 10.11.2011, Qejvanaj: “Kundër vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Vlorë ka ushtruar rekurs i gjykuari R. (V.) Qejvanaj, i cili kërkon pushimin e këtij vendimi dhe pushimin e çështjes, duke parashtruar këto shkaqe:

... - Në paraqitjen për njohje tre persona kanë qenë veshur me të zeza, ndërsa i pandehuri me kostum veror të bardhë.

... Ky Kolegj konstaton gjithashtu se edhe pretendimi tjetër për pavlefshmërinë e proces-verbalit të paraqitjes për njohje është i pabazuar. ... Në të kundërt të asaj që pretendon i gjykuari, rezulton se në momentin e kryerjes së njohjes, i gjykuari Qejvani nuk ka pasur cilësinë e të pandehurit dhe as të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, pasi njohja është kryer në të njëjtën ditë me regjistrimin e procedimit penal.

Për më tepër, procesverbali i njohjes është në harmoni me provat e tjera të administruara nga gjykatat, të cilat në tërësinë e tyre krijojnë bindjen se i gjykuari është autori i veprës penale për të cilën është akuzuar.”

³⁸⁶ Çështja Laska dhe Lika kundër Shqipërisë, Ankimet nr.12315/04 dhe 17605/04, Strasburg, 20 prill 2010: “Në fillim, ankuesve dhe B.L. iu kërkuan të qëndronin në rresht duke mbajtur veshur kapuç të bardhë dhe blu, të ngjashëm në ngjyrë me ato të veshur nga autorët e krimit. Dy personat e tjerë në rresht mbanin kapuç të zinj, në kontrast të qartë me kapuçat bardhë e blu të veshur nga ankuesit dhe B.L. të cilët akuzoheshin për kryerjen e krimit. Ndryshimi i pozicionit të personave në rresht nuk rezultoi në ndonjë rezultat të ndryshëm për ankuesit, meqenëse atyre vazhdimisht u kërkohet të vishnin të njëjtën ngjyrë kapuçi (bardhë dhe blu) (shih paragrafin më lart). Gjykata konstaton se parada e identifikimit ishte e barasvlershme me një ftesë të hapur për dëshmitarë për të vënë gishtin e fajit mbi të dy ankuesit dhe B.L. si autorë të krimit. ...

Gjykata konsideron se në rrethanat e çështjes së ankuesve, drejtësia kërkonte që ata të mund të argumentonin se kapuçat që u ishin kërkuar atyre të vishnin në paradën e identifikimit, të cilët përbënin provën vendimtare për dënimin e ankuesve, ishin krejtësisht të ndryshëm nga ato të veshur nga grabitësit. Megjithatë, në gjyq atyre iu mohua mundësia të rivendosnin parregullsitë që kishin ndodhur në paradën e identifikimit. Në këtë drejtim, Qeveria nuk iu referua ndonjë arsyeje të interesit publik për të fshehur prova të tilla, dhe arsye të tilla nuk janë të dukshme nga procedimet gjyqësore vendase.

Në përfundim, duke pasur parasysh konstatimet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin që procedimet gjyqësore në fjalë nuk përmbushnin kushtet e një gjykimi të drejtë. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në çështjen aktuale.”

Tek: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_te_vitit_2010_737_1-103.php, vizita e fundit 21.10.2015.

ku mbështetej akuza). Ashtu si në rastin që përmendëm, dallimi i qartë në veshje i të dyshuarit nga personat që u rreshtuan përbri tij, ka qenë një ftesë e pandershme për ta njohur atë³⁸⁷.

Në një rast tjetër, kolegji me të drejtë tërheq vëmendjen se vendimi penal i huaj nuk mund të përdoret nëse ai nuk është njohur nga juridiksioni ynë, dëshmitë e shtetasve të huaj nuk mund të përdoren pa u siguruar kontradiktoriteti, kurse njohja me foto pa respektuar procedurën – është e pavlefshme³⁸⁸.

³⁸⁷ Si raste gjykimi të drejtë mund të lexoni vendimet: nr. 00-2010-592 i Vendimit (13), Kamberaj; nr. 00-2010 – 543 i Vendimit (14), Bushaj; nr. 00-2010- 481 i Vendimit (15), Ismaili, datë 7.4.2010; rekurs kundër vendimit për caktimin e masës së sigurimit: “... rezulton se janë bërë dy paraqitje për njohje dhe në të dy rastet kanë paraqitur të njëjtët persona të pranishëm. Konkretisht në paraqitjen e parë për njohje në orën 19⁰⁰ është paraqitur personi nën hetim E.K. dhe shtetasit A.H., Sh.Gj. dhe A.M., ku dëshmitarja G.Z. ka njohur E.K., ndërsa në paraqitjen e dytë për njohje, në atë të orës 21⁰⁰, kanë marrë pjesë të tre personat e mëparshëm, por në vend të E. është vendosur personi tjetër nën hetim, Sh.I. Duke vepruar në këtë mënyrë, kur këta tre persona për rreth 2 orë i kishte përpara dëshmitarja G.Z. dhe i kishte përjashtuar nga mundësia e pjesëmarrjes në krim, pak minuta më vonë duke shtuar një të ri në radhët e tyre, personin nën hetim Sh.I., tregon qartë se njohja e këtij të fundit ishte e paracaktuar, e për rrjedhojë vërtetësia dhe vlera e saj provuese është e dyshimtë.

Kërkesë e nenit 172.1 të K.Pr.Penale është që personat që paraqiten për njohje duhet të jenë sa më të ngjashëm me atë që duhet të njihet. Në rastin konkret këta tre persona, me të cilin ishin të ngjashëm, me të ndaluarin E. apo me të ndaluarin Sh., apo me asnjërin, aq më tepër kur mbrojtja e dy të ndaluarve ka pretenduar se të ndaluarit nuk kanë asnjë ngjashmëri as me njëri tjetrin.

Përveç sa sipër, personat që janë paraqitur për njohje janë në ndryshim të dukshëm në moshë me personat që duhet të njihen (me të ndaluarit), deri në 15 vjet më të rinj. Konkretisht, i ndaluarit Sh.I. është i datëlindjes 30.08.1968, ndërsa personi i paraqitur për njohje, A.F.H., është i datëlindjes 25.02.1983 apo personi tjetër A.M. i datëlindjes 20.10.1976, etj. Edhe mungesa e dokumentimit të paraqitjes për njohje me fotografi apo filmim (neni 172.3 të K.Pr.Penale), e vënë në dyshim zbatimin e kësaj kërkesë ligjore në lidhje me ngjashmërinë e personave.

Kryerja e veprimeve si më sipër, duke mos respektuar kërkesat e dispozitave ligjore të parashikuara nga nenet 171 e 172 të K.Pr.Penale, krijon dyshime mbi vërtetësinë dhe vlerat e saj provuese deri në atë shkallë, sa të çon në deklarinim e papërdorshëm të saj.” (*theximi sipas vendimit – shënimi ynë*).

³⁸⁸ Nr.00-2013-1005 i Vendimit (196), datë 12.6.2013, Oruçi: “16. Gjykata e apelit ka deklaruar fajtor të gjykuarin I.O., mbështetur në një provë të vetme që është vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Athinë, sipas të cilit është shpallur fajtor i gjykuari për veprën penale të “Armëmbajtjes pa leje” dhe “Përdorimit të armës pa leje”. Kjo gjykatë (e Apelit Shkodër) nuk ka marrë parasysh faktin se për këtë vendim nuk është bërë njohje e vendimit penal të huaj sipas neneve 512 e 518 të K.Pr.Penale duke u cenuar në këtë mënyrë e drejta e të gjykuarit për një proces të rregullt ligjor. Kjo logjikë përforcohet edhe me faktin se ky vendim i huaj është dhënë ndaj të gjykuarit I.O. në mungese të tij.

17. Gjykata e Shkallës së Parë Kukës, me të drejtë ka marrë në konsideratë faktin se, duke parë deklarinimet e tre dëshmitarëve shtetas grekë të dhëna para autoriteteve greke, në ditët e para pas ngjarjes vërejmë se asnjë prej tre dëshmitarëve nuk ka njohur autorin drejtpërdrejt më përpara në kohë. Në deklarinimet e dhëna para policisë, të shtetasve greke, është folur për një person të quajtur “Alqi” që dyshohej se ishte nga Shqipëria. Gjykata e faktit në pamundësi të ardhjes së këtyre dëshmitarëve para trupit gjykues për të bërë të mundur të verifikonte këto thënie, ka kërkuar pyetjen e tyre qoftë edhe në shtetin grek por për shkaqe të pavarura nga autoritetet shqiptare nuk është bërë e mundur kjo procedurë duke kaluar në leximet e lejueshme të këtyre dëshmimeve.

Të papërdorshme, sipas kolegjit, janë edhe leximet e lejueshme, kur prova merret më pas faqe gjykatës, në seancë gjyqësore debatuese³⁸⁹. Në fakt, kolegji gabon me këtë përgjithësim, sepse ndalimi nuk është absolut: përdorshmëria e tyre është vetëm e kufizuar: ato mund të lexohen për ta bërë të pabesueshme dëshminë në gjyq, por mund të kenë vlerë provuese kur *“lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre”*³⁹⁰.

Papërdorshmëri të provave të marra shkakton edhe cilësia e papërshtatshme e subjektit, kur përdoret metoda e posaçme e infiltrimit në përbërje të grupeve kriminale. Në raste të tilla, ai duhet të gëzojë statusin e oficerit të policisë gjyqësore, për shkak të natyrës delikate të misionit të tij, i cili kërkon një nivel të caktuar aftësish profesionale dhe intelektuale. Në fakt, subjekti në fjalë nuk e gëzonte një cilësi të tillë, ndaj rezultatet e provave të siguruar prej tij, kolegji i ka përjashtuar nga përdorimi³⁹¹. Konkluzioni kategorik i kolegjit na duket i tepruar dhe në

... 19. në gjykimin e çështjes nga gjykata e faktit është provuar qartë se, procedura e njohjes së personit me fotografi, sipas të cilës dëshmitarja K.P.A. ka njohur të gjykuarin I.O., është bërë vetëm nëpërmjet fotografisë së paraqitur nga policia greke, e cila nuk dihet se në ç’rrugë është siguruar, pa fotografi të tjera të ngjashme, pa praninë e mbrojtësit të personit ndaj të cilit zhvillohej njohja, duke e bërë këtë provë të pavlefshme dhe pa vlerë provuese në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.”

³⁸⁹ Nr.00-2012-1261 i Vendimit (232), datë 19.9.2012, Lika: “23. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka pranuar të dëgjojë dëshminë e të dëmtuarës gjatë debatit gjyqësor për më tepër kur ajo përbën dhe provën kryesore dhe të vetme të akuzës. Dëgjimi dhe debati gjatë shqyrtimit gjyqësor mbi këtë provë merr një rëndësi të veçantë në kushtet kur organi i akuzës provueshmërinë e fajësisë për të gjykuarin e ka mbështetur vetëm mbi këtë provë, pa e konfirmuar atë me prova të tjera. Palëve duhet t’i jepet mundësia që të debatojnë mbi provat dhe në rastin e dëshmitarëve të kenë mundësinë t’i drejtojnë pyetje në lidhje me faktet që ata dëshmojnë.

... 25. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se leximet e lejueshme sipas nenit 362 të K.Pr.Penale nuk përbëjnë provë në vetvete dhe mund të vlerësohen si të tilla vetëm në mungesë të marrjes së dëshmisë në gjykatë. Pavarësisht se ato mund të jenë pranuar nga gjykata dhe janë bërë pjesë e fashikullit ato janë të papërdorshme në rast se para gjykatës arrihet të merret dëshmia në mënyrë të drejtpërdrejtë.”

³⁹⁰ Neni 362.3 i KPP.

³⁹¹ Nr.00-2012-941 i Vendimit (201), datë 5.7.2012, Brahimaj, etj.: “28. Përveç sa më sipër, ashtu siç me të drejtë ka konstatuar edhe mbrojtësi i të gjykuarit D.I., në rekursin e paraqitur para Gjykatës së Lartë, ky Kolegj, duke iu referuar dëshmisë së bërë nga shtetasi R.Xh. në gjykim, si dhe procesverbaleve të përgjimeve të bisedave telefonike, vlerëson se “veprimet simuluese” të kryera nga ky shtetas, në të vërtetë nuk kanë qenë veprime që mund të kryhen sipas nenit 294/a të Kodit të Procedurës Penale, por kanë qenë veprime që kanë të bëjnë me infiltrimin e tij në grupin e personave që mund të kryenin një krim, të cilat nuk mund të kryhen kurrësi nga një shtetas i zakonshëm, siç është shtetasi R.Xh., por vetëm nga një oficer i policisë gjyqësore. Një gjë e tillë rezulton e parashikuar në mënyrë të shprehur nga pika 1 e nenit 294/b të Kodit të Procedurës Penale në të cilën parashikohet se: “1. Për qëllimet e zbulimit të krimeve të rënda, oficeri i policisë gjyqësore, me autorizimin e prokurorit, mund të futet në përbërjen e një grupi kriminal për të individualizuar pjesëtarët e grupit dhe për të mbledhur të dhëna të nevojshme për hetimin, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e vet si punonjës policie”.

“29. Duke iu referuar akteve dhe provave të shqyrtuara, rezulton e qartë se ajo çfarë ka bërë shtetasi R. Xh., megjithëse me “autorizimin” e paligjshëm të prokurorit, nuk është gjë tjetër, veçse infiltrimi në një grup kriminal, ku më pas, ka bërë individualizimin e personave dhe ka mbledhur të dhëna të nevojshme për hetimin, veprime që sipas akuzës janë “kurorëzuar” me sukses me arrestimin e të pandehurve, por, që këto veprime ky shtetas nuk kishte asnjë të drejtë ligjore që t’i kryente dhe për pasojë të gjitha rezultatet e ardhura prej tyre, përfshirë edhe

kundërshtim me ligjin; nuk ka ndonjë normë ligjore që të sanksionojë me papërdorshmëri rezultatet e marra falë infiltrimit të një subjekti të papërshtatshëm. Në të gjitha hipotezat e përdorimit të metodave të posaçme të hetimeve, ligjvënësi sanksionon me papërdorshmëri vetëm rezultatet e siguruara përmes provokimit³⁹². Në këtë rast, provokim nuk ka pasur, por subjekti i infiltruar nuk i gëzonte cilësitë e kërkuara nga ligji, ndaj përfshirja e tij në një operacion delikat mund të passillte një procedurë disiplinore për personat përgjegjës, përfshi edhe prokurorin. Madje, kolegji ka dalë krejtësisht jashtë kuadrin ligjor kur ka përjashtuar nga përdorimi edhe dëshminë e dhënë nga ky subjekt para gjykatës, duke krijuar një rast “*pavlefshmërie të prejardhur*” që nuk është parashikuar nga ligjvënësi. Në fakt, sikurse do ta shohim në vijim, zbatimi tepër i ngurtë i normave për papërdorshmërinë nga juridiksioni ynë, është një tejkalim i vullnetit të ligjvënësit dhe nuk gjen shembuj referues në jurisprudencën e huaj (*shih në vijim, § 4.5*).

Në një rast tjetër, kolegji me të drejtë ka konsideruar të papërdorshme faktet që burojnë nga një deklaratë noteriale, e përfshirë në aktet e gjykimit me diskutimin përfundimtar të mbrojtjes³⁹³. Arsyetimi qëndron pasi është përfshirë me aktet një dokument me vlerë provuese i pashqyrtuar, për shkak të ritit të shkurtuar.

Nisur nga fakti se, në praktikën gjyqësore, shënohen raste të pranimit si provë të deklaratave noteriale³⁹⁴, problemi duhet parë edhe në një këndvështrim tjetër: *a mund të përdoret për të provuar fakte në proces një dëshmi e dhënë në formën e një deklaratë para noterit?* Sipas procedurës sonë dëshmitari pyetet në seancë gjyqësore, nga protagonistët e procesit, sipas rregullit të *cross-examination*, por edhe nga gjykata, në rast se lind nevoja për të sqaruar faktet. Kjo është e pamundur të realizohet para noterit, të cilin ligji e ngarkon të provojë, përmes aktit noterial, vërtetësinë e fakteve që kanë ndodhur në praninë e tij, por jo vërtetësinë e përmbajtjes

dëshminë e tij të bëra para gjykatës, janë të paligjshme dhe nuk mund të përdoren.” (theksimet sipas vendimit – shënimi ynë).

³⁹² Shih nenet 294a, par.3 (veprimet simuluese) dhe 294b, par.2 (infiltrimi): “Punonjësi i policisë i infiltruar nuk duhet të provokojë një akt kriminal, i cili, pa ndërhyrjen e tij, nuk do të ishte kryer. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret.”

³⁹³ Nr.00-2013-651 i Vendimit (123), datë 10.4.2013, Hodaj: “16. Megjithëse gjykata e shkallës së parë ka pranuar ta shqyrtojë çështjen me procedurën e gjykimit të shkurtuar, gjatë gjykimit rezulton të ketë pranuar për shqyrtim dhe më pas të ketë përdorur për marrjen e vendimit një provë tjetër për më tepër të pavlefshme. Në seancën gjyqësore, të datës 02.06.2009 së bashku me konkluzionet përfundimtare, pasi gjithë gjykimi ishte kryer me procedurën e posaçme të gjykimit të shkurtuar nga ana e mbrojtësit është paraqitur me cilësinë e provës deklarata noteriale nr.1628 rep dhe nr.130/2 kol, datë 18.04.2009 e lëshuar nga shtetësja I.H. Kjo deklaratë është administruar si provë dhe është përdorur nga gjykata në vendimin përfundimtar duke e vlerësuar përmbajtjen e saj për faktet e pohuara.

22. ... Në këtë këndvështrim të arsytimit të rregullimit të institutit të gjykimit të shkurtuar si dhe të vendimit unifikues, Kolegji Penal, në kushtet kur i gjykuari ka pranuar aktet e hetimit paraprak duke shmangur debatin gjyqësor, e gjen të gabuar pranimin për shqyrtim të një prove të re, mbi të cilat gjykata ka vendosur ndryshimin e kualifikimit ligjor dhe argumentimin mbi masën e dënimit.”

³⁹⁴ Shih vendimet: nr.523, datë 27.9.2006, Muhameti, etj.; nr.00-2010-1084 i Vendimit (558), datë 2.6.2010, Çelhaka; nr.00-2010-1063 i Vendimit (22), datë 7.7.2010, Pali, masë sigurimi [shih, gjithashtu, **zgjidhje të përkundërta**: nr.532, datë 20.6.2007, Alija; nr.289, datë 4.6.2008, Pashaj; nr.292, datë 11.6.2008, Bedinaj; nr.130, datë 25.3.2009, Derri, etj.; nr.49, datë 18.2.2009, Rexha, etj.]

së një dëshmie, detyrë që i takon gjykatës. Në sisteme të tjera, sidomos në Angli dhe SHBA, në gjykata mund të përdoret i ashtuquajti *affidavit*, që është një deklaratë e shkruar, e dhënë përgjithësisht, por jo domosdoshmërisht, nën betim, para një zyrtari që ligji e ngarkon të marrë deklaratë të tilla³⁹⁵. Sistemi ynë nuk e lejon noterin të marrë deklarime nën betim për t'u përdorur në procesin penal, ndaj dokumente të tilla nuk mund të përdoren për të provuar fakte.

Nga shqyrtimi i rasteve të mësipërme, konkludojmë se jurisprudenca e kolegjit ka dhënë zgjidhje shpeshherë të diskutueshme, hera-herës kundërthënëse dhe, në ndonjë rast, interpretime të normave të ligjit procedural që shkojnë tej vullnetit të ligjvënësit.

§ 4.5 Mbi “papërdorshmërinë e prejardhur” dhe praktikën gjyqësore. Profile krahasuese

Tek Kreu 3 (§ 3.5.1) trajtuam zgjerimin e pasojave të aktit të pavlefshëm dhe konceptin e pavlefshmërisë së prejardhur, e cila normohet nga neni 131 i KPP. Në thelb, një akt i pavlefshëm mund t'i shtrijë pasojat edhe mbi aktet e mëpasme që kanë lidhje logjike dhe juridike me të. Diskutimi bëhet interesant lidhur me mundësinë nëse një akt i pavlefshëm mund ta bëjë të papërdorshme provën që prodhohet nga akti pasues, i lidhur funksionalisht dhe juridikisht me të. Rasti tipik do të ishte prova e sekuestruar pas një kontrolli të paligjshëm. Me një fjalë, problemi shtrohet nëse mund të flitet dhe të zbatohet rregulli i “*papërdorshmërisë së prejardhur*”, nocion që nuk parashikohet shprehimisht në Kod. Le të shohim, në vijim, si është orientuar praktika jonë gjyqësore në këtë drejtim.

4.5.1 Për praktikën tonë gjyqësore lidhur me provat e sekuestruara si pasojë e një akti të kryer në kundërshtim me ligjin

Rasti tipik i pasojave që sjell një kontroll banese i kryer në kundërshtim me ligjin, shqyrtohet në një vendim të kolegjit, të vitit 2010. Është rasti i sekuestrimit të një arme automatike (në gjendje teknike të parregullt), të 55 copëve fishekë dhe të një sasive prej 23 gr bimë narkotike cannabis sativa. I pandehuri u deklarua i pafajshëm nga gjykatat e faktit, vendim i cili u la në fuqi nga kolegjii penal i Gjykatës së Lartë. Gjykata e mbështeti vendimin në arsyetimin, sipas të cilit një kontroll i kryer në kundërshtim me ligjin e bën provën e sekuestruar të papërdorshme³⁹⁶. Në vijim të arsyetimit, kolegjii ka vërejtur edhe mangësi të tjera, si

³⁹⁵ Lozzi Gilberto, *vep. e cit.*, faqe 236

³⁹⁶ Nr.00-2010-396 i Vendimit 252, datë 17.3.2010, Ndreu: “Kontrolli i banesës se të gjykuarit pa pasur vendim gjykatë është kryer në kundërshtim me dispozitat e nenit 151/4 dhe 251 dhe nenit 32 të Kushtetutës, e si rrjedhojë, rezultati i dale prej saj është i papërdorshëm. Ky kontroll është një akt procedural i papërdorshëm dhe nga fakti se ai nga pikepamja formale nuk është realizuar konform dispozitave ligjore procedurale. Kështu, sipas proces-verbalit të kontrollit të banesës rezultoi se ai është bërë në datën 20 të vitit 2007, por nuk është pasqyruar muaji kur është realizuar ky veprim hetimor.

Në kundërshtim me ligjin është vepruar nga ana e organit të akuzës edhe sa i përket fiksimit dhe marrjes së provave. Siç rezultoi nga proces-verbali i kqyrjes dhe marrjes së provës materiale të datës 20.12.2006 është bërë e mundur dhe fiksimi dhe marrja e provës materiale. Kjo provë materiale është rezultat i një kontrolli të paligjshëm dhe i një kqyrje të realizuar në kundërshtim me ligjin, duke mos qenë i pranishëm pronari i vendit të kqyrur. Në të njëjtën kohë kjo provë materiale është gjetur, marrë, e fiksuar në kundërshtim me dispozitat ligjore. Në momentin që ajo është paraqitur para gjykatës si provë materiale ndodhesh në një qese dhe nuk kishte asnjë element identifikues që të sillte informacion në lidhje me materialin e ndodhur, numrin e provës, personin ose veprën që i atribuohet, si dhe

mospasqyrimin e muajit në procesverbalin e kontrollit të banesës, mungesën e pronarit gjatë këqyrjes, shkeljen e rregullave për administrimin e provave (*mungesën e vulës së organit procedues në qesen e tyre*), mosvlerësimin e sekuestrimit nga ana e prokurorit. Këtë të fundit, kolegji e lidh me “*cënimin e së drejtës kushtetuese të ankimit*”, një konkluzion jobindës, pasi personi që i sekuestrohen sendet nuk pengohet të ankohet në gjykatë, edhe pse vlerësimi i sekuestrimit mund të mos jetë kryer³⁹⁷.

Një rast i mëvonshëm, gati analog, konstatohet në jurisprudencën e kolegjit, në vitin 2013. Rasti ka të bëjë me kontrollin e banesës së një personi, të kryer rreth orës 21.⁰⁰, pra, tej kohës së zakonshme që parashikon ligji (*ora 07.⁰⁰ - 20.⁰⁰, neni 206.1 i KPP*), me ç’rast është sekuestruar një armë gjysëautomatike. Duke iu referuar rregullave që vendos Kodi për pavlefshmërinë e prejardhur, duke e konsideruar aktin e kontrollit të pavlefshëm, kolegji konsideroi të tilla edhe aktet e mëpasme: përkatësisht, aktin e sekuestrimit të armës dhe aktin e ekspertimit teknik të saj³⁹⁸.

Në këtë rast, kolegji iu referua institutit të pavlefshmërisë së prejardhur, edhe pse aktin e kontrollit, të kryer pas orës 20.⁰⁰, ligjvënësi nuk e sanksionon me pasojë pavlefshmërie. Pra, një interpretim i zgjeruar i ligjit, jashtë rregullit të taksativitetit. Në vijim, tej parashikimeve të ligjit procedural, kolegji çmoi se cënimi i rregullave për marrjen e provave shkakton pavlefshmëri absolute, një vlerësim ky tërësisht i gabuar³⁹⁹. Këtu kemi të bëjmë thjesht me një parregullsi gjatë ekzekutimit të aktit, edhe pse me ndikim në cënimin e një të drejte kushtetutshme të

nuk ishte e siguruar me vulen e organit procedues, sipas nenit 215 të K.Pr.Penale. Ndodhur në keto kushte, është i dyshimt fakti se kjo është e njëjta prove materiale e gjetur në banesën e të pandehurit.

Nuk rezulton që të jete kryer vlefesimi i sekuestrimit nga prokurori dhe për pasojë, ky veprim procedural është në kundërshtim me ligjin, duke pasjelle cenim të së drejte kushtetuese të ankimit, e njohur shprehimisht nga ligji. Po kështu, përveç këtij fakti, por edhe për arsytet e parashtruara në pikën 1 dhe 2 të arsyetimit, rezultati i dale nga ky veprim hetimor, sipas nenit 151/4 i K.Pr.Penale, është i paperdorshëm.

Është e vërtetë që nga praktika e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, është pranuar se jo çdo shkelje procedurale e bën procesin ligjor tërësisht të parregullt por në rastin objekt gjykimi kemi të bëjmë me një sërë veprimesh procedurale që lidhen me zgjidhjen në themel të çështjes dhe ligjshmëria e të cilave është e kontestueshme.”

³⁹⁷ Personi ankohet kundër aktit të sekuestrimit dhe jo kundër mungesës së vlerësimit të tij nga prokurori.

³⁹⁸ Nr.00-2013-1335 i Vendimit (180), datë 29.05.2013, Smajlaj: “2. Në përputhje me parimet e shprehura në K.Pr.Penale, për sa i përket kohës për kryerjen e kontrollit të banesës, Kolegji Penal vëren se policia gjyqësore ka vepruar në kundërshtim me këto parime, në momentin që ajo ka ushtruar kontroll në banesën e të gjykuarit M.S., përtej afatit kohor (rreth orës 21.⁰⁰) të përcaktuar në ligjin procedural penal.

3. Në përputhje me frymën e Kushtetutës, Kolegji Penal thekson se vetë ligji themeltar i vendit, ka parashikuar se “**Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme**”³⁹⁸. Në këtë drejtim, që në momentin që policia gjyqësore ka vendosur dhe ka ushtruar kontroll në banesën e të gjykuarit M.S., ka vepruar në kundërshtim me rregullat e parashikuara në K.Pr.Penale, të cilat kanë sjellë pavlefshmërinë e të gjitha akteve të mëpasme, akte mbi të cilat organi procedues ka mbështetur akuzën në ngarkim të të gjykuarit.

4. Referuar nenit 131, paragrafit të parë të K.Pr.Penale, pavlefshmëria e një akti i bën të pavlefshme aktet e më pasme që varen nga ai që është deklaruar i pavlefshëm. Nisur nga ky përkufizim, Kolegji Penal në rastin në gjykim, çmon se çdo akt i prodhuar, siç është proces-verbali i sekuestrimit të provës materiale apo akt ekspertimi teknik të armës së sekuestruar, janë akte të pavlefshme, për shkak të paligjshmërisë së kontrollit të banesës së të gjykuarit M.S., konstatuar kjo edhe nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër (vendimi nr.9, datë 31.01.2011, “Për vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit”). [theksimet dhe nënvizimet sipas vendimit – shënimi ynë].

³⁹⁹ “5. Kolegji Penal vlerëson se qëllimi i ligjvënësit është përcaktimi i rregullave konkrete ligjore mbi mënyrën e sigurimit të një prove, mosrespektimi i të cilave shkakton deri në pavlefshmëri absolute, e cila në rastin konkret rezultoi të jetë marrë nëpërmjet ushtrimit të kontrollit të banesës së të gjykuarit M.S. në kundërshtim me rregullat procedurale, kontrolli i cili është cilësuar i paligjshëm nga gjykata.” [ibidem]

mbrojtur, por që nuk është e natyrës absolute (*në raste të ngutshme, me vendim të motivuar të organit që procedon, kontrolli i banesës mund të kryhet edhe tej caqeve orare që paracakton ligji*⁴⁰⁰).

Zgjidhja e themelit të akuzës duket e pambështetur, sipas një këndvështrimi të një garantizmi të tepruar, për më tepër kur nuk vihej në dyshim vërtetësia e provës (*vetë i akuzuari pati pohuar se arma i përkiste vëllait të tij*). Nuk jemi para një prove të paligjshme, jemi para cënimit të modaliteteve të ekzekutimit të një akti procedural, ndaj prova nuk duhej të përjashtohet nga shqyrtimi, pa një gjykim drejtpeshues në rrafshin e detyrimit të organeve ligjzbatuese për mbrojtjen e shoqërisë nga krimi.

Në të dyja rastet e analizuara, duke qenë se mungon arsyetimi mbi ndikimin e mundshëm të secilës prej parregullsive të konstatuara mbi provën e sekuestruar, në thelb, kolegji ka adaptuar një koncept të papërdorshmërisë së prejardhur, duke e lidhur automatikisht paligjshmërinë e kontrollit me papërdorshmërinë e elementit të provës të sekuestruar (*në rastin e dytë flitet shprehimisht për pavlefshmëri të prejardhur*). Ky arsyetim duket shumë i ngurtë, sepse kontrolli i banesës për kërkim sendesh nuk është një akt i paligjshëm në vetvete, por atë mund ta bëjnë të tillë modalitetet e ekzekutimit. Për rrjedhojë, papërdorshmëria e provës që ai shkakton nuk ka natyrë absolute, ndaj kërkohet një analizë e të gjitha rrethanave dhe shkeljeve të kryera, në mënyrë që të argumentohet dyshimi mbi autenticitetin e provës së sekuestruar dhe mundësinë e përjashtimit të saj nga vlerësimi për të provuar fakte në proces.

Për të kuptuar se qasja e interpretimit të kolegjit nuk shkon në drejtimin nga orientohet prej vitesh jurisprudenca e huaj, në vijim, po ndalemi shkurt tek mënyra se si e trajtojnë doktrina dhe jurisprudenca, e së drejtës kontinentale dhe anglosaksone, problemin e provave të paligjshme, në tërësi, si dhe përdorshmërinë e provës që sekuestrohet si rezultat i një kontrolli të kryer në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji, në veçanti.

4.5.2 Për praktikën gjyqësore të huaj lidhur me provat e sekuestruara si pasojë e një akti të kryer në kundërshtim me ligjin.

Sistemet e procedurës penale të shteteve demokratike janë të ndjeshme ndaj problemit të përdorimit në procesin penal të provave të paligjshme; natyrisht vihen re karakteristika dalluese dhe ngjyrimet e caktuara, shpeshherë fryt i përpunimit shumëvjeçar dhe i luhatjeve të jurisprudencës dhe doktrinës. Në vijim, do të na duhet të ndalemi tek sistemet kryesore, si të familjes së *common law*, ashtu edhe të *civil law*, për të nxjerrë përfundime lidhur me normat që vendos sistemi ynë dhe interpretimin që ofron jurisprudenca e kolegjit penal.

a. Sistemi i SHBA-ve. – Është ndër sistemet tradicionalisht pioniere përsa i takon problemeve të ligjshmërisë së provës, që përmbledhen në togfjalëshin e njohur “*exclusionary rule*” (*rregulli i përjashtimit*), i frymëzuar nga Amendamenti IV i Kushtetutës Federale, që synon të mbrojë qytetarët nga kontrollimet dhe sekuestrimet arbitrare. Rregullave që përjashtojnë provat e paligjshme, jurisprudenca amerikane filloi t’u qaset aty nga fundi i shek. XIX⁴⁰¹.

⁴⁰⁰ Neni 206. Koha për kryerjen e kontrollit të banesës – 1... Në raste të ngutshme organi procedues mund të urdhërojë që kontrolli të bëhet tej këtyre caqeve.

⁴⁰¹ Conti Carlotta, *Accertamento del fatto ed inutilizzabilità nel processo penale*, CEDAM, 2007, faqe 339.

Amendamenti IV normon që “e drejta e qytetarëve që t’u garantohet mbrojtja e personit, e banesës, e dokumenteve dhe e pronës nga kontrollet dhe sekuestrimet e paarsyeshme nuk mund të dhunohet.”⁴⁰². Vendimi i parë i Gjykatës Federale, që shënoi prirjen e saj për t’u shkëputur nga parimi i gjithëpërfshirjes së provave në proces, i përket çështjes *Boyd v. United States (1886)*⁴⁰³. Gjykata, në fakt, nuk pranoi që prova të përjashtohet nga procesi; por ajo vërejti se ashtu sikundër deklaratimet vetëakuzuese, të marra në shkelje të Amendamentit V nuk mund të përdoren kundër të pandehurit, edhe provat reale, të marra në shkelje të Amendamentit IV, janë të papërdorshme për të njëjtin qëllim. Vetëm shumë vite më vonë⁴⁰⁴, Gjykata e pohoi në mënyrë të shprehur papërdorshmërinë e provave, në dritën e Amendamentit IV, duke garantuar jo vetëm mbrojtjen nga kontrollet e paligjshme, por edhe përjashtimin e mundësisë që provat e siguruara *contra legem* të mund të përdoren në procesin gjyqësor kundër të akuzuarit. Ky qëndrim u qartësua më tej në çështjen *Silverthorne Lumber Co. v. United States (1920)* teksa, duke iu referuar çështjes *Weeks*, Gjykata saktësoi se provat e marra në shkelje të Amendamentit IV janë tërësisht të papërdorshme. Më pas, jurisprudenca u zhvillua drejt përjashtimit jo vetëm të provave të marra në shkelje të të drejtave të mbrojtura nga Kushtetuta, por edhe të të drejtave që garantohen nga Statutet e Shteteve të veçanta⁴⁰⁵.

Duke zënë fill nga çështja e sipërpërmendur *Silverthorne Lumber Co.*, në jurisprudencën e Gjykatës Supreme u shtrua problemi i papërdorshmërisë së prejardhur, e cila synonte të përforconte rregullat e përjashtimit. Pra, u vu në diskutim jo vetëm papërdorshmëria e një prove të paligjshme, por edhe mundësia e përdorimit të një prove dytësore, të prejardhur, që bëhet e mundur të merret pikërisht falë provës së vesuar. Sipas Gjykatës, nëse nuk do të përjashtoheshin edhe këto prova, policia do të inkurajohej që të kryente akte të paligjshme, me shpresën se do të zbulonte prova që, pavarësisht se do t’i nënshtroheshin rregullit të përjashtimit, mund të gjeneronin prova të tjera, gjithsesi të papërdorshme kundër të pandehurit.

Megjithatë, lidhur me papërdorshmërinë e prejardhur, që në krye të herës, pati kundërshti që lidhen me dy pika të diskutueshme: *së pari*, si do të zgjidhej rasti kur pavarësisht paligjshmërisë së provës së parë, prova e prejardhur, në vetvete, rezultonte e pavesuar dhe, *së dyti*, si mund të pranohej që një veprim i paligjshëm i policisë të mund të shkaktonte një pasojë kaq të rëndë sa sakrifikimi i pariparueshëm i mbrojtjes shoqërore - pandëshkueshmëria e kriminelëve të rrezikshëm.

Gjithsesi, pikërisht me anën e çështjes në fjalë, gjyqtarët e lartë vendosën disa kufizime të rregullit të përjashtimit: papërdorshmëria nuk mund të shtrihej mbi të dhënat e marra përmes një burimi të pavarur nga prova e paligjshme (*independent source*), pra, në rastet kur do të mungonte lidhja shkakësore mes provës së parë dhe asaj dytësore. Pikërisht teoria e “burimit të pavarur”, përbën anën tjetër të medaljes së papërdorshmërisë së prejardhur, me një fjalë, kufizimin e rasteve të zbatimit të saj.

⁴⁰² “The right of the people to be secure in their persons, houses, papers, and effects, against unreasonable searches and seizures, shall not be violated, and no warrants shall issue, but upon probable cause, supported by oath or affirmation, and particularly describing the place to be searched, and the persons or things to be seized.”

Marrë nga: https://www.law.cornell.edu/constitution/fourth_amendment; vizita e fundit më 2.11.2015.

⁴⁰³ Conti Carlotta, *vep. e cit.*, faqe 349: i pandehuri u detyrua të krijonte një dokument që e inkriminonte, ndaj ai u ankua duke iu referuar Amendamentit IV, si dhe Amendamentit V, që garanton mbrojtjen nga vetëakuzimi.

⁴⁰⁴ Çështja *Weeks v. United States (1914)*: i pandehuri pretendoi kthimin e sendeve që iu sekuestruan pas një kontrolli të paligjshëm.

⁴⁰⁵ Shih *Wolf v. Colorado (1949)*, *Rochin v. California (1952)*, *Mapp v. Ohio (1952)*.

Teoria e papërdorshmërisë së prejardhur, u përcaktua ndryshe me shprehjen teoria e “*fryteve të pemës helmuese*”, pikërisht në çështjen *Nardone v. United States (1939)* ku, megjithatë, Gjykata orientoi një qëndrim më pak të ngurtë, teksa saktësoi se, edhe në mungesë të një burimi të pavarur, mund të ndodhë që lidhja shkakësore mes provave të zbehet (*attenuated connection*), deri në atë masë sa të mos e përcjellë dot vesin e origjinës⁴⁰⁶.

Zbehja e lidhjes shkakësore u zhvillua më tej në çështjen *Wong Sun v. United States (1963)*, ku Gjykata zhvilloi katër raste, shumë elastike, kur lidhja zbehej:

- i- koha relativisht e gjatë mes akteve përkatëse të marrjes së provave;
- ii- ndërhyrja e faktorëve të tjerë shkakësorë;
- iii- shkelja e kryer nga autoritetet nuk është e rëndësishme;
- iv- prova e marrë më pas është fryt i një bashkëpunimi spontan.

Natyrisht, konstatimi i zbehjes së lidhjes shkakësore i lihej interpretimit të Gjykatës, rast pas rasti, duke marrë në konsideratë nevojën e ruajtjes së drejtpeshimit mes interesave kontradiktore në proces.

Jurisprudenca amerikane pati zhvillime të rëndësishme rreth viteve '80 të shek. XX, kur Gjykata Supreme theksoi disa raste të tjera kur rregulli i “*fryteve të pemës helmuese*”, nuk mund të përdorej. Në një vendim të mëvonshëm, *Hudson v. Michigan (2006)*, Gjykata pranoi se edhe një kontroll në shkelje të Amendamentit IV, mund t'i hapë rrugën një sekuestrimi të përdorshëm⁴⁰⁷. Këto vendime përbëjnë një pikë kthese të rëndësishme në drejtim të ruajtjes së elementeve me vlerë provuese në proces. Nga jurisprudenca e gjykatave u zhvilluan pikërisht dy teori:

Së pari, e ashtuquajtura “*teoria e zbulimit të pashmangshëm*” (inevitable discovery doctrine), një variant i teorisë së burimit të pavarur, sipas të cilës për të vendosur përjashtimin e një prove nga procesi duhet çmuar nëse ajo, gjithsesi, do të ishte zbuluar, edhe sikur policia të mos kishte kryer shkelje. Në raste të tilla, nëse akuza arrin të provojë se ekzistonte mundësia që prova të merrej edhe duke vepruar ligjërisht, atëhere prova mund të përdoret. Madje, në raste të tilla, nuk kërkohet të provohet as fakti se policia ka vepruar në mirëbesim⁴⁰⁸.

Së dyti, në vitin 1984 u vendos një kufizim tjetër, i ashtuquajtura “*përjashtimi për shkak të mirëbesimit*” (good faith exception), sipas të cilit sanksioni i përjashtimit është i papërshtatshëm në rastet kur policia ka arsye të besojë në ligjshmërinë e veprimtarisë së saj⁴⁰⁹. Në të dyja rastet, policia pati kryer kontrollime në bazë të një mandati që, më pas, u shpall i pavlefshëm. Kërkohet që mirëbesimi të mbështet në arsye objektive mbi ligjshmërinë e mandatit, jo në një bindje subjektive që nuk mbështetet nga rrethanat e faktit.

Në të drejtën amerikane, jo çdo i interesuar lejohet të ngrejë çështjen e papërdorshmërisë së provës; ajo i përket vetëm të pandehurit, të drejtat e të cilit janë çenuar nga paligjshmëria e marrjes së saj. Edhe pse gjyqtari nuk pengohet që problemet e ligjshmërisë së provës t'i ngrejë kryesisht, si rregull, ato nuk mund t'i shpëtojnë vëmendjes së palës së interesuar, të drejtat e së cilës çënohen nga veprimi i paligjshëm. Gjithsesi, mosngritja nga pala e interesuar nuk përbën shkak për korrigjimin e paligjshmërisë.

⁴⁰⁶ *Po aty*, faqe 355.

⁴⁰⁷ Conti Carlotta, “Il volto attuale dell'inutilizzabilità: derive sostanzialistiche e bussola della legalità”, tek Diritto Penale e Processo, 2010, n.7, faqe 797.

⁴⁰⁸ Shih çështjen *Nix v. Williams (1984)*, *po aty*, faqe 358.

⁴⁰⁹ Shih çështjet *United States v. Leon* dhe *Massachussets v. Sheppard*, *po aty*, faqe 359. Mund të shihni edhe: Miller Frank. W., etj. Criminal Justice Administration, *Cases and Materials*, Third Edition, The Foundation Press, INC., 1986, faqe 40.

b. Sistemi anglez. – Sikurse dihet, sistemi anglez nuk mbështetet në një Kushtetutë të shkruar, ndaj problemi i provave të paligjshme shtrohet në optikën tradicionale të cënimit të rregullave të procesit të drejtë (*fair trial*), që përforcohet nga normat që cakton neni 6 i KEDNJ-së, të detyrueshme për t’u zbatuar nga gjykatat angleze pas miratimit të Human Rights Act në vitin 1998 (në fuqi nga viti 2000).

Sipas traditës së common law-t, që zë fill nga mesi i shek.XVIII, qëllimi i procesit është vërtetimi i fakteve; në këtë këndvështrim, prova e paligjshme që besohet se ka rëndësi për vërtetimin e fakteve, duhej të merret. Mund të fillohet një procedurë kundër agjentëve të policisë, në rastet e akteve të paligjshme të kryera gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre (*arrestime, kontrollime apo sekuestrime*), por kjo nuk mund të pengojë përfshirjen e provës në proces⁴¹⁰.

Doktrina, nga ana e saj, mbështeste forcimin e rregullave të përjashtimit të provave të paligjshme, duke u mbështetur në dy argumente: *së pari*, në këndvështrimin e rivendosjes të së drejtës së shkelur (*një rend juridik që njeh të drejtat e patjetërsueshme të individit nuk mund të lejojë përdorimin e provave të marra në dhunim të tyre*) dhe, *së dyti*, pranimi i përjashtimit do të kishte një efekt frenues ndaj praktikave të paligjshme të policisë. Ashtu si edhe në SHBA, doktrina ngrinte edhe argumentin e “integritetit moral të procedurës” (moral integrity of criminal proceedings), ngaqë nëse gjyqtarët do t’i lejonin hapësirë veprimeve të paligjshme të policisë në sigurimin e provave, ata nuk do të kishin asnjë dallim nga kriminelët.

Natyrisht, kishte edhe argumente në drejtim të kundërt: b.fj., duke kufizuar një të drejtë, mund të merrej një provë që mund të parandalonte krime të rënda. Ngriheshin edhe argumente të natyrës pragmatiste, sipas të cilave nëse prova sigurohej, ajo duhej të përdorej, pavarësisht nga fakti i paligjshmërisë së marrjes. Në raste të tilla, mbrojtja më e mirë për qytetarët nuk do të ishte përjashtimi i provës, por ndëshkimi disiplinor i subjekteve që kryen shkeljen.

Me një fjalë, problemi i përjashtimit të provave të paligjshme shtrohej në planin e drejtpeshimit të interesave në lojë; nga njëra anë, kërkesat për një proces të drejtë (*due process*) dhe, nga ana tjetër, nevoja e shoqërisë për t’u mbrojtur nga krimi (*crime control*).

Jurisprudenca i qëndronte rregullit të përgjithshëm të pranimit tërësor të provave, rregull që filloi të zbutej nga fillimi i shek.XX⁴¹¹, sidomos lidhur me provat e siguruara duke e shtrënguar personin të pohonte fajësinë e tij (*vetëinkriminimi*). Në çështjen *R. v. Sang (1980)*, u pohua e drejta e gjyqtarit për të përjashtuar provat që mund të çojnë në gjykim të parregullt të të akuzuarit⁴¹², kurse në çështjen *Fox v. Chief Constable of Gwent (1986)* u pohua doktrina e lejimit të përdorimit të provës së paligjshme, nëse ekziston mundësia për ta marrë atë në rrugë të ligjshme. Por, u theksua e drejta e gjykatës për të përjashtuar provat e marra nga policia përmes gënjeshtërisë ose përmes ushtrimit të dhunës⁴¹³. Ky është një qëndrim i hershëm i gjykatave angleze. Përmendim që në çështjen *Callis v. Gun (1964)*, Lordi Parker CJ, e kuptonte

⁴¹⁰ Conti, Carlotta, *vep. e cit.*, faqe 364.

⁴¹¹ *Po aty*, faqe 367

⁴¹² Murphy Peter, Murphy për provën, Botim i UET Press, 2010, faqe 119. Por, gjykatësit nuk mund të kenë të drejtë të përjashtojnë çdo provë të marrë në kundërshtim me ligjin, sepse “*gjykata shqyrton rëndësinë e provave të akuzës dhe jo burimin e tyre.*” Pra, në Angli, provat nuk përjashtohen nga procesi thjesht dhe vetëm për shkak të mënyrës se si janë siguruar.

⁴¹³ Ky rast ka të bëjë me hyrjen e paligjshme të policisë në një banesë, për të kryer alkooltestin e personit që dyshohej se kishte shkaktuar aksident, duke drejtuar automjetin në gjendje të dehur. Paligjshmëria e veprimit të policisë u konsiderua e parëndësishme nga *House of Lords*, përderisa kryerja e testit mund të realizohej normalisht edhe në rrugë të ligjshme.

discrecionin e gjykatës për të përjashtuar provat në këtë mënyrë: “*Ky diskrecion, siç e kuptoj unë, sigurisht që do të ushtrohet për të përjashtuar provat, nëse ka ndonjë indicje se ato janë siguruar nëpërmjet presionit, përfaqësimit fiktiv, dredhisë, kërcënimeve, rryshfeteve apo në çfarëdolloj mënyre tjetër të ngjashme.*”⁴¹⁴.

Në vitin 1984, u miratua *Police and Criminal Evidence Act*, i cili në nenin 78 të tij parashikon, në mënyrë të shprehur, mundësinë e përjashtimit të provave nga gjykata, kur marrja e tyre mund të paragjykojë procesin e rregullt ligjor. Por, duhet theksuar se dështuan përpjekjet për të vendosur rregullin e përjashtimit të çdo prove të marrë në kundërshtim me ligjin⁴¹⁵. Ligji në fjalë zbatohet në bazë të disa rregulloreve të formuluar në bazë të tij (*Codes of practice*), që parashikojnë rregulla të detajuara mbi të drejtën e arrestimit dhe të marrjes në pyetje nga policia, kontrollimet e sekuestrimet, marrjen e të dhënave nga të tjerët, etj., por si jurisprudenca, ashtu edhe doktrina, nuk pranojnë që shkelja formale e një rregulli mund të çojë automatikisht në papërdorshmërinë e provës. Sipas jurisprudencës, shkelja duhet të jetë e rëndësishme dhe thelbësore (*significant and substancial*), që do të thotë se “*qasja e sistemit anglez ndaj problematikës së papërdorshmërisë nuk mbështetet në ndonjë rregull të përgjithshëm, por synon, tejskajshmërisht, zgjidhjet e dhëna rast pas rasti*”⁴¹⁶ dhe ky qëndrim përbën parimin që zbatojnë gjykatat, sa herë shtrohet çështja e përjashtimit të provave të paligjshme.

Edhe pas hyrjes në fuqi të Human Rights Act (1988), që i detyron gjykatat angleze t’i përshtaten jurisprudencës së Strasburgut, në temën e paligjshmërisë së provave nuk është se ka ndryshime të ndjeshme në praktikën e gjykatave angleze, të cilat konstatojnë përputhshmëri të ligjit anglez me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, sa i takon raportit të ligjshmërisë së provës me procesin e rregullt ligjor⁴¹⁷.

Si përfundim, mund të themi se jurisprudenca angleze në këtë temë i qëndron kriterit të *fair trial*, tipik për common law-n dhe që normohet në mënyrë të shprehur në KEDNJ-në, duke ruajtur drejtpeshimin e duhur mes interesit publik për të luftuar kriminalitetin dhe mbrojtjes së të drejtave të individit në procesin penal.

c. Sistemi gjerman. – Kodi gjerman i Procedurës Penale (StPO) është ndërtuar mbi parimin e kërkimit të së vërtetës, në tekstin e tij nuk gjendet ndonjë normë e shprehur lidhur me papërdorshmërinë e provave; rregullat në këtë lëmë janë të shpërndara në orientimet e shumta jurisprudenciale dhe doktrinare. Këto të fundit i kanë fillimet në punimet e Ernst Beling, në fillim të shek. XX, sipas të cilit ndalimet në temën e provave nuk janë gjë tjetër veçse “*precipitati teknik i një konflikti mes interesash*

⁴¹⁴ Murphy Peter, po aty, faqe 121.

⁴¹⁵ *Ibidem*, faqe 114.

⁴¹⁶ Conti Carlotta, po aty, faqe 371.

⁴¹⁷ Në çështjen *Khan*, Lordi Nicholls i Birkenhead, u shpreh: “...autoriteti diskrecionar i gjyqtarit të çështjes për të përjashtuar prova është i lidhur ngushtë me nenin 6(1) të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Të dyja këto duan t’i sigurojnë të akuzuarit për vepra penale një proces të rregullt gjyqësor. Po kështu, kur konsiderojmë common law-n dhe pushtetin ligjor diskrecionar sipas ligjit anglez, jurisprudenca e nenit 6 mund të luajë një rol të rëndësishëm. Ligji anglez është shumë i zhvilluar për sa u përket elementeve të një procesi të rregullt gjyqësor. Por, çdo sistem ligjor përfiton nga njohja e përgjigjeve të dhëna nga gjykatat e tjera për probleme të ngjashme. Në rastin konkret, vendimi i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për çështjen *Shenk kundër Zvicrës* (1988) 13 EHRR 242 konfirmon se përdorimi ndaj një çështjeje penale i materialeve të marra në kundërshtim me të drejtën e privatësisë, sipas nenit 8, nuk nënkupton në vetvete se gjykimi është i parregullt. Kështu që praktika ligjore e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për këtë çështje është pothuajse e njëjtë me atë të ligjit anglez.”. Shih Murphy Peter, *vep. e cit.*, faqe 114.

*kontradiktore.*⁴¹⁸: nga njëra anë interesi i shtetit për kërkimin e së vërtetës dhe, nga ana tjetër, një sërë interesash që lidhen me individin, para së gjithash, por edhe me shtetin (*p.sh., interesi për ruajtjen e sekretit shtetëror*).

Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës të vitit 1949, u vendos ndalimi i shprehur i përdorimit të të dhënave të marra përmes metodave të ndaluara të marrjes në pyetje. Duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit XX, ndalimet në temën e provave u zhvilluan në drejtimin e mbrojtjes së individit në procesin penal. Doktrina heq një vijë ndarëse të qartë midis ndalimeve për marrjen e provave (*Beweiserhebungsverbote*) dhe ndalimeve të përdorimit të tyre (*Beweisverwertungsverbote*).

Ndalimet e përdorimit mund të jenë të shprehura dhe të nënkuptuara. Në rastin e parë problemi është më i thjeshtë, ndërkohë që ndalimet e nënkuptuara i nënshtrohen interpretimit, rast pas rasti. Këto të fundit, doktrina i ndan në ndalime të *varura* (kur lidhen me ndonjë ndalim të parashikuar nga Kodi ose nga ligje të posaçme) dhe të *pavarura* (kur çenohet drejtpërsëdrejti një normë kushtetuese)⁴¹⁹.

Teoritë e përpunuara nga doktrina dhe jurisprudenca janë të shumta, sidomos në temën e ndalimeve të përdorimit, të llojit të varur. Ndër to, më e njohur dhe bindëse është *teoria e drejtpeshimit* (*Abwägungslehre*), e cila nisët nga një gjykim empirik, duke marrë në konsideratë nevojën për demonstrimin e së vërtetës dhe mbrojtjen e interesit të çenuar. Nëse mbizotëron ky i fundit, atëherë teoria në fjalë orienton drejt ndalimit të përdorimit të provës. Pikërisht, kjo teori është pranuar nga jurisprudenca mbizotëruese e Gjykatës së Kasacionit dhe e Gjykatës Kushtetuese. Përsa u takon ndalimeve të përdorimit të llojit të *pavarur*, të cilat e kanë fillësën në dhunimin e një të drejte kushtetuese, pa asnjë mëdyshje, jurisprudenca pranon zgjidhjet që mbështeten në *teorinë e drejtpeshimit*, e cila nuk është gjë tjetër veçse “*zbatimi në të drejtën procedurale i një metodologjie që është tipike për të drejtën kushtetuese.*”⁴²⁰

Si përfundim, edhe në procedurën gjermane, problemi i ndalimeve në temën e provave, në mungesë të një sanksioni të shprehur të natyrës së përgjithshme, mbetet në diskrecionin e gjykatave, në bazë të një qasjeje rast pas rasti, duke mbajtur parasysh drejtpeshimin e interesave: interesin publik për efektivitetin e luftës ndaj kriminalitetit dhe mbrojtjen e individit në procesin penal. Gjithashtu, pjesa dërmuese e jurisprudencës i jep rëndësi interesit për ruajtjen e të dhënave provuese, duke përjashtuar papërdorshmërinë e prejardhur; ashtu sikundër në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë të SHBA-ve, papërdorshmëria e prejardhur nuk vepron kur rezulton se prova gjithsesi mund të ishte marrë edhe në rrugë të ligjshme (*teoria e zbulimit të pashmangshëm*).

ç. Sistemi spanjoll. – Në sistemin spanjoll të procedurës penale, papërdorshmëria është një nga konceptet më komplekse. Deri nga mesi i viteve ‘80 të shekullit të kaluar, nuk ekzistonte ndonjë normë disiplinuese lidhur me këtë nocion; ndërkohë, jurisprudenca orientonte se kur prova ishte e rëndësishme për vendimin, ajo duhej të merrej, edhe pse mund të kishte çenuar të drejta themelore. Vetëm në vitin 1984, një vendim i Gjykatës Kushtetuese pohoi, për herë të parë, papërdorshmërinë e provave të marra në shkelje të të drejtave kushtetuese të individit⁴²¹. Në dritën e këtij vendimi, ligji organik i pushtetit gjyqësor, i vitit 1985 (*Ley Orgánica del Poder Judicial*), rregulloi në mënyrë të shprehur veset e provave. Sipas nenit 11.1 të këtij ligji “*provat*

⁴¹⁸ Conti Carlotta, *po aty*, faqe 385.

⁴¹⁹ *Ibidem*, faqe 381.

⁴²⁰ *Ibidem*, faqe 386.

⁴²¹ *Po aty*, faqe 395.

e marra drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore nuk do të kenë vlerë”.

Pra, marrja e provave lidhet me të drejtat themelore të mbrojtura nga Kushtetuta. Kështu që lind nevoja e drejtpeshimit mes të drejtave themelore të individit dhe interesit publik për luftën ndaj krimit. Nga ana tjetër, kemi një ndalim të përdorimit të provave, kur ato janë marrë duke cënuar të drejta dhe liri të mbrojtura kushtetutshmërisht. Natyrisht, vlerësimi i natyrës së shkeljes mbetet detyrë e interpretuesve të ligjit, që duhet të provojnë se shkelja ka cënuar një “*të drejtë themelore*”, pasi vetëm kjo e fundit passjell papërdorshmërinë e provës. Nga ana e saj, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se kërkohet shkelja ose cënimi i përmbajtjes kushtetuese të së drejtës, jo thjesht një cënim i normave zbatuese, ligjvënëse, rregulluese apo jurisprudenciale qofshin ato. Edhe në sistemin spanjoll vlen *teoria e drejtpeshimit*, ngaqë për çdo rast cënimi i së drejtës kushtetuese duhet të përlligjet nga ekzistenca e indicjeve të rëndësishme të fajësisë, prova duhet të jetë e rëndësishme për hetimet dhe, së fundi, duhet të verifikohet përshtatshmëria e kufizimit të së drejtës në raport me rëndësinë e faktit që hetohet⁴²².

Ligji në fjalë garanton posaçërisht të drejtën e mbrojtjes, teksa e konsideron të pavlefshme provën që merret duke cënuar një normë themelore të procedimit, që garanton pikërisht këtë të drejtë. Ka një lloj dikotomie mes papërdorshmërisë dhe pavlefshmërisë së provës, ngaqë e para është e pakorrigjueshme dhe ngrihet edhe *ex officio*, ndërsa e dyta korrigjohet dhe nuk i shtrin pasojat mbi provat e tjera, që lidhen juridikisht dhe kronologjikisht me të (*shih nenin 243.1 të LOPJ*).

Norma që vendos ligji në fjalë për papërdorshmërinë është e natyrës së përgjithshme. Kështu që, rast pas rasti, duhet të identifikohet e drejta e shkelur dhe rëndësia e saj në raport me provën dhe raportin e kësaj të fundit me provueshmërinë e fakteve në proces. Pra, përsëri vijmë tek rregulli i drejtpeshimit të interesave, tek i ashtuquajtur i “*parim i proporcionalitetit*”. Zbatimi i këtij parimi duhet të adresojë dy probleme: *së pari*, a kemi cënim të një të drejte themelore të mbrojtur nga Kushtetuta dhe, *së dyti*, ky cënim a përbën një dhunim të së drejtës, në kuptimin e vërtetë të fjalës⁴²³. Nëse këto dy pyetje marrin përgjigje pozitive, nuk ka shumë hapësirë që të diskutohet mundësia që prova të mos përjashtohet nga procesi, ngaqë, b.f.j., është e rëndësishme për të provuar fakte të caktuara. Në doktrinë diskutohet problemi i përdorshmërisë së provës së marrë në kundërshtim me të drejtat themelore, në rastin kur ajo shkon në favor të të akuzuarit.

Gjithsesi, duhet theksuar se, fillimisht, ndonëse e pranonte mundësinë e drejtpeshimit, jurisprudenca përgjithësisht i përjashtonte provat e marra në shkelje të të drejtave themelore. Me kalimin e kohës, me një vendim të vitit 2003, Gjykata Kushtetuese arriti të pohojë se prova e marrë në shkelje të të drejtave themelore mund të përdoret, në rastin kur organi hetimor vepron në mirëbesim⁴²⁴. Edhe jurisprudenca, merr në konsideratë rëndësinë e shkeljes dhe, nëse konstaton se prova është e domosdoshme për vërtetimin e fakteve, mund ta zbatojë sanksionin e korrigjueshëm të pavlefshmërisë, në vend të atij të papërdorshmërisë së provës.

Në sistemin spanjoll pranohet koncepti i papërdorshmërisë së prejardhur. Por, duke filluar nga viti 1998, jurisprudenca e *Tribunal Constitucional* e ka kufizuar shumë sferën e zbatimit të papërdorshmërisë së prejardhur, duke iu referuar një gjykimi empirik të mbështetur tek rregullat e përvojës, i cili duhet të mbajë parasysh një numër elementesh, ndër të cilat rëndësinë e shkeljes, vlerën e rezultatit provues dhe nevojën për të mbrojtur të drejtën e dhunuar⁴²⁵.

⁴²² *Po aty*, faqe 399.

⁴²³ *Po aty*, faqe 403.

⁴²⁴ Trib. Const., sent. 10 febrario 2003, n. 22 (RTC 2003, 22); *po aty*, faqe 406-407.

⁴²⁵ Trib. Const., sent. 24 ottobre 2005, n. 259; shih www.boe.es; referuar nga Conti Carlotta, *vep. e cit.*, faqe 412.

Duke përfunduar, mund të themi se e drejta spanjolle e procedurës penale e lidh papërdorshmërinë e provës vetëm me dhunimin e të drejtave themelore kushtetuese, duke ia nënshtruar rastin një gjykimi me natyrë drejtpeshuese. Pra, nuk ka ndonjë automatizëm përjashtimi, por gjykim të mbështetur në rregullat e përvojës dhe të racionalizmit logjik, duke vënë në peshore interesin e mbrojtur dhe rëndësinë e provës për të provuar fakte në procesin penal.

d. Sistemi francez. – Në sistemin francez të procedurës penale instituti i papërdorshmërisë nuk ekziston; ai nuk është parashikuar në të drejtën pozitive, gjithashtu, nuk trajtohet as në doktrinë ose në jurisprudencën e gjykatave⁴²⁶.

Sikundër kemi përmendur (*shih § 1.3.1*), veset e akteve të procedurës, përfshi edhe mjetet e kërkimit të provës në fazën e hetimeve, i nënshtrohen sanksionit të pavlefshmërisë; këtë aspekt të procedurës franceze e kemi trajtuar në hollësi.

Pavarësisht mungesës së një norme të shprehur që sanksionon papërdorshmërisë e provave të marra në kundërshtim me ligjin, parimi i ligjshmërisë së provës trajtohet nga doktrina (*edhe nga jurisprudenca*)⁴²⁷ krahas parimit të lirisë së saj, si dy anë të së njëjtës medalje. Ligjshmëria e provës konsiderohet një problem thelbësor për shtetin e së drejtës. Doktrina thekson se prova penale nuk mund të pranohet nëse administrimi i saj nuk respekton ligjshmërinë e marrjes, e cila gjen shprehjen e vet në parimet e përgjithshme të *ligjshmërisë materiale* dhe të *ligjshmërisë formale*⁴²⁸.

Respektimi i *ligjshmërisë materiale* nënkupton:

- i) respektimin e dinjitetit njerëzor, duke përjashtuar në mënyrë absolute përdorimin e çdo forme shtrëngimi ose dhune (*fizike apo morale*) në marrjen e provave;
- ii) respektimin e ndershmërisë (*luajalitetit*) në kërkimin e provave, duke përjashtuar administrimin e provave me metoda të pandershme, në rrugë mashtrimi, apo përmes dredhisë dhe hileve, ku përfshihet edhe provokimi policor;
- iii) respektimin e lirisë së informimit, duke siguruar sekretin e burimit të informacionit të siguruar nga gazetarët.

Respektimi i *ligjshmërisë formale* nënkupton rregullat e përgjithshme të zbatueshme në temën e provave, sikurse janë:

- i) respektimi i të drejtës së mbrojtjes të personit, ku përfshihen jo vetëm e drejta e mbrojtjes me avokat, por edhe e drejta për të mos u vetëakuzuar, procesi i drejtë ligjor (*procès équitable*) dhe barazia e armëve, edhe në temën e provave;
- ii) respektimi i intimitetit të jetës private.

Respektimi i ligjshmërisë formale nënkupton, gjithashtu, zbatimin e disa rregullave, të paracaktuara posaçërisht për autoritetet publike, në temën e marrjes dhe administrimit të provave, që kanë të bëjnë me mënyrën se si dokumentohet marrja e tyre, rregullat që parashikon procedura penale lidhur me aktet që kryen policia gjyqësore, me nismën e vet, ose mbi bazën e një delegimi, gjatë fazës së hetimeve, duke përfshirë edhe vëzhgimet dhe metodat e posaçme të hetimeve (*p.sh., infiltrimi në përbërje të grupeve kriminale*), aktet e kryera nga gjyqtari hetues, etj.

⁴²⁶ Conti Carlotta, *vep. e cit.*, faqe 413.

⁴²⁷ Guinchard Serge, Buisson Jacques, *Procédure pénale*, 4^e édition, Litec, 2008, faqe 422.

⁴²⁸ *Ibidem*, faqe 431.

Fusha e zbatimit të ligjshmërisë formale në Francë u zgjerua pas ratifikimit të KEDNJ-së, e cila është bërë pjesë e së drejtës së brendshme.

Procedura penale e Francës njih institutin e pavlefshmërisë së prejardhur; anulimi i aktit të vesuar nga akti i mëparshëm nul është në diskrecionin e Dhomës së Hetimeve (*chambre de l'instruction*)⁴²⁹. Duke qenë se instituti i papërdorshmërisë nuk njihet në të drejtën pozitive, nuk mund të flitet as për papërdorshmërinë e prejardhur. Por, marrja e provës trajtohet në kuadrin e përgjithshëm të ligjshmërisë së saj, formale dhe materiale, në përputhje me normat që vendos Konventa e KE për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

e. Sistemi italian. – Sistemi italian i papërdorshmërisë së provave të marra *contra legem* materializohet në të drejtën pozitive me kodifikimin e institutit të papërdorshmërisë, në nenin 191 të Kodit të Procedurës Penale të vitit 1988⁴³⁰, sipas të njëjtit formulim të pranuar në nenin 151.4 të Kodit tonë. Doktrina⁴³¹ pohon se papërdorshmëria është një lloj pavlefshmërie që nuk godet aktin në vetvete, por “*vlerën (e tij) provuese*”.

Pra, papërdorshmëria është një institut autonom që godet provën, i cili nuk lejon korrigjimin (*akti është kryer duke ushtruar një pushtet të ndaluar nga ligji*), ribërjen e aktit të vesuar (*për shkak të vetë strukturës logjikës të vesit që konsiston në cënimin e një ndalimi të provës*) dhe as transmetimin e vesit në aktet pasuese që varen prej tij⁴³² (*rregulli i vendosur për pavlefshmërinë e prejardhur nuk vlen për papërdorshmërinë*)⁴³³.

Në rastet kur prova merret në shkelje të ndalimeve të shprehura nga ligji, papërdorshmëria e saj ka natyrë absolute (e ashtuquajtura “*papërdorshmëri patologjike*”); në rastet e kësaj natyre përfshihet edhe e ashtuquajtura “*prova jokushtetuese*” (la prova incostituzionale), një nocion i përpunuar nga doktrina dhe jurisprudenca, por që ende përbën objekt debati⁴³⁴.

Disa norma të Kodit italian parashikojnë edhe papërdorshmërinë e një kategorie aktesh që, ndonëse nuk janë kryer në shkelje të ndalimeve ligjore për marrjen e provave, janë kryer para debatit gjyqësor ndaj, si rregull, nuk vlejnë për të provuar fakte (*gjykata vendos vetëm mbi bazën e provave të administruara në seancë gjyqësore*). Në raste të tilla, papërdorshmëria ka natyrë relative (e ashtuquajtura “*papërdorshmëri fiziologjike*”), pasi prova duhet të merret në debatin gjyqësor (me përjashtime të caktuara). Për shembull, deklaratimet e dhëna nga personi që ka dijeni mbi faktet apo rrethanat objekt hetimi, si rregull, nuk mund të përdoren nëse personi nuk pyetet në cilësinë e dëshmitarit. Pikërisht, kjo lloj papërdorshmërie, synon të garantojë parimin e

⁴²⁹ Shih nenin 174, paragrafi II dhe 206, paragrafi III të KPP.

⁴³⁰ Art. 191 – 1. “Le prove acquisite in violazione dei divieti stabiliti dalla legge non possono essere utilizzate. 2. L’inutilizzabilità è rilevabile anche d’ufficio in ogni stato e grado del procedimento.” [1. Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. 2. Papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të procedimit. – përkthimi ynë]. Tek: Borrelli G., etj. (a cura di), Codice di procedura penale operativo, Annotato con la dottrina e giurisprudenza, VI Edizione, Edizioni giuridiche Simone, 2010.

⁴³¹ Tonini Paolo, La prova penale, Quarta edizione, CEDAM 2000, faqe 58.

⁴³² Sipas teorisë të Franco Cordero-s, e shprehur me lokucionin “*male captum, bene retentum*”, të përpunuar tek “*Tre studi sulle prove penali*”, Milano 1963, faqe 159. *Cituar nga*: Tonini Paolo, Manuale di procedura penale, 8° edizione, Giuffrè editore, 2007, faqe 186.

⁴³³ Angeletti Rizziero (*a cura di*), Le invalidità in generale delle prove e dei mezzi di prova, G. Giappichelli editore, Torino, 2005, faqe 121.

⁴³⁴ Tonini Paolo, po aty, faqe 186.

kontradiktoritetit⁴³⁵, sepse provat e marra gjatë hetimeve paraprake, që nuk janë marrë ligjërisht gjatë shqyrtimit gjyqësor (*përfashto rastet e leximeve të lejueshme*), nuk mund të përdoren për të themeluar vendimin, ngaqë nuk i janë nënshtruar debatit të palëve në proces.

Pra, në pikëpamje të rregullimit të ligjshmërisë së provës, modeli italian është një sistem i shtangët (*natyrisht, edhe sistemi ynë i ndërtuar mbi këtë model*), por jurisprudenca ka orientuar zgjidhje më elastike, të cilat nisen nga parimi i drejtpeshimit të interesave. Tipik dhe shumë interesant është rasti i shtruar për zgjidhje lidhur me vlerën provuese të sendit të sekuestruar pas një kontrolli të paligjshëm. Duke qenë se kjo çështje na intereson posaçërisht për argumentin që po studjojmë, po e trajtojmë më hollësisht në vijim.

Duke qenë se qëllimi i kontrollimeve është gjetja e sendeve që duhet t'i nënshtrohen sekuestrimit dhe duke qenë se akti i sekuestrimit pason në kohë atë të kontrollit, nuk ka dyshim se të dy aktet kanë një lidhje ndërvartësie mes njëri-tjetrit. Në doktrinën dhe jurisprudencën italiane është ngritur problemi se në çfarë mase një kontroll i paligjshëm veson sekuestrimin e realizuar si pasojë e tij⁴³⁶, edhe në rrafshin e papërdorshmërisë së provës të siguruar pas një kontrolli të pavlefshëm.

Sipas një vendimi të Kasacionit të vitit 1994⁴³⁷, midis kontrollit dhe sekuestrimit nuk mund të ngrihet asnjë lloj lidhjeje shkak-pasojë, pasi pushteti për të sekuestruar sende objektivisht të sekuestrueshme, nuk varet fare nga modalitetet e gjetjes së tyre; për rrjedhojë është e pamundur të ngrihet pavlefshmëria e prejardhur e sekuestrimit të kryer në vijim të një kontrolli të pavlefshëm.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit saktësuan, më pas⁴³⁸, parimin sipas të cilit kontrolli dhe sekuestrimi janë jo vetëm akte në lidhje thjesht kohore mes tyre, por mbi të gjitha akte të lidhura në pikëpamje funksionale dhe juridike. Duke iu referuar vendimeve të mëparshme, Kolegjet arritën në përfundimin se “...raporti mes kontrollit dhe sekuestrimit nuk mund të reduktohet thjesht në një raport kronologjik...; kontrolli jo vetëm i paraprin sekuestrimit, por përfaqëson mjetin juridik që bën të mundur shkuarjen tek sekuestrimi.”⁴³⁹, madje theksuan se është vetë ligji procedural që e pranon raportin funksional mes kontrollit dhe sekuestrimit që e pason atë. Po ashtu, duke iu referuar faktit se sekuestrimi është një procedurë marrjeje e provës, e cila lë gjurmë në cënimin e një të drejte subjektive, kjo e drejtë, për shkak të rëndësisë së saj në profilin kushtetues, e përligj sanksionin radikal të papërdorshmërisë së provës së marrë, në çdo fazë të procedimit.

Në të njëjtin vendim, Kolegjet e Bashkuara synuan të kufizojnë pasojat e një papërdorshmërie të prejardhur, duke përjashtuar të gjitha rastet kur sekuestrimi ka të bëjë me “*prova materiale ose sende që lidhen më veprën penale*”, pasi në këtë rast ai është një “*akt i detyrueshëm*” (it. atto dovuto). Sipas Gjykatës, pa mohuar raportin funksional kontroll-sekuestrim dhe mundësinë e shtrirjes së vesit procedural nga njëri akt tek tjetri, në raste të kësaj natyre nuk ka shumë rëndësi mënyra se si u arrit tek prova materiale, pasi një mosveprim i oficerit/agjentit të policisë gjyqësore do ta përballte atë me rrezikun për t'u ndjekur penalisht për mospërbushje të një akti që i diktohet nga arsye të detyrës apo shërbimit. Kolegjet e Bashkuara theksuan se “... kur plotësohen kushtet që parasheh neni 253, paragrafi 1 i KPP [neni përkatës 208, paragrafi 1 i Kodit tonë – shënimi ynë], aspektet instrumentale të kërkimit, ..., nuk mund të

⁴³⁵ *Ibidem*, faqe 187.

⁴³⁶ Di Geronimo Paolo, *vep. e cit.*, faqe 319.

⁴³⁷ Cass. sez.II, 5 dicembre 1994, Prizinzano, C.E.D. Cass. 201267; tek Di Geronimo Paolo, *ibidem*.

⁴³⁸ Cass., Sez. Un., 27.3.1996, n. 5021, Sala; tek Di Geronimo Paolo, *ibidem*, faqe 319-321.

⁴³⁹ *Ibidem* [shqipërimi ynë].

*paralizojnë kurrë përmbushjen e një detyrimi juridik, që legjitimohet nga vetë sistemi procedural dhe që përlligjet në mënyrë racionale dhe të kënaqshme në kërkesat që oficeri i policisë gjyqësore nuk mund t'i shmanget detyrimeve të lidhura pazgjidhshmërisht me statusin e tij, ciladoqoftë situata – e ligjshme apo jo – ku atij i duhet të veprojë.*⁴⁴⁰

Vendimi i mësipërm është kritikuar nga doktrina në disa aspekte të tij, sidomos lidhur me pasojat e pavlefshmërisë së kontrollit dhe mundësinë e mbajtjes së sekuestros, por edhe lidhur me faktin se, në terrenin praktik, nuk është e qartë cila do të ishte ajo situatë kur si rezultat i kontrollit të vesuar nuk do të sekuestroheshin prova materiale apo sende të lidhura me krimin⁴⁴¹.

Lipset të shtojmë se një sërë vendimesh të Kasacionit, të marra pas vendimit *Sala*, i mëshojnë idesë se parimi sipas të cilit pavlefshmëria e një akti i bën të pavlefshme aktet e mëpasme që varen nga ai që është deklaruar i pavlefshëm, nuk gjen zbatim në lëmin e papërdorshmërisë, pasi kjo e fundit ka të bëjë me provat e marra në mënyrë të paligjshme dhe jo me provat marrja e të cilave është bërë në mënyrë autonome dhe në format e lejuara nga ligji⁴⁴².

4.5.3 Disa përfundime.

Nga studimi i sistemeve të ndryshme të procedurës penale, në lidhje me ligjshmërinë e provës, vërejmë se rregulli i përjashtimit të provave të ndaluara nga ligji ndërtohet mbi bazën e *kritereve të ngurta* (Italia, natyrisht edhe vendi ynë, që ka marrë modelin italian), ose mbi bazën e *kritereve elastike*, kur për zbatimin e tij gjykatat u drejtohen parimeve të përgjithshme të mishëruara në Kushtetutë, ose në KEDNJ-në (tipike për Gjermaninë, Spanjën dhe Shtetet e Bashkuara). Edhe në Angli, në kushtet e mungesës së një Kushtetute të shkruar, u takon gjykatave që, duke zbatuar parimet e përgjithshme të *common law-t*, të vendosin rast pas rasti, nëse prova do të pranohet apo do të përjashtohet për shkak të paligjshmërisë së marrjes së saj. E drejta e brendshme, me ratifikimin e Konventës së sipërpërmendur, e afron sistemin anglez me sistemet që mbështeten në Kushtetuta të shkruara.

Sikundër vërejnë studjuesit⁴⁴³, në këto vende, rregullat e përjashtimit përbëjnë “*të drejtën kushtetuese të zbatuar*” drejtpërsëdrejti në procesin penal; ndaj janë gjykatat kushtetuese që përmes jurisprudencës së tyre japin një kontribut të dorës së parë në zhvillimin e teorisë së papërdorshmërisë. Për këtë arsye, zgjidhja e rasteve mbështetet në parimin e drejtpeshimit të interesave në proces: garantimin e një procesi të drejtë dhe të ndershëm, por edhe kënaqjen e nevojave për efektivitetin e ndjekjes penale.

Në sistemin italian, sikurse shënuam më sipër, në tekstin e Kodit, që e rregullon papërdorshmërinë në mënyrë taksative, parimi i ligjshmërisë së provës është formuluar në mënyrë të ngurtë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se gjykatat nuk i referohen parimit të drejtpeshimit të interesave, në dritën e zhvillimit të institutit në vendet e tjera. Sikundër e përmendëm, Kolegjet e Bashkuara të Kasacionit orientuan një zgjidhje elastike; edhe në rast të një kontrollimi të paligjshëm, sendet e gjetura duhet të sekuestrohen nëse përbëjnë *corpora delicti*. Por, kontrollimet pikërisht këtë qëllim kanë, të gjenden prova materiale ose sende të

⁴⁴⁰ *Ibidem* [shqipërimi ynë].

⁴⁴¹ “Në fakt, duke qenë e vështirë të supozohet rast i një kontrolli të paligjshëm që çon në sekuestrimin e sendeve të ndryshme nga provat materiale apo sendet e lidhura me veprën, duke pasur parasysh edhe gjerësinë që tentohet t'i jepet këtij koncepti, nuk është e qartë cila do të jetë konkretisht fusha e zbatimit të orientimeve të dhëna në këtë vendim.”, Vessichelli Maria, “*Osservazioni a Cass. Sez. Un., 17.3.1996, Sala*”, Cassazione Penale, 1996, faqe 3274 [shqipërimi ynë]. Referencë nga: Di Geronimo Paolo, *vep. e cit.*, faqe 322.

⁴⁴² Spangher Giorgio, *vep. e cit.*, faqe 804.

⁴⁴³ Conti Carlotta, *vep. e cit.*, faqe 422.

lidhura me krimin, ndaj zgjidhja e dhënë mund të shtrihet pothuajse në të gjitha rastet e praktikës hetimore.

Për t'u larguar nga zgjidhja e ngurtë që ofron Kodi italian, pavarësisht zhvillimeve doktrinare dhe jurisprudenciale në drejtim të teorisë së drejtpeshimit të interesave, ka studjues që e shohin zgjidhjen në kodifikimin e rasteve të korrigjimit të papërdorshmërisë⁴⁴⁴, në analogji me korrigjimin e pavlefshmërive relative.

Është momenti t'i rikthehemi sistemit tonë dhe zgjidhjeve të ofruara deri tani nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë. Përmendëm që, nisur nga taksativiteti i formulimit të institutit të papërdorshmërisë në nenin 151.4 të KPP, kolegji ka parapëlqyer zgjidhjen e përjashtimit automatik të provave të sekuestruara si rezultat i kontroleve të paligjshme, duke i dhënë jetë një koncepti të pakodifikuar të papërdorshmërisë së prejardhur. Kjo zgjidhje nuk shkon në drejtimin që orienton jurisprudenca e huaj, evropiane dhe amerikane, e cila parapëlqen zgjidhjet e ekuilibruara, mbi bazën e parimit të drejtpeshimit të interesave në lojë, duke analizuar, rast pas rasti, normën e cënuar dhe ndikimin e këtij cënimi në vlefshmërinë e provës së marrë dhe mundësinë e përdorimit të saj në proces.

Mendojmë se ka ardhur koha që jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, të lëvizë qartë në drejtim të jurisprudencës evropiane, tashmë e kolauduar edhe nga vendimet e Gjykatës së Strasburgut, përmes një vendimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara. Mund të studjohen edhe ndërhyrje ligjvënëse, me qëllim zbutjen e shtangësisë së normës dhe parashikimin e rasteve të korrigjimit të papërdorshmërisë relative (fiziologjike), por natyrisht, kjo kërkon një studim të kujdesshëm, çka do të thotë se kjo mund të jetë një zgjidhje e perspektivës. Kështu që, më e udhës dhe më efektive do të ishte një ndërhyrje unifikuese, mbase e kolauduar edhe nga Gjykata Kushtetuese, në përqasje me nenin 32.2 të Kushtetutës dhe me vlerat e tjera të mbrojtura prej saj.

⁴⁴⁴ *Ibidem*, faqe 431.

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

1) Nga studimi i pavlefshmërisë së akteve në KPP rezulton se ligjvënësi ka normuar një sistem binar të pavlefshmërive, të ndarë në mënyrë të prerë në pavlefshmëri absolute dhe relative, duke shmangur kategorinë ndërmjetëse të pavlefshmërive të llojit të tretë. Kjo zgjedhje padyshim i jep qartësi sistemit duke e bërë atë më të kuptueshëm, por i bën më të shtangëta rastet e pavlefshmërive absolute, me pasoja në kohëzgjatjen e procesit penal.

2) Studimi i jurisprudencës mbi 10-vjeçare të Gjykatës së Lartë na çon në përfundimin se praktika gjyqësore luhatet midis pranimit dhe mospranimit të natyrës taksative të pavlefshmërive, qëndrim që krijon jo vetëm paqartësi të subjekteve të procedimit penal, por edhe pasiguri në zbatimin e normave të së drejtës. Interpretimet e zgjeruara, madje disa herë kundërthënëse të jurisprudencës së gjykatave lidhur me këtë temë, në kushtet e mungesës të një Vendimi Unifikues, diktojnë nevojën që, në përputhje me modelin italian, në seksionin përkatës të Kodit të shtohet një dispozitë, sipas këtij formulimi: *“Mosrespektimi i dispozitave të caktuara për aktet e procedimit përbën shkak pavlefshmërie vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.”*

3) Në praktikën gjyqësore, për rastet që lidhen me interpretimin e nenit 15.1 të KPP vërehen paqartësi, të cilat kanë diktuar ndërhyrjen e Gjykatës Kushtetuese, në disa raste. Zgjidhjet korrektuese të Gjykatës Kushtetuese kanë qenë të sakta, ndonëse në disa vendime të fundit jurisprudenca e saj pasqyron paqëndrueshmëri parimore, duke e humbur koherencën e krijuar ndër vite.

Në nenin 15.1 të Kodit sugjerohet të bëhet një shtesë me natyrë saktësuese, e cila të normojë ndalimin që gjyqtari, i cili ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në njërin shkallë të procedimit, të jetë i penguar të marrë pjesë edhe në rishikimin e vendimit (*nenet 449 e vijues të Kodit*).

4) Ushtrimi i ndjekjes penale, sipas ligjit tonë procedural, mund dhe duhet të konceptohet si një proces dinamik që fillon me ngritjen e akuzës dhe materializohet me vendimin e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq; ai nuk normohet nga ligji si një çast i vetëm, i mirëpërcaktuar. Në praktikën gjyqësore, ende ka moskuptime të rënda të rolit dhe funksioneve të gjyqtarit në sistem, duke i veshur atij pushtete akuzuese të cilat nuk i gëzon më. Vërehet, gjithashtu, se edhe lidhur me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes konstatohen paqartësi të kolegjit penal për të bërë dallimin parimor që ndan kriteret dalluese të dy llojeve të pavlefshmërive që parashikon ligji ynë i procedurës.

5) Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë lidhur me interpretimin e nenit 15.2 të KPP është kundërthënëse dhe nuk ka mundur të krijojë praktikë gjyqësore për shkak të luhatjes së zgjidhjeve të dhëna në vite. Gjithashtu, kjo jurisprudencë në rastin e sigurimit të provës na rezultoi e pasaktë, e paargumentuar, hera-herës kundërthënëse dhe bie ndesh me këndvështrimin e

GJEDNJ-së. Besojmë se ndodhemi në situatën kur zgjidhja duhet të jepet përmes një Vendimi Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara.

6) Detyrimi i thirrjes së të pandehurit në gjykim, mosrespektimi i të cilit sanksionohet me pavlefshmëri absolute, synon të kënaqë dy parime themelore të procedurës: sigurimin e kontradiktoritetit në proces dhe garantimin e të drejtës së të pandehurit për t'u vetëmbrojtur nga akuzat që rëndojnë mbi të. Megjithëse jurisprudenca e Gjykatës së Lartë lidhur me këtë temë ka qenë e saktë dhe koherente, ndonëse ka edhe një Vendim Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, shumë vendime të gjykatave vazhdojnë të prishen për shkelje që lidhen me thirrjen dhe njoftimin e të pandehurit për t'u paraqitur në proces. Mendojmë se, duke mbajtur parasysh edhe qartësinë e normës, kjo dukuri duhet të lidhet me moskuptimin e parimeve që synojnë të mbrojnë dispozitat për thirrjen e të pandehurit në procesin që zhvillohet kundër tij dhe rëndësinë e tyre në procesin penal modern.

7) Lidhur me rastet e pranisë së detyrueshme të mbrojtësit në proces, vitet e fundit, në procesin e kontrollit kushtetues të vendimeve të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese ka krijuar një jurisprudencë të qartë dhe solide, veçanërisht lidhur me detyrueshmërinë e sigurimit të pranisë së mbrojtësit gjatë gjyimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Prania e mbrojtjes në vendimet e Gjykatës Kushtetuese është vështruar e lidhur ngushtë me kënaqjen e parimeve të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, të cilat sigurojnë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

8) Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka theksuar, gjithashtu, rëndësinë e mbrojtjes së detyrueshme në rastin e të pandehurit të mitur dhe të kontrollit të rregullsisë së njoftimit për palën mbrojtëse, si dhe rëndësinë e mbrojtjes teknike efektive gjatë gjyimit për çështje të ligjit. Gjykata Kushtetuese ka tërhequr vëmendjen për rëndësinë e mbrojtjes së të pandehurit, që në fazën e hetimeve paraprake, jo vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, duke theksuar prerë se mospërmbushja e kësaj procedure do të shkaktoje pavlefshmëri absolute të akteve dhe gjithë procesi do të bëhej i parregullt për shkak të cënimit të parimit kushtetues të mbrojtjes.

9) Lidhur me temën e njoftimit të të pandehurit për të marrë pjesë në procesin kundër tij, si dhe kriteret e gjyimit *in absentia*, praktika gjyqësore ka shfaqur paqartësi të dukshme, të cilat janë korrigjuar me ndërhyrjet e qarta të Gjykatës Kushtetuese, në frymën e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut. Të drejtën e të pandehurit për të marrë pjesë në gjykimin e zhvilluar kundër tij Gjykata Evropiane i sheh në këndvështrimin e nenit 6 të Konventës (*e drejta për një proces të rregullt*), si shkelje e procesit të rregullt ligjor, për shkak të dhunimit të së drejtës të mbrojtjes.

10) Kodi ynë normon që pavlefshmëritë relative të ngrihen nga pala e interesuar, duke ia nënshtruar ato një regjimi që parashikon *kufizime lidhur me çastin kohor të ngritjes dhe mundësinë e korrigjimit*, në dallim nga pavlefshmëritë e natyrës absolute, të cilat ngrihen kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit dhe që karakterizohen nga pakorrigjueshmëria e tyre. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë paraqit paqartësi të dukshme lidhur

me konceptin që përcakton neni 128.2 i KPP-së, fakt që dikton nevojën e një Vendimi Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara.

11) Shënojmë që ligjvënësi nuk ka mundur të ndërtojë mekanizmin e duhur procedural që do të shmangte krijimin e pavlefshmërive të qëllimshme, me synimin për të konsumuar afate procedurale në interes të palës që vepron *in mala fides*. Nuk ka arsye që pavlefshmëria relative të mund të ngrihet edhe nga pala që nuk ka asnjë interes; një parashikim i tillë sugjerojmë se duhet të shtohet në përmbajtje të nenit 129 të Kodit. Gjithashtu, në jurisprudencën e kolegjit penal të Gjykatës së Lartë vërehet mungesë orientimi dhe paqartësi lidhur me problemin parimor të afateve që Kodi i disiplinon vetëm kur palët synojnë të ngrejnë pavlefshmëri të natyrës relative, ndërkohë që, për ngritjen e pavlefshmërisë absolute nuk mund të ketë afate. Zgjidhja që sugjerojmë do të ishte një Vendim Unifikues, i cili do të sqaronte gjithë paqartësitë dhe kundërshtitë e jurisprudencës në vite.

12) Kodi parashikon rastet e korigjimit të pavlefshmërisë *me pranimin e pasojave të aktit dhe për shkak të arritjes së qëllimit të tij*. Neni 130.1, shkronja “b”, paraqit vështirësi interpretimi për shkak të përkthimit të gabuar të dispozitës analoge të Kodit italian (*neni përkatës 183.1/b*). Shqipërimi i saktë, i cili sqaron njëherësh edhe kuptimin e kësaj dispozite, do të ishte: “*kur pala ka përfitur nga e drejta, ushtrimin e së cilës akti i pavlefshëm synon të mbrojë*”. Me fjalë të tjera, pala nuk mund të përfitojë për të ngritur një pavlefshmëri të natyrës relative, kur të drejtën që synon të mbrojë dispozita e cënuar, në interes të palës, ajo ka mundur ta realizojë, korigjim që duhet të gjejë pasqyrim në tekstin e Kodit.

13) Papërdorshmëria është *ves* i aktit procedural me natyrë provuese dhe, njëkohësisht, *sanksion* procedural autonom që godet provën që buron prej tij. Ajo ka natyrë absolute, ndaj nuk mund të korigjohet në rastin e provave të marra në kundërshtim me ligjin (*rastet e papërdorshmërisë patologjike*). Në disa raste të tjera, papërdorshmëria ka natyrë relative (*rastet e papërdorshmërisë fiziologjike*).

14) Për çështjen e raportit mes aktit të pavlefshëm dhe përdorshmërisë së provës që buron prej tij, zgjidhjet e propozuara ndër vite nga Gjykata e Lartë, na rezultojnë se janë rrjedhojë e një interpretimi tepër të ngushtë të normës. Shtrirjen automatike të pavlefshmërisë relative të aktit në asgjësimin e vlerës së tij provuese, përmes mekanizmit të përjashtimit për shkak papërdorshmërie, nuk e shohim si zgjidhje realiste dhe në përputhje me vullnetin e ligjvënësit. Kemi vërejtur rastet e posaçme të mëposhtme:

14.1 Interpretimi i ngushtë që i ka bërë kolegji penal, ndër vite, bashkëjetesës mes pavlefshmërisë së aktit dhe papërdorshmërisë së dëshmisë, në rastin e parashikuar nga neni 158 i KPP, nuk është bindës dhe duket se e ka zgjeruar sferën e veprimit të sanksioneve të pakorigjueshme, me pasojë kohëzgjatjen e papërligjur të procesit. Ndryshimi i jurisprudencës së kolegjit vitet e fundit, është një zgjidhje juridike e drejtë, e cila mund të konsolidohet me anën e një Vendimi Unifikues;

14.2 Mosrespektimi i procedurës për marrjen e provave jashtë shtetit përmes letërporosisë shkakton papërdorshmëri të provës së marrë, e cila mund të jetë e natyrës patologjike ose fiziologjike dhe, në këtë aspekt duket se jurisprudenca e kolegjit penal ka orientuar zgjidhje të drejta;

14.3 Mendojmë se Vendimi Unifikues Nr.2, datë 29.1.2003, është i paorientuar drejt lidhur me të drejtat që i pandehuri lëshon në rastet kur zgjedh gjykimin e shkurtuar, duke cënuar parimin e ligjshmërisë në formimin e provës dhe funksionin garantues të gjyqtarit. I pandehuri vërtet heq dorë nga garancitë e gjykimit kontradiktor, por fajësia e tij në përfundim të ritit të shkurtuar, nuk mund të mbështetet në akte absolutisht të pavlefshme, as mbi prova patologjike të papërdorshme, të cilat gjykata ka detyrimin t'i konstatojë edhe kryesisht. Nisur nga ky këndvështrim, jurisprudenca jonë ka nevojë të ngutshme të lëvizë në drejtimin e duhur.

Një ndërhyrje në Kod, sipas modelit italian, për të ndryshuar regjimin e gjykimit të shkurtuar, gjykojmë se do të ishte një zgjidhje e mirë;

14.4 Papërdorshmëria e provave të marra jashtë afatit të hetimeve paraprake është papërdorshmëri relative, e natyrës fiziologjike; ajo nuk mund të barazohet tërësisht me provat e marra *contra legem* që sanksionon neni 151.4 i KPP. Si e tillë ajo nuk ngrihet kryesisht, por mbi kërkesë të palës që akuzuar, që cënohet nga vlera e saj provuese, ndaj sanksioni nuk vepron në rastet kur i pandehuri zgjedh gjykimin e shkurtuar. Doktrina dhe jurisprudenca e huaj, që i referohet të njëjtit rregullim ligjor, ka qenë shumë e qartë në drejtim të regjimit të papërdorshmërisë së provave të marra pas përfundimit të afatit të hetimeve paraprake. Ndaj, vijmë në përfundimin se praktika gjyqësore ka pasur luhajtje dhe zgjidhje gati kontroverse, sa i takon natyrës së vesit dhe pasojave që shkakton përfundimi i afatit të hetimeve në lidhje me provat. Një Vendim Unifikues mund t'i jepte zgjidhje të arsyeshme edhe këtij problemi;

14.5 Lidhur me regjistrimin e bisedës nga njëri prej të pranishmëve, megjithë luhajtjet në vite, kolegji penal duket se është orientuar drejt, duke theksuar se normat ndaluese për përgjimin e telekomunikimeve dhe formave të tjera të komunikimit, nuk shtrihen mbi privatët, por mbi organet shtetërore. Regjistrimi i bisedës nga njëri prej të pranishmëve është plotësisht i përdorshëm si provë.

15) Nisur nga taksativiteti i formulimit të institutit të papërdorshërisë në nenin 151.4 të KPP, jurisprudenca e Gjykatës së Lartë ka parapëlqyer zgjidhjen e përjashtimit automatik të provave të sekuestruara si rezultat i kontrolleve të paligjshme, duke i dhënë jetë një koncepti të pakodifikuar të papërdorshërisë së prejardhur. Kjo zgjidhje nuk shkon në drejtimin që orienton jurisprudenca e huaj, evropiane dhe amerikane, e cila parapëlqen zgjidhjet e ekuilibruara, mbi bazën e parimit të drejtpeshimit të interesave në lojë, duke analizuar, rast pas rasti, normën e cënuar dhe ndikimin e këtij cënimi në vlefshmërinë e provës së marrë dhe mundësinë e përdorimit të saj në proces.

Mendojmë se ka ardhur koha që jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, të lëvizë qartë në drejtim të jurisprudencës evropiane, tashmë e kolauduar edhe nga vendimet e Gjykatës së Strasburgut, përmes një Vendimi Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara.

BIBLIOGRAFIA

DOKTRINË

1. BORRELLI, G., etj. (*a cura di*), Codice di procedura penale operativo, Annotato con la dottrina e giurisprudenza, VI Edizione, Edizioni giuridiche Simone, 2010.
2. BOULOC Bernard, MATSOPOULOU Haritini, Droit pénal général et procédure pénale, 16^e édition, Edition Dalloz, 2006.
3. CAVINI Sofia, “*La pubblica accusa nei diversi stati dell’Unione Europea: breve rapporto sui principi vigenti in Italia, Francia, Germania, Gran Bretagna e Spagna*”, Rivista Italiana di Diritto Pubblico Comunitario, 1999.
4. CONSO Giovanni, GREVI Vittorio, etj., Compendio di procedura penale, 3^a edizione, CEDAM, 2006.
5. CONTI Carlotta, Accertamento del fatto ed inutilizzabilità nel processo penale, CEDAM, 2007.
6. CONTI Carlotta, “*Il volto attuale dell’inutilizzabilità: derive sostanzialistiche e bussola della legalità*”, Diritto Penale e Processo, 2010, n.7.
7. DI GERONIMO Paolo, La nullità degli atti nel processo penale, Fatto & Diritto, Collana diretta da Paolo Cendon, Giuffrè Editore, 2006.
8. GAITO Alfredo (*diretto da*), La prova penale, Wolters Kluwer, 2008.
9. GJIKA Grigor, “*Ligjeshmëria dhe forma procedurale – penale*”, Drejtësia Popullore, Nr. 6, nëndor-dhjetor 1960.
10. GJIKA Grigor, “*Respektimi i normave procedurale penale, kërkesë themelore e drejtësisë sonë socialiste*”, Drejtësia Popullore, Nr. 2, prill – qershor 1976.
11. GUINCHARD Serge, BUISSON Jacques, Procédure pénale, 4^e édition, Litec, 2008.
12. ISLAMI Halim, Hoxha Artan, PANDA Ilir, Procedura penale, Komentar, Botimet Morava, Tiranë 2003.
13. Leksione të së drejtës procedurale penale, Dispensë, UT Fakulteti i Drejtësisë, 1992, faqe 4.
14. LIGORI Henrik, «*Një vendim, tri probleme*», Jeta Juridike, nr. 2, dhjetor 2007.
15. LIGORI Henrik, “*Legalità dell’intercettazioni e il principio della sovranità dello Stato*”, Cultura e Diritti, numero 2, aprile-giugno 2014, Pisa University Press.
16. LOZZI Gilberto, Lezioni di procedura penale, G. Giappichelli Editore, 3^o edizione, Torino 2000.
17. MILLER Frank W., DAWSON Robert O., DIX George E., PARNAS Raymond I., Criminal Justice Administration, *Cases and Materials*, Third Edition, The Foundation Press, INC., 1986.
18. MURPHY Peter, Murphy për provën, Botim i UET Press, 2010.
19. OMARI Luan, Parime dhe institucione të së drejtës publike, Shtëpia botuese Elena Gjika, Tiranë, 1993.

20. RASSAT Michèle-Laure, Procédure pénale, 2^e édition refondue, PUF (*Presses Universitaires de France*), mars 1995.
21. ANGELETTI Rizziero (*a cura di*), Le invalidità in generale delle prove e dei mezzi di prova, G. Giappichelli editore, Torino, 2005.
22. RUGGIERI Francesca, “*Lineamenti del sistema processuale penale tedesco*”, Relazione all’incontro di studio “Acquisizione e valutazione della prova nei Paesi dell’Unione Europea”, Roma, 22.03.2000. Konsultuar në internet në adresën: www.apinter.csm.it.
23. SPANGHER Giorgio, (*diretto da*), Atti processuali penali, patologie, sanzioni, rimedi, Wolters Kluwer, 2013.
24. SPANGHER Giorgio, La pratica del processo penale, Epub, Volume III, CEDAM 2014.
25. TONINI Paolo, La prova penale, Quarta edizione, CEDAM 2000.
26. TONINI Paolo, Manuale di procedura penale, 8^o Edizione, Giuffrè Editore, 2007.
27. TONINI Paolo, Manuale di procedura penale, 11^a Edizione, Giuffrè Editore, 2010.

KODE DHE TEKSTE LIGJORE

1. Code Allémand de Procédure Pénale (texte applicable au 1^{er} janvier 1999), *Traduit de l’allemand* par Raymond LEGEAIS - Président honoraire de l’Université de Poitiers, Professeur émérite de la Faculté de droit de Poitiers. Konsultuar në internet në adresën : www.juriscope.org/publications/documents/index.htm
2. Code de Procédure Pénale Espagnol (texte applicable au juin 1999), traduit par Raymond LEGEAIS - Doyen honoraire de la Faculté de Droit et des Sciences sociales de l’Université de Poitiers. Konsultuar në internet në adresën : www.juriscope.org/publications/documents/index.htm
3. Code de Procédure Pénale, 47^e édition, Dalloz, 2006.
4. Codice di Procedura Penale e leggi complementari, a cura di Giustino Gatti, Edizioni Simone, 1994.
5. Codul de Procedura Penala, konsultuar në internet, në adresën www.dreptonline.ro/legislatie/_codul_de_procedura_penala.php. Dispozitat e cituara janë shqipëruar nga Ilda STEFA.
6. Il codice di procedura penale, annotato con la giurisprudenza, a cura di Piermaria Corso, 3^a edizione, CELT CasaEditriceLaTribuna, 2004
7. Kodi i Procedurës Penale i R.P. të Shqipërisë, Botim i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë 1959
8. Kodi i Procedurës Penale i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.6069, datë 25.12.1979, Tiranë 1980
9. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, botim i QPZ, tetor 2004
10. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore, kopje elektronike në formatin pdf.
11. Kushtetuta dhe materiale shpjeguese, botim i QAKAPP, dhjetor 1998

12. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, konsultuar në internet në adresën www.unhchr.ch/french/html

13. Procedura penale otomane në fuqi në Shqipëri (*përktim*), kopje e shaptilografuar, Biblioteka Kombëtare Tiranë, S123/10C.

VENDIME TË KOLEGJEVE TË BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

1. Vendim Nr. 1, datë 15.02.2001, Lika
2. Vendim Nr.2, datë 29.1.2003, Zaharia, etj.
3. Vendim Nr.3, datë 19.5.2009, Ngluci, etj.
4. Vendim Nr.5, datë 15.9.2009, Dredha, etj.
5. Vendimi Nr.2, datë 24.1.2011, Salis, etj.
6. Vendimi Nr.7, datë 14.10.2011, Kumbara

VENDIME TË KOLEGJIT PENAL TË GJYKATËS SË LARTË

1. Nr. 189 i Vendimit, datë 18.4.2003, Sulaj
2. Nr.430 i Vendimit, datë 16.7.2003, Dashi, etj.
3. Nr. 540 i Vendimit, datë 22.10.2003, Regolli, etj.

4. Nr. 67 i Vendimit, datë 4.2.2004, Allamani
5. Nr. 77 i Vendimit, datë 11.2.2004, Kazazi
6. Nr. 76 i Vendimit, datë 11.2.2004, Ndregjoni

7. Nr. 2 i Vendimit, datë 12.1.2005, Muçi, etj.)
8. Nr. 536 i Vendimit, datë 13.7.2005, Hila
9. Nr. 663 i Vendimit, datë 5.10.2005, Kulla
10. Nr. 738 i Vendimit, datë 24.10.2005, Brija, etj.

11. Nr. 237 i Vendimit, datë 15.3.2006, Bytyçi
12. Nr. 238 i Vendimit, datë 26.4.2006, Hoxhallari
13. Nr. 239 i Vendimit, datë 26.4.2006, Pasholli, etj.
14. Nr. 325 i Vendimit, datë 24.5.2006, Daja, etj.
15. Nr. 350 i Vendimit, datë 31.5.2006 (ankim kundër vendimit të pushimit të çështjes, neni 329.1 i KPP)
16. Nr. 483 i Vendimit, datë 13.9.2006, Bitanji
17. Nr. 523 i Vendimit, datë 27.9.2006, Muhameti, etj.
18. Nr. 689 i Vendimit, datë 22.11.2006, Rrushi
19. Nr. 629 i Vendimit, datë 8.11.2006, Demiri
20. Nr. 769 i Vendimit, datë 20.12.2006, Kabashi, etj.

21. Nr.24 i Vendimit, datë 31.1.2007, Vathi, etj.
22. Nr.64 i Vendimit, datë 14.2.2007, Rustemi
23. Nr.87 i Vendimit, datë 21.2.2007, Misiri
24. Nr.145 i Vendimit, datë 28.2.2007, Kodra, etj.
25. Nr.282 i Vendimit, datë 15.3.2007, Shahini, etj.

26. Nr.418 i Vendimit, datë 18.4.2007, Buçpapaj
27. Nr.424 i Vendimit, datë 25.4.2007, Bytyçi
28. Nr.532 i Vendimit, datë 20.6.2007, Zefi, etj.
29. Nr.533 i Vendimit, datë 20.6.2007, Kuçi, etj.
30. Nr.544 i Vendimit, datë 29.6.2007, Hasani, etj.
31. Nr.612 i Vendimit, datë 3.10.2007, Hyseni
32. Nr.688 i Vendimit, datë 13.10.2007, Hoxha
33. Nr.686 i Vendimit, datë 31.10.2007, Koçi
34. Nr.702 i Vendimit, datë 31.10.2007, Ahmetaj, etj.
35. Nr.764 i Vendimit, datë 19.12.2007, Spahiu

36. Nr.48 i Vendimit, datë 16.1.2008, Xhemaj, etj.
37. Nr.60 i Vendimit, datë 06.2.2008, Shemuni
38. Nr.61 i Vendimit, datë 06.2.2008, Bajramaj
39. Nr.59 i Vendimit, datë 06.2.2008, Metko
40. Nr.96 i Vendimit, datë 20.2.2008, Rakaj.
41. Nr.100 i Vendimit, datë 20.2.2008, Sula
42. Nr.103 i Vendimit, datë 27.2.2008, Zuna, etj.
43. Nr.104 i Vendimit, datë 27.2.2008, Hyskaj, etj.
44. Nr.158 i Vendimit, datë 2.4.2008, Sina
45. Nr.162 i Vendimit, datë 2.4.2008, Gosturani
46. Nr.115 i Vendimit, datë 21.5.2008, Sokolaj
47. Nr.280 i Vendimit, datë 4.6.2008, Zeneli, etj.
48. Nr.289 i Vendimit, datë 4.6.2008, Pashaj
49. Nr.292 i Vendimit, datë 11.6.2008, Bedinaj
50. Nr.00-2008-102 i Vendimit (555), datë 3.12.2008, Kane, etj.
51. Nr.309 i Vendimit, datë 17.12.2008, Sefa
52. Nr.00-2008-116 i Vendimit (570), datë 17.12.2008, Dibra
53. Nr.571 i Vendimit, datë 17.12.2008, Peqini, etj.

54. Nr.11 i Vendimit, datë 4.2.2009, Duda
55. Nr.00-2009-20 i Vendimit (14), datë 4.2.2009, Shira
56. Nr.49 i Vendimit, datë 18.2.2009, Rexha, etj.
57. Nr.92 i Vendimit, datë 4.3.2009, Laze, etj.
58. Nr.100 i Vendimit, datë 18.3.2009, Bushgjokaj
59. Nr.130 i Vendimit, datë 25.3.2009, Derri, etj.
60. Nr.147 i Vendimit, datë 1.4.2009, Brushtulli
61. Nr.440 i Vendimit, datë 30.9.2009, Ejupi
62. Nr.00-2009-499 i Vendimit (637), datë 25.11.2009, Prenga, etj.

63. Nr.00-2010-126 i Vendimit (87), datë 3.2.2010, Daja, etj.
64. Nr.00-2010-266 i Vendimit (135), datë 17.2.2010, Lleshi
65. Nr.00-2010-195 i Vendimit (138), datë 17.2.2010, Islami
66. Nr.00-2010-267 i Vendimit (140), datë 17.2.2010, Yzeiraj, etj.
67. Nr.00-2010-266 i Vendimit (135), datë 17.2.2010, Lleshi
68. Nr.00-2013-533 i Vendimit (93), datë 22.2.2010, Kraho

69. Nr.00-2010-392 i Vendimit (185), datë 3.3.2010, Nikolla
70. Nr.00-2010-353 i Vendimit (187), datë 3.3.2010, Rustemi, etj.
71. Nr.00-2010-399 i Vendimit (220), datë 10.3.2010, Bajramaj
72. Nr.00-2010-818 i Vendimit (246), datë 17.3.2010, Qato
73. Nr.00-2010-396 i Vendimit 252, datë 17.3.2010, Ndreu
74. Nr.00-2010-592 i Vendimit (13), datë 7.4.2010, Kamberaj
75. Nr.00-2010-543 i Vendimit (14), datë 7.4.2010, Bushaj
76. Nr.00-2010-481 i Vendimit (15), datë 7.4.2010, Ismaili
77. Nr.00-2010-503 i Vendimit (331), datë 7.4.2010, Halilaj, etj.
78. Nr.00-2010-516 i Vendimit (342), datë 14.4.2010, Vathaj
79. Nr.00-2010-531 i Vendimit (367), datë 21.4.2010, Kroji
80. Nr.00-2010-1027 i Vendimit (431), datë 7.5.2010, Fejzulla, etj.
81. Nr.00-2010-1028 i Vendimit (557), datë 2.6.2010, Hoxha, etj.
82. Nr.00-2010-1084 i Vendimit (558), datë 2.6.2010, Çelhaka
83. Nr.00-2010-863 i Vendimit (559), datë 2.6.2010, Etemaj, etj.
84. Nr.00-2010-1063 i Vendimit (22), datë 7.7.2010, Pali
85. Nr.00-2010-1222 i Vendimi (809), datë 15.9.2010, Meta
86. Nr.00-2010-1180 i Vendimit (841), datë 22.9.2010, Bylyku
87. Nr.00-2010-1208 i Vendimit (843), 22.9.2010, Abdi
88. Nr.00-2010-1201 i Vendimit (851), datë 29.9.2010, Stragu
89. Nr.00-2010-1210 i Vendimit (32), datë 29.9.2010, Kreka

90. Nr.00-2011-87 i Vendimit (7), datë 12.1.2011; Shtëmbari
91. Nr.00-2011-208 i Vendimit (37), datë 16.2.2011, Sukaj
92. Nr.00-2011-216 i Vendimit (42), datë 23.2.2011, Lepuri
93. Nr.00-2011-429 i Vendimit (65), datë 28.4.2011, Lleshi
94. Nr.00-2011-437 i Vendimit (66), datë 28.4.2011, Qosja
95. Nr.00-2011-465 i Vendimit (78), datë 25.5.2011, Sulaj
96. Nr.00-2011-549 i Vendimit (79), datë 8.6.2011, Dushku, etj.
97. Nr.00-2011-489 i Vendimit (81), datë 8.6.2011, Disha
98. Nr.00-2011-590 i Vendimit (92), datë 6.7.2011, Harizaj
99. Nr.00-2011-584 i Vendimit (95), datë 13.7.2011, Tinaj, etj.
100. Nr.00-2011-550 i Vendimit (98), datë 13.7.2011, Lushaj
101. Nr.00-2011-579 i Vendimit (101), datë 13.7.2011, Shahini, etj.
102. Nr.00-2011-788 i Vendimit (112), datë 21.9.2011, Zeqo
103. Nr.00-2011-1075 i Vendimit (120), datë 5.10.2011, Milla
104. Nr.00-2011-859 i Vendimit (125), datë 6.10.2011, Aliu
105. Nr.00-2011-1141 i Vendimit (149), datë 10.11.2011, Qejvanaj
106. Nr.00-2011-1106 i Vendimit, datë 27.12.2011, Pllumbi, etj.

107. Nr.8 i Vendimit, datë 12.1.2012, Meta, juridiksion fillestar
108. Nr.00-2012-938 i Vendimit (197), datë 4.7.2012, Shehaj
109. Nr.00-2012-941 i Vendimit (201), datë 5.7.2012, Brahimaj, etj.
110. Nr.00-2012-1117 i Vendimit (224), datë 12.09.2012, Shtëpani, etj.
111. Nr.00-2012-1261 i Vendimit (232), datë 19.9.2012, Lika
112. Nr.00-2012-1404 i Vendimit (242), datë 26.9.2012, Reçi

113. Nr.00-2012-1333 i Vendimit (251), datë 03.10.2012, Kacolli
114. Nr.00-2012-1330 i Vendimit (253) datë 10.10.2012, Baçi
115. Nr.00-2012-1463 i Vendimit (255), datë 10.10.2012, Balliu, Xhezo
116. Nr.00-2012-1457 i Vendimit (268), datë 17.10.2012, Gjokeja
117. Nr.00-2012-1403 i Vendimit (277), datë 17.10.2012; Hasani
118. Nr.00-2012-1582 i Vendimit (299), datë 14.11.2012, Kaçi
119. Nr.00-2012-1624 i Vendimit (312), datë 21.11.2012, Dogan
120. Nr.00-2012-1569 i Vendimit (313), datë 21.11.2012, Hasani, etj.
121. Nr.00-2012-1685 i Vendimit (329), datë 5.12.2012, Shquti

122. Nr.00-2013-413 i Vendimit (1), datë 9.1.2013, Mallkuçi
123. Nr.00-2013-247 i Vendimit (35), datë 31.1.2013, Kurti, etj.
124. Nr.00-2013-388 i Vendimit (50), datë 3.2.2013, Rabeli, etj.
125. Nr.00-2013-780 i Vendimit (37), datë 6.2.2013, Avduli
126. Nr.00-2013-337 i Vendimit (38), datë 6.2.13, Limushaj, etj.
127. Nr.00-2013-389 i Vendimit (44), datë 6.2.2013, kundërshtim i vendimit të

pushimit

128. Nr.00-2013-385 i Vendimit (47), datë 13.2.2013, ankues prokuroria
129. Nr.00-2013-575 i Vendimit (64), 27.2.2013, Agushi
130. Nr.00-2013-665 i Vendimit (70), datë 27.2.2013, Kelmendi
131. Nr.00-2013-531 i Vendimit (82), datë 6.3.2013, Quni
132. Nr.00-2013-530 i Vendimit (91), datë 13.3.2013, Merkaj
133. Nr.00-2013-632 i Vendimit (101), datë 20.3.2013, Medinaj
134. Nr.00-2013-702 i Vendimit (117), datë 3.4.2013, Doda
135. Nr.00-2013-871 i Vendimit (119), datë 3.4.2013, Goxhaj
136. Nr.00-2013-651 i Vendimit (123), datë 10.4.2013, Hodaj
137. Nr.00-2013-864 i Vendimit (124), 10.4.2013, Toshi
138. Nr.00-2013-1001 i Vendimit (128), datë 10.4.2013, Zaimi
139. Nr.00-2013-856 i Vendimit (129), 17.4.2013, Piperi
140. Nr.00-2013-867 i Vendimit (135), datë 17.4.2013, Kamaj
141. Nr.00-2013-977 i Vendimit (178), datë 29.5.2013, Kelmendi
142. Nr.00-2013-1335 i Vendimit (180), datë 29.05.2013, Smajlaj
143. Nr.00-2013-988 i Vendimit (194), datë 12.06.2013, Telushi, etj.
144. Nr.00-2013-1005 i Vendimit (196), datë 12.6.2013, Oruçi
145. Nr.00-2013-1010 i Vendimit (202), datë 12.6.2013, Lulja
146. Nr.00-2013-1117 i Vendimit (217), datë 10.7.2013, Lita, Çejku

147. Nr. 00-2014-811 i Vendimit (86), datë 19.3.2014, Seferi

VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE

1. Vendim nr.27, datë 01.10.2003, Sulaj
2. Vendim nr.7, datë 27.4.2005, Durrësi
3. Vendim nr.13, datë 10.06.2005, Brahimaj
4. Vendim nr.20, datë 10.07.2005, Kurpali
5. Vendim nr.7, datë 19.02.2007, Lala

6. Vendim nr.12, datë 13.04.2007, Elezi, etj.
7. Vendim nr.14, datë 17.04.2007, Koçiu, etj.
8. Vendim nr.38, datë 15.10.2007, Kaçi
9. Vendim nr.3, datë 06.02.2008, gjykata e rrethit gjyqësor Bulqizë
10. Vendim nr.5, datë 04.03.2008, Zeka
11. Vendimi nr. 21, datë 29.04.2010, Meçe
12. Vendim nr.30, datë 17.06.2010, Gjykata e Lartë (Kolegjet e Bashkuara)
13. Vendim nr.38, datë 30.12.2010, Perati
14. Vendim nr.20, datë 22.9.2011, Kota
15. Vendim nr.2, datë 25.1.2012, Bukaçi
16. Vendim nr.18, datë 2.4.2012, Qosja
17. Vendim nr.22, datë 23.4.2012, Balliu
18. Vendim nr.26, datë 8.5.2012, Boriçi
19. Vendim nr.31, datë 17.5.2012, Gjykata e Lartë
20. Vendim nr.33, datë 24.5.2012, Aliaj
21. Vendim nr.3, datë 19.2.2013, Vagenas
22. Vendim nr.8, datë 27.2.2014, Dhima
23. Vendim nr.19, datë 2.4.2014, Beqiraj
24. Vendim nr.70, datë 17.11.2015, Doda

VENDIME TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

1. Vendim nr.227, datë 3.3.2005, Dosti
2. Vendim nr.797, datë 11.7.2005, Dushi, etj.
3. Vendim nr.34, datë 24.1.2006, Toto
4. Vendim nr.897, datë 6.10.2006, Myftari, etj.
5. Vendim Nr. Akti 1623, datë 15.12.2008, kërkues Basha.

VENDIME TË GJYKATËS SË APELIT PËR KRIME TË RËNDA

1. Vendimi nr.28, datë 19.5.2008, Fejzulla, etj.
2. Vendim Nr.27, datë 19.5.2009, E.SH., etj.
3. Vendim Nr.71, datë 17.12.2009, L.SH., etj.

VENDIME TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

1. Çështja **Delcourt c. Belge**, Décision, Strasbourg 17 janvier 1970, Requête n° 2689/1965.
2. Affaire **Hauschildt c. Danemark**, Arrêt, Strasbourg 24 mai 1989, Requête n° 10486/83.
3. Affaire **Poitrinol c. France**, Arrêt, Strasbourg 23 novembre 1993, Requête n° 14032/88.
4. Affaire **Bulut c. Autriche**, Arrêt, Strasbourg, 22 février 1996, Requête n° 17358/90.
5. Affaire **Belziuk c. Pologne**, 45/1997/829/1035, Arrêt, Strasbourg 25 mars 1998.
6. Affaire **Sejdovic c. Italie**, Grande Chambre, Requête n° 56581/00, Arrêt, Strasbourg, 1^{er} mars 2006, <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-72622>.
7. Case of **Stoichkov v. Bulgaria**, Application n° 9808/02, Judgment, Strasbourg, 24 March 2005, Final 24/06/2005, <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-68625>.

8. Affaire **Hu c. Italie**, Requête n° 5941/04, Arrêt, Strasbourg, 25 septembre 2006, définitif 28/12/2006, <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-77068>.
9. Affaire **Asciutto c. Italie**, Requête n° 35795/02, Arrêt, Strasbourg 27 novembre 2007, Définitif 07/07/2008.
10. Çështja **Laska dhe Lika kundër Shqipërisë**, Ankimet nr.12315/04 dhe 17605/04, Strasbourg, 20 prill 2010.
11. Affaire **Abdelali c. France**, Requête n° 43353/07, Arrêt, Strasbourg, 11 octobre 2012, définitif 11/01/2013, <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-113406>.
12. Çështja **Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë**, *Applications nos. 33192/07 and 33194/07*, Former Fourth Section, Strasbourg, 25 June 2013, Final 09/12/2013.

VENDIME TË GJYKATËS ITALIANE TË KASACIONIT

1. Cass. Pen., Sez. VI, vendim i datës 3.6.1993, *De Tommasi*
2. Cass. Pen., Sent. 7.2.1994, n. 196636
3. Cass. Sez. II, 5 dicembre 1994, n. 201267, *Prizinzano*
4. Cass. Sez. Un., 27 marzo 1996, n. 5021, *Sala*
5. Cass. Pen., Sez. II, 8 luglio 1996, n. 6916, *Campanale*
6. Cass. Pen., Sez. V, 21 ottobre 1998, n. 4401 (c.c. 2 luglio 1998), *Assisi ed altri*
7. Cass. pen., Sez. V, vendim 15 luglio 1999, n. 9047 (*udienza del 15 giugno 1999*), *Larini S. ed altri*
8. Cass. Pen., Sent. 12.1.2000, n. 215306
9. Cass. Sez. Un., Sent. 21.6.2000, n.16, *Tammaro*
10. Cass. Pen., Sez. II, 28 febbraio 2002, n. 8392, *Clausi G. ed altro*
11. Cass. Pen., Sez. VI, 20 maggio 2002, n. 11415 (*udienza del 4 marzo 2002*), *Staller Elena Anna*
12. Cass. Sez. Un., Sentenza 28.5.2003, n.11, *Torquasio*
13. Cass. Sez. Un., 27.10.2004, n.119, *Palumbo*
14. Cass. Pen., Sez. I, 31-03-2009 (04-03-2009), n.13972, *B.F. ed altri*
15. Cass. Pen., Sez. VI, sent., (ud.19-01-2011) 11-03-2011, n.10088, *A.L. ed altri*
16. Cass. Pen., Sez. I, sent. 5 luglio 2011, n.816, *Bega ed altri*